<p>2.9. Atyre që kanë mbi 3 hektarë sipërfaqe me vreshta u lejonet edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim;</p> <p>3. Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore për sektorin e rrushit janë të përcaktuara në Shtojcën I Tabela 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p style="text-align: center;">III.VI. SEKTORI I VEZËVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Kriteret e pranueshmërisë</p> <p>1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë:</p> <p>1.1. Aplikuesit për investime në sektorin e vezëve, duhet të dëshmojnë posedimin e së paku 5,000 pulave vojse në prodhimtari aktive;</p> <p>1.2. Aplikuesit që aplikojnë për ndërtimin e fermës së pulave, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj - shiko listën e standardeve minimale kombëtare në udhëzuesin për aplikues;</p>	<p>2.9. Those who have over 3 hectares of vineyards are allowed to apply for the construction of facilities for post-harvest operations, such as refrigeration warehouses, classification machinery, cleaning, packaging.</p> <p>3. Selection criteria for Measure 1 Investments in physical assets in agricultural holdings for the grape sector are defined in Annex I Table 1 of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;">III.VI. EGGS SECTOR</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Eligibility criteria</p> <p>1. Special eligibility criteria:</p> <p>1.1. Applicants for investments in the egg sector must prove possession of at least 5,000 laying hens in active production;</p> <p>1.2. Applicants applying to build a poultry farm must include in their project a manure depot with sufficient capacity for at least 3 months - see the list of minimum national standards in the guide for applicants;</p>	<p>2.9. Onima koji imaju preko 3 hektara vinograda dozvoljeno je da se prijave za izgradnju objekata za posle berbe, kao što su hladnjača, klasifikacione mašine, čišćenje, pakovanje.</p> <p>3. Kriterijumi odabira za meru 1. Investicije u fizička sredstva u poljoprivrednim gazdinstvima za sektor grožđa su definisane u Aneksu I tabele 1 ovog Administrativnog uputstva.</p> <p style="text-align: center;">III.VI. SEKTOR JAJA</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Kriterijumi prihvatljivosti</p> <p>1. Specifični kriterijumi podobnosti:</p> <p>1.1. Podnosioci zahteva za ulaganja u sektor jaja moraju dokazati posedovanje najmanje 5.000 koka nosilja u aktivnoj proizvodnji;</p> <p>1.2. Kandidati koji se prijavljuju za izgradnju živinarske farme moraju u svoj projekat uključiti depo za stajnjak sa dovoljnim kapacitetom za najmanje 3 meseca – videti listu minimalnih nacionalnih standarda u vodiču za podnosiocë prijave;</p>
--	---	--

<p>1.3. Aplikuesit në sektorin e vezëve, me rastin e aplikimit duhet të shënojnë në planin e biznesit kur do të bëjnë ndërrimin e turnusit dhe sa do të zgjasë pauza pa prodhim.</p> <p>1.4. Aplikuesi duhet të dorëzoj edhe faturën e furnizimit të fundit me pula;</p> <p>1.5. Në rast të sëmundjeve të cilat dëmtojnë numër të madh të pulave, duhet të sigurohet vërtetimi i AUV.</p> <p>2. Investimet e pranueshme janë:</p> <p>2.1. Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave dhe dhomave për ruajtjen e vezëve;</p> <p>2.2. Investimet në infrastrukturë të brendshme (sistemi i të ushqyerit, ujë-pirëset dhe pajisje për rregullimin e mikroklimës, pajisje për largimin e plehut, klasifikim të vezëve);</p> <p>2.3. Investimet në kafaze, vetëm sipas standardeve të BE-së;</p> <p>2.4. Ndërtimi dhe renovimi i depove për ruajtjen e ushqimit, përfshirë pajisjet për përgatitje të ushqimit, trajtim, paketim dhe ruajtje të vezëve;</p>	<p>1.3. Applicants in the egg sector, when applying must indicate in the business plan when they will make the change of tournament and how long the break without production will last;</p> <p>1.4. The applicant must also submit the last chicken supply invoice;</p> <p>1.5. In case of diseases which harm a large number of chickens, FVA certification must be provided.</p> <p>2. Eligible investments are:</p> <p>2.1. Construction/renovation/ expansion of stables and egg storage rooms;</p> <p>2.2. Investments in internal infrastructure (feeding system, water-drinkers and equipment for microclimate regulation, equipment for manure removal, egg classification);</p> <p>2.3. Investments in cages, only according to EU standards;</p> <p>2.4. Construction and renovation of food storage depots, including equipment for food preparation, handling, packaging and storage of eggs;</p>	<p>1.3. Kandidati u sektoru jaja, prilikom prijave moraju da navedu u poslovnom planu kada će izvršiti promenu turnusa-garniture i koliko će trajati pauza bez proizvodnje;</p> <p>1.4. Podnosilac zahteva mora dostaviti i poslednju fakturu nabavke sa kokama;</p> <p>1.5. U slučaju bolesti koje štete velikom broju koka, mora se obezbediti AHV potvrda- sertifikat.</p> <p>2. Prihvatljive investicije su:</p> <p>2.1. Izgradnja / renoviranje / proširenje štale i prostorija za skladištenje jaja;</p> <p>2.2. Ulaganja u internu infrastrukturu (sistem za ishranu, pojilice i oprema za regulaciju mikroklimе, oprema za uklanjanje stajnjaka, klasifikacija jaja);</p> <p>2.3. Ulaganja u kaveze, samo po standardima EU-a;</p> <p>2.4. Izgradnja i renoviranje skladišta hrane, uključujući opremu za pripremu hrane, rukovanje, pakovanje i skladištenje jaja;</p>
--	---	--

<p>2.5. Investimet në pajisje për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;</p> <p>2.6. Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik dhe deponimin e tij;</p> <p>2.7. Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës;</p> <p>3. Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore për sektorin e vezëve janë të përcaktuara në Shtojcën I Tabela 2 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI IV</p> <p style="text-align: center;">MASA 3 INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE</p>	<p>2.5. Investments in energy equipment or on-farm energy production from all types of renewable sources;</p> <p>2.6. Investments for cleaning / disposal of manure and its disposal;</p> <p>2.7. Investments for the production of concentrated feed, of whose total capacity, at least 50% will be used for the needs of the farm.</p> <p>3. Selection criteria for Measure 1 Investments in physical assets in agricultural holdings for the egg sector are defined in Annex I Table 1 of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER IV</p> <p style="text-align: center;">MEASURE 3 INVESTMENTS IN PHYSICAL ASSETS IN PROCESSING AND TRADING OF AGRICULTURAL PRODUCTS</p>	<p>2.5. Ulaganja u energetsku opremu ili proizvodnju energije na farmi iz svih vrsta obnovljivih izvora;</p> <p>2.6. Ulaganja u čišćenje/odlaganje stajnjaka i njegovo odlaganje;</p> <p>2.7. Investicije za proizvodnju koncentrovane stočne hrane, čiji će ukupni kapacitet najmanje 50% biti iskorišćen za potrebe farme.</p> <p>3. Kriterijumi odabira za meru 1. Investicije u fizička sredstva u poljoprivrednim gazdinstvima za sektor jaja su definisane u Aneksu I tabele 2 ovog Administrativnog uputstva.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLE IV</p> <p style="text-align: center;">MERA 3 ULAGANJA U FIZIČKOJ IMOVINI U PRERADI I PROMETU POLJOPRIVREDNIH PROIZVODA</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Përfituesit</p> <p>1. Përfituesit përfundimtarë:</p> <p>1.1. Përfitues mund të jenë ndërmarrjet përpunuese të prodhimeve bujqësore të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Beneficiaries</p> <p>1. Final beneficiaries:</p> <p>1.1. Beneficiaries may be agricultural processing enterprises registered with the Kosovo Business Registration Agency</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Korisnici</p> <p>1. Krajnji-konačni korisnici:</p> <p>1.1. Korisnici mogu biti poljoprivredna prerađivačka preduzeća registrovana u Kosovskoj agenciji za registraciju</p>

<p>Bizneseve të Kosovës së paku 5 vite në nën-sektorin përkatës ,dhe të aprovuara/regjistruar nga AUV-i së paku 5 vite para datës së aplikimit.</p> <p>1.2. Ky kriter për Pika grumbulluese/depo është 2 vite i regjistruar nga AUV dhe 2 vite i regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës me aktivitetin përkatës.</p> <p>1.3. Aplikuesi në sektorin e verës, duhet të jenë të regjistruar edhe në Regjistrin e Prodhuesve të Verës në Kosovë.</p> <p>1.4. Aplikuesi nuk mund të përfitoj një projekt nëse është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik dhe Ligjin 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.5. Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë tri (3) vjetëve pas datës së ekzekutimit të pagesës, aq sa zgjatë periudha monitoruese;</p> <p>1.6. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike;</p>	<p>for at least 5 years in the relevant sub-sector, and approved / registered by the FVA at least 5 years before the date of application;</p> <p>1.2. This criterion for collection point / warehouse is 2 years registered by the FVA and 2 years registered with the Kosovo Business Registration Agency with the respective activity;</p> <p>1.3 Applicants in the wine sector must also be registered in the Register of Wine Producers in Kosovo;</p> <p>1.4. The applicant may not benefit from a project if it is contrary to Law No. 06 / L-011 on Prevention of Conflict of Interest in Exercising Public Function and Law 03 / L-149 on Civil Service of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. All beneficiaries of rural development projects are obliged to maintain their investments according to the approved project during three (3) years after the date of execution of the payment, as long as the monitoring period lasts</p> <p>1.6. If it does not maintain the investments, the beneficiary is obliged to return the financed amount of public support;</p>	<p>poslovanja najmanje 5 godina u relevantnom podsektoru, i odobrena/ registrovana od strane AHV najmanje 5 godina pre datuma podnošenja zahteva;</p> <p>1.2. Ovaj kriterijum za sabirno mesto/skladište je 2 godine registrovano od strane AHV-a i 2 godine registrovano u Kosovskoj agenciji za registraciju poslovanja za relevantnu delatnost;</p> <p>1.3 Podnosioci zahteva u sektoru vina takođe moraju biti registrovani u registru proizvođača vina na Kosovu;</p> <p>1.4 Podnosilac zahteva ne može imati koristi od projekta ako je u suprotnosti sa Zakonom br.06/L-011 o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija i Zakonom 03/L-149 za civilnu službu Republike Kosovo;</p> <p>1.5. Svi korisnici projekata ruralnog razvoja dužni su da održavaju svoje investicije u skladu sa odobrenim projektom tokom tri (3) godine nakon datuma izvršenja uplate, sve dok traje period praćenja;</p> <p>1.6. Ukoliko ne održava investicije, korisnik je dužan da vrati finansirani iznos javne podrške;</p>
--	---	---

<p>1.7. Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural pas finalizimit të investimeve duhet të kenë projektin funksional sipas planit të biznesit, PZHR dhe kritereve të këtij Udhezimi Administrativ;</p> <p>1.8. Kërkesa për pagesë refuzohet për projekte të cilat nuk kanë finalizuar ndonjë aktivitet për të cilin është poentuar gjatë procesit të vlerësimit.</p> <p>2. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë</p> <p>Të gjithë aplikuesit e kësaj mase duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës.</p> <p>2.1. Llojet e ndërmarrjeve të përkrahura:</p> <p>Të gjithë aplikuesit e kësaj mase duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës dhe në ARBK. Kjo masë përkrah ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të përcaktuara në bazë të Ligjit NR.04/L-220 Për Investime të huaja , (gazeta Zyrtare Nr1/09 Janar 2014).</p> <p>2.2. Standardet Kombëtare</p> <p>2.2.1. Ndërmarrja duhet të demonstrojë qartë planin e investimeve në biznes plan të cilat do të ndikojnë në zbatimin e</p>	<p>1.7. All beneficiaries of rural development projects after the finalization of investments must have a functional project according to the business plan, RDP and the criteria of this Administrative Instruction;</p> <p>1.8. The request for payment is rejected for projects which have not finalized any activity for which it was scored during the evaluation process.</p> <p>2. Common eligibility criteria</p> <p>All applicants for this measure must be registered in the Farm Register.</p> <p>2.1. Types of supported companies:</p> <p>All applicants for this measure must be registered in the Farm Register and in KBRA. This measure supports small and medium enterprises, according to Law no. 04 / L-220 On Foreign Investments, (Official Gazette No.1 / 09 January 2014).</p> <p>2.2. National standards</p> <p>2.2.1. The enterprise must clearly demonstrate the investment plan in the business plan which will affect the</p>	<p>1.7. Svi korisnici projekata ruralnog razvoja nakon završetka investicija moraju imati funkcionalan projekat prema poslovnom planu, PRR i kriterijumima ovog Administrativnog uputstva;</p> <p>1.8. Zahtev za isplatu se odbija za projekte koji nisu završili nijednu aktivnost za koju je ocenjen tokom procesa ocene-evaluacije.</p> <p>2. Zajednički kriterijumi podobnosti</p> <p>Svi podnosioci zahteva ove mere treba da budu registrovani u registar poljoprivrednih gazdinstava.</p> <p>2.1. Vrste podržanih preduzeća:</p> <p>Svi podnosioci zahteva za ovu meru moraju da budu registrovani u registru poljoprivrednih gazdinstava i u KBRA. Ova mera podržava mala i srednja preduzeća definisana u skladu sa Zakonom br.04/L-220 O stranim ulaganjima, (Službeni list br.1/09. januar 2014.).</p> <p>2.2. Nacionalni standardi</p> <p>2.2.1. Preduzeće mora jasno da demonstrira poslovni plan u investicioni plan koji će uticati na</p>
---	---	--

<p>standardeve të sigurisë së ushqimit dhe uljen e rrezikshmërisë sipas kategorizimeve;</p> <p>2.2.2. Para paraqitjes së kërkesës për pagesë në AZHB, secili projekt duhet të vlerësohet nga AUV nëse janë plotësuar standardet kryesore kombëtare sipas ligjeve në fuqi;</p> <p>2.2.3. Përfituesit së bashku me kërkesën për pagesë dhe dokumente tjera, duhet të sigurojnë Raportin të bashkëngjitur me Listat e kontrollit nga AUV-i që konfirmon se investimi është në përputhje me standardet kombëtare;</p> <p>2.2.4. E gjithë ndërmarrja përfituese në fund të zbatimit duhet të përmbushë standardet kombëtare sipas ligjeve në fuqi;</p> <p>2.2.5. Aplikuesit duhet të kenë Raportin/procesverbalin (jo me të vjetër se gjashtë muaj) të lëshuar nga AUV për gjendjen ekzistuese të operatorit dhe cilat standarde duhet t' i plotësoj;</p> <p>2.2.6. Konform kërkesave të AUV-it për përmirësimin e standardeve në planin e biznesit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të investimeve dhe aktiviteteve të planifikuara;</p>	<p>implementation of food safety standards and reduce risk by categorization;</p> <p>2.2.2. Before submitting a request for payment to ADA, each project must be evaluated by the FVA if the main national standards are met according to applicable laws;</p> <p>2.2.3. Beneficiaries together with the request for payment and other documents, must provide the Report attached to the Checklists by the FVA confirming that the investment is in line with national standards;</p> <p>2.2.4. The entire beneficiary enterprise at the end of implementation must meet national standards according to applicable laws;</p> <p>2.2.5. Applicants must have the Report / minutes (not older than six months) issued by the FVA for the existing situation of the operator and what standards I must meet;</p> <p>2.2.6. In accordance with the requirements of the FVA for the improvement of standards in the business plan should contain a detailed description of investments and planned activities;</p>	<p>primenu standarda bezbednosti hrane i smanjenje rizika prema kategorizacijama;</p> <p>2.2.2. Pre podnošenja zahteva za plaćanje u ARP, svaki projekat mora biti ocenjen od strane AHV-a da li su ispunjeni glavni nacionalni standardi u skladu sa važećim zakonima;</p> <p>2.2.3. Korisnici zajedno sa zahtevom za isplatu i drugim dokumentima, moraju dostaviti Izveštaj priložen uz kontrolne liste od strane AHV koji potvrđuje da je investicija u skladu sa nacionalnim standardima;</p> <p>2.2.4. Celokupno preduzeće korisnik na kraju implementacije mora ispuniti nacionalne standarde u skladu sa važećim zakonima;</p> <p>2.2.5. Podnosioci zahteva moraju imati Izveštaj/zapisnik (ne stariji od šest meseci) izdat od strane AHV-a za postojeće stanje operatera i koje standarde treba da ispuni;</p> <p>2.2.6. U skladu sa zahtevima AHV za unapređenje standarda u biznis planu treba da sadrži detaljan opis investicija i planiranih aktivnosti;</p>
--	---	---

<p>2.2.7. Para kërkesë përfundimtare për pagesë në AZHB, investimi i mbështetur duhet të plotësojë standardet kombëtare relevante në fuqi që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë në punë.</p> <p>2.3. Qëndrueshmëria ekonomike e ndërmarrjes</p> <p>2.3.1. Qëndrueshmëria ekonomike e aplikusit duhet të demonstrohet me anë të një plani biznesi;</p> <p>2.3.2. Të gjithë aplikuesit duhet të paraqesin një plan biznesi, në përputhje me modelin e kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;</p> <p>2.3.3. Aplikuesi duhet të demonstrojë në planin e biznesit qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fund të realizimit të projektit;</p> <p>2.3.4. Ndërmarrja duhet të demonstrojë se ajo mund t'i kryejë detyrimet dhe borxhet rregullisht, pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes;</p> <p>2.3.5. Plani i biznesit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të investimeve dhe aktiviteteve të planifikuara, konform kërkesave të AUV-it për përmirësimin e standardeve;</p>	<p>2.2.7. Prior to the final ADA payment requirement, the supported investment must meet the relevant national standards in force relating to environmental protection, public health, animal welfare and safety at work.</p> <p>2.3. Economic viability of the enterprise</p> <p>2.3.1. The economic viability of the applicant must be demonstrated by means of a business plan;</p> <p>2.3.2. All applicants must submit a business plan, in accordance with the model required by the Agricultural Development Agency;</p> <p>2.3.3. The applicant must demonstrate in the business plan the economic viability of the enterprise at the end of the project;</p> <p>2.3.4. The enterprise must demonstrate that it can perform its obligations and debts regularly, without compromising the normal functioning of the enterprise;</p> <p>2.3.5. The business plan should contain a detailed description of investments and planned activities, in accordance with the requirements of the FVA for the improvement of standards;</p>	<p>2.2.7. Pre konačne prijave za isplatu u ARP, podržana investicija mora da ispuni relevantne nacionalne standarde na snazi koji se odnose na zaštitu životne sredine, javno zdravlje, dobrobit životinja i bezbednost na radu.</p> <p>2.3. Ekonomska održivost preduzeća</p> <p>2.3.1. Ekonomska održivost podnosioca zahteva mora biti dokazana putem poslovnog plana;</p> <p>2.3.2. Svi podnosioci zahteva moraju dostaviti biznis plan, u skladu sa modelom koji zahteva Agencija za razvoj poljoprivrede;</p> <p>2.3.3. Podnosilac prijave mora da pokaže u poslovnom planu ekonomsku održivost preduzeća na kraju realizacije projekta;</p> <p>2.3.4. Preduzeće mora pokazati da može redovno da izvršava svoje obaveze i dugove, bez ugrožavanja normalnog funkcionisanja preduzeća;</p> <p>2.3.5. Poslovni plan treba da sadrži detaljan opis investicija i planiranih aktivnosti, u skladu sa zahtevima AHV za unapređenje standarda;</p>
--	--	---

<p>2.3.6. Plani i biznesit duhet të tregojë se në çfarë mënyre zbatimi i projektit do të çojë në përmirësimin e performancës së përgjithshme të ndërmarrjes agro-shqimore përmes prezantimit të perspektivës së qëndrueshmërisë financiare/ekonomike.</p> <p>2.3.7. Vlerësimi i qëndrueshmërisë financiare / ekonomike dhe perspektiva e vazhdimësisë së investimeve vlerësohet nga AZHB-ja, për të siguruar zgjedhjen e projekteve me cilësi më të lartë për sa i përket qëndrueshmërisë financiare/ ekonomike;</p> <p>2.3.8. Modeli për planin e biznesit përgatitet nga AZHB-ja dhe të do publikohet në web-faqen e Agjencisë dhe MBPZHR-së. Të gjithë aplikuesit duhet të paraqesin një plan biznesi, në përputhje me modelin e kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.</p>	<p>2.3.6. The business plan should show how the project implementation will lead to the improvement of the overall performance of the agri-food enterprise by presenting the perspective of financial / economic sustainability;</p> <p>2.3.7. The assessment of financial / economic viability and the prospect of continued investment is assessed by ADA, to ensure the selection of projects of the highest quality in terms of financial / economic viability;</p> <p>2.3.8. The business plan template is prepared by ADA and will be published on the websites of the Agency and MAFRD. All applicants must submit a business plan, in accordance with the model required by the Agricultural Development Agency.</p>	<p>2.3.6. Poslovni plan treba da pokaže kako će implementacija projekta dovesti do poboljšanja ukupnog učinka poljoprivredno-prehrambenog preduzeća predstavljanjem perspektive finansijske / ekonomske održivosti;</p> <p>2.3.7. Procenu finansijske/ekonomske održivosti i perspektive kontinuiteta ulaganja ocenjuje se od ARP-a, kako bi se obezbedio izbor projekata najvišeg kvaliteta u smislu finansijske/ ekonomske održivosti;</p> <p>2.3.8. Model biznis plana priprema ARP i biće objavljen na sajtovima Agencije i MPŠRR-a. Svi aplikanti moraju dostaviti biznis plan, u skladu sa modelom koji zahteva Agencija za razvoj poljoprivrede.</p>
<p>3. Kriteret tjera të pranueshmërisë</p> <p>3.1. Në rastin e projekteve të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet t'i dorëzojnë:</p> <p>3.1.1. Certifikatën e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi;</p>	<p>3. Other eligibility criteria</p> <p>3.1. In the case of construction/ renovation / expansion projects, applicants upon application must submit:</p> <p>3.1.1. Certificate of ownership (Possession List) of the parcel in which the investment will be made;</p>	<p>3. Drugi kriterijumi podobnosti</p> <p>3.1. U slučaju projekata izgradnje / renoviranja / proširenja, aplikanti prilikom prijave treba dostaviti:</p> <p>3.1.1. Sertifikat - potvrda o vlasništvu (posedovni list) parcele u koju će se investirati;</p>

<p>3.1.2. Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit.</p> <p>3.1.3. Kontrata duhet të përmbajë edhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit për investimin që do të bëhet në tokën ose objektin e tij. Pëlqimi mundet të jetë pjesë e kontratës së qiramarrjes ose i ndarë veçmas;</p> <p>3.1.4. Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;</p> <p>3.1.5. Kopjen e skicave të objektit;</p> <p>3.1.6. Aplikuesi që aplikon në investimet për menaxhimin e mbetjeve dhe menaxhimin e ujrave të shkarkuara në rastin e aplikimit të sjellin projekt ideor me paramasa dhe parallogaritje;</p> <p>3.1.7. Parallogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;</p>	<p>3.1.2. In case the land or object is leased, the notarized lease contract for at least 10 years counting from the year of application;</p> <p>3.1.3. The contract must also contain the consent of the owner (lessor for investment to be made in his land or building. The consent can be part of the lease contract or separate;</p> <p>3.1.4. Copy of the plot plan where the investment will be made;</p> <p>3.1.5. Copy of sketches of the object;</p> <p>3.1.6. The applicant who applies for investments in waste management and wastewater management in the case of application to bring a conceptual design with pre-measures and pre-calculations;</p> <p>3.1.7. Estimate of material costs and foreseen works;</p>	<p>3.1.2. U slučaju da se zemljište ili objekat daju u zakup, overen ugovor o zakupu na najmanje 10 godina računajući od godine podnošenja zahteva;</p> <p>3.1.3. Ugovor takođe mora da sadrži saglasnost vlasnika (zakupodavac za ulaganje u njegovo zemljište ili zgradu). Saglasnost može biti deo ugovora o zakupu ili odvojena;</p> <p>3.1.4. Kopija plana parcele na kojoj će se izvršiti investicija;</p> <p>3.1.5. Kopija skica objekta;</p> <p>3.1.6. Podnosilac zahteva koji aplicira za investicije za upravljanje otpadom i otpadnim vodama u slučaju prijave da donese idejni projekat sa predmerama i predračunima;</p> <p>3.1.7. Predračun troškova materijala i predviđenih radova;</p>
<p>3.1.8. Pëlqimin nga organi kompetent (Komuna) për leje të ndërtimit, në rastet e projekteve të ndërtimit / zgjerimit, por jo në rastet e projekteve të rinovimit;</p>	<p>3.1.8. Consent from the competent body (Municipality) for construction permits, in cases of construction / expansion projects, but not in cases of renovation projects;</p>	<p>3.1.8. Saglasnost nadležnog organa (Opštine) za građevinske dozvole, u slučaju projekata izgradnje/proširenja, ali ne u slučaju projekata renoviranja;</p>

<p>3.1.9. Nëse toka ose ndonjë pronë tjetër në të cilën do të bëhet investimi është në bashkëpronësi aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve edhe kopjet e letërnjoftimeve;</p> <p>3.1.10. Në rast të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit, aplikuesit duhet ta dorëzojnë edhe projektin teknik të planit të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit.</p> <p>3.1.11. Te gjithë aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera ose te rregulluara detyrimet tatimore, tatimin në të ardhura dhe tatimet e tjera të aplikueshme;</p> <p>3.1.12. Toka nën hipotekë nuk është e pranueshme për investim, qoftë në pronësi apo e marrë me qira.</p>	<p>3.1.9. If the land or any other property on which the investment will be made is in joint ownership, the applicant must bring the consent of the co-owners and copies of ID cards;</p> <p>3.1.10. In case of construction / renovation / expansion, applicants must also submit the technical design of the construction / renovation / expansion plan;</p> <p>3.1.11. All applicants must have paid or adjusted tax liabilities, income taxes and other applicable tax;</p> <p>3.1.12. Mortgage land is not eligible for investment, whether owned or leased.</p>	<p>3.1.9. Ukoliko je zemljište ili bilo koja druga imovina na kojoj će se investirati u zajedničkom vlasništvu, podnosilac zahteva mora da donese saglasnost suvlasnika i kopije licne karte;</p> <p>3.1.10. U slučaju izgradnje / renoviranja / proširenja, podnosioci zahteva moraju dostaviti i tehnički projekat plana izgradnje / renoviranja / proširenja;</p> <p>3.1.11. Svi podnosioci zahteva moraju platiti svoje poreske obaveze ili rgulisati, porez na dobit preduzeća i druge primenjive poreze;</p> <p>3.1.12. Zemljište pod hipotekom nije prihvatljivo za ulaganje, bilo da je u vlasništvu ili pod zakup.</p>
<p>4. Para kërkesës për pagesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, përfituesi duhet të dorëzojë:</p> <p>4.1. Lejen për ndërtim nga organi kompetent (Komuna), nuk kërkohet për projektet e rinovimit;</p> <p>4.2. Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse është paraparë me ligj;</p>	<p>4. Whereas, before requesting payment to the Agricultural Development Agency, the beneficiary must submit:</p> <p>4.1. Construction permit from the competent body (Municipality). Permission is not required for renovation projects;</p> <p>4.2. Environmental impact assessment, if provided by law;</p>	<p>4. Dok, pre zahteva za isplatu u Agenciji za razvoj poljoprivrede, korisnik mora da dostavi:</p> <p>4.1. Građevinska dozvola od nadležnog organa (Opštine). Dozvola nije potrebna za projekte renoviranja;</p> <p>4.2. Procena uticaja na životnu sredinu, ako je predviđena po zakonu;</p>

<p>5. Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB-në;</p> <p>5.1. Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2022 nuk bën të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar.</p> <p>5.2. Në rast se përfituesi ka përfunduar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen masat ndëshkimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>5.3. Aplikuesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse nuk e ka përfunduar investimin paraprak. Nëse përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR në 3 vitet e fundit dhe ndodhet në periudhën monitoruese, para nënshkrimit të kontratës së re me AZHB-në duhet të behet një kontroll në mënyrë që të behet verifikimi i projektit të mëparshme. Nëse projekti nuk është mirëmbajtur dhe /ose nuk është funksional nuk mund të lidhet kontrata e re.</p>	<p>5. A new project may not be awarded to the Beneficiary if the previous projects have not been completed in accordance with the contract signed with ADA;</p> <p>5.1. Projects funded by the Rural Development Program 2022 do not have to be funded by the EU Office in Kosovo or any other local or international public donor;</p> <p>5.2. In case the beneficiary has received support for the same project from another donor, he is not given the support or if he has received it, he will be obliged to return the funds received, and the measures will be applied to him punitive in accordance with applicable law;</p> <p>5.3. An applicant may not be granted a new project unless he has completed the prior investment. If the potential beneficiary has previously been a beneficiary of a project from MAFRD in the last 3 years and is in the monitoring period, before signing the new contract with ADA, a check should be made in order to verify the previous project. If the project is not maintained and / or is not functional, a new contract cannot be concluded.</p>	<p>5. Korisniku se ne može dodeliti novi projekat ako prethodni projekti nisu završeni u skladu sa ugovorom potpisanim sa ARP;</p> <p>5.1. Projekti finansirani od strane Programa ruralnog razvoja 2022 ne moraju da budu finansirani od strane Kancelarije EU-a na Kosovu ili bilo kog drugog lokalnog ili međunarodnog javnog donatora;</p> <p>5.2. Ukoliko je korisnik dobio podršku za isti projekat od drugog donatora, neće mu biti data podrška ili ako ju je dobio biće prinuđen da vrati primljena sredstva i prema njemu će se primeniti kaznene mere u skladu sa važećim zakonodavstvom;</p> <p>5.3. Aplikantu se ne može odobriti novi projekat osim ako nije završio prethodnu investiciju. Ukoliko je potencijalni korisnik prethodno bio korisnik projekta iz MPŠRR u poslednje 3 godine i nalazi se u periodu praćenja, pre potpisivanja novog ugovora sa ARP, treba izvršiti proveru da bi se verifikovao prethodni projekat. Ukoliko se projekat ne održava i/ili nije funkcionalan, ne može se zaključiti novi ugovor.</p>
--	---	--

<p>5.4. Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 3 vjet, aq sa zgjatë periudha monitoruese;</p>	<p>5.4. All beneficiaries, who in their business plan have stated that they will create new jobs and for this have earned points during the evaluation, must create them and prove by paying the pension contribution and tax in salary starting at least from the last month before the request for the last payment. Beneficiaries are required to hold these vacancies filled with full-time employees for 3 years, as long as the monitoring period lasts;</p>	<p>5.4. Svi korisnici, koji su u svom poslovnom planu naveli da će otvarati nova radna mesta i za to su zaradili bodove tokom ocenjivanja, moraju ih otvoriti i dokazati uplatom penzijskog doprinosa i poreza na zaradu počev od poslednjeg meseca pre zahtev za poslednju uplatu. Korisnici su dužni da ova slobodna radna mesta budu popunjena zaposlenima sa punim radnim vremenom 3 godine, koliko traje period praćenja;</p>
<p>6. Investimet e përbashkëta te pranueshmerisë</p> <p>6.1. Investimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë përfshirë në Listën e Investimeve për Masën 3.</p> <p>6.2. Ndërtimi / rindërtim / zgjerimi i objekteve;</p> <p>6.3. Blerja e makinerive dhe e pajisjeve të reja, duke përfshirë programe kompjuterike të nevojshme për funksionimin e linjave të prodhimit apo funksioneve të tjera primare që ndërlidhen me aktivitetet kryesore të ndërmarrjes;</p> <p>6.4. Investimet në përpunimin e qumështit, mishit, pemëve dhe të perimeve, si dhe prodhimin të verës, përfshirë edhe investimet e marketingut për promovimin e tyre;</p>	<p>6. Common eligibility investments</p> <p>6.1. Eligible investments are limited to those included in the Investment List for Measure 3.</p> <p>6.2. Construction / reconstruction / expansion of facilities;</p> <p>6.3. Purchase of new machinery and equipment, including software necessary for the operation of production lines or other primary functions related to the main activities of the enterprise;</p> <p>6.4. Investments in the processing of milk, meat, fruits and vegetables, as well as wine production, including marketing investments for their promotion</p>	<p>6. Zajednička prihvatljiva ulaganja</p> <p>5.1 Prihvatljive investicije su ograničene na one koje su uključene na Listu ulaganja za Meru 3.</p> <p>6.2. Izgradnja/rekonstrukcija/proširenje objekata;</p> <p>6.3. Kupovina novih mašina i opreme, uključujući kompjuterski softver neophodan za rad proizvodnih linija ili drugih primarnih funkcija u vezi sa glavnim aktivnostima preduzeća;</p> <p>6.4. Ulaganja u preradu mleka, mesa, voća i povrća, kao i proizvodnju vina, uključujući marketinške investicije za njihovu promociju;</p>

<p>6.5. Shpenzimet e pranueshme të marketingut për të gjitha nën masat e Masës 3 janë: përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosjeve, broshurave, posterëve etj, për promovimin e produkteve, por jo edhe për shpërndarjen e tyre. Po ashtu, shpenzimet e pranueshme të marketingut janë edhe prodhimi i audio dhe video-spotëve promovuese, por jo edhe shpërndarja e tyre mediale;</p>	<p>6.5. Eligible marketing expenses for all sub-measures of Measure 3 are: preparation and printing of catalogs, leaflets, brochures, posters, etc., for the promotion of products, but not for their distribution. Also, eligible marketing expenses are the production of promotional audio and video spots, but not their media distribution;</p>	<p>6.5. Prihvatljivi marketinški troškovi za sve podmere Mere 3 su: priprema i štampanje kataloga, letaka, brošura, postera itd. za promociju proizvoda, ali ne i za njihovu distribuciju. Takođe, prihvatljivi troškovi marketinga su proizvodnja promotivnih audio i video spotova, ali ne i njihova medijska distribucija;</p>
<p>6.6. Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar në 5% të totalit të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se dhjetmijë (10,000) €;</p>	<p>6.6. The maximum value of eligible marketing expenses is limited to 5% of the total eligible expenses, but not more than ten thousand (10,000) €;</p>	<p>6.6. Maksimalna vrednost prihvatljivih troškova marketinga je ograničena na 5% od ukupnih prihvatljivih troškova, ali ne više od deset hiljada (10,000) €;</p>
<p>6.7. Shpenzimet e tjera të ndërlidhura me projektin, siç janë: shpenzimet për arkitekt, për inxhinier dhe shpenzimet për studime parapake, si dhe nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante janë të pranueshme deri në 7% të shpenzimeve të pranueshme por jo më shumë se pesëmbëdhjetmijë (15,000) €, kurse shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit janë të pranueshme deri në 3% të shpenzimeve të pranueshme për projekt, por jo më shumë se pesëmijë (5,000) €;</p>	<p>6.7. Other costs related to the project, such as: costs for architect, engineer and costs for preliminary studies, as well as the issuance of relevant documents and permits are eligible up to 7% of eligible costs but not more than fifteen thousand (15,000) €, while the costs for the preparation of the business plan are eligible up to 3% of the eligible costs for the project, but not more than five thousand (5,000) €;</p>	<p>6.7. Ostali troškovi u vezi sa projektom, kao što su: troškovi za arhitektu, inženjera i troškovi za prethodne studije, kao i izdavanje relevantnih dokumenata i dozvola su prihvatljivi do 7% prihvatljivih troškova ali ne više od petnaest hiljada (15.000) €, dok su troškovi za izradu biznis plana prihvatljivi do 3% prihvatljivih troškova za projekat, ali ne više od pet hiljada (5.000) €;</p>
<p>6.8. Shpenzimet administrative, edhe pse ndodhin para nënshkrimit të kontratës, janë të pranueshme vetëm në qoftë se projekti është përzgjedhur dhe është kontraktuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;</p>	<p>6.8. Administrative costs, although incurred prior to the signing of the contract, are eligible only if the project has been selected and contracted by the Agricultural Development Agency;</p>	<p>6.8 Administrativni troškovi, iako su nastali pre potpisivanja ugovora, prihvatljivi su samo ako je projekat odabran i ugovoren od strane Agencije za razvoj poljoprivrede;</p>

<p>7. Investment në prodhimin e energjisë së ripërtitshme:</p> <p>7.1. Në kuadër të këtij investimi mbështete prodhimi i energjisë elektrike nga burimet ripërtitshme për "vetë-konsum". (d.m.th. kapacitete prodhues i energjisë e huazuar/depozituar në rrjet është mesatarisht e barabartën me energjinë elektrike të shpenzuar gjatë vitit). Kjo justifikohet me faktin se, meqenëse energjia elektrike nuk mund të ruhet, ajo nëse nuk harxhohet, mund të lëshohet në rrjet; rrjeti i energjisë elektrike mund të konceptohet si një vend depozitimi për energjinë elektrike ku futet dhe tërhiqet gjatë vitit në sasi të ngjashme dhe me një ritëm të ndryshëm.</p> <p>7.2. Koncepti i "vetë-konsumit" duhet të kontrollohet në fazën në të cilën paraqitet / vlerësohet një projekt. Investimi konsiderohet i pranueshëm kur kapaciteti (teorik) i energjisë i impiantit të energjisë së ripërtitshme ("investimi") nuk tejkalon 120% të konsumit mesatar prej 3 vjetësh të ndërmarrjes;</p> <p>8. Shkalla e përkrahjes publike</p> <p>8.1. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 30.000 €;</p>	<p>7. Investment in renewable energy production:</p> <p>7.1. This investment supported the production of electricity from renewable sources for "self-consumption". (i.e. the capacity of energy borrowed / stored in the grid is on average equal to the electricity consumed during the year). This is justified by the fact that, since electricity cannot be stored, it can, if not consumed, be released into the grid; The electricity grid can be conceived as a storage site for electricity where it is introduced and withdrawn during the year in similar quantities and at different rates.</p> <p>7.2. The concept of "self-consumption" should be checked at the stage where a project is presented / evaluated. The investment is considered eligible when the (theoretical) energy capacity of the renewable energy plant ("investment") does not exceed 120% of the average 3-year consumption of the enterprise;</p> <p>8. Level of public support</p> <p>8.1. The minimum amount of eligible project costs within this measure is € 30.000;</p>	<p>7. Ulaganje u proizvodnju obnovljive energije:</p> <p>7.1. Ova investicija je podržala proizvodnju električne energije iz obnovljivih izvora za "samopotrošnju". (tj. kapacitet pozajmljene / uskladištene energije u mreži je u proseku jednak utrošenoj električnoj energiji tokom godine). Ovo se opravdava činjenicom da, pošto se električna energija ne može skladištiti, može, ako se ne potroši, pustiti u mrežu; Električna mreža se može zamisliti kao skladište električne energije gde se ona uvodi i povlači tokom godine u sličnim količinama i s jednim drugim ritmom.</p> <p>7.2. Koncept "samopotrošnje" treba proveriti u fazi u kojoj je predstavljen/ocenjen u projektu. Investicija se smatra prihvatljivom kada (teoretski) energetska kapacitet postrojenja za obnovljivu energiju ("investicija") ne prelazi 120% prosečne trogodišnje potrošnje preduzeća;</p> <p>8. Stepen javne podrške</p> <p>8.1. Minimalni iznos prihvatljivih troškova projekta u okviru ove mere je 30.000 €;</p>
---	--	--

<p>8.2. Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 400,000 €;</p> <p>8.3. Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit;</p> <p>8.4. Pagesa për Masën 3 bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm;</p> <p>8.5. Garancioni bankar duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50% të përkrahjes publike;</p> <p>8.6. Garancioni bankar duhet të sigurohet për periudhën kohore deri sa të realizohet pagesa e fundit nga AZHB-ja, respektivisht deri te vendimi i fundit nga komisioni i ankesave. Çdo kërkesë për afat shtesë duhet të mbulohet me garancion bankar.</p> <p>8.7. Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të draft programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2021-2027 për Masën 3 është tetqindmijë (800.000) € për përfitues;</p>	<p>8.2. The maximum value of eligible project costs within this measure is € 400,000;</p> <p>8.3. Public support is 50% of eligible investment costs;</p> <p>8.4. Payment for Measure 3 is made in two installments, the first part of public support in the amount of 50% is made in the form of an advance after signing the contract with the beneficiary, provided the bank guarantee is provided, while the remaining 50%, paid after verifying the completion of the total investment;</p> <p>8.5. The bank guarantee should be provided only for the advance payment of 50% of the public support;</p> <p>8.6. The bank guarantee must be provided for the period of time until the final payment is made by the ADA, respectively until the final decision by the appeals commission. Any request for additional term must be covered by a bank guarantee;</p> <p>8.7. The maximum public assistance for the period of implementation of the program for agriculture and rural development 2021-2027 for Measure 3 is eight hundred thousand (800,000) € per beneficiary;</p>	<p>8.2. Maksimalna vrijednost prihvatljivih troškova projekta u okviru ove mere je 400.000 €;</p> <p>8.3. Javna podrška iznosi 50% prihvatljivih troškova ulaganja;</p> <p>8.4. Plaćanje za Meru 3 se vrši u dve rate, prvi deo javne podrške u iznosu od 50% se vrši u vidu avansa nakon potpisivanja ugovora sa korisnikom, uz obezbedenu bankarsku garanciju, dok se preostalih 50 %, plaća se nakon verifikacije završetka ukupne investicije;</p> <p>8.5. Bankarska garancija treba da se obezbedi samo za akontaciju od 50% javne podrške;</p> <p>8.6. Bankarska garancija mora biti obezbedena za period do konačne isplate od strane ARP, odnosno do konačne odluke žalbene komisije. Svaki zahtev za dodatnim rokom mora biti pokriven bankarskom garancijom;</p> <p>8.7 Maksimalna javna pomoć za period sprovođenja programa za poljoprivredu i ruralni razvoj 2021-2027 za Meru 3 je osamsto hiljada (800.000) € po korisniku;</p>
---	---	--

8.8. Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021 - 2027, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkalojë shumën e përcaktuar në këtë nen.

9. Afati i zbatimit

1. Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është dhjetë (10) muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në.

2. Pas kësaj periudhe, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë.

3. AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti dy (2) muaj, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç është kushtet e papershtatshme klimatike, sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër.

KAPITULLI V

NËN MASAT V.I. SEKTORI I PËRPUNIMIT TË QUMËSHIT, MISHIT DHE THERTORET

8.8. The applicant can apply with several projects during the implementation period of the Program for Agriculture and Rural Development 2021 - 2027, in different years, provided that the previous projects have been successfully completed and the public support does not exceed the amount specified in this article.

9. Deadline for implementation

1. The deadline for the implementation of projects of this measure is ten (10) months from the day of signing the contract with ADA.

2. After this period, the beneficiary has an additional 15 days to prepare the documentation and submit the request for payment.

3. ADA can extend the implementation period for a maximum of two (2) months, if there are constant reasons for this, such as unfavorable climatic conditions, the bringing of any specific machinery from another country.

CHAPTER V

SUB MEASURES V.I. SECTOR OF DAIRY AND MEAT PROCESSING AND SLAUGHTERHOUSE

8.8. Podnosilac prijave može konkurisati sa više projekata tokom perioda implementacije Programa poljoprivrede i ruralnog razvoja 2021 - 2027, u različitim godinama, pod uslovom da su prethodni projekti uspešno završeni i da javna podrška ne prelazi iznos koji je naveden u ovom članu.

9. Rok sprovođenja

1. Rok za realizaciju projekata ove mere je deset (10) meseci od dana potpisivanja ugovora sa ARP.

2. Nakon ovog roka, korisnik ima dodatnih 15 dana da pripremi dokumentaciju i podnese zahtev za isplatu.

3. ARP može produžiti period implementacije za najviše dva (2) meseca, ako za to postoje ubedljivi razlozi, kao što su nepovoljni klimatski uslovi, donošenje bilo koje specifične mašinerije iz druge zemlje.

POGLAVLJE V

POD MERE V.I. SEKTOR PRERADE MLEKA, MESA I KLANICE

<p align="center">Neni 14 Kriteret e pranueshmërisë</p>	<p align="center">Article 14 Eligibility criteria</p>	<p align="center">Član 14 Kriterijumi prihvatljivosti-podobnosti</p>
<p>1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë:</p> <p>1.1. Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me aktivitetin përkatës dhe i aprovuar nga AUV-i së paku 5 vjet para datës së aplikimit.</p> <p>1.2. Aplikuesit e kategorisë “A”, “B” dhe “C” nuk janë të pranueshëm në rast të ndërtimit të objektit të ri, ndërsa janë të pranueshëm në rast të renovimit, zgjerimit të objektit ekzistues dhe investimeve në pajisje.</p> <p>1.3 Aplikuesit e kategorisë “D” janë të pranueshëm vetëm në rast të ndërtimit të objektit të ri dhe mbylljes së objektit ekzistues. Investimet në pajisje/ linja përpunimi për këtë kategori janë të pranueshme nëse në biznes plan prioritet i është dhënë ndërtimit të objektit.</p>	<p>1. Special eligibility criteria:</p> <p>1.1. All applicants must be registered with the Kosovo Business Registration Agency (KBRA) with the relevant activity and approved by the FVA at least 5 years before the application date.</p> <p>1.2. Applicant of the category “A”, “B” and “C” are not eligible in case of construction of new facility, while they are acceptable in case of renovation, expansion of the existing facility and investments in equipment.</p> <p>1.3. Category "D" applicants are eligible only in case of construction of a new facility and closure of an existing facility. Investments in equipment / processing lines for this category are acceptable if in the business plan priority is given to the construction of the facility.</p>	<p>1. Specifični kriterijumi podobnosti:</p> <p>1.1. Svi podnosioci zahteva moraju biti registrovani u Kosovskoj agenciji za registraciju preduzeća (KBRA) sa relevantnom delatnošću i odobreni od strane AHV najmanje 5 godina pre datuma podnošenja zahteva.</p> <p>1.2. Aplikanti kategorije “A”, “B” i “C” ne ispunjavaju uslove u slučaju izgradnje novog objekta, dok ispunjavaju uslove u slučaju renoviranja, proširenja postojećeg objekta i ulaganja u opremu.</p> <p>1.3 Aplikanti kategorije “D” su kvalifikovani samo u slučaju izgradnje novog objekta i zatvaranja postojećeg objekta. Ulaganja u opremu/procesne linije za ovu kategoriju su prihvatljiva ako se u poslovnom planu daje prioritet izgradnji objekta.</p>
<p>2. Investimet e pranueshme</p> <p>2.1 Investimet e pranueshme për nën masën e përpunimit të qumështit:</p> <p>2.1.1. Investimet në ndërtim/rinovim / zgjerim të qumështoreve; (Investimet në</p>	<p>2. Eligible investments</p> <p>2.1. Eligible investments for dairy processing sub measure:</p> <p>2.1.1. Investments in construction / renovation / expansion of dairies;</p>	<p>2. Prihvatljiva ulaganja</p> <p>2.1. Prihvatljive investicije za podmeru prerada mleka:</p> <p>2.1.1. Investicije u izgradnju / renoviranje / proširenje mlekara;</p>

<p>1. Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë:</p> <p>1.1. Shtojca Nr. I Masën 1 - Investimet në Asetet Fizike në Ekonomitë Bujqësore;</p> <p>1.1.1. Tabela 1: Kriteret e përzgjedhjes për prodhimin bimor;</p> <p>1.1.2. Tabela 2: Kriteret e përzgjedhjes për prodhimtarin blegtorale.</p> <p>1.2. Shtojca Nr.II. Masa 3 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore:</p> <p>1.2.1. Tabela 3: Kriteret e përzgjedhjes për të gjitha nën masat e kësaj mase.</p> <p>1.3. Shtojca Nr. III Masa 7 – Divesifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve:</p>	<p>1. Component part of this administrative Instruction is as follow:</p> <p>1.1. Annex No. I Measure 1 – Investments in Physical Assets in Agricultural Holdings:</p> <p>1.1.1. Table 1: Selection criteria for plant production;</p> <p>1.1.2. Table 2: Selection criteria for livestock production.</p> <p>1.2. Annex No. II. Measure 3– Investments in physical assets in processing and trading of agricultural products:</p> <p>1.2.1. Table 3: Selection criteria for all sub measures of this measure .</p> <p>1.3. Annex No. III Measure 7 – Farm Diversification and Business Development:</p>	<p>1. Sastavni deo ovog Administrativnog uputstva su:</p> <p>1.1. Aneks br. I Mera 1 - Ulaganja u fizička sredstva u poljoprivrednim gazdinstvima:</p> <p>1.1.1. Tabela 1: Kriterijumi odabira za biljnu proizvodnju;</p> <p>1.1.2. Tabela 2: Kriterijumi odabira za stočnu proizvodnju.</p> <p>1.2. Aneks br.II. Mera 3 - Ulaganja u fizičku imovinu u preradi i plasmanu poljoprivrednih proizvoda:</p> <p>1.2.1. Tabela 3: Kriterijumi izbora za sve podmere ove mere.</p> <p>1.3. Aneks br. III Mera 7 – Diverzifikacija farmi i razvoj poslovanja:</p>
<p>1.3.1. Tabela 4. Nën Masën Prodhimi i mjaltit;</p> <p>1.3.2. Tabela 5: Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i produkteve jo drusore të malit;</p> <p>1.3.3. Tabela 6: Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare;</p>	<p>1.3.1. Table 4. Sub measure of honey production;</p> <p>1.3.2. Table 5: Collection, processing and promotion of non-wood forests products;</p> <p>1.3.3. Table 6: Processing of agricultural products in house holding;</p>	<p>1.3.1. Tabela 4. U okviru mere Proizvodnja meda;</p> <p>1.3.2. Tabela 5: Sakupljanje, prerada i promocija nedrvnih planinskih proizvoda;</p> <p>1.3.3. Tabela 6: Prerada poljoprivrednih proizvoda u domaćinstvima;</p>

<p>1.3.4. Tabela 7: Aktivitete jo-bujqësore në zona rurale;</p> <p>1.3.5. Tabela 8: Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural;</p> <p>1.3.6. Tabela 9. Akuakultura /Kultivimi i peshkut;</p> <p>1.3.7. Tabela 10. Rritja e shpezëve të fshatit</p> <p style="text-align: center;">Neni 47 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"> Faton Peci Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural</p> <p style="text-align: right;">Datë: <u>22 / 06</u> 2022</p>	<p>1.3.4. Table 7: Non – agricultural activities in rural areas;</p> <p>1.3.5. Table 8: Development and promotion of rural tourism;</p> <p>1.3.6. Table 9. Aquaculture/fish farming;</p> <p>1.3.7. Table 10. Growing the village poultry</p> <p style="text-align: center;">Article 47 Entry into force</p> <p>This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"> Faton Peci Minister of the Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development</p> <p style="text-align: right;">Date: <u>22 / 06</u> 2022</p>	<p>1.3.4. Tabela 7: Napoljoprivredne aktivnosti u ruralnim područjima;</p> <p>1.3.5. Tabela 8: Razvoj i promocija seoskog turizma;</p> <p>1.3.6. Tabela 9. Akvakultura / Uzgoj ribe;</p> <p>1.3.7. Tabela 10. Uzgoj seoske živine</p> <p style="text-align: center;">Član 47 Stupanje na snagu</p> <p>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana od dana objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"> Faton Peci Ministar Ministarstva poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja</p> <p style="text-align: right;">Datum: <u>22 / 06</u> 2022</p>
---	---	---

SHTOJCA I

MASA 1 INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË EKONOMITË BUJQËSORE

Tabela 1. Kriteret e përzgjedhjes për prodhimin bimor

Nr	Lloji i kriterëve	Kategoria	Pikë		
1.	Investimet në rritjen e prodhimit , përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit në fermë. Kapaciteti prodhues: sipërfaqja që do të ngritët. Në rast të investimit në infrastrukturë të pemishtes, depo, ujitje, mbrojtje kundër breshëri dhe / ose makineri, pikët llogariten varësisht prej sipërfaqes ekzistuese ¹ apo asaj që do të ngritët, cila do qoftë më e madhe.	drufrutore	Serra/serra për fidanë		
		≥ 3 ha	manore/rrush	> 0.20 ha	55
		≥ 1 ha - < 3 ha	≥ 0.25 ha - < 0.5 ha	0.10 - 0.20 ha	50
2.	Investimet në zonat malore- ky kriter nuk vlen për aplikuesit për serra.	Investimet në zonat malore	5		
3.	Investimet në prodhim të energjisë së ripërtrishme ²	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtrishme (<i>min. 5% e investimit të pranueshëm</i>). (piket nga ky kriter do të merren sipas vlerësimit të biznesi planit)	10		
4.	Investimet që përfshijnë krijimin e vendeve të punës duke u bazuar në biznes plan.	Vende të punës do të vlerësohen sipas biznes planit, nëse nuk ju përmbahen kërkesave do të sanksionohen me kthim të investimit “çdo vend i krijuar i punës duhet te regjistrohet ne ATK dhe të i paguhet të gjitha kontributet për periudhën monitoruese”.	5		
5.	Aplikuesi apo ekonomia familjare nuk ka përfutuar grant nga MBPZHR në tri vitet e fundit		10		
6.	Pronësia mbi token ³	toka në emër të aplikuesit	10		
7.	Aplikuesi i ri ⁴	Aplikanti është 40 vjeç ose më i ri	3		
8.	Gjinia e fermerit ⁵	Aplikuesi femër	2		
GJITHSEJ			100		

¹ Sipërfaqet ekzistuese të dëshmohet me marrjen e pagesës direkte për këto sipërfaqe në vitin paraprak ose nëse nuk ka marrë pagesa direkte dëshmohet me certifikatën e pronës dhe NIF-in.

² Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtrishme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtrishme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit te kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtrishme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

³ E tër toka përfshir token ku bëhet investimi duhet të jet në emër të aplikuesit në tri vitet e fundit. Krijimi i kushteve artificiale për të marrë pikë paraqet mashtrim dhe do të ndëshkohet sipas nenit 38A, nen-nen-paragrafit, 1.2.3 të Ligjit Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

⁴ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

⁵ Gjinia e fermerit, aplikuesi do të merr piket e këtij kriteri nëse e tër toka përfshir token ku bëhet investimi duhet të jet në emër të aplikuesit në tri vitet e fundit. Krijimi i Kushteve artificiale për të marrë pikë paraqet mashtrim dhe do të ndëshkohet sipas nenit 38A, nen-nen-paragrafit, 1.2.3 të Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

Tabela 2. Kriteret e përzgjedhjes për prodhimin shtazor

Nr	Lloji i kriterëve	Kategoria	Pikë
1.	Investimet në rritjen e prodhimit në përmirësimin e efikasitetit. Lloji i investimit: Në rast të investimit edhe nga pika a) edhe nga pika b), pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të buxhetit të planifikuar në biznes plan.	a) Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i stallës	40
		b) Makineri dhe/ose përmirësimi i infrastrukturës së jashtme depo e plehut, depo e silazhit, depo e sanës	35
2.	Kapaciteti prodhues (numri i kafshëve) pas realizimit të projektit.	Lopë ose viça	10
		Derra	
		Dele/dhi	Pula
		≥ 20 < 70 krerë	≥ 40 < 100
		≥ 150 < 300	≥ 5000 < 50.000
		≥ 70 krerë	≥ 100 krerë
		≥ 300 krerë	≥ 50.000 krerë
3.	Investimet në prodhim të energjisë së ripërtrishme ⁶	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtrit shme (min. 5% e investimit të pranueshëm) piket nga ky kriter do të merren simbas vlerësimit të biznesi planit.	10
4.	Investimet në zonat malore	Investimet në zonat malore	5
5.	Investimet që përfshinë krijimin e vendeve të punës duke u bazuar në biznes plan.	Vendet e punës do të vlerësohen sipas biznes planit, nëse nuk ju përmbahen kërkesave do të sanksionohen me kthim të investimit. “Çdo vend i krijuar i punës duhet të regjistrohet në ATK dhe të i paguhet të gjitha kontributet për periudhën monitoruese”.	5
6.	Aplikuesi apo ekonomia familjare nuk ka përfituar grant nga MBPZHR në tri vitet e fundit		10
7.	Pronësia mbi token ⁷	Toka në emër të aplikuesit.	10
8.	Aplikuesi i ri ⁸	Aplikanti është 40 vjeç ose më i ri	3
9.	Gjinia e fermerit ⁹	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ			100

⁶ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtrishme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtrishme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtrishme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural

⁷ Svo zemljište, uključujući zemljište na kome se investira, mora biti na ime podnosioca zahteva u poslednje tri godine.Stvaranje veštačkih uslova za dobijanje bodova je prevara i biće kažnjeno u skladu sa članom 38A, podčlan-stav, 1.2.3 Zakona br.04/L-090 o izmenama i dopunama zakona br.03/L098 o poljoprivredi i ruralnom razvoju .

⁸ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

SHTOJCA II
MASA 3 INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE
TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE:

Tabela 3 :Kriteret e përzgjedhjes për të gjithë nën masat

Nr	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit	25
2.	Investimet në projekte për përmirësim të pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës (lidhja e kontratave/ të noterizuar) ¹⁰	20
3.	Investimi në prodhimin e energjisë në ndërmarrje nga burimet e ripërtërishme (min. 10% investimit të pranueshëm) ¹¹	20
4.	Investimet që kanë të bëjnë me trajtimin e mbeturinave, pastrimin e ujit dhe/ose shfrytëzimin e produkteve të mbeturinave - ekonomia qarkore	15
5.	Investime që shpijnë në inovacion dhe diversifikim të prodhimit Futja e të paktën dy produkteve të reja	10
6.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 vjetëve të fundit (shih dokumentin: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera nga ATK)	5
7.	Krijimi i vendeve të punës (për çdo punëtor të ri të punësuar nga një pikë por jo më shumë se 5 pikë në total)	5
	GJITHSEJ	100

¹⁰ Investimetet në projekte për të përmirësuar pozitën e fermerëve në zinxhirin e vlerës (lidhja e kontratave/të noterizuara)

a) se paku 80% e lëndës së parë të qumështit e kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;

b) se paku 30% e lëndës së parë e mishit të kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;

c) se paku 80% e lëndës së parë të pemëve, perimeve dhe rrushit të kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor; (këto duhet të dëshmohen përmes kontratave të noterizuara ndërsa prodhimi vetanak i ndërmarrjes dëshmohet me plan biznesi)

(këto duhet të dëshmohen përmes kontratave të noterizuara ndërsa prodhimi vetanak i ndërmarrjes dëshmohet me plan biznesi).

¹¹ Përfituesi që ka paraparë investime në prodhimin e energjisë së ripërtërishme dhe fiton pikë për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe mbajë aktiv për qëllime që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë nga zyrtarët e AZHB-së (ad-hoc ose ex- post) konstatohet që investimet në energji të ripërtërishme nuk janë duke u përdorur ashtu siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligjit Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L 098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

SHTOJCA III
MASA 7 DIVESIFIKIMI I FERMAVE DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE

Tabela 4: Kriteret e përzgjedhjes për nën -masën “Prodhimi i mjaltit

		Kategoritë	Pikët	
1.	Madhësia e fermës në momentin e aplikimit	Numri i koshereve	30 - 60	55
			61 - 150	50
			>150	45
2.	Aplikuesi është i regjistruar si biznes me (kodin e bletarisë)		5	
3.	Adresa / vendbanimi i aplikuesit	Investimi është në zonë malore;	5	
4.	Mbrojtja e mjedisit ¹²	Investimet në energjinë e ripërtritshme;	10	
5.	Siguria e ushqimit	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit;	10	
6.	Punësimi	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit / planit të biznesit;	5	
7.	Gjinia e fermerit ¹³	a) Femra/person fizik së paku 2 vite pronare e fermës ku zhvillohet aktiviteti i “Prodhimtaria e mjaltës” të dëshmohet me NIF; b) Femra /person juridik se paku 2 vite pronare e biznesit “Prodhimtaria e mjaltës”	5	
8.	Aplikuesi i ri ¹⁴	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri;	5	
GJITHSEJ			100	

¹² Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural

¹³ Gjinia e fermerit, aplikuesi do të merr piket e këtij kriteri nëse ferma (bletishta)ose biznesi (me aktivitetin “ prodhim i mjaltës”) është në pronësi të saj në dy vitet e fundit. Krijimi i Kushteve artificiale për të marrë pikë paraqet mashtrim dhe do të ndëshkohet sipas nenit 38A, nen-paragrafit, 1.2.3 të Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

¹⁴ pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet.

Tabela 5: Kriteret e përzgjedhjes “Grumbullimi dhe përpunimi produkteve jo drusore të pyllit përfshirë bimët mjekësorë dhe aromatike

Kategoritë		Pikët
1. Përvoja e aplikuesit	Aplikuesi (ndërmarrja) ka përvojë 2 vite e më shumë (në grumbullimin, përpunimi të PJDP dhe BMA);	45
	Aplikuesi (ndërmarrja) ka përvojë më pak se 2 vite (në grumbullimin, përpunimi të PJDP dhe BMA);	40
2. Vendi i investimit	Investimi në zona malore;	10
3. Siguria e ushqimit	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit;	15
4. Punësimi	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit / planit të biznesit;	10
5. Mbrojtja e mjedisit ¹⁵	Investimet në energjinë e ripërtritshme;	10
6. Aplikuesi i ri ¹⁶	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri;	5
7. Prodhimtaria organike	I certifikuar për prodhim organik;	5
GJITHSEJ		100

¹⁵ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

¹⁶ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

Tabela 6: Kriteret e përzgjedhjes për nën-masën “Përpunimin e prodhimeve bujqësore në ekonomin familjare”

		Kategoritë	Pikët
1.	Madhësia e fermës	> 1ha tokë bujqësore (toka në emër aplikuesit);	50
		≤ 1ha tokë bujqësore (toka në emër aplikuesit);	45
		3 e më shumë lopë qumështore ose 15 dele ose 15 dhi (në ekonominë familjare në emër të aplikuesit);	50
		Me pak se 3 lopë qumështore ose 15 dele ose 15 dhi (në ekonominë familjare në emër të aplikuesit);	45
2.	Siguria e ushqimit	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit;	15
3.	Mbrojtja e mjedisit ¹⁷	Investimet në energjinë e ripërtitshme;	15
4.	Punësimi	Krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të planit të biznesit/projekt propozimit;	5
5.	Vendi i investimit	Investimi në zona malore;	5
6.	Gjinia e fermerit	Aplikuesi Femër	5
7.	Aplikuesi i ri ¹⁸	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri ;	5
GJITHSEJ			100

¹⁷ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtitshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtitshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtitshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural

¹⁸ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

Tabela 7: Kriteret e përzgjedhjes për nën -masën “Aktivitete jo-bujqësore në zona rurale”

Kategoritë		Pikët	
1.	Aplikuesi i ri ¹⁹	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri;	45
		Aplikuesi është mbi 40 vjeç;	35
2.	Përvoja aplikantit	Aplikuesi ka së paku 2 vjet përvojë në aktivitetin për të cilën aplikon, (të jetë i regjistruar si biznes për veprimtarinë e caktuar);	15
3.	Vendi i investimit	Investimi është në zonë malore;	15
4.	Punësimi	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit / planit të biznesit ;	10
5.	Mbrojtja e mjedisit ²⁰	Investimet në energjinë e ripërtritshme;	10
6.	Gjinia e fermerit	Aplikuesi Femer	5
GJITHSEJ			100

¹⁹ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

²⁰ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural

Tabela 8: Kriteret e përzgjedhjes për nën-masën “Zhvillimin e turizmit rural /agro-turizmi”

		Kategoritë	Pikët
1.	Përvoja e aplikuesit		
	a)Përvoja e aplikuesit në turizëm rural (për personat fizik, të dëshmohet me NIF)	Aplikuesi (ka përvojë 2 vite e më shumë në ofrimin e shërbimeve të turizmit);	55
	b)Për biznese të dëshmohet me aktivitetin përkatës të biznesit	Aplikuesi (ka përvojë më pak se 2 vite në ofrimin e shërbimeve të turizmit);	50
2.	Vendi i investimit	Investimi në zona malore;	10
3.	Aplikuesi i ri ²¹	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri;	5
4.	Gjinia e fermerit	a) Femra/person fizik së paku 2 vite pronare e fermës ku zhvillohet aktiviteti i turizmit rural(të dëshmohet me NIF); b)Femra /person juridik se paku 2 vite pronare e biznesit për turizëm rural;	5
5.	Mbrojtja e mjedisit ²²	Investimet në energjinë e ripërtitshme;	10
6.	Punësimi	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekte propozimit / planit të biznesit;	5
7.	Trashëgimia kulturore	Investimet në objekte të trashëgimisë kulturore;	5
8.	Përkrahja nga GLV –të	Investimet që janë në linjë me SZHL të GLV-së përkatëse;	5
GJITHSEJ			100

²¹ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

²² Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtitshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtitshme dhe i fiton pikët për-këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtitshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

Tabela 9: Kriteret e përzgjedhjes për nën -masën “Kultivimi i peshkut”

		Kategoritë	Pikët
1.	Kapaciteti prodhues Për fillestar kapaciteti pas investimit. (në biznes plan)	≥ 3 t/vit - < 10 t/vit	45
		≥ 10 t/vit - < 30 t/vit	40
		≥ 30 t/vit	35
2.	Përvoja e aplikuesit në akuakulturë	Aplikuesi është i licencuar nga MBPZHR-ja;	20
		Aplikuesi ka marrë pagesa direkte për akuakulturë në vitin paraprak, por nuk është i licencuar;	15
		Aplikuesi është fillestar;	10
3.	Aplikuesi i ri ²³	Aplikuesi është 40 vjeç ose me i ri/re;	5
4.	Vendi i investimit	Investimi është në zone malore;	10
5.	Punësimi	Investimi përfshinë krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit / planit të biznesit;	10
6.	Mbrojtja e mjedisit ²⁴	Investimet në energjinë e ripërtitshme.	10
TOTAL			100

Tabela 10: Kriteret e përzgjedhjes për nën -masën “Rritja e shpezëve të fshatit”

		Kategoritë	Pikët
1.	Përvoja e aplikuesit para aplikimit	≥ 500 pula ose rosa (ose gjithsej me shum se 500 krerë)	55
		≥ 200 pata ose biba(ose gjithsej me shum se 200 krerë)	
		< 500 pula ose rosa (ose gjithsej me pak se 500 krerë)	50
		< 200 pata ose biba(ose gjithsej me pak se 200 krerë)	
2.	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	10
3.	Aplikuesi i ri ²⁵	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri/re	15
4.	Vendi i investimit	Investimi është në zone malore;	20
GJITHSEJ			100

²³ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

²⁴ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtitshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtitshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit te kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtitshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Buqësinë dhe Zhvillimin rural

²⁵ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

**Masa 1: Investimet në asetet fizike të ekonomive
bujqësore**

Udhëzues për Aplikues

2022

1. Hyrje

Udhëzuesi ka për qëllim t'u ndihmojë aplikuesve në përgatitjen e aplikacioneve të tyre, të qartësojë kushtet e pranueshmërisë që duhet të respektohen, sistemin e pikëve, cilat janë investimet e pranueshme, cilat janë dokumentet e nevojshme për aplikim, si do të bëhet vlerësimi i projekteve, si do të njoftohen aplikuesit për rezultatet e vlerësimit, sit ë pregaditet kërkesa për pagesë, cilat janë procedurat e prokurimit, cilat janë ndëshkimet në rast të parregullsive apo tentimeve për mashtrim etj.

Roli i Udhëzuesit është të sqaroj në detaje dispozitat e paraqitura në Masën 1 dhe Jo të përsërisë atë, prandaj ky nuk e zëvendëson masën por duhet lexuar (bashkë me shtojcat), me qëllim të shmangies së gabimeve gjatë aplikimit apo pregaditjes së kërkesës për pagesë.

Kjo masë përfshinë 6 sektorë: pemët, perimet, mishin, qumështin, rrushin dhe vezët. Masa është përgatitur nga Autoriteti Menaxhues duke u bazuar në analizën sektoriale, këshillime me palët e interes etj.

2. Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime:

“MBPZHR” - nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

“Autoriteti Menaxhues” - nënkupton entitetin publik brenda MBPZHR-së, përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e PZHR;

“ARBK” - nënkupton Agjencinë per Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

“AZHB” - nënkupton Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në kuadër të MBPZHR, përgjegjës për zbatimin e PZHR;

“PZHR 2022” – nënkupton Programin për Zhvillimin Rural për vitin 2022;

“Masa 1” - nënkupton investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore;

“Masa 3” - nënkupton investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore;

“Masa 7” - nënkupton diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e bizneseve;

“Masa 5” - nënkupton përgatitjen dhe zbatimin e strategjive zhvillimore lokale - Qasja LEADER;

“Thirrja për aplikim” - nënkupton njoftimin publik për pranimin e aplikimeve;

“Aplikues” - nënkupton personin fizik apo juridik, i cili aplikon për të përfituar projekt në PZHR 2022;

“Aplikacioni” - nënkupton formularin e plotësuar për aplikim me të gjitha dokumentet e kërkuara nga AZHB;

“Projekt-nënkupton dokumentin që parasheh investimin e planifikuar për përkrahje nga PZHR 2022, të dorëzuar nga aplikuesi;

“Përzgjedhja” - nënkupton selektimin e projekteve, sipas pikëve të renditura;

“Kriteret e përzgjedhjes” - nënkupton kriteret që Autoriteti Menaxhues duhet t'i përcaktoj, për të siguruar prioritetet e financimit të projekteve më të mira që adresojnë nevojat e identifikuara në analizën SEOT dhe objektivat e përcaktuara në PZHR 2022;

“Përfitues” - nënkupton personin fizik apo juridik, i cili është përzgjedhur përfitues pas vlerësimit të aplikimit, nënshkrimit të kontratës dhe financimit të projektit nga MBPZHR;

- “Shkalla e përkrahjes publike”** - nënkupton kontributin nga buxheti publik për zbatimin e projektit;
- “Kontrata”** - nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të përfituesit dhe AZHB-së për zbatimin e projektit të përfituar;
- “Mashttrim”** - nënkupton çdo vepër e qëllimshme ose mospërfillje sipas përkufizimit të Ligjit Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, 16 tetor 2012);
- “Shpenzimet e pranueshme”** - nënkupton shpenzimet që përkrahen me mjete financiare;
- “Pemë drufrutore dhe manore”** – nënkupton molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, qershia, kajsia, pjeshka, ftoni, dredhëza, mjedra, manaferra dhe boronica;
- “Periudha e zbatimit të projektit”** - nënkupton periudhën për zbatimin e afatit të projektit të përcaktuar në udhëzim administrativ dhe kontratën e nënshkruar mes përfituesit dhe AZHB.
- “Kërkesa për pagesë”** - nënkupton parashtrimin e kërkesës për pagesë për shpenzimet e pranueshme, të dëshmuara me fatura valide për shpenzimet e realizimit të projektit;
- “Ex-post kontrolli”** - nënkupton periudhën kohore prej tre (3) vjetësh pas ekzekutimit të pagesës së fundit, gjatë të cilës përfituesi duhet ta ruajë qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave është përzgjedhur si përfitues;
- “NIF”** - nënkupton Numrin Identifikues të Fermës;
- “PJDP”**- nënkupton produktet jodrusore të pyllit;
- “BMA”**-nënkupton bimët mjeksore aromatike.
- “FERMA”**- nënkupton njesin prodhuese në aspektin teknik dhe ekonomik e cila menagjohet nga fermeri në të cilin zhvillohen aktivitete bujqesore dhe aktivitete të zhvillimit rural
- “ZGJERIMI”**- nënkupton zgjerimin e objektit egzistues
- “Person fizik afarist”**- nënkupton personin që ka të regjistruar një biznes në baze të legjislacionit në fuqi dhe zhvillon aktivitet të rregullt biznesor.

3. Objektivat dhe mjetet financiare për këtë Masë

3.1 Objektivat e përgjithshme

- Rritja e efikasitetit, aftësisë konkurruese dhe prodhimin më të qëndrueshëm të sektorit të agro – ushqimit, me zbatimin e standardeve kombëtare duke synuar përafrimin e standardeve të BE - së, forcim i pozitës së fermerëve në zinxhirin e agro-ushqimit dhe duke mbështetur fermerët e rinj.
- Sigurimin e përgjigjes më të mirë të sektorit të agro-ushqimit ndaj kërkesës publike për ushqim me cilësi të lartë, të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, si dhe mirëqenie e kafshëve.
- Të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike, në prodhimin e energjisë së qëndrueshme/ripërtitëshme dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, siç janë uji, toka dhe ajri.

3.2 Objektivat specifike

Sektori i pemëve dhe sektori i perimeve (përfshirë patatet)

- Rritja e prodhimit komercial të pemëve dhe perimeve (përfshirë patatet);
- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit modern dhe dixhitalizimi i fermës;
- Zvogëlimi i humbjeve pas vjeljes nëpërmjet investimeve në fermë, në teknologjinë e ruajtjes, në infrastrukturë dhe pajisje, përfshirë kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim;
- Krijimi i vendeve të punës;
- Mbrojtja e mjedisit dhe adresimi i ndryshimeve klimatike
- Përmirësimi i zinxhirit të vlerës (integritet të fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre)

Sektori i qumështit dhe sektori i mishit

- Rritja e prodhimit në fermat e specializuara;
- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit modern dhe dixhitalizimi i fermës;
- Zvogëlimi i lirimit të oksidit të azotit dhe metanit përmes trajtimit të duhur të plehut organik dhe mosndotjes së ujërave mbitokësore dhe nëntokësore;
- Krijimi i vendeve të punës;
- Mbrojtja e mjedisit dhe adresimi i ndryshimeve klimatike
- Përmirësimi i zinxhirit të vlerës (integritet të fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre)

Sektori i rrushit

- Rritja e prodhimit të rrushit të tryezës dhe rrushit të verës;
- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të fidanëve cilësorë dhe mekanizimit modern si dhe dixhitalizimi i sektorit;
- Krijimi i vendeve të punës;
- Mbrojtja e mjedisit dhe adresimi i ndryshimeve klimatike
- Përmirësimi i zinxhirit të vlerës (integritet të fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre)

Sektori i vezëve

- Përmirësimi dhe zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese prodhuese;
- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit modern dixhitalizim i sektorit;
- Zvogëlimi i lirimit të oksidit të azotit dhe metanit përmes trajtimit të duhur të plehut organik;
- Krijimi i vendeve të punës;
- Mbrojtja e mjedisit dhe adresimi i ndryshimeve klimatike;
- Përmirësimi i zinxhirit të vlerës (integritet të fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre)

3.3 Buxheti indikativ

Ndarja e planifikuar buxhetore ndërmjet sektorëve për vitin 2022

		Buxheti	%
1.1	Pemë drufrutore	2,500,000.00	19.09
a)	arra dhe lajthia	500,000.00	3.82
1.2	Pemë manore	1,000,000.00	7.64
1.3	Sektori i perimeve dhe serrave	1,700,000.00	12.98
a)	Sektori i serrave për fidane	1,500,000.00	11.45
1.4	Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	1,195,325.00	9.13
1.5	Prodhimi i mishit / rritja e viçave	1,500,000.00	11.45
1.6	Prodhimi i mishit / rritja e derrave	200,000.00	1.53
1.7	Prodhimi i qumështit/lopë	1,500,000.00	11.45
1.8	Prodhimi i qumështit / dele dhe dhi	300,000.00	2.29
1.9	Pikat grumbulluese të qumështit	250,000.00	1.91
1.10	Prodhimi i rrushit	450,000.00	3.44
1.11	Prodhimi i vezëve	500,000.00	3.82
	Totali i buxhetit	13,095,325.00	100

4. Përfituesit

Përfituesit përfundimtar:

1. Përfituesit përfundimtar nën këtë masë janë “fermerët” sipas përkufizimit nga neni 1 i Ligjit Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, 16 tetor 2012);
2. Të gjithë aplikuesit e kësaj mase duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës.
3. Certifikata e Numrit Identifikues të Fermës (NIF) duhet të jetë në emër të aplikuesit.
4. Nëse aplikuesi është ndërmarrje, edhe certifikata e NIF-it duhet të jetë në emër të ndërmarrjes.
5. Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të zbatuar gjatë tri (3) viteve pas datës së ekzekutimit të pagesës, aq sa zgjatë periudha monitoruese;
6. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike.
7. Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural pas finalizimit të investimeve duhet të kenë projektin funksional sipas planit të biznesit, PZHR-së dhe kriterëve të këtij Udhëzimi Administrativ.
8. Kërkesa për pagesë refuzohet për projekte, të cilat nuk kanë finalizuar ndonjë aktivitet për të cilin është poentuar gjatë procesit të vlerësimit.
9. Përfituesit janë të obliguar të posedojnë dhe të ruajnë dosjen e dokumenteve për grantin e fituar aq sa zgjat periudha e kontrolles.

10. Përfituesit obligohen të ia ofrojnë dosjen e dokumentëve të grantit personit zyrtar me rastin e kontrollit të rregullt apo ex-post kontrolles.

5. Qëndrueshmëria ekonomike

1. Aplikuesi duhet të dëshmojë qëndrueshmërinë ekonomike të fermës përmes plani të biznesit që synon të arrij rezultatet deri në fund të periudhës së investimeve.
2. Mënyra se si dëshmohet qëndrueshmëria ekonomike duhet të shpjegohet në udhëzuesin për aplikues i cili përgatitet nga AZHB.
3. Fondet e AZHB-së të dhëna për përfituesin duhet të merren parasysh kur llogaritet qëndrueshmëria ekonomike e përfituesit.
4. Në rastet kur investimet janë më të vogla ose baras me njëzetmijë (20.000) euro, një formë e thjeshtuar e një plani të biznesit ose projekt-propozimi, mund të pranohet, duke ruajtur parashikimet e qëndrueshmërisë financiare / ekonomike.
5. Aplikuesi duhet ta dorëzojë projekt propozim sipas modelit që do të publikohet në web-faqet e AZHB-së dhe MBPZHR-së.
6. Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se njëzetmijë (20,000) €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit që do të publikohet në web-faqet e AZHB-së dhe MBPZHR-së.
7. Plan i biznesit është dokumenti kryesor për vlerësimin e qëndrueshmërisë ekonomike.
8. Investimet e planifikuara duhet të jenë në përputhje me kapacitetin prodhues.
9. Gjatë vlerësimit të aplikacioneve, duke u bazuar në planin e biznesit, zyrtarët e AZHB-së janë të obliguar të refuzojnë pjesën e investimeve të cilat janë në kundërshtim me këtë parim.
10. Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare vlerësohet në bazë të projekt-propozimit ose planit të biznesit.
11. Plan i biznesit duhet të tregojë qëndrueshmërinë ekonomike të fermës/ ndërmarrjes në fund të realizimit të investimit.

6. Standardet kombëtare:

1. Standardet kombëtare për shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit janë paraqitur në udhëzuesin për aplikues.
2. Ato duhet të përmbushen më së voni para kërkesës për pagesën e fundit dhe verifikohen me rastin e kontrollit të personit zyrtar në vendin e investimit.
3. Në rast të investimeve në pemishte dhe vreshta të reja, para nënshkrimit të kontratës për bashkëfinancim, përfituesi i grantit duhet të sjellë analizat kimike dhe fizike të tokës me rekomandim pozitiv për përshtatshmërinë për investimin e paraparë. Në rast se rekomandimi është negativ refuzohet dhënia e grantit.

7. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë.

1. Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë së paku 18 vjeç, por që nuk i ka mbushur 65 vjet. Në rastin e ndërmarrjeve ky kriter nuk aplikohet;
2. Personi fizik duhet ta ketë të përfunduar së paku shkollimin e detyrueshëm elementar (8 ose 9 vjeçar) dhe dy (2) vjet përvojë pune në lëmin në të cilën aplikon. Aplikuesit që nuk kanë përvojë pune dy vjeçare, duhet të ndjekin kurse trajnimi me së paku 20 orë mësimi, në fushën për të cilën aplikojnë, e të cilat do t'i përfundojnë para kërkesës për pagesën e fundit;
3. Në rastin e ndërmarrjeve, kërkesa e sipërpërmendur vlen për pronarin, për të punësuarin ose për personin e autorizuar të ndërmarrjes. I punësuar i ndërmarrjes ose personi i autorizuar duhet të ketë kontratë pune së paku edhe për tri vjet pas momentit të aplikimit.
4. Aplikuesit duhet t'i kenë të rregulluara detyrimet tatimore dhe atë, personat fizik, tatimin në pronë, kurse ndërmarrjet, tatimin në të ardhura të korporatave;
5. Nëse toka ose ndonjë pronë tjetër në të cilën do të bëhet investimi është në bashkëpronësi, aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve;
6. Në rast se toka në certifikatën e pronësisë është mal ose tokë pyjore dhe në teren është tokë bujqësore, aplikuesi duhet paraprakisht ta ndërroj destinimin e tokës në kadastrë dhe pastaj të aplikoj.
7. Në rastet e tokave të marra me qira nga APK apo AKP pranohen edhe tokat pyjore me kusht që në aplikacion të bashkëngjitet një vërtetim nga APK apo AKP se toka në fjalë është tokë bujqësore;
8. Te behet digjitalizimi i parces ku behet investimi;
9. Përfituesit te cilet ne planin e biznesit janë zotuar te kenë te punësuar, duhet te regjistrohen ne ARBK se paku si Biznes Individual dhe te gjitha pagesat duhet te behen nga llogaria e biznesit.

8. Kriteret tjera të pranueshmërisë:

1. Përfituesit e projekteve te investimeve të pranueshme në vlerë më të madhe se pesëdhjetëmijë (50,000) € dhe përfituesit te cilët ne planin e biznesit kan deklaruar puntor te ri dhe per te cilët janë poentuar, para nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, duhet t'i regjistrojnë ndërmarrjet si person juridik apo biznes individual dhe investimet/shpenzimet e zbatimit të projektit duhet të faturohen në emër të biznesit.
2. Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2022 nuk lejohet të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar.
3. Në rast se vërtetohet se përfituesi ka përfitur përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen masat ndëshkimore në përputhje me ligjin.
4. Të gjithë përfituesit e masës 1, obligohen që gjatë periudhës monitoruese të mbajnë librin e fermës, në formë fizike apo elektronike, për sektorin përkatës.
Sqarim: Për formatin dhe procedurat se si të mbahet libri i fermës, informatat mund të merren në Departamentin e Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike (DSHKT)
5. Në rast se përfituesi i grantit nuk e mban librin gjatë periudhës monitoruese ndëshkohet me mosdhënie të pagesave direkte për investimin përkatës për dy vjet në vijim.

6. Aplikuesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse nuk e ka përfunduar investimin paraprak. Nëse përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR në 3 vitet e fundit dhe ndodhet në periudhën monitoruese, para nënshkrimit të kontratës së re me AZHB-në duhet të bëhet një kontroll në mënyrë që të bëhet verifikimi i projektit të mëparshme. Nëse projekti nuk është mirëmbajtur dhe /ose nuk është funksional nuk mund të lidhet kontrata e re.
7. Të gjitha asetet që kanë të bëjnë me investimin dhe për të cilat ka rubrika përkatëse në aneksin e NIF-it duhet të jenë të regjistruara në Regjistrin e Fermës.
8. Të gjitha kontratat e qiramarrjes duhet të jenë të noterizuara apo të vërtetuara nga gjykata, përveç kontratave të qiramarrjes me Agjencionin e Pyjeve të Kosovës (APK), Agjencionin e Kosovës për Privatizim (AKP) dhe me Komuna të cilat nuk ka nevojë të jenë të noterizuara.
9. Në rast të tokave të marra me qira nga Agjencionin e Pyjeve të Kosovës dhe Agjencionin Kosovë për Privatizim, kontratat mund të jenë edhe për kohë më të shkurtër se sa është e paraparë për aplikuesit e tjerë, me kusht që ata të dorëzojnë një vërtetim nga qiradhënësi se nuk do të ketë vështirësi me vazhdimin e kontratës.
10. Tokat e privatizuara nga AKP-ja, të cilat në certifikatën e pronës paraqiten si "tokë e marrë me qira për 99 vjet" trajtohen si tokë në pronësi të privatizuesit.
11. Tokat e blera nga privatizuesit trajtohen si tokë në pronësi të blerësit.
12. Tokat me komasacion të papërfunduar pranohen me vendime të organit kompetent, pra edhe pa certifikatë të pronës.
13. Toka nën hipotekë nuk është e pranueshme për investim, qoftë në pronësi apo e marrë me qira.
14. Nëse nga një parcelë është dhënë me qira vetëm një pjesë e saj, aplikuesi para aplikimit duhet të bëjë digjitalizimin e pjesës së dhënë me qira dhe një kopje fizike të pjesës së digjitalizuar t'ia bashkojë dosjes së aplikimit.
15. Në rast se ngastrat janë ngjitur fizikisht me njëra-tjetrën pranohen si një ngastër, qoftë edhe në rastet kur njëra është me qira dhe tjetra në pronësi.
16. Në rastin e projekteve që parashohin ndërtim apo zgjerim, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:
 - 16.1. Certifikatën e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi.
 - 16.2. Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku dhjetë (10) vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit;
 - 16.3. Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
 - 16.4. Kopjen e skicave të objektit;
 - 16.5. Parallogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara; Dokument i përgatitur i veçantë (jo pjesë e planit të biznesit) nga aplikuesi vetë ose me ndihmën e ndërtuesit.
 - 16.6. Pëlqimin e Komunës që dëshmon se në rast të dhënies së grantit, aplikuesi mund të marrë - leje ndërtimi;
17. Në rast të ndërtimit, zgjerimit apo renovimit të objekteve, të ngritjes së pemishtes, vreshtit dhe / apo vendosjes së sistemit të ujitjes në toka të marra me qira, kontrata për qiramarrje duhet të jetë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit.

18. Kontrata duhet të përmbajë edhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit), për investimin që do të bëhet në tokën e tij.

19. Kontrata për qiramarrje nuk kërkohet vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, mbesat në bazë të ligjit në fuqi.) dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës apo certifikatës së lindjes dhe / apo certifikatës së vdekjes.

20. Aplikuesi duhet të plotësojë Deklaratën nën betim, me të cilën dëshmon se ai është trashëgimtar potencial i tokës.

21. Përfituesi, me rastin e parashtrimit të kërkesës për pagesë në AZHB, duhet të dorëzojë Lejen për ndërtim nga organi kompetent i Komunës në rast të ndërtimit apo zgjerimit.

22. Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për tri (3) vjet, aq sa zgjatë periudha monitoruese.

9. Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtitshme

1. Në kuadër të këtij investimi mbështetet prodhimi i energjisë elektrike nga burimet ripërtitshme për "vetë-konsum". (d.m.th. energjia elektrike e prodhuar/depozituar në rrjet është mesatarisht e barabartë me energjinë elektrike të shpenzuar gjatë vitit).

2. Kjo justifikohet me faktin se, meqenëse energjia elektrike nuk mund të ruhet, ajo nëse nuk harxhohet, mund të lëshohet në rrjet; rrjeti i energjisë elektrike mund të konceptohet si një vend depozitimi për energjinë elektrike ku futet dhe tërhiqet gjatë vitit në sasi të ngjashme dhe me një ritëm të ndryshëm.

3. Koncepti i "vetë-konsumit" duhet të kontrollohet në fazën në të cilën paraqitet / vlerësohet një projekt. Investimi konsiderohet i pranueshëm kur kapaciteti (teorik) i energjisë së impiantit të energjisë së rinovueshme ("investimi") nuk tejkalon 120% të konsumit mesatar prej 3 vjetësh të ekonomisë familjare.

4. Në rastin e fermave të reja ose në rastet e fermave që kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore madhësinë e veprimtarisë së tyre në tre vitet e fundit, konsumi i prishëm duhet të vlerësohet nga AZHB-ja.

10. Shpenzimet e përbashkëta të pranueshme

1. Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt-propozimit nuk mund ta tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se njëmijëepesëqind (1500) euro.

2. Në rast të investimeve që parashohin ndërtim të stallave apo depove për ruajtjen e pemëve dhe perimeve, shpenzimet për arkitekt dhe inxhinier, leje dhe licenca të ndryshme janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se tremijë (3000) €.

1. Të gjitha shpenzimet tjera të pranueshme janë të kufizuara në ato që janë përfshirë në Listën e Investimeve të Pranueshme për Masën 1.

11. Shkalla e përkrahjes publike

1. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është pesëmbëdhjetëmijë (15,000) €, përveç projekteve të sektorit të rrushit, ku vlera minimale e projektit është tremijë (3,000) €;

2. Vlera maksimale e shpenzimeve te pranueshme për projekt brenda kësaj mase është njëqindmijë (100.000) €;
3. Përkrahja publike është 70% e shpenzimeve të pranueshme të investimit;
4. Përkrahja maksimale publike për periudhën e zbatimit të draft Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027 për Masën 1 është treqindmijë (300,000) € për përfitues;
5. Aplikuesi mund të aplikoj me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkaloj shumën e lartpërmendur.

12. Afati i zbatimit

1. Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 90 ditë kalendarike, përveç për projekte që parashohin ndërtim të stallës apo të depos me ç'rast afati i zbatimit është 120 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në dhe për sektorin e rrushit, për projektet e të cilit afati i implementimit është 300 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, për shkak të periudhës pranverore të mbjelljes së rrushit.
2. Pas afatit të zbatimit, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë.
3. AZHB-ja mund të zgjasë afatin e zbatimit për më shumti se 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç janë kushtet e papershtatshme klimatike, sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër.

13. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

13.1 Kriteret e veçanta të pranueshmërisë për sektorin e pemëve:

1. Sektori i pemëve - molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, qershia, kajsia, pjeshka, ftoni, dredhëza, mjedra, manaferra dhe boronica dhe aronia.
2. Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku dhjetë (10) vjet të llogaritur nga viti i aplikimit dhe atë së paku 1 hektar për pemë drufrutore - molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, qershia, kajsia, pjeshka, dhe ftoni dhe/ose 0.25 hektar për pemë manore-dredhëza, mjedra, boronica, manaferra dhe aronia.
3. Sipërfaqja minimale e ngastrës për pemë manore duhet të jetë 0.10 hektar dhe për pemë drufrutore 0.35 hektar;
4. Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (Conformitas Agraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidanë të importuar nga vendet e BE-së, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese.
5. Fidanët e mbjellë të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues.

13.2. Investimet e pranueshme në sektorin e pemëve janë:

1. Investimet në ngritjen e pemishteve të reja me sipërfaqe minimale prej 1 hektar për pemët drufrutore dhe 0,25

ha për pemë manore;

2. Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes në fermë, sipas praktikave efikase të ujitjes;
3. Investimet në prodhimin e energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;
4. Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshëri dhe ngricat;
5. Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
6. Investimet për blerje të traktorit për pemët dru-frutore;
7. Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pas vjeljes, objekteve për vendosjen e makinave, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale.
8. Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e pemëve janë të përcaktuara në Shtojcën I Tabela 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.

13.3. Kriteret e pranueshmërisë për sektorin e perimeve, serrave, serra për fidanë dhe depo - përfshirë patatet:

1. Në momentin e aplikimit për investime në depo për pemë dhe perime (përfshirë patatën), aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 2 hektarë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet.
2. Në momentin e aplikimit për investime në serra të reja të përhershme, aplikuesi duhet të dëshmojë se ka së paku 0.10 hektar tokë të punueshme të regjistruar në Regjistrin e Fermave. Madhësia minimale e një serre e pandarë është 0,10 ha.

13.4. Investimet në sektorin e perimeve, serra, serra për fidanë dhe depo (përfshirë patatet):

1. Investimet në ndërtimin e serrave të përhershme për perime, pemë manore apo fidanë. Sipërfaqja minimale e një serre është 0.1 hektar;
2. Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet burimeve të ripërtërishme;
3. Blerja dhe instalimi i pajisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike, përfshirë pajisjet për ngrohje në serra;
4. Investimet në vendosjen ose avancimin e sistemeve të ujitjes në serrë sipas praktikave efikase të ujitjes;
5. Ndërtimi i objekteve për trajtim pas vjeljes (klasifikim, paketim, etiketim) dhe për ruajtje të prodhimit, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale.
6. Blerja e mekanizmit përkatës për kultivimin e perimeve në fushë të hapur apo në serra (makinë për mbjellje të fidanëve, makinë për shtrirje të folisë.)

Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e perimeve serrave dhe serrave për fidanë - përfshirë patatet janë të përcaktuara te pjesa e Kriterëve të vlerësimit.

13.5. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë për sektorin e mishit:

1. Për investime në sektorin e mishit (majmëria e viçave dhe derrave, aplikuesit duhet të kenë së paku 10 viça respektivisht 20 derra në momentin e aplikimit, por para kërkesës për pagesën e fundit duhet të kenë së paku 20 krerë viça, ose 40 derra për trashje me matrikuj të Republikës së Kosovës ose të vendeve të BE-së, dhe këto duhet t'i dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë.
2. Aplikantët që aplikojnë për ndërtimin e stallës për viça dhe për derra, në projektin e tyre duhet ta përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku tre (3) muaj -shiko listën e standardeve minimale kombëtare ne Udhezuesin për Aplikues.
3. Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, në momentin e aplikimit, aplikuesit për majmëri të viçave duhet të dëshmojnë se kanë së paku 0,20 hektar të tokës bujqësore për kokë viçi, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku tri (3) vjet.

13.6. Investimet e pranueshme:

1. Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave, objekteve përcjellëse (deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit) dhe infrastrukturës në fermë (p.sh. furnizim me ujë në nivel ferme);
2. Investimet në prodhim të energjisë e në fermë nga të gjitha llojet burimeve të ripërtërishme;
3. Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
4. Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrje;
5. Investimet për blerje të traktorit;
6. Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik (të lëngët dhe të ngurtë) dhe deponimin e tij;
7. Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës;

Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e mishit janë të përcaktuara te pjesa e Kriteve të vlerësimit.

13.7. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë të sektorit të qumështit:

1. Aplikuesit për investime në sektorin e prodhimit të qumështit, në momentin e aplikimit janë të obliguar të kenë së paku 15 lopë qumështore ose 130 dele ose 130 dhi, të regjistruara në Regjistrin e Fermës dhe në Regjistrin për Regjistrim dhe Identifikim të Kafshëve (RRIK) në AUV. Kjo dispozitë nuk vlen për pikat grumbulluese;
2. Pikat grumbulluese duhet të kenë kontrata afatgjate (së paku njëvjeçare) me së paku 5 fermerë të cilët bashkërisht mbarështojnë së paku 30 lopë qumështore;
3. Aplikantët që aplikojnë për ndërtimin e stallës për lopë qumështore, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj -shiko listën e standardeve minimale kombëtare ne udhëzuesin për aplikues;
4. Depo e plehut nuk është e obligueshme për mbarështuesit e deleve dhe dhive;

5. Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë të paktën 0.5 hektar të tokës bujqësore për çdo krerë lope, respektivisht 0.05 hektar të tokës bujqësore për kokë deleje/dhie, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 3 vjet.

13.8. Investimet e pranueshme:

1. Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave, objekteve përcjellëse si dhe objekteve të qendrave grumbulluese të qumështit (deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit, mjeltore) dhe infrastrukturës në fermë (p.sh. instalimi i ujit, i rrymës);
2. Investimet në modernizimin e mjeljes dhe pajisjeve për ftohje, si pajisjet për mjelje, ruajtje të qumështit, përfshirë dhomat e ruajtjes së qumështit, laktofrizat;
3. Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;
4. Pajisje dhe makineri për heqjen e plehut;
5. Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
6. Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrije;
7. Investimet për blerje të traktorit;
8. Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik (të lëngët dhe të ngurtë) dhe deponimin e tij;
9. Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e qumështit janë të përcaktuara te pjesa e Kritereve të vlerësimit.

13.9. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë të sektorit të rrushit:

1. Në momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e rrushit duhet të dëshmojnë se kanë tokë bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku dhjetë (10) vjet, dhe atë së paku 0.25 hektar;
- 2 Sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.10 hektar;
- 3 Në rast të investimeve në mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, si dhe depo për trajtim pas vjeljes, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 3 hektarë me vreshta, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet, të regjistruar në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës.

13.10. Investimet e pranueshme:

1. Investimet në ngritjen/modernizimin e plantacioneve të vreshtave (konvertim, zëvendësim) për rrush të tryezës dhe rrush të verës me madhësi minimale 0.25 hektar;
2. Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes, sipas praktikave efikase të ujitjes;
3. Investimet në vendosjen e plasmasit për rrush të tryezës;
4. Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;

5. Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshëri;
 6. Investimet në sisteme mbajtëse të hardhive dhe në rrethoja;
 7. Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për vreshta, makineri për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
 8. Investimet për blerje të traktorit;
 9. Atyre që kanë mbi 3 hektarë sipërfaqe me vreshta u lejohej edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim;
- Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e rrushit janë të përcaktuara te pjesa e Kritereve të vlerësimit.

13.11. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë të sektorit të vezëve:

1. Aplikuesit për investime në sektorin e vezëve, duhet të dëshmojnë posedimin e së paku 5,000 pulave vojse në prodhimtari aktive;
2. Aplikuesit që aplikojnë për ndërtimin e fermës së pulave, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj - shiko listën e standardeve minimale kombëtare në udhëzuesin për aplikues;
3. Aplikuesit në sektorin e vezëve, me rastin e aplikimit duhet të shënojnë në planin e biznesit kur do të bëjnë ndërrimin e turnusit dhe sa do të zgjasë pauza pa prodhim.
4. Aplikuesi duhet të dorëzoj edhe faturën e furnizimit të fundit me pula;
5. Në rast të sëmundjeve të cilat dëmtojnë numër të madh të pulave, duhet të sigurohet vërtetimi i AUV.

13.12. Investimet e pranueshme janë:

1. Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave dhe dhomave për ruajtjen e vezëve;
2. Investimet në infrastrukturë të brendshme (sistemi i të ushqyerit, ujë-pirëset dhe pajisje për rregullimin e mikroklimës, pajisje për largimin e plehut, klasifikim të vezëve);
3. Investimet në kafaze, vetëm sipas standardeve të BE-së;
4. Ndërtimi dhe renovimi i depove për ruajtjen e ushqimit, përfshirë pajisjet për përgatitje të ushqimit, trajtim, paketim dhe ruajtje të vezëve;
5. Investimet në pajisje për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;
6. Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik dhe deponimin e tij;
7. Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës;

Kriteret e përzgjedhjes për Masën 1 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore për sektorin e vezëve janë të përcaktuara te pjesa e Kritereve të vlerësimit.

14. Kriteret e përzgjedhjes për nënsektorë

Në mënyrë që të sigurohet që investimi të përmbushë objektivat e masës, projektet e pranueshme do të poentohen sipas pikëve më mëposhtme.

Tabela 1. Kriteret e përzgjedhjes për prodhimin bimor

Nr	Lloji i kriterëve	Kategoria	Pikë	
1.	Investimet në rritjen e prodhimit, përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit në fermë. Kapaciteti prodhues: sipërfaqja që do të ngritët. Në rast të investimit në infrastrukturë të pemishtes, depo, ujtitje, mbrojtje kundër breshëri dhe / ose makineri, pikët llogariten varësisht prej sipërfaqes ekzistuese ¹ apo asaj që do të ngritët, cila do qoftë më e madhe.	drufrutore		
		manore/rrush	Serra/serra për fidanë	
		≥ 3 ha	≥ 0.5 - 1 ha	> 0.20 ha
	≥ 1 ha - < 3 ha	≥ 0.25 ha - < 0.5 ha	0.10 – 0.20 ha	50
2.	Investimet në zonat malore- ky kriter nuk vlen për aplikuesit për serra.	Investimet në zonat malore	5	
3.	Investimet në prodhim të energjisë së ripërtrishme ²	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtrishme (<i>min. 5% e investimit të pranueshëm</i>). (piket nga ky kriter do të merren sipas vlerësimit të biznesi planit)	10	
4.	Investimet që përfshijnë krijimin e vendeve të punës duke u bazuar në biznes plan.	Vende të punës do të vlerësohen sipas biznes planit, nëse nuk ju përmbahen kërkesave do të sanksionohen me kthim të investimit “çdo vend i krijuar i punës duhet të regjistrohet në ATK dhe të i paguhet të gjitha kontributet për periudhën monitoruese”.	5	
5.	Aplikuesi apo ekonomia familjare nuk ka	përfitur grant nga MBPZHR në tri vitet e fundit	10	
6.	Pronësia mbi token ³	toka në emër të aplikuesit	10	
7.	Aplikuesi i ri ⁴	Aplikanti është 40 vjeç ose më i ri	3	
8.	Gjinia e fermerit ⁵	Aplikuesi femër	2	
GJITHSEJ			100	

¹ Sipërfaqet ekzistuese të dëshmohe me marrjen e pagesës direkte për këto sipërfaqe në vitin paraprak ose nëse nuk ka marrë pagesa direkte dëshmohe me certifikatën e pronës dhe NIF-in.

² Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtrishme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfuturi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtrishme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad-hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtrishme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

³ E tër toka përfshir token ku bëhet investimi duhet të jet në emër të aplikuesit në tri vitet e fundit. Krijimi i kushteve artificiale për të marrë pikë paraqet mashtrim dhe do të ndëshkohet sipas nenit 38A, nen-nen-paragrafit, 1.2.3 të Ligjit Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

⁴ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

⁵ Gjinia e fermerit, aplikuesi do të merr piket e këtij kriteri nëse e tër toka përfshir token ku bëhet investimi duhet të jet në emër të aplikuesit në tri vitet e fundit. Krijimi i Kushteve artificiale për të marrë pikë paraqet mashtrim dhe do të ndëshkohet sipas nenit 38A, nen-nenparagrafit, 1.2.3 të Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

Tabela 2. Kriteret e përzgjedhjes për prodhimin shtazor

Nr	Lloji i kriterëve	Kategoria	Pikë		
1.	Investimet në rritjen e prodhimit në përmirësimin e efikasitetit. Lloji i investimit: Në rast të investimit edhe nga pika a) edhe nga pika b), pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të buxhetit të planifikuar në biznes plan.	a) Ndërtimi /rinovimi /zgjerimi i stallës	40		
		b) Makineri dhe/ose përmirësimi i infrastrukturës së jashtme depo e plehut, depo e silazhit, depo e sanës	35		
2.	Kapaciteti prodhues (numri i kafshëve) pas realizimit të projektit.	Lopë ose viça	10		
		Derra		Dele/d hi	Pula
		$\geq 20 < 70$ krerë		$\geq 40 < 100$	≥ 150 < 300
≥ 70 krerë	≥ 100 krerë	≥ 300 krerë	≥ 50.000 krerë	15	
3.	Investimet në prodhim të energjisë së ripërtitshme ⁶	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtitshme (min. 5% e investimit të pranueshëm) piket nga ky kriter do të merren sipas vlerësimit të biznesi planit.	10		
4.	Investimet në zonat malore	Investimet në zonat malore	5		
5.	Investimet që përfshijnë krijimin e vendeve të punës duke u bazuar në biznes plan.	Vendet e punës do të vlerësohen sipas biznes planit, nëse nuk ju përmbahen kërkesave do të sanksionohen me kthim të investimit. “Çdo vend i krijuar i punës duhet të regjistrohet në ATK dhe të i paguhet të gjitha kontributet për periudhën monitoruese”.	5		
6.	Aplikuesi apo ekonomia familjare nuk ka përfituar grant nga MBPZHR në tri vitet e fundit		10		
7.	Pronësia mbi token ⁷	Toka në emër të aplikuesit.	10		
8.	Aplikuesi i ri ⁸	Aplikanti është 40 vjeç ose më i ri	3		
9.	Gjinia e fermerit ⁹	Aplikuesi femër	2		
GJITHSEJ			100		

⁶ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtitshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtitshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së para nënshkrimit të kontratës, ad-hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtitshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligjit Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural

⁷ E tërë toka përfshir token ku bëhet investimi duhet të jetë në emër të aplikuesit në tri vitet e fundit. Krijimi i kushteve artificiale për të marrë pikë paraqet mashtrim dhe do të ndëshkohet sipas nenit 38A, nen-nen-paragrafit, 1.2.3 të Ligjit Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

⁸ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

15. Procedurat për zbatimin e projekteve

15.1. Zbatimi

Procedura për zbatimin e PZHR 2022 bëhet sipas Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009), Ligji Nr. 04/L-090 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimit Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012), Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21/qershor 2016), Ligji Nr.08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 (Gazeta Zyrtare Nr.13/31 Dhjetor 2021) sipas këtij udhëzimi administrativ dhe legjislacionit në fuqi.

Masat 1 zbatohen nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

15.2. Thirrja për Aplikim

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është përgjegjës për hartimin, publikimin e thirrjen për Aplikim dhe udhëzuesit për aplikues, në pajtim me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.

15.3. Procedura e dorëzimit dhe shqyrtimit të aplikacioneve

Procedurat e dorëzimit dhe shqyrtimit të aplikacioneve janë:

1. Aplikimi bëhet përmes web-modulit online në web-faqen e AZHB-se www.azhb-ks.net, në të cilën gjendet linku “**aplikimi online**” që dërgon në modulën e aplikimit online. Në web-modul regjistrohet projekti si dhe ngarkohen (upload) dokumentet e nevojshme për aplikim në PDF. *(Duhet të kihet kujdes të ngarkohen të gjitha dokumentet para se të klikohet butoni përfundo, pasi që të klikoni butonin përfundo nuk mund të riktheni më për ngarkim të ndonjë dokumenti)*
2. Pas përfundimit të procesit të aplikimit online nga nën paragrafi 1.1 i këtij neni, fillon shqyrtimi administrativ i aplikacioneve;
3. Procesi i vlerësimit të aplikacioneve;
4. Shpallja publike e rezultateve preliminare të vlerësimit të projekteve;
5. Njoftimi i fermerit me rezultatin e vlerësimit të projektit;
6. Periudha e ankimimit/ E drejta e ankesës;
7. Kontrolla e parë në terren;
8. Miratimi / Refuzimi i projekteve;
9. Periudha e ankimimit;
10. Nënshkrimi i kontratës në mes të përfituesit dhe AZHB-së;
11. Koha e kryerjes së investimeve;
12. Dorëzimi i kërkesës për pagesë nga përfituesi bëhet në AZHB;
13. Kontrolli administrativ i pakos së kërkesës për pagesë;

14. Kontrolla e dytë në terren;
15. Masat ndëshkimore në rast të parregullësive gjatë zbatimit të projekteve;
16. Autorizimi dhe ekzekutimi i pagesës;
17. Kontrolla pas zbatimit të projektit;
18. Vendimi për kthimin e mjeteve financiare;
19. E drejta e ankesës.

- Procedimi administrativ përfundon brenda një periudhe prej 45 ditëve, pas përfundimit të procesit të aplikimit deri tek raporti i vlerësimit/publikimi i rezultateve preliminare mbi përkrahjen, në pajtim me nenin 98 Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- Në rastet e kompleksitetit të çështjes administrative, afati mund të shtyhet bazuar në nenin 99 të Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

16. Dorëzimi i aplikacioneve

1. Aplikimi online duhet të ketë të ngarkuara të gjitha dokumentet e kërkuara brenda afatit për aplikim;
2. Në aplikacionin online duhet të përfshihen projekti me të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim;
3. Aplikuesi mund të aplikoj vetëm një herë brenda programit për zhvillim rural 2022;
4. Aplikuesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri, nëse projekti i mëparshëm nuk është përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB;
5. Aplikuesi siguron që të gjitha informatat dhe dokumentet e dhëna janë të qarta dhe të sakta;
6. Aplikuesi pranon një njoftim online përmes e-mailit për dorëzimin e aplikacionit.

17. Kontrolli, vlerësimi dhe miratimi i aplikacioneve në AZHB

1. Kontrolli dhe vlerësimi i aplikacioneve duhet të filloj pas mbylljes së afatit për aplikim;
2. Aplikacionet e kompletuara i nënshtrohen vlerësimit të mëtutjeshëm të shpenzimeve të pranueshme dhe vlerësimit të qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare;
3. Nëse projekti apo kërkesa është vlerësuar nga ekspertët e fushës përkatëse, shqyrtimi i projektit apo i kërkesës shtyhet deri sa ekspertët e fushës përkatëse të ofrojnë rekomandim;
4. Pranueshmëria e shpenzimeve kontrollohet dhe miratohet, duke i krahasuar me çmimet referente / çmimoret e aprovuara nga MBPZHR;
5. Një projekt/aplikacion mund të përzgjidhet për mbështetje vetëm nëse arrin pragun minimal prej 50 pikësh deri në pragun maksimal prej 100 pikësh. Pragu minimal vendoset për të siguruar që projektet e përkrahura sjellin vlerë të shtuar të mjaftueshme për sektorin;

6. Pas vlerësimit dhe poentimit të projekteve, bëhet shpallja publike e listës preliminare të vlerësimit të projekteve të zhvillimit rural në ëeb-faqen zyrtare të MBPZHR-së dhe AZHB-së;
7. Njoftimi për publikimin e listës preliminare të përfituesve të mundshëm listës së vlerësimit të aplikimeve të projekteve të zhvillimit rural bëhet në web-faqen zyrtare të MBPZHR-së dhe AZHB-së;
8. AZHB përmes postës elektronike dhe mesazheve SMS duhet t'i njoftojë të gjithë aplikuesit për publikimin e listës së vlerësimeve preliminare të projekteve të zhvillimit rural po atë ditë;
9. Aplikuesit që konsiderohen përfitues të mundshëm kanë të drejtë që brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga dita e marrjes së njoftimit të paraqiten në AZHB për të marrë letrën informuese dhe vlerësimin e projektit të tyre;
10. Afati i ankimit fillon të rrjedh ditën e nesërme, pas publikimit të listës preliminare të përfituesëve të mundshëm të projekteve të zhvillimit rural;
11. Në të njejtën ditë Lista me përfituesit e mundshëm / projektet e përzgjedhura dërgohet tek Drejtorati i Kontrollës në AZHB për kontrollën e parë në terren, e cila duhet të fillojë menjëherë;
12. Në bazë të raportit të kontrollës së parë në terren dhe raportit të procesit të ankimit, bëhet miratimi i projekteve të zhvillimit rural për financim dhe aprovohet Lista përfundimtare e përfituesëve të projekteve të zhvillimit rural, e cila duhet të publikohet në uebfaqen e MBPZHR-së dhe të AZHB-së;
13. Të gjithë aplikuesit duhet të informohen për përzgjedhjen ose refuzimin e projektit të tyre;
- 1.4. Pas miratimit të projekteve, hartimit të Listës përfundimtare të përfituesëve të projekteve të zhvillimit rural dhe njoftimit të aplikuesëve përfitues, bëhet nënshkrimi i kontratës ndërmjet përfituesit dhe AZHB-së;
- 1.5. Aplikanti ftohet të nënshkruaj kontratën për bashkë – financim të projektit brenda pesë (5) ditëve pas pranimit të letër imfotimit për miratimin e projekteve;
16. Pas nënshkrimit të kontratës, përfituesi është i obliguar që të fillojë zbatimin e projektit sipas kontratës.

18. Vlerësimi, përzgjedhja, kontraktimi dhe implementimi

AZHB përdor listën e kontrollimit të aplikuesve dhe projekteve dhe mund të verifikon të dhënat me sistemet zyrtare (Regjistrin e fermës dhe Regjistrin për identifikim të kafshëve).

Aplikacionet duhet të refuzohen nëse nuk janë të kompletuara, nëse nuk e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë ose/edhe kur e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë mund të mos përfitojnë për shkak të numrit të vogël të pikëve në krahasim me aplikuesit e tjerë dhe buxhetit të paraparë.

Aplikacionet e pakompletuara refuzohen në momentin e verifikimit nga zyrtari i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, me rastin e dorëzimit të tyre. Në rast se konstatohet më vonë se aplikacioni nuk është i kompletuar, ai po ashtu refuzohet.

Aplikacionet e papranueshme – deklarohen të papranueshme gjatë procesit të vlerësimit të cilin e bëjnë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë. Projektet mund të deklarohen si të papranueshme gjatë kontrollit administrativ (psh. mospërputhje me të dhënat nga Regjistri i Fermës apo Regjistri për Identifikimin e Kafshëve), gjatë vlerësimit të dokumenteve (psh. vlerësimi i Planit të Biznesit) ose gjatë kontrollit në terren (psh. pemishtja ose Serra ka qenë e ngritur më herët). Projektet e papranueshme nuk i nënshtrohen procesit të dhënies së pikëve.

19. Vlerësimi i planit të biznesit ose i projekt-propozimit

Aplikacionet me vlerë të investimeve të pranueshme mbi 20,000 € duhet të përmbajnë një plan të biznesit, sipas modelit të paraqitur në shtojcën.

Aplikacionet me vlerë të investimeve të pranueshme deri në 20,000 € duhet të përmbajnë një projekt-propozim sipas modelit të paraqitur në shtojcën.

Nëse aplikacioni parasheh plan biznes, atëherë nuk ka nevojë të ketë projekt-propozim.

Disa informata që përfshihen në planin e biznesit ose në projekt-propozim, duhet të merren parasysh për poentimin e aplikacioneve. Gjithashtu, këto dokumente paraqesin burimin e të dhënave për plotësimin e formularit për indikator.

Të dhënat/informatat e paraqitura Brenda këtyre dokumenteve mund të kontrollohen në të gjitha bazat e të dhënave ekzistuese (Regjistrin e fermës, regjistrin për identifikimin e kafshëve, regjistrin kadastral të vreshtave, sLPIS etj.), duhet të mbështeten me dokumentet shtesë – shih shtojcën nr. 1, dhe duhet të jetë subjekt kontrollimi në terren para se kontrata të nënshkruhet, para pagesës së mjeteve financiare dhe pasi që projekti është përfunduar, gjatë periudhës së monitorimeve ex-post.

Plani i biznesit ose projekt-propozimi duhet ta respektojë plotësisht modelin e përgatitur nga MBPZHR. Të gjithë kapitujt duhet të trajtohen; mostrajtimi i ndonjë kapitulli është arsye e mjaftueshme për refuzimin të aplikacionit. Paraqitja e kapitujve shtesë do të injorohet gjatë vlerësimit të projektit.

19.1. Përmbajtjet e mëposhtme janë pjesë e vlerësimit të planit të biznesit:

1. Të gjithë kapitujt dhe nënkaptujt janë trajtuar: nëse nuk është relevante atëherë duhet sqaruar arsyeja;
2. Është përmbushur së paku 1 (një) objektive specifike e masës;
3. Kthimi i investimeve dëshmon që fitimi shtesë (të hyra shtesë – kosto shtesë) mbulon kostot e investimeve (të llogaritet vetëm bashkëfinancimi privat) për më pak se 10 vjet;
4. Vlerësohet se aplikuesi ka mjaft staf (të punësuar) për të funksionuar biznesi;
5. Blerjet/ndërtimet e propozuara janë në pajtim me nevojat e aplikuesit (p.sh. jo më shumë traktorë, rimorkio, apo makina se sa ka nevojë; nuk lejohen ndërtesa nëse aplikuesi ka mjaft);
6. Çmimet për blerjet/ndërtimet janë të arsyeshme;
7. Orari për blerjet/ndërtimet është real dhe jep mundësinë që investimi të përfundojë në afatin e implementimit të paraparë në udhëzues.
8. Është paraqitur kapaciteti i prodhimit para dhe pas investimit
9. Rritja e paraparë e kapacitetit prodhues është plotësisht e dëshmuar bazuar në investimin e propozuar
10. Është përshkruar procesi teknologjik dhe teknologjia e zbatuar;
11. Procesit teknologjik është në përputhje me asetet ekzistuese plus investimet e parapara dhe shërbimet e ofruara;
12. Furnizuesit potencial dhe klientët potencial janë identifikuar
13. Strategjia e tregut është reale
14. Për të gjithë investimet e pranueshme dhe të papranueshme janë paraqitur saktë vlerat e ndihmës publike dhe financimit privat;
15. Bilanci i rrjedhjes së parasë në fund të çdo muaji, duhet të jetë pozitiv në 3 vitet e ardhshme pas

- përfundimit të investimit;
16. Të hyrat totale janë në përputhje me kapacitetin prodhues;
 17. Të hyrat totale në llogaritjen e kthimit të investimit janë në përputhje me të hyrat totale prodhimin të paraqitur në indikatorët e ndikimit;
 18. Aplikuesi nuk ka krijuar kushte artificiale për të përfituar përparësi.

Për projekt - propozimet janë të zbatueshme kontrollet nr: 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, dhe 18

20. Rradhitja në listë

Të gjitha projektet që kanë kaluar kriteret e pranueshmërisë, pas vlerësimit, duhet të rradhiten në listë në bazë të pikëve të fituara dhe eventualisht kohës së aplikimit. Përzgjedhja e përfituesve bëhet duke filluar nga aplikuesi me numrin më të madh të pikëve dhe vazhdon deri sa të shpenzohet buxheti i paraparë.

21. Procedurat e dhënies së grantit dhe njoftimi i aplikuesit

Pas vlerësimit, AZHB përgatit raportin e vlerësimit. Projektet klasifikohen në këtë raport në:

- 1) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë) dhe
- 2) Projekte të pranueshme dhe të vlerësuara me pikë.

Ky raport nënshkruhet nga Kryeshefi i AZHB-së.

Pas kontrollës administrative dhe vlerësimit, AZHB përgatit Raportin preliminar të publikimit i cili krahas publikimit në uebfaqe të AZHB-së, aplikuesit i dërgohet informatë me sms dhe email. Aplikuesit të cilët nuk e pranojnë informatën përmes sms-it dhe email-it mund të vijnë në AZHB për informata lidhur me aplikacionin e tyre. Raporti përfshinë: 1) projekte të pranueshme, të vlerësuara dhe të shpallura si përfitues potencial, 2) projekte të pranueshme dhe të vlerësuara dhe 3) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë - refuzuara). Raporti preliminar, nënshkruhet nga Kryeshefi i AZHB-së dhe publikohet në uebfaqe të AZHB-së dhe uebfaqe të MBPZHR-së. Prej ditës së publikimit të raportit preliminar në uebfaqe të AZHB-së, aplikuesi ka afat 30 ditë (kalendarike) të ushtroj ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në AZHB.

Shenim: Në rast se përfituesi tërhiqet nga implementimi i projektit pas nënshkrimit të kontratës, duke e njoftuar AZHB-në, ai e humb të drejtën e aplikimit për vitin vijues.

Përfituesit që pas nënshkrimit të kontratës nuk e implementojnë projektin dhe nuk lajmërohen në AZHB për tu tërhequr, humbin të drejtën e aplikimit për tri vitet e ardhshme.

22. Refuzimi i projekteve

Aplikuesi refuzohet nëse:

1. Dokumentacionin e ka të pa kompletuar;
2. Dështon t'i plotëson kriteret e pranueshmërisë;
3. Shpenzimet nuk mund të verifikohen si të pranueshme;
4. Projekti nuk është i qëndrueshëm ekonomikisht;

5. Në rast të mashtrimit në çdo fazë të procedurës;
6. Nëse projekti i financuar nga përkrahja publike nuk është funksional sipas projektit/ plan biznesit dhe kontratës;
7. Në rast të mos respektimit të kushteve të kontratës për financim të projektit;
8. Aplikuesi i cili aplikon për investime publike gjithashtu do të refuzohen nëse ata dështojnë të kryejnë procesin e prokurimit sipas rregullave të aplikueshme të prokurimit.
9. Aplikuesi njoftohet për projektin që është refuzuar me anë të vendimit për refuzim të nxjerr nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.
10. Vendimi për refuzim përmban arsyet e refuzimit në mënyrë të detajuar.

23. Kërkesa për pagesë

1. Përfituesit që kanë përfunduar investimin sipas kontratës e dorëzojnë kërkesën për pagesë në Zyret Regjionale të AZHB-së.
2. Formulari i kërkesës për pagesë mund të shkarkohet nga web-faqja e AZHB-se apo sigurohet nga Zyra Regjionale e AZHB-së.
3. Kërkesa për Pagesë me dokumentacionin e kompletuar dorëzohet kopje fizike, dhe një CD me dokumentet e skanuara, personalisht nga përfituesi ose nga personi i autorizuar, siç është përcaktuar në Kontratën për financimin e projekteve.
4. Nëse kërkesa për pagesë nuk është e kompletuar me të gjitha dokumentet sipas kontratës, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon Kërkesën për pagesë, por e regjistron atë duke i dhënë përfituesit një kopje dhe i kërkon plotësimin e dokumentacionit përkatës brenda afatit prej pesë (5) ditëve.
5. Nëse përfituesi brenda afatit të përcaktuar sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij Neni, nuk e dorëzon dokumentacionin e kompletuar, kërkesa për pagesë refuzohet.
6. Pas kontrolles administrative të kërkesës për pagesë, Drejtoria e Kontrollit në AZHB bën kontrollën e dytë në terren për tu siguruar se investimi është bërë sipas projekt propozimit / biznesit planit të aprovuar dhe letres miratuese.
7. Në rast të gabimeve teknike në pakon e kërkesës për pagesë aplikuesi duhet të njoftohet për korigjimin e gabimeve teknike, në afat prej pesë (5) ditëve.
8. Nëse përfituesi brenda afatit të përcaktuar sipas paragrafit 7 të këtij neni, nuk e korigjon dokumentacionin me gabime teknike, ky dokument refuzohet.
9. Në bazë të Vlerësimit të Raportit të Kontrollit nga terreni dhe faturave të dorëzuara, me kërkesën për pagesë dhe çmimorese se AZHB-se, AZHB nxjerr Vendim për pagesë brenda afatit 60 ditësh dhe e njofton përfituesin përmes me një Letre Informuese.
10. Asnjë pagesë nuk bëhet për përfituesit për të cilën konstatohet se kanë krijuar kushte artificiale për marrjen e pagesave.
11. Nëse kërkesa për pagesë nuk është pranuar apo mbështetja publike është zvogëluar, përfituesi duhet të informohet përmes Letrës Informuese.
12. Prej ditës së dorëzimit të kërkesës për pagesë deri te ekzekutimi i pagesës nuk duhet të kalojnë më shumë se

(90) ditë, përveç nëse një tejkalim i afatit bëhet për arsye objektive.

13. Para kërkesës për pagesë perfituesi duhet të vendos në vend investim tabelen me logo të MBPZHR/AZHB me madhësi 100cmx50cm * të përcaktuar sipas Shtojcave të këtij udhëzuesi.

14. Pagesa duhet të bëhet në afat prej (30) ditësh nga dita e Vendimit për pagesë.

15. Në rast të kontestimit të vendimit për pagesë ose vendimit për refuzim të pageses, perfituesi ka të drejtë ankese dhe të kërkojë rishqyrtimin e vendimit përkatës.

16. AZHB krijon një Komision të veçantë për ankesa që ndërlidhen me vendimin për nderprerje të kontratës, vendimin për pagesë, vendimin për refuzim dhe vendimit për përjashtim për tri vite.

17. Kundër vendimit të Komisionit pala ka të drejtë të ushtroj padi për konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.

23.1. Dokumentacioni i kërkuar për pagesë

1. Kërkesa për pagesë duhet të përmbajë origjinalin e dokumenteve të kërkuara sipas kërkesës për pagesë dhe një CD me dokumentet e skanuara. (sipas formularit të kërkesës për pagesë)

2. Pagesat mbi shumën pesëqind euro (500.00€), bëhen përmes transferit bankar dhe duhet të vërtetohen me pasqyrat bankare të llogarise rrjedhëse.

3. Për pagesat me vlerë nën pesëqind euro (500.00) € nëse pagesa është bërë me para në dorë, duhet të sigurohet faktura dhe kuponi fiskal, kurse nëse pagesa është bërë përmes bankës duhet të dorezohet fletepagesa e transferit bankar.

24. Shkalla e kontrolleve në teren

1. AZHB obligohet të kontrollojë në teren në shkallën prej 100 % të gjitha projektet, të cilat janë përzgjedhur si perfituese nga PZHR 2022 dhe të verifikojë përmbushjen e kriterëve për financim.

2. Pas parashtrimit të Kërkesës për pagesë, Drejtoria e Kontrollit e AZHB-së është i obliguar të verifikojë zbatimin e investimeve me anë të kontrollit në teren. Në këtë rast perfituesi është i obliguar të jete i pranishëm gjatë zhvillimit të kontolles në teren me se largu 5 dite nga njoftimi i AZHB-së.

3. Rikontrolli në terren bëhet në raste të caktuara dhe me kërkesë të Drejtorive përkatëse të AZHB-së.

4. Në bazë të raportit të kontrollit për verifikimin, kërkesës për pagesë me dokumentacionin e bashkangjitur për kryerjen e investimeve, bëhet autorizimi i pagesës.

5. AZHB kryen Ex-post kontroll për verifikimin e të gjitha projekteve të përzgjedhura për financim tre (3) vjet, nga dita e ekzekutimit të pagesës së fundit. Në këtë rast perfituesi është i obliguar të jete i pranishëm gjatë zhvillimit të kontolles në teren me se largu 5 dite nga njoftimi i AZHB-së.

6. AZHB me vendim të veçantë e cakton komisionin për superkontroll të projekteve.

24.1. Kontrolla e veçantë

Për kontrollën e veçantë në terren, në rastet të investimeve në ndërtimtari dhe investimeve që kërkojnë ekspertizë të veçantë, AZHB mund të angazhojë ekspertë të fushave përkatëse për të dhënë vlerësim profesional.

25. Procedura e ankesave për aplikues

1. Aplikuesit e pakënaqur me rezultatin e vlerësimit kanë të drejtën e ankesës ndaj vendimeve të AZHB-së.
2. Ankesa duhet t'i drejtohet Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave.
3. Aplikuesi mund të paraqesë ankesë me shkrim në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të Listës preliminare të përfituesëve të mundshëm të projekteve të zhvillimit rural.
4. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës, duhet të jep përgjigje me shkrim, me arsyetim të plotë, drejtuar parashtruesit të ankesës.
5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të tij, me të cilin:
 - 5.1. Refuzon ankesën ndaj vendimit të AZHB-së në lidhje me vlerësimin e projektit përkatës.
 - 5.2. Aprovon ankesën dhe anulon vendimin e AZHB-së në lidhje me vlerësimin e projektit përkatës dhe merr vendim meritior.
6. Gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave mund të kërkoj informacione të nevojshme nga AZHB, të realizojë vizita në terren dhe të kërkoj informata edhe drejtpërdrejt nga pala në lidhje me projektet përkatëse.
7. Kundër vendimit përfundimtar në procedurë të rregullt administrative nuk lejohet ankesë por me padi mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente.

25.1. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave

1. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave është një trup profesional për shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen për ankesa, i cili përbëhet nga zyrtarë të AZHB-së dhe MBPZHR-së dhe themelohet me vendim të MBPZHR-së.
2. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave përbëhet nga pesë (5) anëtarë, dy (2) prej të cilëve janë zyrtarë në AZHB, ndërsa tre (3) prej të cilëve janë zyrtarë të MBPZHR.
3. Anëtarët e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave janë të pavarur në punën e tyre dhe vendimet i marrin në pajtim me faktet dhe gjendjen e verifikuar.
4. Anëtari i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave obligohet që:
 - 4.1. Të zbatojë kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ;
 - 4.2. Të jetë i paanshëm;
 - 4.3. Të ushtrojë të drejtën e votës së lirë dhe të pandikuar;
 - 4.4. Të marrë pjesë në takimet e Komisionit dhe të nënshkruaj raportet punuese dhe vendimet përkatëse.
5. Komisioni për ankesa nga paragrafi 2 i këtij neni obligohet që vendimet e marra të hartoi në pajtim me arsyetimin e aktit administrativ të përcaktuar në nenin 48 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr.20/21 Qershor 2016).
6. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave obligohet që për punën e vet dhe për veprimet e marra të hartojë raport me shkrim dhe të informojë zyrtarët më të lartë të MBPZHR-së dhe AZHB-së, si dhe palët e interesit, më së largu

30 ditë nga dita e përfundimit të afatit të ankimimit.

26. Trajtimi i lëndëve të gjykatave

Lëndët të cilat kthehen për rishqyrtim dhe rivendosje sipas Aktgjykimeve të Gjykatave përkatëse, trajtohen dhe përgatitet vendim nga Zyra Ligjore e AZHB-së.

27. Kushtet për mirëmbajtjen e investimit

1. Investimi për të cilin përfituesi ka marrë mbështetje nuk duhet të pësoj ndryshim thelbësor brenda tri (3) viteve nga data kur pagesa përfundimtare është pranuar.

2. Ndryshime thelbësore të një investimi janë ato të cilat rezultojnë në:

2.1. Ndërprerjen ose zhvendosjen e aktivitetit prodhues nga paragrafi 1 i këtij neni, në një fushë që nuk është e mbuluar me Program;

2.2. Ndryshimi i pronësisë në një pjesë të infrastrukturës e cila i jep një ndërmarrjeje ose institucioni publik një përparësi të pamerituar;

2.3. Ndryshim përmbajtjesor që ndikon në natyrën, objektivat ose kushtet e zbatimit të cilat rezultojnë me ndryshimin e objektivave fillestare.

3. Në rast të situatave të jashtëzakonshme që mund të ndikojnë në investim nga fatkeqësitë natyrore, përfituesi duhet të informojë AZHB-në brenda afateve, sipas kontratës së nënshkruar nga dy palët.

4. Përfituesit janë të detyruar të mbajnë të gjitha të dhënat e kontabilitetit në fermë të paktën tri (3) vjet pas zbatimit të projektit, si dhe të bashkëpunojnë me zyrtarët e MBPZHR-së për të siguruar çdo informacion të kërkuar nga AZHB ose MBPZHR si dhe zyrtarë tjerë të autorizuar nga të dy palët, për të kontrolluar dhe audituar zbatimin e projekteve. Kushtet e financimit do të përcaktohen më detajisht në kontratë në mes të përfituesit dhe AZHB-së.
Sqarim: Sa i përket të dhënave për të mbajtur kontabilitetin në fermë, informatat të merren në Departamentin e Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore (DAESB)

28. Kontrolla në terren Ex-posti dhe procedura pas zbatimit të projektit

1. Përfituesi është i obliguar ta kthejë mbështetjen financiare pjesërisht apo teresisht në rast se pas implemtimit kontratës deri në përfundim të periudhës monitoruese/ ex-post paraqiten parregullësi.

2. Në rast të evidentimit të parregullësive si në paragrafin 1 të këtij neni AZHB nxjerrë vendim për kthim të mbështetjes financiare publike pjesërisht apo teresisht si dhe Vendim për përjashim deri në tri vite në rast se nuk e kthen shumën financiare të kërkuar nga AZHB.

3. Përfituesi ka të drejtë ankese ndaj Vendimit si në paragrafin 2 të këtij neni, në Komisionin për shqyrtimin e ankesave të cilin e formon Kryeshefi Ekzekutiv i AZHB-së në përberje prej 3/5/7, për vendosje në ankesë.

4. Kundër vendimit përfundimtar në procedurë të rregullt administrative nuk lejohet ankesë por me padi mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente.

5. Pas përfundimit të procedurës së ankesës AZHB është e obliguar që të vazhdojë procedimin e kthimit të përkrahjes publike përmes organeve kompetente.

29. Dispozitat ndëshkimore

1. Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara në Nenin 38 të Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009), Nenin 38.A të Ligjit Nr. 04/L-090 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimit Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28, datë 16 Tetor 2012) dhe legjislacionin në fuqi.

2. Në rast të shkeljes së dispozitave të lartpërmendura, AZHB duhet menjëherë të informoj palën për shkelje të kontratës, ndërsa AZHB-së duhet të filloj procedurat ligjore sipas Kodit Nr.04/L-123 i Procedurës Penale (Gazeta Zyrtare Nr.37/28 Dhjetor 2012).

30. Dispozitat përfundimtare

30.1. Toka nën komasacion

Përjashtimisht dispozitave të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, aplikuesit të cilët e kanë sipërfaqen e tokës bujqësore nën komasacion por nuk e posedojnë kopjen e planit dhe fletën poseduese, por kanë aktvendime të ligjshme të komasacionit nga kadastru, ju lejohej aplikimi për përkrahje në kuadër të PZHR 2022.

30.2. Dokumentacioni për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok

1. Aplikuesit e komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok, të cilët nuk mund të sigurojnë fletat poseduese dhe kopjen e planit nga komuna e tyre perkatëse, këto dokumente duhet t'i marrin nga Agjencioni Kadastral i Kosovës.

2. Aplikuesit e komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok, ju lejohej të aplikojne për përkrahje në kuadër të PZHR 2022 pa vërtetim për tatimin në pronë.

31. Lista e shtojcave

1. Shtojca nr. 1: Formulari i aplikimit për Masën 1
2. Shtojca nr. 2: Lista e dokumenteve të dorëzuara
3. Shtojca nr. 3: Modeli për Përgatitjen e Projekt-Propozimit
4. Shtojca nr. 4: Modeli për përgatitjen e planit të biznesit
5. Shtojca nr. 5: Procedurat e prokurimit
6. Shtojca nr. 6: Standardet minimale kombëtare
7. Shtojca nr. 7: Lista e investimeve të pranueshme për Masën 1
8. Shtojca nr. 8: Zonat malore
9. Shtojca nr. 9: Kërkesa për pagesë
10. Shtojca nr. 10: Raporti i Vlerësimit
11. Shtojca nr. 11: Forma e ankesës për fermerë
12. Shtojca nr. 12: Kontaktet dhe vendet informuese për aplikim
13. Shtojca nr. 13: Formularët për mbledhjen e indikatorëve për M-1
14. Shtojca nr. 14: Pjesa financiare e planit të biznesit
15. Shtojca nr. 15: Promovimi
16. Shtojca nr. 16: Kodi i etikës për kompanitë këshilluese
17. Shtojca nr. 17: Kushtet specifike për ndërtimin e serrave
18. Shtojca nr. 18: Deklarata nën betim
19. Shtojca nr. 19: Deklarata për zotim

Shtojca Nr. 1 Formulari i aplikimit për masën 1

Formulari i aplikimit krijohet vet nga sistemi pasi që aplikimi është online

Shtojca Nr. 2 Lista e dokumenteve të dorëzuara

Lista e dokumenteve të kërkuara Masa 1 - 2022

Dokumentet e kompletuara (dosja) duhet t'i ketë dokumentet e radhitura si në listën e më poshtme.

Nr.	Dokumenti	Obligativ	Opcional
1.	Formulari për aplikim (Formulari i aplikimit krijohet nga sistemi pasi që aplikimi është online)	<input type="checkbox"/>	
2.	Kopja e Letërnjoftimit të aplikuesit i Republikës së Kosovës valid	<input type="checkbox"/>	
3.	Certifikata ose ekstrakti i lindjes	<input type="checkbox"/>	
4.	Certifikata e regjistrimit në regjistrin e fermës (NIF) me aneks	<input type="checkbox"/>	
5.	Formulari për indikator (<i>Plotësohet në formë fizike si dhe gjat aplikimit online</i>)	<input type="checkbox"/>	
6.	Në rastin e personave juridik: Certifikata e regjistrimit të biznesit me aneks dhe Certifikata e numrit fiskal-	<input type="checkbox"/>	
7.	<u>Në rastin e projekteve të ndërtimit/zgjerimit:</u> <ul style="list-style-type: none"> ○ Certifikata e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi; ○ Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit (Për tokat e marra me qira nga komunitat dhe APK-ja kontratat nuk kanë nevojë të noterizohen; ○ Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi; ○ Kopjen e skicave të objektit; ○ Paralogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara; ○ Pëlqimin e Komunës që dëshmon se në rast të dhënies së grantit, aplikuesi mund të marrë leje ndërtimi; <u>Në rastin e projekteve që parashohin renovim, aplikuesit, me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:</u> <ul style="list-style-type: none"> ○ Paralogarinë e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara; 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
8.	- Pëlqimi i Bashkëpronarve (Deklaratë e nënshkruar, të cilës i bashkangjitet kopja e letërnjoftimit në rast të investimeve në pronat me më shumë pronarë. - Deklarata nën betim për vijën e drejtë të gjakut (ti bashkangjiten si dëshmi edhe certifikata e lindjes dhe/apo certifikata e vdekjes apo certifikata e martesës).	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	

9.	5. Kopje fizike e digjitalizimit për vendin e investimit për të gjithë aplikuesit: aplikuesi para aplikimit duhet të bëjë digjitalizimin e vendit të investimit dhe një kopje fizike të pjesës së digjitalizuar t'ia bashkoj dosjes së aplikimit.	<input type="checkbox"/>	
10.	Plani i biznesit - Në rastin e projekteve në vlerë mbi 20,000 € ose Projekt-propozimi - Në rast të projekteve me vlerë deri në 20,000 €. Zyrtari verifikon nëse këto dy dokumente janë në përputhje me modelin e AZHB-së.	<input type="checkbox"/>	
11.	Në këtë pikë jo të gjitha dokumentet janë të obligueshme për të dëshmuar përvojën 2 vjeçare në sektor Certifikata e regjistrimit në regjistrin e fermës Deklarata për mbajtjen e 20 orë trajnim në fushën përkatëse, për aplikuesit që nuk i kanë 2 vite përvojë. Certifikata e regjistrimit të biznesit, nëse ndermarrja ka aktivitet primar bujqësinë dhe është regjistruar së paku 2 vjet para aplikimit		<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
12.	Aplikuesit duhet t'i kenë të rregulluara detyrimet tatimore dhe atë; Personat juridik: VËRTETIM nga Administrata Tatimore e Kosovës që dëshmon se aplikuesi duhet t'i kenë të rregulluara detyrimet tatimore në të ardhura të koorportave. Personat fizik: VËRTETIM nga komuna që ka të rregulluar tatimin në pronë*	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
13.	Autorizimi për menaxhim të projektit - Në rast se aplikuesi është person fizik, autorizimi për menaxhim bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri - në origjinal. Në rast se aplikuesi është ndërmarrje, i autorizuari për menaxhim duhet të jetë punëtorë i ndërmarrjes me kontratë punë jo më të shkurtër se 3 vjet. Obligative vetëm për ata aplikues që autorizojnë menagjer të projektit.		<input type="checkbox"/>
14.	Certifikata e pronësisë (fleta poseduese) që dëshmon pronësinë mbi tokën dhe kopja e planit ose Kontrata e qiramarrjes së tokës për së paku 10 vjet (e noterizuar) me kopjen e fletës poseduese të pronarit dhe kopjen e planit të bashkangjitur, përveç në rast të majmërisë së viçave kur dëshmohet toka si bazë ushqimore, toka e marrë më qira, duhet të jetë për së paku 3 vjet dhe nëse ka investime në makineri bujqësore, kontrata e tokës duhet të jetë për 5 vjet. Kontrata duhet të përmbaj edhe pëlqimin e qiradhënënsit për investimin që do të bëhet në pronën e tij.	<input type="checkbox"/>	
15.	Në rast të kontratave për qiramarrje nga APK-ja , të cilat janë për kohë më të shkurtër se sa është paraparë në masë, aplikuesi duhet të sjell një vërtetim nga qiradhënësi me të cilin vërteton se nuk do të ketë problem për vazhdimin e kontratës së qirasë.		<input type="checkbox"/>
16.	Kontratat me përpunuesit ose blerësit, të nënshkruara dhe të vulosur nga p[ërpunuesi ose blerësi.	<input type="checkbox"/>	
17.	Dëshmi që vërteton se aplikuesi ka përfunduar se paku shkollën fillore-kopje e noterizuar**.	<input type="checkbox"/>	
18.	Deklarata për zotim (për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të prezentuara)	<input type="checkbox"/>	

Dokumente tjera specifike sipas nënmasës				
19.	1.1, 1.1 a, 1.2 Pemet, peme manore	Nuk kërkohen dokumente shtesë		<input type="checkbox"/>
20.	1.3 dhe 1.3 a Serrat	Nuk kërkohen dokumente shtesë		
21.	1.4 Depot	Nuk kërkohen dokumente shtesë		
22.	1.5 dhe 1.6. Mishi	Çertifikata e regjistrimit në regjistrin për identifikimin e kafshëve me numër të viçave apo derrave.	<input type="checkbox"/>	
23.	1.7. dhe 1.8. Qumështi	Certifikata e regjistrimit në regjistrin për identifikimin e kafshëve me numër të lopëve qumështore /deleve /dhive	<input type="checkbox"/>	
24.	1.9 Pikat grumbulluese	Nuk kërkohen dokumente shtesë		
25.	1.10 Rrushi	Nuk kërkohen dokumente shtesë		
26.	1.11 Vezët	Fatura e blerjes së fundit të pulave (si dëshmi se aplikuesi ka pula në prodhimtari aktive)	<input type="checkbox"/>	

*Nëse aplikuesi nuk ka pronë të tatueshme në emrin e tij, ai duhet të sjellë një vërtetim nga komuna që vërteton këtë fakt ose vërtetimin në emër të ndonjërit nga anëtarët e ekonomisë familjare duke e përfshirë edhe emrin e aplikuesit.

**Dëshmi për përfundimin e së paku shkollës fillore është edhe dëshmia e përfundimit të shkollës së mesme apo të shkollimit të lartë.

Shtojca Nr. 3 Model për përgatitjen e projekt-propozimit

MODEL PËR PËRGATITJEN E PROJEKT-PROPOZIMIT

SHËNIM! Ky dokument duhet të respektohet në tërësi. Ky dokument nuk është për t'u plotësuar, por është një model si të shkruhet një projekt-propozim. Në rast se ekziston ndonjë kapitull që nuk ndërlidhet me projektin tuaj, ju duhet që një gjë të tillë ta cekni brenda kapitullit përkatës.

1 Informata të përgjithshme

1.1 Emri i aplikuesit (me të dhënat e tij specifike të identifikimit)

1.2 Asetet kryesore në pronësi të aplikuesit: tokë (me specifikim të llojit të pronësisë), pajisje dhe makineri, kafshë, etj. – sikur në Regjistrin e fermës

Tabela 1. Asetet e aplikuesit

Asetet	Data e blerjes / ndërtimi	Vlera e blerjes për persona fizikë ose gjendja e fundit e bilancit për persona juridik	Sasia (me copë)
1. Objektet – gjithsej			
1. 1 detaje.....			
1. n detaje.....			

Tabela 6. Shembull/Orari i realizimit të investimeve

Lloji i investimit dhe kostoja totale (euro)	Viti 2022		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
p.sh. Themelet e stallës	5000		
p.sh. muret e stallës		5000	
p.sh. kulmi i stallës			5000
p.sh. Blerja e paneleve solare			

5 Kapaciteti prodhues

Kapacitetet prodhuese që rezultojnë nga investimi (në njësi fizike). Perveq kapacitetit në njësi fizike duhet të paraqiten edhe vlerën e parashikuar monetare për kapacitetin prodhues të planifikuar. Duhet të paraqiten specifikimet e kapacitetit para dhe pas finalizimit të investimit. Duhet të jepet përshkrimi i procesit të prodhimit që aplikohet në investimin e planifikuar.

Nëse nuk përshkruhet kapaciteti prodhues dhe procesi i prodhimit, aplikacioni mund të refuzohet.

6 Furnizimi i tregut / shitja

Tabela 7. Furnizuesit potencial të aplikuesit

Furnizuesit potencial të aplikuesit				
Emri i furnizuesit me lëndët e para/materialet ndihmëse/produktet/ shërbimet	Adresa	Produkti furnizues dhe shuma e përafërt	Vlera e llogaritur	% nga shpërndarja totale
1				
2				
N				

Tabela 8. Klientët potencial të aplikuesit

Klientët potencial të aplikuesit			
Nr.	Klienti (Emri dhe adresa)	Vlera	% e shitjes
1			
2			
N			

Tabela 9. Detaje financiare të investimit

Shpenzime të detajuara të pranueshme dhe të papranueshme

Shpenzimet e pranueshme	Përkrahja publike	Bashkëfinancimi privat (euro)	Totali
Investimet e pranueshme			
...			
Shpenzimet administrative (për shembull: planin e biznesit)			
Investimet e papranueshme			
TOTALI			

Shtojca Nr. 4 Model për përgatitjen e planit të biznesit



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MODEL PËR PËRGATITJEN E PLANIT TË BIZNESIT

për projektet e përkrahura nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

SHËNIM!

Ky dokument duhet të respektohet në tërësi. Ky dokument nuk është për t'u plotësuar por është një model si të shkruhet plani i biznesit. Në rast se ekziston ndonjë kapitull që nuk ndërlidhet me projektin tuaj, ju duhet që një gjë të tillë ta cekni brenda kapitullit përkatës.

1 Informata të përgjithshme

1.1 Emri i përfutuesit (me të dhënat e tij specifike të identifikimit) Për personat fizik:

Emri dhe Mbiemri

Adresa e plotë NIF:

Numri i telefonit Për

personat juridik:

Emri i ndërmarrjes

Adresa e ndërmarrjes

Numri fiskal

Pronarët e ndërmarrjes

Personi i autorizuar për menaxhim të projektit Numri kontaktues i telefonit

1.2 Asetet kryesore në pronësi të aplikuesit: tokë (me specifikim të llojit të pronësisë), pajisje, makineri, kafshë, etj. – sikur në Regjistrin e fermës

Tabela 1. Asetet e aplikuesit

Asetet	Data e blerjes / ndërtimit	Vlera e blerjes per persona fizik ose gjendja e fundit e bilancit per persona juridik	Sasia (me copë)
1. Objektet – gjithsej			
1.1 detaje.....			
1. n detaje.....			
2.Pajisje – gjithsej			
2.1 detaje.....			
2. n detaje.....			
3. KAFSHË			
3.1 detaje.....			
3. n detaje.....			
4. Të tjera – detaje			
GJITHSEJ			

Tabela 2. Toka

Nr.	Rajoni/Komuna/Fshati	Sipërfaqja (m ²) / lloji i shfrytëzimit	Statusi juridik (pronë e aplikuesit, pronë familjare apo e marrë me qira)
1			
N			

Shto rreshta tjerë nëse ka nevojë!

Të dhëna për personat e ekonomisë familjare/ndërmarrjes

1.2 Për persona fizik:

Tabela nr. 3. Të dhëna për anëtarët e ekonomisë familjare

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vitii lindjes	Gjinia (M/F)	Profesioni/ vendi i punës	Të ardhurat (€)
1					
2					
3					
4					

5					
6					
7					

Shto rreshta tjerë nëse ka nevojë!

Tabela nr. 4. Pasqyra e prodhimeve kryesore të dy viteve paraprake

Nr	Produkti /	Njësia	Viti					
			2020			2021		
			Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Çmimi	Vlera
1								
2								
3								
4								
5								
Gjithsej								

Shto rreshta tjerë nëse ka nevojë!

1.2 Për persona juridik

Tabela nr. 5. Të dhëna për ndërmarrjen

Nr.	Pronarët (emri & mbiemri)	% e akcioneve	Aktivitetet e ndërmarrjes	Qarkullimi në vitin 2020	Qarkullimi në vitin 2021
1					
2					
3					

Tabela nr. 6. Pasqyra e prodhimeve kryesore të dy viteve paraprake

Nr	Produkti/ shërbimi	Njësia	Viti					
			2020			2021		
			Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Çmimi	Vlera
1								
2								
3								
4								
5								
6								
Gjithsej								

Shto rreshta tjerë nëse ka nevojë!

2 Përshkrimi projektit

2.1 Emërtimi i investimit

2.2 Vendi i projektit (rajoni, komuna dhe fshati)

2.3 Objektivat,

2.4 Arsyetimi i nevojës dhe mundësia e investimit

2.5 Duhet të ceket përputhshmëria mes objektivave të masës dhe objektivave të projektit. Sqarime për objektivat e përgjithshme dhe së paku për njërin prej objektivave të projektit duhet të bëhet paraqitja sipas tabelës në vijim:

Tabela 7. Harmonizimi i objektivave të programit me ato të projektit

Objektivat e përgjithshme dhe specifike	Objektivat e projektit (Shkruaj „x” në katrorin pranë objektivit të arritur)	Përshkrimi se si projekti synon që të arrijë objektivat (shkruaj brenda katrorëve të kësaj kolone paralel me objektivin e nën/masës
<i>Aftësia konkurruese</i>	<input type="checkbox"/>	
Së paku një prej objektivave specifike në vijim:		
Objektiva specifike të masës dhe nënmasës Hartuesi i projektit i merr objektivat e masës dhe nënmasës nga Programi dhe i paraqet në këtë kolonë	<input type="checkbox"/>	

Tabela 9. Përshkrimi i blerjeve/investimeve të kryera përmes projektit

Nr.	Emri / lloji i pajisjeve / makinerisë /shërbimeve etj.	Njësitë (m ² , ditë pune, kg, etj.)	Vlera pa TVSh	TVSh	Gjithsej vlera me TVSh	Përqindia e përkrahjes publike
GJITHSEJ						

Shënim: Duhet të cekën karakteristikat teknike të mekanizmit dhe paisjeve për të cilat aplikon

3 Kalendar i zbatimit (muajt) dhe fazat kryesore

Orari i investimit i shprehur me vlera, muaj dhe aktivitete.

Tabela 10. Planifikimi kohor i realizimit të investimeve

Lloji i investimit dhe kostoja totale (euro)	Viti (p.sh.: 2022)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
p.sh. përgatitja e tokës	5,000		
p.sh. mbjellja e fidaneve		15,000	
p.sh. sistemi mbajtës			8,000
P.sh. Panele solare			

4 Kapaciteti prodhues

Kapaciteti prodhues përveq kapacitetit në njësi fizike kg/tonë, aplikuesi të paraqes edhe vlerën e parashikuar monetare për kapacitetin prodhues të planifikuar dhe të harmonizohet me pjesët /kapitujt tjerë ku paraqiten të dhënat financiare.

Duhet të jepet përshkrimi i procesit të prodhimit që aplikohet në investimin e planifikuar.

Nëse nuk përshkruhet kapaciteti prodhues dhe procesi i prodhimit, aplikacioni mund të refuzohet.

Duhet të jepet përshkrimi i rrjedhës teknologjike të punës që aplikohet në teknologjinë e projektit.

5 Furnizimi i tregut / shitja

Tabela 12 Furnizuesit potencial të aplikuesit

Furnizuesit potencial të aplikuesit				
Emri i furnizuesit me lëndet e para/produktet / shërbimet (kur furnitori është vendor të vendoset shenja „V” pas emrit)	Adresa	Produkti furnizues dhe shuma përafërt	Vlera e llogaritur	% nga shpërndarja totale
1				
2				
N				

Tabela 13. Klientet potencial të aplikuesit

Klientet potencial të aplikuesit			
Nr.	Klienti (Emri dhe adresa) kur blerësi është vendor të vendoset shenja „V” pas emrit	Vlera	% e shitjes
1			
2			
N			

Sqarim: Aplikuesit duhet ti kenë kontratat me klientët e tyre potencial për shitjen e prodhimit.

6 Konkurrenca dhe strategjia e tregut

Përshkrimi i konkurrencës lokale dhe ndërkombëtare. Përshkrimi i strategjisë së tregut.

7 Detaje financiare të investimit

Tabela 14. Shpenzime të detajuara të pranueshme dhe të papranueshme

Shpenzimet e pranueshme	Ndihma publike	Bashkë-financimi privat (euro)	Totali
Investimet e pranueshme			
...			
Shpenzimet administrative (për shembull: planin e biznesit)			
Investimet e papranueshme			

TOTALI			
---------------	--	--	--

8 Rrjedhja e parasë (hyrje-daljet)

Parashikimi i hyrjeve dhe daljeve për 3 vjet pas finalizimit të investimit. Aplikuesi duhet të demonstrojë se ekonomia e tij do të jetë fitimprurëse dhe se paratë e gatshme asnjë muaj nuk do të ketë vlerë negative. Aplikuesi duhet pasur parasyshë se si të hyra duhet të deklarohen vetëm të hyrat nga shitja e prodhimit si rezultat i zbatimit të projektit në ket kolone pra mos shkruani të hyra nga burime tjera si psh të hyra nga prodhimet tjera pagesa direkte kredi etj.

Gjithashtu gjatë plotësimit të formularit për mbledhjen e trguesve të monitorimit (indikatorit) të keni parasyshë që në kolonen - Lloji i treguesit të pjesa e ndikimit rubrikat:

Vlera totale e të hyrave pa zbatim të projektit të ndikimit të formularit për indikatorët përputhet me vlera totale e të hyrave të parashikimi i shpenzimeve dhe të hyrave pa zbatimin e projektit në pjesën e kthimit të investimit (K I) dhe

Vlera totale e të hyrave me zbatim të projektit të ndikimit të formularit për indikator të përputhet me vlera totale e të hyrave të parashikimi i shpenzimeve dhe të hyrave nëse zbatohet projekti në pjesën e kthimit të investimit (K I).

Tabela 15. Rrjedhja e parasë për tri vitet pas investimit (Ju lutemi, shfrytëzojeni tabelën në excel publikuar në webfaqe e AZHB)

Rrjedhja e parasë-Cash-floë					
Të hyrat			Shpenzimet		Saldo (euro)
Data	Artikulli	Vlera (euro)	Artikulli	Vlera (euro)	
Viti 1			Lëndët e para kryesore		Nëse në këtë kolonë paraqitet një vlerë negative, projekti duhet të refuzohet si i pa pranueshëm
			Fuqia punëtore		
Muaji 1			Rryma, uji		
			Transporti/karburanti		
			Mirëmbajtja dhe riparimet		
			këstet e kredisë		
			Investime të reja		
	Tjera		Tjera		
	Total	0.00	Total	0.00	

Kthimi i Investimeve- KI / për grantet e zhvillimit rural

Vitet	Parashikimi i shpenzimeve dhe të hyrave pa implementimin e projektit (euro)			Parashikimi i shpenzimeve dhe të hyrave nëse implementohet projekti (euro)			Dallimi si rezultat i implementimit të projektit (euro)				Vlera e bashkë-financimit privat të shpenzimeve të pranueshme (euro)	Kthimi i Investimit KI (nëse të gjitha rubrikat
	Vlera totale e shpenzimeve të	Vlera totale e	Profiti	Vlera totale e shpenzimeve të	Vlera totale e të	Profiti	Dallimi në të	Dallimi në	Profiti shtesë	Profiti shtesë (pasqyrë)		
Viti			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
2			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
3			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
4			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
5			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
6			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
7			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
8			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
9			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
10			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00

Skjarim:

Vetëm në rubrikat e bardha mund dhe duhet të shkruhet



Së paku numri në fund të kësaj kolone duhet të jetë pozitiv, përndryshe projekti duhet të refuzohet si i papranueshëm sepse profiti shtesë nuk e mbulon investimin as pas 10 vitesh

Shtojca Nr 5. Procedurat e prokurimit
(t'i bashkëngjiten kontratës së Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, për përfituesit)

1. Dispozitat e përgjithshme të zbatueshme për të gjitha llojet e blerjeve

- Asnjë nënkontraktues i kontraktuar nga përfituesi nuk mund të kontraktojë ndonjë nënkontraktues tjetër për realizimin e kontratës;
- Blerjet duhet t'i respektojnë investimet që përmbushin kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në kuadër të masave dhe udhëzimeve të planit të biznesit psh. për sa i përket kthimit të investimeve, rrjedhës së parasë, etj.;
- Procedurat e prokurimit vlejné vetëm për investimet e pranueshme. Për investime të papranueshme nuk janë të obligueshme procedurat e prokurimit;
- Ka 3 lloje të procedurave: blerjet e drejtpërdrejta, blerjet me së paku 3 oferta dhe përzgjedhje të bazuar në prokurim me shpallje publike (tender i hapur);
- Procedura për blerjet që do të aplikohen është në varësi të vlerës së blerjeve; Është e ndaluar ndarja e blerjeve për llojin e njëjtë të mallrave, punimeve apo shërbimeve me qëllim të shmangies së rregullave procedurale të aplikueshme për një prag më të lartë;
- Ofertuesit nuk duhet të jetë në konflikt të interesit;
- Ofertuesit do të përjashtohen nga dhënia e kontratave; në rastin e shtrembërimit të informacionit të kërkuar nga përfituesi ose nëse dështojné për të dhënë këtë informacion. Respektimi i rregullave të prokurimit është kusht i detyrueshëm për t'u pranuar shpenzimet. Prandaj, dosja e kërkesës duhet të përmbajë dokumentet e pagesave për të dëshmuar plotësimin e procedurave të prokurimit, shih shtojcën 5.

2. Kriteret e dhënies së kontratës

Kontratrat duhet të jepen duke u bazuar në këto kritere:

A. Në rast të furnizimit me mallra - të bazuar në çmimin më të ulët;

B. Në rastin e ndërtimit (nënkupton rezultatit e ndërtimit ose projektit të inxhinierisë civile që vetvetiu është e mjaftueshme të plotësojë një funksion ekonomik ose teknik dhe mbulon të dyja dizajnimin dhe ekzekutimin) - bazuar në çmimin më të ulët;

C. Në rast të shërbimeve (studime ose për ndihmë teknike) - bazuar në çmimin më të ulët;

Përkufizimi i konfliktit të interesit

- Ekzistimi i lidhjeve ndërmjet përfituesit dhe furnizuesit (të afërm, apo aksionarë të përbashkët në kompanitë ofertuese) ose në mes të anëtarëve të Komitetit Vlerësues.
- Pronësia e përbashkët (si individë ose si aksionarë) në mesin e furnizuesve të cilët dorëzojnë oferta.

3. Procedurat e blerjes:

3.1 Blerjet direkte deri në 10,000.00 euro. Rregullat:

- Përfituesi mund të blejë drejtpërdrejt nga tregu;
- Kostoja e blerjes duhet t'i respektojë pragjet e vendosura në masë;
- Nuk ka nevojë për një kontratë të nënshkruar në mes të shfrytëzuesit dhe furnizuesit, përveç në rast të shpenzimeve të konsulencës;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

3.2 Përzgjedhja bazuar në të paktën 3 oferta për blerjet në vlerë prej 10,000.01 euro deri në 60,000.00 euro.

Rregullat:

- Blerjet mund të bëhet vetëm me së paku 3 oferta (kuotim i çmimit);

- Shpenzimet brenda ofertës duhet t'i respektojnë edhe pragjet e vendosura brenda masave;
- Në të gjitha rastet, duhet të nënshkruhet kontrata mes përfituesit dhe furnizuesit;
- Ftesat për oferta, ofertat dhe kontrata duhet të respektojnë dispozitat/detajet e të cilave janë paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe brenda planit të biznesit;
- Përfituesi duhet të dërgojë një ftesë për oferta, duke respektuar një format standard-shih shtojcën nr. 1 të kontratës;
- Furnizuesit duhet të regjistrojnë ofertën e tyre në regjistrin e hyrje/daljeve;
- Përfituesi duhet të nënshkruajë deklaratën për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit-shih shtojcën nr. 2 të kontratës;
- Ofertuesit duhet të nënshkruajnë deklaratën e tenderuesit të besueshëm-shih shtojcën 3;
- Përfituesi vendos për dhënien e kontratës ofertuesit dhe argumenton arsyen e përzgjedhjes;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

3.3 Prokurimi me shpallje publike (tender i hapur) –për blerjet në vlerë mbi 60,000.00 euro

Rregullat:

- Të gjitha dispozitat nga pika 3.2. duhet të respektohen;
- Përfituesi duhet tapublikojë interesin e tij për blerjen përmes shpalljes në së paku 1 gazetë të përditshme kombëtare, por në qoftë se vlera është më e lartë se 150,000 €, tenderi duhet të paraqitet edhe në mediet ndërkombëtare. Përveç kësaj, përfituesi ka të drejtë të dërgoj direkt ftesat për furnizuesit e mundshëm për të siguruar një konkurrencë më të mirë në mesin e ofertave, por vetëm në të njëjtën ditë kur është shpallur tenderi;
- Përmbajtja e ftesës publike duhet të përfshijë të gjithë informacionin e paraqitur në Shtojcën1;
- Afati kohor për marrjen e ofertave duhet të jetë të paktën 10 ditë; Përfituesi do të krijojë një komision vlerësimi. Ky komision duhet të ketë një numër tek të anëtarëve, të paktën tre, me të gjitha kapacitetet teknike dhe administrative të nevojshme për të dhënë një opinion të vlefshëm mbi tenderët;
- Komisioni i vlerësimit duhet të lëshojë një vendim të argumentuar për dhënien e tenderit; Anëtarët e komisionit të vlerësimit duhet të nënshkruajnë një deklaratë të konfidencialitetit dhe neutralitetit. Shih Shtojcën 4;
- Të gjitha kërkesat për pjesëmarrje dhe tenderët që i plotësojnë kërkesat, duhet të vlerësohen dhe renditen nga komisioni i vlerësimit në bazë të kriterëve të përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës të shpallura paraprakisht;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

Shtojca 1. e Procedurave të Prokurimit Ftesë për dorëzimin e një ofertë

Emri i përfituesit privat.....
 Numri i regjistrimit të Biznesit ose numri personal i identifikimit..... Numrit
 fiskal.....
 Adresa.....
 Fiks. tel. /faks/e-mail.....Nr.....Data.....

Për: Emri i kompanisëE pranuar sot:.....
 Nr.....Data.....
 Emri dhe Mbiemri:.....

Nr. i regjistrimit të biznesit..... Numri
 fiskal.....

Nënshkrimi.....

**Ftesë për dorëzimin e një oferte
(Formular)**

Të nderuar Zonja/Zotëri,

(Emri i Përfituesit) ju fton që ta paraqitni ofertën tuaj për (lloji i blerjes)për zbatimin e një projekti të bashkë-financuar nga MBPZHR nënmasën/nënmasën kodin <masa/nën-masa dhe emri> me titullin e mëposhtëm titulli i projektit, i cili do të zbatohet në komunën <Emri komuna>.

Përzgjedhja përdhënien e kriterit është..... (duhet përmendur sipas llojit të kontratës, siç paraqitet në pikën 2 të këtij dokumenti - Kriteret për dhënien e çmimit);

Kontrata do të konsistojë në blerjen/përvetësimin e.....për implementimin e projektit të lartpërmendur;

Lloji i kontratës: blerja e <shërbimeve/mallrave/punë ndërtuese>; Afati i fundit për dorëzimin e ofertës: <data>, <ora>.

Adresa ku do të dorëzohen ofertat.....

Data dhe ora kur do të fillojë vlerësimi.....

Vlera maksimale e blerjes.....

Bashkangjitur i gjeni sasinë, specifikimet teknike/termat e referencës për ofertën e kërkuar (të jetë e bashkangjitur siç është paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe, nëse është e zbatueshme, në kuadër të planit të biznesit).

Ne presim ofertën tuaj deri në afatin e përcaktuar dhe në adresën e përmendur më lart.

<Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit> Nënshkrimi,

Vendi dhe data

Shtojca 2. Procedurave të Prokurimit

Deklaratë

për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit

Unë, i nënshkruari....., si përfaqësues ligjor i projektit, deklaroj nën sanksionin e Ligjeve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, se i respektoj të gjitha rregullat e përcaktuara si më poshtë:

1. Nuk ekzistojnë lidhje (të afërmit, apo aksionarë të përbashkët për çdo kompani) ndërmjet përfituesit (apo partnerë të përfituesve) dhe tenderuesve (ose partnerët e tenderuesit), të cilët dorëzojnë oferta;
2. Nuk ka pronësi të përbashkët (si individë ose si një aksionar) në mesin e ofertuesve nga i cili kam marrë

oferta.

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit > Nënshkrimi

Data

Shtojca 3. Procedurave të Prokurimit

Deklarata për seriozitetin e ofertuesit

Unë, i nënshkruari, si përfaqësues ligjor i projektit, vërtetoj nën sanksionin e ligjeve të agjencisë së pagesave se nuk jam në njërin prej situatave të listuara më poshtë:

Në falimentim ose duke u likuiduar, në afëra të administruara nga gjykatat, kam hyrë në një marrëveshje me kreditorët, aktivitetet të suspenduara të biznesit, u nënshtrohem procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

Kam qenë i dënuar për ndonjë shkelje lidhur me sjelljen profesionale përmes një gjykimi të plotfuqishëm (res judicata); kam qenë fajtor për shkelje të rëndë profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund të justifikoj përfituesi;

Nuk kam përmbushur detyrimet lidhur me pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose për pagesën e tatimeve, në përputhje me dispozitat ligjore të vendit në të cilin unë jam përcaktuar dhe në vendin e përfituesit;

Kam qenë objekt i një gjykimi të plotfuqishëm (res judicata) për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Kosovës;

Aktualisht i nënshtrohem një ndëshkimi administrativ financiar të lëshuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë e cila është përgjegjëse për subvencione dhe grante për bujqësi dhe zhvillim rural në Kosovë.

Jam deklaruar si i papranueshëm për Bankën Botërore, Danidën ose Komisionin Evropian.

<Emri dhe Mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit>

Vendi dhe data

Nënshkrimi

Shtojca 4. Procedurave të Prokurimit

Deklaratë e konfidencialitetit dhe neutralitetit

Unë, i nënshtrohem, anëtar i komisionit të vlerësimit për blerjen e....., nën procedurën e aplikuar <përzgjedhja bazohet në të paktën 3 oferta ose përzgjedhje në bazë të prokurimit të reklamuar organizuar nga <emri i Përfituesit>.

Unë deklaroj nën sanksionin e Ligjeve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, më poshtë:

- a) Unë nuk kam asnjë të afërm apo aksione ose partnerë të biznesit në mes të ofertuesve dhe komisionit vlerësues;
- b) Unë nuk jam anëtar i ndonjë Bordi, trupi vendimmarrës ose mbikëqyrës për ndonjë nga tenderuesit;
- c) Unë nuk kam asnjë interes që mund të ndikojnë në neutralitetin tim gjatë vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu, unë do të angazhohem plotësisht në ruajtjen e konfidencialitetit të përmbajtjes së ofertave edhe të veprimtarisë së komisionit të vlerësimit në rast se informacioni mund të ndikojë në të drejtat ligjore pronë e tenderuesit, ose sekretet e tyre tregtare.

<Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit>

Vendi dhe data

Nënshkrimi

Dokumentet që duhet të dorëzohen bashkë me kërkesën për pagesë, varësisht nga procedura e prokurimit

Numri i dokumentit	*Vlera e tenderit		
	Deri në 10, 000 euro	10, 000,01 – 60, 000 euro	Më shumë se 60, 000,01 eur
Lloji i blerjes	a. Mallra <input type="checkbox"/> b. Ndërtim <input type="checkbox"/> c. Shërbime <input type="checkbox"/>	a. Mallra <input type="checkbox"/> b. Ndërtim <input type="checkbox"/> c. Shërbime <input type="checkbox"/>	a. Mallra <input type="checkbox"/> b. Ndërtim <input type="checkbox"/> c. Shërbime <input type="checkbox"/>
1.	Deklarata <input type="checkbox"/>	- <input type="checkbox"/>	Kopja e shpalljes e publikuar në shtyp/gazetë <input type="checkbox"/>
2.		Së paku tri ftesa me shkrim të plotësuar, të nënshkuara nga pranuesi i ofertës (tenderuesit) (nga Shtojca 1)	Ftesa me shkrim të plotësuar, të nënshkuara nga pranuesi i ofertës (tenderuesit) (nga Shtojca 1) – nuk është e obligueshme – nëse ky është rasti/ vendosur nga përfituesi i grantit
3.		Kopjet e certificates për regjistrimin e biznesit të secilit nga tenderuesit (për së paku 3 tenderues)	Kopjet e certificates për regjistrimin e biznesit të secilit nga tenderuesit (për së paku 3 tenderues)
4.		Kopjet e numrit fiskal të tenderuesve (për së paku 3 tenderues)	Kopjet e numrit fiskal të tenderuesve (për së paku 3 tenderues)
5.		Ofertat e pranuar (së paku 3)	Ofertat e pranuar (së paku 3)
6.		-	Vendimi për krijimin e komisionit për vlerësim
7.		Deklarata për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit (nga shtojca 2)	Deklarata për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit (nga shtojca 2)
8.		Deklarata përbesueshmërinë e tenderuesit (nga shtojca 3)	Deklarata përbesueshmërinë e tenderuesit (nga Shtojca 3)
9.		-	Deklarata për konfidencialitetin dhe neutralitetin (nga shtojca 4)
10.		Raporti për dhënien e tenderit	Raporti për dhënien e tenderit
11.		Kontrata e nënshkuar e ofertuesin e përcaktuar fitues	Kontrata e nënshkuar e ofertuesin e përcaktuar fitues

*Vlera dhe tërësia e dokumenteve i referohet njëose më shumë blerjeve – varësisht nga lloji i blerjes (të veçanta janë ato për shërbime, mallra osendërtim); secila blerje mund t'i referohet një ose më shumë fatura vet- paguara.


Tabela 1. Llogaritja e hapësirës së nevojshme për deponinë e plehut për 3 muaj/kafshë

Lloji i kafshëve	Pleh i lëngët (m^3)	Pleh i ngurtë (m^2)
Viçat/demat	2.75	0,75
Lopët qumështore	5	1,5
Pula vojse (për 1000 pula)		5
Derra	0,375	

Për dele dhe për dhi nuk është e nevojshme të ndërtohet depo e plehut.

Varësisht prej tipit të mbajtjes dhe mënyrës së largimit të plehut, depoja e plehut duhet të plotësoj këto kushte:

- Platforma e depos së plehut të ngurtë është e rrethuar me mur të betonit në tri anë me lartësi 1m.
- Është llogaritur që lartësia e plehut të hedhur/grumbulluar të jetë 2m
- Për çdo 20 m² sipërfaqe të plehut të ngurtë duhet të sigurohet 1 m³ rezervuar për lëngun e plehut (shih skicën).
- Përfituesi duhet të sigurohet që lëngu i plehut të mos depërtojë në tokë.
- Depoja e plehut të lëngët duhet të jetë e mbuluar.
- Depo e plehut të lëngët duhet të jetë së paku 10 m larg burimit të ujit.
- Të dy tipet e depove të plehut duhet ndërtuar nga materiali që nuk e lëshon ujin (p.sh. betoni i ngjeshur, plastika e tj.).
- Varësisht prej tipit të mbajtjes dhe mënyrës së largimit të plehut, përfituesi duhet të ndërtoj njërën nga depot ose të dyja dhe këtë duhet ta sqaroj në planin e biznesit.



Skicë orientuese për ndërtimin e depos së plehut të ngurtë

Hapësira minimale për kafshë

Për lopë qumështore:

Shtrati/boksi (vendpushimi):

gjërësia = 120 cm, gjatësia = 170 cm me kusht që lartësia e grazhdit krahasuar me nivelin e shtratit të mos jetë më shumë se 30 cm

Grazhdi: gjërësia = 60 cm,

Koridori në mes = 240 cm (në gjërësinë e koridorit nuk llogariten grazhdet)

Koridori pas shtretërve = 150 cm

Vendqëndrimi për viça së paku 1m²/kokë

Fermeri/investitori ka të drejtë zbatoj hapësira më të mëdha, por jo më të vogla.

Tabela 2. Për viça dhe dema për majmëri:

Mosha e kafshës	Deri në 2 javë	2-8 javë	Mbi 8 javë
Gjatësia e shtratit		160 cm	170 cm
Gjërësia e shtratit		100 cm	120 cm
Gjërësia e grazhdit	35 cm	45 cm	50 cm

Nëse lopët mbahen në sistem të lirë: për çdo lopë duhet siguruar nga një shtrat me madhësi si më lartë dhe stalla duhet të ketë madhësi që siguron së paku 10 m²/lopë.

Nëse stalla ka padok (hapësirë për shëtitje të kafshëve), madhësia e tij duhet të jetë e tillë që siguron së paku 4,5 m²/lopë.

Të gjithë përfituesit e prodhimit të qumështit të lopëve duhet të kenë laktofriz ose nëse nuk kanë duhet të aplikojnë për laktofriz me madhësi të përshtatshme për kapacitetin e tyre prodhues.

Standardet për pula vojse në kafaz:

Kushtet minimale teknike të kafazëve të përmirësuar (sipas standardeve të BE-së) për pula vojse:

- Sipërfaqja minimale e kafazit së paku 2,000 cm²,
- 750 cm²/pulë vojse nga e cila 600 cm me lartësi 45 cm, me fole/strofull, me pjesën e shtruar për shpurthje dhe çukitje dhe 15 cm shkop (purtekë)/pulë për qëndrim, e vendosur mbi pjesën e shtruar,
- qasja në ushqim së paku 12 cm për pulë,
- koridori në mes të baterive minimum 90 cm,
- në mes të dyshemesë dhe fundit të kafazëve duhet të mbetet një hapësirë prej 35 cm

Për pula vojse dhe për broiler të mbajtur në dysheme:

Dendësia maksimale: 33 kg peshë e gjallë/m²

si dhe të plotësohen kushtet vijuese:

- Pajisjet lineare për ushqim të sigurojnë të paktën 10 cm për pulë/zog kurse ato rrethore të paktën 4 cm për pulë/zog;
- govatat lineare të ujit të pijshëm duhet të sigurojnë së paku 2,5 cm për pulë ose govatat rrethore 1 cm për pulë. Kur furnizimi me ujë është me pikatore, për çdo 10 pula/zogj = 1 pikatore.

Vetëm për pula vojse:

- të paktën një fole për çdo shtatë pula.

- Nëse përdoren fole grupore, për 120 pula duhet siguruar së paku 1,2 m²
- 15 cm shkopinj(purteka)/pulë, pa tehe të mprehta, të ngritur mbi shtroje dhe distanca horizontale mes tyre duhet të jetë së paku 30 cm ndërsa distanca në mes të shkopinjve dhe murit duhet të jetë së paku 20 cm;
- të paktën 250 cm² shtroje për pule, shtroja zë të paktën një të tretën sipërfaqes së dyshemesë*.

Ndricimi

- ✓ Për lope qumështore dhe viça, madhësia e dritareve të stallës duhet të jetë së paku sa 5% e sipërfaqes së dyshemesë.
- ✓ Për broiler dhe pula vojse të mbajtura në dysheme, madhësia e dritareve të stallës duhet të jetë së paku sa 3% e sipërfaqes së dyshemesë.

**Për detaje shih Rregulloren 1999/74/EC*

Standardet minimale për shëndet dhe mirëqenie të dhënëve dhe dhive

Me rastin e ndërtimit të stallës për dhenë dhe dhi duhet të plotësohen këto kushte tekniko-teknologjike të llogaritura për një dele/dhi të rritur:

- Sipërfaqja e nevojshme e dyshemesë duhet të jetë së paku 1,5 m²
- Sipërfaqja e grazhdit duhet të jetë së paku 0,15 m²
- Gjatësia e grazhdit 0,3 m
- Sipërfaqja e hapësirave për ventilim 0,01 m²

Përmes stallës duhet të kaloj korridori me gjerësi prej së paku 2 m i cili përfundon në të dy anët me dyert ballore që mundësojnë hyrjen e papenguar të traktorit.

Lartësia e mureve anësore është së paku tri metra, mbi të cilat, për të lejuar ajrosjen nuk mund të vendoset pllakë masive betoni, por mund të vendosen trarë . Dyshemeja e stallës duhet të jetë nga dheu/toka apo ndonjë material tjetër i cili mundëson thithjen ujit respektivisht urinës.

Ndriçimi në stallën e deleve dhe dhive gjatë ditës sigurohet përmes dritareve, sipërfaqja e të cilave duhet të jetë së paku sa 5% e sipërfaqes së dyshemesë, kurse natën të sigurohet ndriçim prej së paku 60 lux/m².

Standardet minimale për shëndet dhe mirëqenie të derrave

Sipërfaqja minimale e dyshemesë varësisht prej masës së kafshës:

Masa e kafshës (kg)	Sipërfaqja (m ²)
Deri në 10	0,15
> 10 deri 20	0,2
> 20 deri 30	0,3
>30 deri 50	0,4
>50 deri 85	0,55
>85 deri 110	0,65
>110	1,0

- Mbajtja lidhur e dosave është e ndaluar.
- Derrave duhet t'u sigurohet ndriçim me intensitet prej së paku 40 lux, për së paku 8 orë në ditë.

Për detaje shitesë shih Rregulloren 2008/120/EC

Në rast të investimeve në pemishte dhe vreshta të reja, vetëm perfituesit e grantit, para nënshkrimit të kontratës, duhet të sjellin analizat kimike dhe fizike të tokës me rekomandim për përshtatshmërinë për investimin e paraparë.

Shtojca Nr. 7 Lista e investimeve të pranueshme

Tabela 1 LISTA E SHPENZIMEVE TË PRANUESHME PËR MASËN 1	
A	SEKTORI I PEMËVE
1	<i>Investimet në ngritjen e pemishteve të reja dhe/ose rehabilitimi i pemishteve ekzistuese</i>
2	Punimet e kryera për mbjelljen e fidaneve dhe përgatitjen e tokës. Blerja e fidaneve të çertifikuara, sistemit mbajtës për fidane me shtylla të betonit ose të metalta (nuk pranohen shtylla nga druri apo materiale tjera) Blerja e materialit për rrethojë me shtylla të betonit ose të metalta Punimet e kryera për vendosjen e sistemit mbajtës dhe rrethojës Infrastruktura (shtyllat, teli, rrethoja, ujitja, mbrojtja kundër breshërit) për pemishtet ekzistuese
B	<i>Investimet në vendosjen e sistemit të ujitjes në pemishte.</i>
1	Punimet e kryera nga një palë e tretë për hapjen e puseve Blerja e gypave për ujitje Blerja e pajisjeve për hedhjen e ujit (spërkatje, vesim) Blerja e pompave Blerja e pajisjeve të TI duke përfshirë edhe programet (softëare) Punimet e kryera nga një palë e tretë për vendosjen e sistemit të ujitjes
2	Pajisje për furnizim me energji të ripërtitëshme dhe jo të ripërtitëshme, për funksionim të sistemit të ujitjes dhe pajisjeve kontrollim dhe monitorim
3	Blerja e rrjetave kundër breshërit, mbrojtjen ndaj zogjëve dhe pajisje për mbrojtje nga drita Blerja e sistemit mbajtës për rrjetë kundër breshërit Punimet e kryera nga një palë e tretë për vendosjen e rrjetave kundër breshërit dhe sistemit të tyre mbajtës
4	Ndërtimi ose renovimi i objekteve për makineri bujqësore dhe pajisje, magazinimin e karburantëve/lubrifikantëve, objektet e magazinimit për mbrojtjen e produkteve të bimëve, plehrave dhe pajisjeve për mbrojtje personale
C	<i>Investimet në makina dhe pajisje bujqësore për kultivimin e pemishteve, për mbrojtjen e bimëve, për shpërndarjen e plehut, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes.</i>
1	Traktorë special dhe kultivatorë për pemishte Makina për prodhimin e kompostit Automjete dhe rimorkio speciale për vjelje Blerja e pajisjeve dhe makinave speciale për hortikulturë (spërkatës, atomizerë), pajisje për shpërndarje të plehut, për mbjellje, për mulqerim, për vjelje, trajtim të kompostit etj.
2	Pajisje kompjuterike dhe softëare përfshirë sensorë që kanë lidhshmëri vetëm me pajisjet e pranueshme për njësitë prodhuese të vreshtave)

3	<i>Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve të trajtimit pasvjeljes, objektet për strehimin e makinave dhe pajisjeve bujqësore, depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehëra artificiale</i>
4	<p>Ndërtimi i depove të reja vetëm me panel izolues apo renovimi i objekteve ekzistuese ose blerja dhe vendosja e paneleve për depo të përhershme apo të përkohshme, depo me ajr të kondicionuar, hapësira për pastrim, klasifikim dhe paketim</p> <p>Blerja e makinave dhe pajisjeve për paraftohje, njësitë për ftohje dhe depo ftohëse. Blerja e makinave dhe pajisjeve për larje, pastrim, selektim, klasifikim, prerje, tharje, paketim dhe etiketim të frutave të freskëta,</p> <p>Blerja e pajisjeve për transport për përdorim brenda objektit: pirunier, rimorkio, kontejner, vinç, pirunier të dorës, karrocë apo pajisje tjera transportuese apo punuese.</p> <p>Pajisje për trajtimin e mbetjeve dhe deponimin e mbeturinave (përfshirë kompostimin)</p> <p>Materiale ndërtimi/komponente për instalimin e sherbimeve teknike për furnizim me ujë, sistemet e ventilimit, sistemet për ngrohje/ftohje, kushtet mikro- klimatike, prodhimin e energjisë dhe furnizimi i energjisë dhe instalimet, kullimi, rrjetet e kanalizimeve/rezervuarëve, të trajtimit të ujërave të zeza</p> <p>sigurimin e kërkesave plotësuese higjienike dhe sanitare (përfshirë ruajtjen e produkteve higjienike dhe sanitare, si dhe zonë punëtorëve), hapësirën administrative (zyre) dhe për instalimin e pajisjeve</p> <p>Blerja e kompjuterëve, programeve speciale dhe pajisjeve speciale teknologjike për inspektim, për monitorim, për regjistrim, kontrollim të ftohjes etj.</p>
SEKTORI I PERIMEVE	
A	Investimet në ndërtimin dhe modernizimin e serrave permanente dhe serrave për fidane
1	Ndërtimi i serrave nga plasmasi, polikarbon (plexi-glas) ose qelqi Materiale ndërtimi/ komponentë për ndërtim/renovimin e serrave
2	<p>Pajisjeve speciale për serra, duke përfshirë makina për vendosje në vazo dhe mbushje, makina për vjelje, sistem ventilimi, sistem i ujitjes,</p> <p>Blerja e mekanizmit përkatës për kultivimin e perimeve në fushë të hapur apo në serra (makinë për mbjellje të fidanëve, makinë për shtrirje të folisë, etj.)</p> <p>Makina për prodhimin e kompostit</p> <p>Inkubatorë për rritje të fidanëve</p> <p>Blerja e kompjutereve, programeve speciale dhe pajisjeve speciale teknologjike për inspektim, monitorim dhe regjistrim, pastaj sisteme për kontrollimin e ftohjes në automjetet frigorifer etj.</p>
3	Pajisje për furnizim me energji të ripërtitëshme dhe jo të ripërtitëshme, për funksionim të sistemit të ujitjes dhe pajisjeve kontrollim dhe monitorim Pajisje për ngrohje të serrës me kusht që ajo të arsyetohet ekonomikisht
4	Blerja dhe instalimi i pajisjeve për sigurimin e kushteve klimatike të kontrolluara dhe kultivimin pa dhé (soil-less)
5	Investime në vendosjen apo modernizimin e sistemit të ujitjes në serrë

	<p>Punimet e kryera nga një palë e tretë për hapjen e puseve,</p> <p>Pajisje për hedhjen e ujit (spërkatje, vesim), pompat e ujit</p> <p>Pajisje të TI duke përfshirë edhe programe (softëare)</p>
B	<i>Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve</i>
1	<p>Ndërtimi i depove të reja vetëm me panel izolues dhe renovimi i objekteve për trajtim të perimeve dhe patateve pas vjeljes, Ndërtimi apo renovimi i objekteve ekzistuese ose blerja dhe vendosja e paneleve për depo të përhershme apo të përkohëshme, depove për patate, hapësira për pastrim, klasifikim dhe paketim.</p> <p>Blerja e makinave dhe pajisjeve për paraftohje, njësi për ftohje dhe depo ftohëse. Blerja e makinave dhe pajisjeve për larje, pastrim, selektim, klasifikim, prerje, tharje, paketim dhe etiketim.</p> <p>Blerja e pajisjeve për transport për përdorim brenda objektit: pirunier, rimorkio, kontejner, furgona, vinç, pirunier i vogël, karrocë apo pajisje tjera transportuese apo punuese.</p> <p>Ndërtimi i objekteve për strehimin e makinave dhe pajisjeve bujqësore, depove për pesticide dhe për plehëra</p>
2	<p>Materiale ndërtimi/komponente për instalimin e shërbimeve teknike për furnizim me ujë, sistemet e ventilimit, sistemet përngrohje/ftohje, kushtet mikro-klimatike, furnizimi me energji dhe instalimet, kullimi, rrjetet e kanalizimeve/rezervuarëve, të trajtimit të ujërave të zeza/të ujit, pastrimit të ujit,</p> <p>Blerja e kompjuterëve, programeve speciale dhe pajisjeve speciale teknologjike për inspektim, për monitorim, për regjistrim, kontrollim të ftohjes, etj.</p>
3	<p>Pajisje për shërbimet teknike (furnizimi me ujë, sistemet e ventilimit, sistemet për ngrohje/ftohje, kushtet mikro-klimatike, instalimet e rrymës elektrike, kullimi, rrjetet e kanalizimeve/rezervuarëve, të trajtimit të ujërave të zeza,</p> <p>Pajisje për furnizim me energji të ripërtritëshme dhe jo të ripërtritëshme, për funksionim të deposë dhe pajisjeve kontrollim dhe monitorim</p> <p>Pajisje për t'i plotësuar kërkesat higjienike dhe sanitare duke përfshirë pajisjet higjienike dhe sanitare edhe për punëtorët, si dhe për pastrimin e makinerive dhe pajisjeve</p>
4	<p>Makineri bujqësore (traktorë, kultivatorë, multi-kultivatorë) dhe pajisje për kultivimin e tokës, krasitje, mulqerim, kositje, pajisje për mbrojtjen e kulturave (spërkatës, atomizerë, pajisje për shpërndarjen e plehrave dhe makineri për vjelje/korrje)</p>
C	<i>Pajisjet për trajtim pas vjeljes</i>
1	<p>Pajisje për trajtim pas vjeljes, për kalibrim, klasifikim, pastrim, larje, tharje, dezinfektimin, zbulimin e metalit, qelqit apo materialeve të tjeratë ngurta.</p> <p>Pajisje për prerje te frutave, paketim dhe etiketim.</p> <p>Pajisje për para-ftohje, ftohje dhe frigorifer</p>
2	<p>Pajisje për manipulim, ngarkim-shkarkim, pajisje-pirunj, rimorkio transporti, mjet transportues me sistem rripi, pajisje për peshim</p>
3	<p>Pajisje dhe objekte për trajtimin e mbetjeve dhe depozitimin e mbeturinave (përfshirë kompostimin)</p>

4	Pajisjet për monitorimin e cilësisë, sistemet e kontrollit, gjurmueshmërisë, ruajtjen dhe shpërndarjen, pajisje kompjuterike dhe softëarëve përfshirë sensorët
SEKTORI I PRODHIMIT TË QUMËSHITIT	
<i>A</i>	<i>Ndërtimi/renovimi i stallave për lopë, dele dhe dhi të qumështit</i>
1	Ndërtimi ose renovimi i stallave dhe objekteve përcjellëse, mjeltoreve dhe infrastrukturës përkatëse. Ndërtimi apo renovimi i stallave të tipit të mbyllur, gjysëm të hapur apo të hapur. Ndërtimi apo renovimi i mjeltoreve, dhomës për ruajtjen e qumështit dhe laktofrizat.
2	Investime në modernizimin e pajisjeve për mjelje dhe ftohje dhe ruajtje të qumështit duke përfshirë dhomën e qumështit dhe laktofrizat. Pajisjet për mjelje, mjeltore, sistemi i mbyllur i mjeljes, pompat vakum dhe sistemet e kontrollit, sistemet për matjen e qumështit. Pajisje për pastrimin e sistemit të mjeljes
3	Ndërtimi apo renovimi i objekteve përcjellëse siç janë depot e ushqimit të koncentruar dhe voluminoz, depo për sillazh, silosëve duke përfshirë hapësirat për përgatitjen e ushqimit, për trajtim dhe paketim të tij. Ndërtimi i objekteve ose dhomave për deponimin e medikamenteve, materialit për higjienë, për veteriner, për qëndrim të punëtorëve etj. Investime në largimin, trajtimin dhe deponimin e plehut, Ndërtimi apo renovimi i depove për grumbullimin dhe deponimin e plehut Tank/gropë për plehun e lëngshëm Pajisje për përzierjen dhe nxjerrjen/pompimin e plehut të lëngët Pajisje automatike për largimin e plehut Pompa dhe sisteme të ajrosjes për plehë të lëngshëm Pajisje për shpërndarjen e plehut të lëngshëm (p.sh. cisterna) dhe atij të ngurtë.
4	Investime për instalimin e shërbimeve teknike për furnizim me ujë, sistemet e ventilimit, sistemet për ngrohje/ftohje, kushtet mikro-klimatike, prodhimin e energjisë dhe furnizimi me rrymë elektrike, kullimi, rrjetet e kanalizimeve/rezervuarëve, të trajtimit të ujërave të zeza/të ujit, brushat, pajisje të peshimit Hapja e pusit dhe blerja e pompës për ujë. <i>Hapja e pusit dhe blerja e pompës për ujë</i>
5	Investime për rrethimin e fermave blegtorale, zonat e mbarështimit, kontrollin e lëvizjes në natyrë, barrierat dezinfektuese, qasje rrugore dhe rrugë në-ferme për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme të fermës
6	Pajisje për shënjimin e kafshëve dhe regjistrimin e të dhënave dhe të pajisjeve kompjuterike dhe softëare përfshirë sensorë (që kanë të bëjnë vetëm me pajisjet e pranueshme për aktivitetet e fermave të qumështit)
7	Investime për pikat grumbulluese të qumështit: Ndërtimi, riparimi ose zgjerimi i objekteve për pranimin e qumështit

	<p>Laktofrizë, frigoriferë, bojler, ventilatorë, Cisternë të izoluar nga inoksi për transportim të qumështit deri në qumështore Pajisje për matjen e cilësisë së qumështit si pajisje për matjen e yndyrës, pH-së, mbetjeve të antibiotikëve, qelizave somatike, mikroorganizmave etj. Peshore, pompë për nxjerrjen e qumështit, bidona inox, kulluese Gjeneratorë për prodhimin e energjisë elektrike, stabilizatorë të rrymës el., pajisje për prodhimin e energjisë së ripërtitëshme</p>
B	<i>Mekanizimi dhe pajisjet bujqësore</i>
1	<p>Makineri bujqësore: përzierse (mikserë), TMR (total mix ratio), makina kositëse, presa, grabujë tedders, makina për grimcim të sillazhit, pajisje dhe makina për përgatitjen e sillazhit në fermë, makina për kultivim të tokës (traktorë, kultivatorë, multi-kultivatorë), makina për mbjellje, mbrojtjen e kulturave (spërkatës, atomizerë), për shpërndarje të plehut, për kositje dhe për kultivimin e livadheve (përfshirë rotoballat)</p>
GRUPI I INVESTIMEVE PËR PRODHIM TË MISHIT	
A	<i>Ndërtimi/ renovimi i objekteve të fermave për mbarështim</i>
1	<p>Ndërtimi/ renovimi i stallave të tipit të mbyllur, gjysëm të hapur apo të hapur dhe objekteve përcjellëse dhe infrastrukturës përkatëse për gjedhë për trashje</p>
2	<p>Ndërtimi apo renovimi i objekteve përcjellëse siq janë depot e ushqimit të koncentruar dhe voluminoz, depo për sillazh, silosëve duke përfshirë hapësirat për përgatitjen e ushqimit, për trajtim dhe paketim të tij.</p> <p>Ndërtimi i objekteve ose dhomave për deponimin e medikamenteve, materialit për higjienë, për veteriner, për qëndrim të punëtorëve etj. Investime në largimin, trajtimin dhe deponimin e plehut, Ndërtimi apo renovimi i depove për grumbullimin dhe deponimin e plehut Tank/gropë përplehunelëngshëm Pajisje për përzierjen dhe nxjerrjen/pompimin e plehut të lëngët Pajisje automatike për largimin e plehut Pompa dhe sisteme të ajrosjes për plehë të lëngshëm Pajisje për shpërndarjen e plehut të lëngshëm (p.sh. cisterna) dhe atij të ngurtë.</p>
3	<p>Investime për instalimin e sherbimeve teknike për furnizim me ujë, sistemet e ventilimit, sistemet për ngrohje/ftohje, kushtet mikro-klimatike, prodhimin e energjisë dhe furnizimi me rrymë elektrike, kullimi, rrjetet ekanalizimeve/rezervuarëve, të trajtimit të ujërave të zeza/të ujit, brushat, pajisje të peshimit. Hapja e pusit dhe blerja e pompës për ujë.</p>
Adresa: _____, me përgjegjësi të plotë ligjore penale deklaroj nën betim se më nënshkrimin tim dhe bashkangjitjen e dokumenteve në aplikimin online siguroj që të gjitha dokumentet, informatat dhe të dhënat që janë prezantuar në aplikim për Programin e ZHR 2022 janë të qarta, të besueshme dhe të sakta dhe së për çdo paqartësi, josaktësi dhe falsifikim do e mbajë përgjegjësi ligjore dhe penale.

Datë ____ . ____ .2022

Nënshkrimi i Deklaruesit

Ky dokument është përgatitur nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në bashkëpunim me Autoritetin Menaxhues dhe shpërndahet falas.

Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore

Udhëzues për Aplikues

2022

1. OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINACIARE PËR MASËN 3

1.1. Hyrje

Udhëzuesi për aplikues ka për qëllim t'u ndihmoj aplikuesëve në përgatitjen e aplikacioneve të tyre, t'i qartësoj kushtet e pranueshmërisë, kriteret e përgjithshme, kriteret e veçanta, kriteret tjera të pranueshmërisë, sistemin e poentimit, investimet e pranueshme, dokumentet e nevojshme për aplikim, vlerësimin e projekteve, njoftimin e aplikuesit për rezultatet e vlerësimit, procedurat e prokurimit, ndëshkimet në rast të parregullësive apo tentimeve për mashtrim, si dhe çështjet tjera me rëndësi për implementimin e Masës 3.

Roli i Udhëzuesit për aplikues (më tutje Udhëzuesi) është të sqarojë në detaje dispozitat e paraqitura në Masën 3 dhe jo të përsërisë atë, prandaj ky nuk e zëvendëson masën porduhet lexuar (bashkë me shtojcat) me qëllim të shmangies së gabimeve gjatë aplikimit.

Masa është dokument që paraqet objektivat e përkrahjes publike në investimet private, përmes granteve, dhe këtë e bën me një gjuhë teknike. Masa 3 synon t'i përkrahë investimet në industrinë e përpunimit të ushqimit në katër nën sektorë: përpunim të qumështit, përpunim të mishit, përpunim të pemëve dhe perimeve dhe prodhim të verës. Masa është përgatitur nga personeli i Autoritetit Menaxhues, duke u bazuar në studime të pavarura për sektorë dhe këshillime me palët e interesit.

1.2. Mjetet financiare për këtë masë

Nën-sektorët		Buxheti	%
3.1	Përpunimi i qumështit	500,000.00	10
3.2	Përpunimi i mishit	800,000.00	16
3.3	Përpunimi i pemëve dhe perimeve	1,236,473	8
3.4	Përpunimi i verës	300,000.00	6
3.5	Pika grumbulluese /depo	3,000,000.00	60
	Totali i buxhetit	5,836,473.68	100

1.3. Përkufizimet kryesore

- Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime:
- “MBPZHR” - nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- “Autoriteti Menaxhues” - nënkupton entitetin publik brenda MBPZHR-së, përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e PZHR;
- “ARBK”- nënkupton Agjencinë per Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
- “AZHB” - nënkupton Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në kuadër të MBPZHR, përgjegjës për zbatimin e PZHR;
- “PZHR 2022” – nënkupton Programin për Zhvillimin Rural për vitin 2022;
- “Masa 3” - nënkupton investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore;
- “Thirrja për aplikim” - nënkupton njoftimin publik për pranimin e aplikimeve;

- **“Aplikues”** - nënkupton personin fizik apo juridik, i cili aplikon për të përfituar projekt në PZHR 2022;
- **“Aplikacioni”** - nënkupton formularin e plotësuar për aplikim me të gjitha dokumentet e kërkuara nga AZHB;
- **“Projekt”** - nënkupton dokumentin që parasheh investimin e planifikuar për përkrahje nga PZHR 2022, të dorëzuar nga aplikuesi;
- **“Përzgjedhja”** - nënkupton selektimin e projekteve, sipas pikëve të renditura;
- **“Kriteret e përzgjedhjes”** - nënkupton kriteret që Autoriteti Menaxhues duhet t’i përcaktoj, për të siguruar prioritetet e financimit të projekteve më të mira që adresojnë nevojat e identifikuara në analizën SWOT dhe objektivat e përcaktuara në PZHR 2022;
- **“Përfitues”** - nënkupton personin fizik apo juridik, i cili është përzgjedhur përfitues pas vlerësimit të aplikimit, nënshkrimit të kontratës dhe financimit të projektit nga MBPZHR;
- **“Shkalla e përkrahjes publike”** - nënkupton kontributin nga buxheti publik për zbatimin e projektit;
- **“Kontrata”** - nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të përfituesit dhe AZHB-së për zbatimin e projektit të përfituar;
- **“Mashtrim”** - nënkupton çdo vepër e qëllimshme ose mospërfillje sipas përkufizimit të Ligjit Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, 16 tetor 2012);
- **“Shpenzimet e pranueshme”** - nënkupton shpenzimet që përkrahen me mjete financiare;
- **“Periudha e zbatimit të projektit”** - nënkupton periudhën për zbatimin e afatit të projektit të përcaktuar në udhëzim administrativ dhe kontratën e nënshkruar mes përfituesit dhe AZHB.
- **“Kërkesa për pagesë”** - nënkupton parashtrimin e kërkesës për pagesë për shpenzimet e pranueshme, të dëshmuara me fatura valide për shpenzimet e realizimit të projektit;
- **“Ex-post kontrolli”** - nënkupton periudhën kohore prej tre (3) vjetësh pas ekzekutimit të pagesës së fundit, gjatë të cilës përfituesi duhet ta ruajë qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave është përzgjedhur si përfitues;
- **“NIF”** - nënkupton Numrin Identifikues të Fermës;
- **“FERMA”**- nënkupton njesin prodhuese në aspektin teknik dhe ekonomik e cila menagjohet nga fermeri në të cilin zhvillohen aktivitete bujqësore dhe aktivitete të zhvillimit rural
- **“ZGJERIMI”**- nënkupton zgjerimin e objektit egzistues
- **“RENOVIMI”**- Kthimi i objektit ekzistues në kushte të pranueshme duke bërë ripërtëritjen, zavendësimin, apo rregullimin e pjesëve të dëmtuara ose të degraduara.

2. OBJEKTIVAT

2.1 Objektivat e përgjithshme

- Rritja e aftësisë konkurruese të sektorit agro-ushqimor, duke siguruar një përgjigje më të mirë të sektorit të ushqimit ndaj kërkesave shoqërore për ushqim të shëndetshëm, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, duke investuar në infrastrukturë fizike në përputhje me standardet kombëtare dhe përkatëse të BE-së.
- Adresimin e sfidës së ndryshimeve klimatike, duke promovuar energjinë e ripërtërishme dhe ekonominë qarkore.
- Adresimin në përfundim të pozitës së fermerëve në zinxhirin ushqimor, duke i inkurajuar ata të bashkëpunojnë në zinxhirët e furnizimit të shkurtër dhe të prodhojnë produkte me vlerë të shtuar.

2.2 Objektivat specifike

- Përmirësimin e efikasitetit dhe produktivitetit duke futur teknologji të reja përfshirë dixhitalizimin e prodhimeve për të rritur aftësinë konkurruese dhe diversitetin e produkteve në treg;
- Integrimin e fermerëve/prodhuesve të lëndës së parë me industrinë agro-përpunuese;
- Përmirësimin e kontrollit të cilësisë, zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore dhe higjienës;
- Përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit përfshirë trajtimin mbetjeve dhe të ujit;
- Harmonizimi gradual me standardet e BE-së, në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, shëndetit publik, mirëqenies së kafshëve dhe sigurisë në punë;

3. PËRFITUESIT PËRFUNDIMTARË

- Aplikuesit duhet të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës;
- Përfitues mund të jenë ndërmarrjet përpunuese të prodhimeve bujqësore të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës së paku 5 vite në nën-sektorin përkatës ,dhe të aprovuara/regjistruar nga AUV-i së paku 5 vite para datës së aplikimit.
- Ky kriter për Pika grumbulluese/depo është 2 vite i regjistruar nga AUV dhe 2 vite i regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës me aktivitetin përkatës.
- Aplikuesi në sektorin e verës, duhet të jenë të regjistruar edhe në Regjistrin e Prodhuesve të Verës në Kosovë.
- Aplikuesi nuk mund të përfitoj një projekt nëse është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe Ligjin 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë tri (3) vjetëve pas datës së ekzekutimit të pagesës, aq sa zgjatë periudha monitoruese;
- Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike;
- Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural pas finalizimit të investimeve duhet të kenë projektin funksional sipas planit të biznesit, PZHR dhe kriterëve të këtij Udhezimi Administrativ;
- Kërkesa për pagesë refuzohet për projekte të cilat nuk kanë finalizuar ndonjë aktivitet për të cilin është poentuar gjatë procesit të vlerësimit.
- Një ndërmarrje mund të përbëhet nga një ose më shumë objekte (njësi lokale të prodhimit).

4. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

4.1. Llojet e ndërmarrjeve të përkrahura:

Të gjithë aplikuesit e kësaj mase duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës dhe në ARBK. Kjo masë përkrah ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të përcaktuara në bazë të Ligji Nr. 04/L-220 Për Investime të Huaja, (Gazeta Zyrtare Nr.1/09 Janar 2014).

4.2. Standardet Kombëtare

- Ndërmarrja duhet të demonstrojë qartë planin e investimeve në biznes plan të cilat do të ndikojnë në zbatimin e standardeve të sigurisë së ushqimit dhe uljen e rrezikshmërisë sipas kategorizimeve;
- Para paraqitjes së kërkesës për pagesë në AZHB, secili projekt duhet të vlerësohet nga AUV nëse janë plotësuar standardet kryesore kombëtare sipas ligjeve në fuqi;
- Përfituesit së bashku me kërkesën për pagesë dhe dokumente tjera, duhet të sigurojnë Raportin të bashkëngjitur me Listat e kontrollit nga AUV-i që konfirmon se investimi është në përputhje me standardet kombëtare;
- E gjithë ndërmarrja përfutuese në fund të zbatimit duhet të përmbushë standardet kombëtare sipas ligjeve në fuqi;
- Aplikuesit duhet të kenë Raportin/ procesverbalin (jo me të vjetër se gjashtë muaj) të lëshuar nga AUV për gjendjen ekzistuese të operatorit dhe cilat standarde duhet t' i plotësoj;
- Konform kërkesave të AUV-it për përmirësimin e standardeve në planin e biznesit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të investimeve dhe aktiviteteve të planifikuara;
- Para kërkesë përfundimtare për pagesë në AZHB, investimi i mbështetur duhet të plotësojë standardet kombëtare relevante në fuqi që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë në punë.

4.3. Qëndrueshmëria ekonomike e ndërmarrjes

- Qëndrueshmëria ekonomike e aplikuesit duhet të demonstrohet me anë të një plani biznesi;
- Të gjithë aplikuesit duhet të paraqesin një plan biznesi, në përputhje me modelin e kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Aplikuesi duhet të demonstrojë në planin e biznesit qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fund të realizimit të projektit;
- Ndërmarrja duhet të demonstrojë se ajo mund t'i kryejë detyrimet dhe borxhet rregullisht, pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes;
- Plani i biznesit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të investimeve dhe aktiviteteve të planifikuara, konform kërkesave të AUV-it për përmirësimin e standardeve;
- Plani i biznesit duhet të tregojë se në çfarë mënyre zbatimi i projektit do të çojë në përmirësimin e performancës së përgjithshme të ndërmarrjes agro-ushqimore përmes prezantimit të perspektivës së qëndrueshmërisë financiare/ekonomike.
- Vlerësimi i qëndrueshmërisë financiare / ekonomike dhe perspektiva e vazhdimësisë së investimeve vlerësohet nga AZHB-ja, për të siguruar zgjedhjen e projekteve me cilësi më të lartë për sa i përket qëndrueshmërisë financiare/ ekonomike;
- Modeli për planin e biznesit përgatitet nga AZHB-ja dhe të do publikohet në web-faqen e Agjencisë dhe MBPZHR-së. Të gjithë aplikuesit duhet të paraqesin një plan biznesi, në përputhje me modelin e kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

4.4. Kriteret tjera të pranueshmërisë

Në rastin e projekteve të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet t'i dorëzojnë:

- Certifikatën e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi;
- Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit.

- Kontrata duhet të përmbajë edhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit për investimin që do të bëhet në tokën ose objektin e tij. Pëlqimi mundet të jetë pjesë e kontratës së qiramarrjes ose i ndarë veçmas;
- Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
- Kopjen e skicave të objektit;
- Aplikuesi që aplikon në investimet për menaxhimin e mbetjeve dhe menaxhimin e ujrave të shkarkuara në rastin e aplikimit të sjellin projekt ideor me paramasa dhe parallogaritje;
- Parallogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;
- Pëlqimin nga organi kompetent (Komuna) për leje të ndërtimit, në rastet e projekteve të ndërtimit / zgjerimit, por jo në rastet e projekteve të rinovimit;
- Nëse toka ose ndonjë pronë tjetër në të cilën do të bëhet investimi është në bashkëpronësi aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve edhe kopjet e letërnjoftimeve;
- Në rast të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit, aplikuesit duhet ta dorëzojnë edhe projektin teknik të planit të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit.
- Te gjithë aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera ose të rregulluara detyrimet tatimore, tatimin në të ardhura dhe tatimet e tjera të aplikueshme;
- Toka nën hipotekë nuk është e pranueshme për investim, qoftë në pronësi apo e marrë me qira.

Para kërkesës për pagesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, përfituesi duhet të dorëzojë:

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent (Komuna), nuk kërkohet për projektet e rinovimit;
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse është paraparë me ligj;

4.5. Investimet e përbashkëta të pranueshmerisë

- Investimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë përfshirë në Listën e Investimeve për Masën 3.
- Ndërtimi / rindërtimi / zgjerimi i objekteve;
- Blerja e makinerive dhe e pajisjeve të reja, duke përfshirë programe kompjuterike të nevojshme për funksionimin e linjave të prodhimit apo funksioneve të tjera primare që ndërlidhen me aktivitetet kryesore të ndërmarrjes;
- Investimet në përpunimin e qumështit, mishit, pemëve dhe të perimeve, si dhe prodhimin të verës, përfshirë edhe investimet e marketingut për promovimin e tyre;
- Shpenzimet e pranueshme të marketingut për të gjitha nën masat e Masës 3 janë: përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosjeve, broshurave, posterëve etj, për promovimin e produkteve, por jo edhe për shpërndarjen e tyre. Po ashtu, shpenzimet e pranueshme të marketingut janë edhe prodhimi i audio dhe video-spotëve promovuese, por jo edhe shpërndarja e tyre mediale;
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar në 5% të totalit të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se dhjetmijë (10,000) €;
- Shpenzimet e tjera të ndërlidhura me projektin, siç janë: shpenzimet për arkitekt, për inxhinier dhe shpenzimet për studime parapake, si dhe nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante janë të pranueshme deri në 7% të shpenzimeve të pranueshme por jo më shumë se pesëmbëdhjetmijë (15,000) €, kurse shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit janë të pranueshme deri në 3% të shpenzimeve të pranueshme për projekt, por jo më shumë se pesëmijë (5,000) €;

- Shpenzimet administrative, edhe pse ndodhin para nënshkrimit të kontratës, janë të pranueshme vetëm në qoftë se projekti është përzgjedhur dhe është kontraktuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.
- Investment në prodhimin e energjisë së ripërtritshme
- Në kuadër të këtij investimi mbështete prodhimi i energjisë elektrike nga burimet ripërtriteshme për "vetë-konsum". (d.m.th. kapacitete prodhues i energjisë e huazuar/depozituar në rrjet është mesatarisht e barabartën me energjinë elektrike të shpenzuar gjatë vitit). Kjo justifikohet me faktin se, meqenëse energjia elektrike nuk mund të ruhet, ajo nëse nuk harxhohet, mund të lëshohet në rrjet; rrjeti i energjisë elektrike mund të konceptohet si një vend depozitimi për energjinë elektrike ku futet dhe tërhiqet gjatë vitit në sasi të ngjashme dhe me një ritëm të ndryshëm.
- Koncepti i "vetë-konsumit" duhet të kontrollohet në fazën në të cilën paraqitet / vlerësohet një projekt. Investimi konsiderohet i pranueshëm kur kapaciteti (teorik) i energjisë i impiantit të energjisë së ripërtriteshme ("investimi") nuk tejkalon 120% të konsumit mesatar prej 3 vjetësh të ndërmarrjes.
- Shkalla e përkrahjes publike
- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 30.000 €;
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 400,000 €;
- Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit;

5. SEKTORI I PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT, MISHIT DHE THERTORET

5.1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë:

- Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me aktivitetin përkatës dhe i aprovuar nga AUV-i së paku 5 vjet para datës së aplikimit.
- Aplikuesit e kategorisë "A", "B" dhe "C" nuk janë të pranueshëm në rast të ndërtimit të objektit të ri, ndërsa janë të pranueshëm në rast të renovimit, zgjerimit të objektit ekzistues dhe investimeve në pajisje.
- Aplikuesit e kategorisë "D" janë të pranueshëm vetëm në rast të ndërtimit të objektit të ri dhe mbylljes së objektit ekzistues. Investimet në pajisje/ linja përpunimi për këtë kategori janë të pranueshme nëse në biznes plan prioritet i është dhënë ndërtimit të objektit.

5.2. Investimet e pranueshme

- Investimet e pranueshme për nën masën e përpunimit të qumështit:
- Investimet në ndërtim/rinovim / zgjerim të qumështoreve; (Investimet në ndërtim të qumështoreve të reja të cilat në kohën e aplikimit janë në kategorinë "D");
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve; (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000) Nuk financohet certifikimi HACCP dhe/ose ISO 22000;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Investimet në mjete transportuese të specializuara;
- Investimet në pajisje për prodhime të reja dhe paketime moderne;

- Pajisje të IT-së, dixhitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;
- Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme;
- Investimet në pajisje për ftohje;
- Investimet e pranueshme për nën masën e përpunimit të mishit dhe thertore;
- Investimet në ndërtim /rinovim / zgjerim të objekteve ekzistuese, përfshirë depot ftohëse bashkë me pajisje; (Investimet në ndërtime të reja të cilat në kohën e aplikimit janë në kategorinë “D”);
- Investimet në pajisje për përpunim të mishit dhe thertoreve ;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000) Nuk financohet certifikimi HACCP dhe /ose ISO 22000;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Investimet për pajisje për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;
- Investimet për pajisje për ftohje dhe ngrirje për ruajtjen e prodhimeve të gatshme;
- Pajisje të IT-së, dixhitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;

6. SEKTORI I PËRPUNIMIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE

6.1. Kriteret e pranueshmërisë

- Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me aktivitetin përkatës dhe i regjistruar nga AUV-i së paku 5 vjet para datës së aplikimit.
- Të gjithë aplikuesit të cilët aplikojnë për pika grumbulluese/depo, duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me aktivitetin përkatës dhe i regjistruar nga AUV-i së paku 2 vjet para datës së aplikimit.
- Në rast të investimit në pika grumbulluese /depo, kapaciteti minimal i ruajtjes duhet të jetë së paku një mijë (1000) m³.
- Në rast të zgjerimit të objektit ekzistues ky objekt duhet të ketë kapacitet minimal prej pesëqind (500) m³, ndërsa objekti i zgjeruar duhet të arrijë kapacitetin minimal një mijë (1000) m³.

6.2. Investimet e pranueshme:

- Investimet në zgjerim, rindërtim të objekteve për përpunim; (pika grumbullues/depo lejohet ndërtimi sipas sipas paragrafit 1, nenparagrafi 1.2 të këtij neni;
- Investimet në linja për konservim / pasterizim të pemëve dhe perimeve;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000); Nuk financohet certifikimi HACCP dhe /ose ISO 22000;
- Investimet në objekte dhe pajisje për trajtim pas vjeljes, për tharje, për klasifikim dhe për deponim;
- Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, mbështjellësit dhe pajisje të tjera të specializuara;

- Investimet në pajisje për zinxhirin ftohës, duke përfshirë depo për ftohje dhe ngrirje, tunele të ngrirjes, mjete transportuese me frigorifer dhe pajisje të tjera të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë në zinxhirin e ftohjes;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Investimet për pajisje për kontrollë të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;
- Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme, me ftohje dhe pa ftohje;
- Pajisje të IT-së, dixhitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;

7. SEKTORI I PRODHIMIT TË VERËS

7.1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë për prodhim të verës:

- Të drejtë aplikimi kanë ndërmarrjet e regjistruara në Regjistrin e Prodhuesve të Verës dhe Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës si dhe të kenë përvojë së paku 5 vjet para datës së aplikimit, prodhuesit e verës duhet që së paku 50% të lëndës së parë (rrushit) të sigurojnë nga prodhuesit e tjerë (jo prodhim vetanak).
- Ky kriter nuk vlen për prodhuesit e verës që kanë në pronësi mbi 50 ha me vreshta.
- Aplikuesit duhet të dëshmojnë se e kanë deklaruar prodhimin vjetor të verës dhe të stoqeve të ngelura.

7.2. Investimet e pranueshme për prodhimin e verës.

- Investimet në zgjerim, rindërtim të objekteve për prodhimin dhe përpunimin e verës;
- Investimet në pajisje për përpunimin e verës;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000) Nuk financohet certifikimi HACCP dhe/ ose ISO 22000;
- Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, ambalazhës dhe pajisje të tjera të specializuara;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;
- Investimet për pajisje dhe aparatura për kontrollë të cilësisë së verës, përfshirë laboratorët përkatës;
- Pajisje të IT-së, dixhitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim.

8. PAGESA E PROJEKTIT

- PAGESA për Masën 3 bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm.
- Garancioni bankar duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50% të përkrahjes

- publike.
- Garancioni bankar duhet të sigurohet për periudhën kohore deri sa të realizohet pagesa e fundit nga AZHB-ja, respektivisht deri te vendimi i fundit nga komisioni i ankesave. Çdo kerkes per afat shtesë duhet të mbulohet me garancion bankar.
- Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të draft programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2021-2027 për Masën 3 është tetqindmijë (800.000) € për përfitues.
- Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021 - 2027, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkalojë shumën e përcaktuar në kete nen.

SHËNIM: TVSH është shpenzim i papranueshëm dhe atë e paguan përfituesi! Edhe shpenzimet tjera të papranueshme do të paguhet nga përfituesi.

Çdo tentim për mashtrim, si: falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, blerja e makinave apo paisjeve të përdorura apo pa numër serik dhe të dhëna teknike do të ndëshkohet me mospagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe mund të ketë ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa.

9. PRANUESHMËRIA E APLIKUESVE DHE APLIKACIONEVE TË TYRE

Të gjithë aplikuesit i nënshtrohen kontrollit të pranueshmërisë. Nëse konstatohet se aplikuesi është i papranueshëm, aplikacioni refuzohet. Pranueshmëria e aplikuesit kontrollohet në bazë të kriterëve të pranueshmërisë, dokumenteve të kërkuara dhe atyre të dorëzuara. Aplikacionet e cilësuar si të papranueshme nuk i nënshtrohen vlerësimit.

SHËNIM: Të gjitha investimet e pranueshmërisë duhet të ruhen për së paku 3 vjet pas implementimit të projektit, aq sa zgjatë periudha monitoruese nga AZHB. Mosrespektimi i këtij kriteri nënkupton kthimin e mjeteve të financuara publike dhe ndëshkim shtesë sipas legjislacionit në fuqi. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë do të bëjë ex-post kontrollë me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike.

Një aplikant mund të dorëzoj vetëm një projekt në vit në kuadër të këtij programi.

Aplikacioni konsiderohet i plotë vetëm nëse shoqërohet me të gjitha dokumentet e kërkuara në Shtojcën nr. 1B) - Lista e dokumenteve të dorëzuara.

Aplikuesi duhet të nënshkruaj një deklaratë me të cilën zotohet se nuk do ta ndërroj qëllimin e investimit edhe 3 vjet pas implementimit të investimit. Përfituesi duhet ta mbaj investimin në kushte të mira. Aplikuesi nuk guxon të ketë obligime fiskale ndaj shtetit (obligime ndaj ATK-së) dhe nuk guxon të ketë obligime financiare ndaj MBPZHR.

Aplikuesi duhet të dorëzojë një plan të biznesit sipas modelit të paraqitur në Shtojcën nr.2 të këtij Udhëzuesi.

Shënim: Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet

t'i krijojnë ato dhe t'i dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga për së paku muajin e fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 3 vjet, aq sa zgjatë periudha monitoruese.

10. SHPENZIMET MINIMALE DHE MAKSIMALE PËR PROJEKT

- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 30,000 €;
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 400,000 €;

11. SHKALLA E PËRKRAHJES PUBLIKE

- Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit.

12. AFATI I ZBATIMIT

- Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është dhjetë (10) muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në.
- Pas kësaj periudhe, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë.
- AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti dy (2) muaj, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç është kushtet e papershtatshme klimatike, sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër.

Projektet e Masës 3 duhet të realizohen brenda dy viteve buxhetore.

13. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Në mënyrë që të siguroheni që investimi të përmbushë objektivat e masës, projektet e pranueshme do t'ju japin pikë, sipas përparësive të mëposhtme

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit	25
2.	Investimet në projekte për përmirësim të pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës (lidhja e kontratave/ të noterizuar) ¹⁰	20
3.	Investimi në prodhimin e energjisë në ndërmarrje nga burimet e ripërtërishme (min. 10% investimit të pranueshëm) ¹¹	20
4.	Investimet që kanë të bëjnë me trajtimin e mbeturinave, pastrimin e ujit dhe/ose shfrytëzimin e produkteve të mbeturinave - ekonomia qarkore	15
5.	Investime që shpijnë në inovacion dhe diversifikim të prodhimit Futja e të paktën dy produkteve të reja	10
6.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 vjetëve të fundit (shih dokumentin: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera nga ATK)	5

7.	Krijimi i vendeve të punës (për çdo punëtor të ri të punësuar nga një pikë por jo më shumë se 5 pikë në total)	5
GJITHSEJ		100

⁰ Investimetet në projekte për të përmirësuar pozitën e fermerëve në zinxhirin e vlerës (lidhja e kontratave/të noterizuara)

a) se paku 80% e lëndës së parë të qumështit e kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;

b) se paku 30% e lëndës së parë e mishit të kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;

c) se paku 80% e lëndës së parë të pemëve, perimeve dhe rrushit të kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;

(këto duhet të dëshmohen përmes kontratave të noterizuara ndërsa prodhimi vetanak i ndërmarrjes dëshmohet me plan biznesi)

(këto duhet të dëshmohen përmes kontratave të noterizuara ndërsa prodhimi vetanak i ndërmarrjes dëshmohet me plan biznesi).

¹ Përfituesi që ka paraparë investime në prodhimin e energjisë së ripërtërishme dhe fiton pikë për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe mbajë aktiv për qëllime që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë nga zyrtarët e AZHB-së (ad-hoc ose ex- post) konstatohet që investimet në energji të ripërtërishme nuk janë duke u përdorur ashtu siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligjit Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L 098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

13.1. Rradhitja në listë

Të gjitha projektet që kanë kaluar kriteret e pranueshmërisë, pas vlerësimit, duhet të radhiten në bazë të pikëve të fituara dhe do të përfitojnë përkrahjen me mjetet financiare publike, duke filluar prej aplikacioneve me më shumë pikë.

Shënim : Për të gjitha nënmasat: Në rastet kur aplikuesit kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

14. PROCEDURAT E APLIKIMIT

14.1. Përmbajta e aplikacionit

Shënim: Një aplikacion konsiderohet i pranueshëm, nëse përmbanë të gjitha dokumentet e rradhitura sipas listës së paraqitur në Shtojcën Nr. 1 B

Aplikimi bëhet përmes web-modulit online në web-faqen e AZHB-se www.azhb-ks.net, në të cilën gjendet linku “aplikimi online” që dërgon në modulën e [aplikimit online PZHR](#). Në web-modul regjistrohet projekti si dhe ngarkohen (upload) dokumentet e nevojshme për aplikim në PDF.

Gjatë procesit të aplikimit të specifikoni me saktësi masën dhe sektorin përkatës.

Gjatë procesit të aplikimit të keni kujdes në bashkangjtitjen e të gjitha dokumenteve të domosdoshme të kërkuara për aplikim për masën dhe sektorin përkatës duke u bazuar në listën e dokumenteve.

Shënim

Gjatë këtij procesi para se të përfundoni aplikimin të verifikoni edhe një herë bashkangjtitjen e të gjitha dokumentave dhe specifikimin e kriterëve të kërkuara sipas U/A përkatës sepse posa të përfundoni këtë proces nuk ka mundësi për rikthim.

Pas përfundimit të procesit të aplikimit online fillon shqyrtimi administrativ i aplikacioneve;

Shenim -Pas përbjlljes së procesit të aplikimit onlin fermeri është i obliguar që origjinalin e aplikimit (dosjen) ta ruaj për një afate kohore prej 3 viteve në menyre që ta kete ne dispozicion kur ti kerkohet nga zyrtaret e AZHB-së.

14.2. Dorëzimi i aplikacioneve dhe afati i fundit

Thirrja për Aplikim bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe njoftimi publikohet në ueb faqen e internetit të MBPZHR-së: <http://www.mbpzhr-ks.net/> dhe në ueb faqen e internetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë <http://www.azhb-ks.net/> dhe në gazetata ditore.

Afati i fundit për aplikim është deri në perfundim të kampanja se thirrjes për aplikim

15. PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE ZBATIMI

Aplikacionet me vlerë të investimeve të pranueshme duhet të përmbajnë një Plan të Biznesit, sipas modelit të paraqitur në Shtojcën 2.

Plani i Biznesit është pjesë e dokumentacionit të pakos së aplikimit. Disa informacione që përfshihen në plan të biznesit duhet të merren parasysh për poentimin e aplikacioneve.

Gjithashtu, këto informacione që janë në planin e biznesit paraqesin burimin e të dhënave të përdorura për plotësimin e formularit për indikator.

Të dhënat /informatat e paraqitura brenda planit të biznesit dhe këtyre dokumenteve duhet të kontrollohen në të gjitha bazat e të dhënave ekzistuese (Regjistrin Kadastral të Vreshtave, Listën e kategorizimit të objekteve për përpunimin e ushqimit sipas kategorisë A, B, C, D i ndërmarrjeve (AUV), duhet të mbështeten me dokumente shtesë – si në Shtojcën Nr. 1 B, dhe duhet të jenë subjekt kontrollimi në terren para se kontrata të nënshkruhet, para pagesës së mjeteve financiare dhe pasi që projekti është përfunduar, gjatë periudhës së monitorimeve ex-post.

Shënim: Aplikacionet me të dhëna të pasakta ose të pavërteta refuzohen. Nëse vërtetohet se përfituesit i është bërë ndonjë pagesë duke u bazuar në të dhëna të pasakta ose të pavërteta të parashtruara nga i njejt, përfituesi obligohet ta kthej shumën e pranuar. Çdo përpjekje për mashtrim duhet të raportohet dhe të trajtohet si mashtrim me fondet publike!

Plani i Biznesit duhet të respektoj modelin e përgatitur nga AZHB/MBPZHR-ja për vitin 2022 Këto nuk janë vetëm dokumente “për t'u plotësuar”, por përfshijnë rekomandimet se si këto dokumente duhet të përgatiten. Të gjithë kapitujt duhet të trajtohen.

Mos trajtimi i ndonjë kapitulli është arsye e mjaftueshme për refuzim të aplikacionit. Paraqitja e kapitujve shtesë nuk do të merret parasysh gjatë vlerësimit të projektit.

15.1. Pikat e mëposhtme janë pjesë e vlerësimit të Planit të Biznesit:

1. Të gjithë kapitujt dhe nënkaptujt janë trajtuar, nëse nuk është relevante për aplikuesin atëherë duhet sqaruar arsyeja;
2. Është përmbyshur së paku 1 (një) objektive specifike e masës;
3. Kthimi i investimeve dëshmon që fitimi shtesë (të hyra shtesë – kosto shtesë) mbulon kostot e

- investimeve (të llogaritet vetëm bashkëfinancimi privat) për më pak se 10 vjet.
4. Numër të mjaftueshëm të stafit (të punësuar) për të funksionuar biznesi.
 5. Blerjet / ndërtimet e propozuara janë në bazë të nevojave të aplikuesit (psh. jo më shumë pajisje sesa ka nevojë, nuk lejohen ndërtimet nëse aplikuesi nuk ka hapësira të mjaftueshme).
 6. Kostot për t'i vlerësuar blerjet/ndërtimet duhet të jenë të arsyeshme
 7. Orari për blerjet/ndërtimet është real dhe jep mundësinë që investimi të përfundojë në kohën optimale, ashtu siç është paraparë në përshkrimin e masës;
 8. Duhet të prezantohet kapaciteti i prodhimit para dhe pas investimit;
 9. Krijta e paraparë në kapacitetin prodhues është plotësisht e dëshmuar bazuar në investimin e propozuar.
 10. Procesi teknologjik është në përputhje me asetet ekzistuese si dhe investimet e parapara (të mundshme) të ofruesit të shërbimeve.
 11. Furnizuesit potencial dhe klientët potencialë janë identifikuar (duke dëshmuar përmes kontratave dhe parakontratave).
 12. Strategjia e tregut është reale.
 13. Për të gjitha investimet e pranueshme dhe të papranueshme janë paraqitur saktë kushtet e nivelit të ndihmës publike dhe niveli i ndihmës private.
 14. Për 2 vitet e fundit duhet të paraqitet nëse aplikuesi ka pasur fitim apo humbje. Ndërmarrjet duhet ta dorëzojnë pasqyrën e të ardhurave dhe bilancin e gjendjes.
 15. Për 3 vitet e ardhshme pasi që investimi është përfunduar, në fund të çdo muaji, bilanci i rrjedhjes së parasë duhet të jetë pozitiv.
 16. Të hyrat e parapara janë në përputhje me kapacitetin prodhues;
 17. Të hyrat e parapara janë në përputhje me strategjinë e marketingut (psh. është e pamundur që një sasi e madhe e perimeve të shpërndahej direkt nga përfituesi në tregun e gjelbër);
 18. Të hyrat totale në llogaritjen e kthimit të investimit janë në përputhje me të hyrat totale nga shitja e prodhimit paraqitur në indikatorët e ndikimit.
 19. Aplikuesi nuk ka krijuar kushte artificiale për të përfituar përparësi.

16. KONTROLLET NË TERREN

Janë të parapara së paku 4 kontrollat në terren.

- 1) Kontrolli i Parë (para miratimit),
- 2) Kontrolli i Dytë (pas investimit dhe para pagesë),
- 3) Ex-pos kontrolli,

Kontrollat e Parë - realizohet pas procesit të vlerësimit dhe përfshin:

- -Kontrollin e aseteve të deklaruara në planin e biznesit nga vet aplikuesi,
- -Verifikimin e parcelave katastrale dhe kopjen e planit,
- -Verifikimi i pikave kyçe për të cilat është poentuar aplikacioni.

Çdo mos përputhje do të regjistrohet në raportin e kontrollit dhe do të ndikojë në procesin e

miratimit.

Kontrolli i Dytë - (kontrolli pas investimit të parapagesës) realizohet pas kryerjes së investimeve sipas kontratës dhe paraqitjes së kërkesës për pagesë dhe përfshin:

-Kontrollin e secilit pozicion investues sipas Letrës së Informimit/miratimit dhe Kontratës, verifikimin e cilësisë së investimit, verifikimin e realizimit të standardeve minimale nacionale, çdo mospërputhje do të regjistrohet në raportin e kontrollit të dytë dhe do të ndikoj në procesin e autorizimit të pagesave.

Pas parashtrimit të Kërkesës për pagesë, Drejtoria e Kontrollit e AZHB-së është i obliguar të verifikojë zbatimin e investimeve me anë të kontrollit në teren. Në këtë rast përfituesi është i obliguar të jetë i pranishëm gjatë zhvillimit të kontrollit në teren me se largu 5 dite nga njoftimi i AZHB-së.

Ex-post Kontroll (monitorimi) - është proces i monitorimit të projektit të bashkëfinancuar nga AZHB/MBPZHR-ja dhe përfituesit, sipas obligimeve të marra me nënshkrimin e kontratës për periudhën 3 vjeçare dhe përfshin:

-Verifikimi i të gjitha pozicioneve investuese,

-Verifikimin e funksionalitetit të projektit dhe mirëmbajtjen e investimit.

Çdo mospërputhje do të regjistrohet në raportin e Ex-post kontrollit dhe do t'i drejtohet zyrës ligjore për procedim të mëtejshëm.

AZHB kryen Ex-post kontroll për verifikimin e të gjitha projekteve të përzgjedhura për financim tre (3) vjet, nga dita e ekzekutimit të pagesës së fundit. Në këtë rast përfituesi është i obliguar të jetë i pranishëm gjatë zhvillimit të kontrollit në teren me se largu 5 dite nga njoftimi i AZHB-së.

Super Kontrolla është kontroll i veçantë që organizohet me vendim të AZHB-së-DK dhe ka për qëllim:

- Pengimin e tentimit të mashtrimit,
- Verifikimin e investimeve të kryera në terren,
- Vlerësimin e punës së inspektoratit në terren.

Rikontrolla kryhen në raste të veçanta, sipas kërkesës së drejtorive përkatëse (pas miratimit të projektit dhe pas kërkesës për pagesë).

Shënim: Kur kërkohet të kontrollohet, përfituesit janë të obliguar të lejojnë qasje të lirë dhe të menjëhershme në ndërmarrje, në pajisjet e ndërmarrjes dhe ndonjë dokument të kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Nëse ndodh mosrespektimi i këtij kushti, duhet të bëhet kthimi i menjëhershëm i përkrahjes publike dhe do të aplikohet ndëshkimi i përfituesit.

17.PROCEDURAT E PËRKRAHJES ME FONDET PUBLIKE DHE NJOFTIMI I APLIKUESIT

Pas Kontrollës administrative dhe vlerësimit, AZHB përgatitë raportin ku Projektet klasifikohen në:

- 1) Projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë) dhe
- 2) Projekte të pranueshme dhe të vlerësuara me pikë.

Ky raport nënshkruhet nga Kryeshefi i AZHB-së. Dhe i cili publikohet në ueb të AZHB-së. Gjithashtu, aplikuesit i dërgohet informatat me sms dhe email. Aplikuesit të cilët nuk e pranojnë informatën përmes sms dhe emailit, mund të vijnë në zyret e AZHB-së për informata lidhur me aplikacionin e tyre.

Raporti preleminar nënshkruhet nga Kryeshefi i AZHB-së dhe publikohet në ueb faqe të AZHB-së dhe ueb faqe të MBPZHR-së. Prej ditës së publikimit në ueb faqe, pranimit të raportit të vlerësimit, si dhe vendimit për refuzim aplikuesi ka afat 30 ditë (kalendarike) të ushtroj ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave.

Komisioni i Ankesave merr vendim brenda 30 ditësh perveq rasteve të veçanta.

18. ORARI INDIKATIV I SHPALLJES

AZHB-ja shpallë thirrje për aplikim.

19.KONTRATA MES PËRFITUESIT DHE AZHB-SË, SI DHE PROCEDURAT E PROKURIMIT.

Të gjithë përfituesit do të nënshkruajnë një kontratë standard, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën Nr.3. Plani i Biznesit, së bashku me të gjitha dokumentet e paraqitura bëhet pjesë e kontratës. Kontrata mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri në përfundim të periudhës monitoruese, që është 3 vjet pas implementimit të projektit.

Pagesa e mjeteve publike për projektet e zhvillimit rural

Pas nënshkrimit të kontratës, përfituesi mund të paraqesë kërkesën për paradhënie deri në 50% të ndihmës publike, duke plotësuar formularin e ofruar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, si në Shtojcën Nr. 6, me kusht të sigurimit të garancionit bankar.

Ndërkaq, pjesa e mbetur e investimeve publike do të realizohet deri në kërkesën e aplikuesit pasi të ketë përfunduar i tërë investimi.

Kërkesës për pagesë përfundimtare, përfituesi duhet t'ia bashkëngjese dëshmitë e pagesës (faturat dhe kuponin fiskal ose transferin bankar për pagesat nën vlerën 500 euro, kurse për pagesat me vlerë 500 e më shumë euro faturat dhe transferin bankar), si dhe provat e kryerjes së procedurave të prokurimit, nëse një gjë e tillë është e paraparë me kontratë. Aprovimi i pagesës do të realizohet pas kontrollimit të dokumenteve dhe pas kontrollit në terren të kryer nga zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Në rastet kur vërehen gabime në fatura, transfere bankare apo procedura të prokurimit përfituesi i jepet mundësia për përmirësimin e tyre prej 5 ditëve kalendarike.

Shënim : Llogaria në të cilën do të kryhet pagesa nga AZHB duhet të jetë në emër të ndërmarrjes dhe JO në emër të pronarit.

20. DISPOZITAT E RËNDËSISHME QË MUND TË JENË SHKAKTAR I REFUZIMIT TË APLIKACIONIT

Aplikacionet mund të refuzohen nëse:

1. Nuk janë të kompletuara,
2. Nuk e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë,
3. Për shkak të numrit të vogël të pikëve (pragu minimal i pikëve në këtë masë duhet të jetë 50 pikë).

Shënim: Arsyet e refuzimit duhet të paraqiten dhe sqarohen në Vendimin për refuzim të cilën AZHB i dërgon aplikuesit.

Aplikacionet e papranueshme - Projektet mund të deklarohen si të papranueshme gjatë kontrollit administrativ (psh. mospërputhje me të dhënat nga Regjistri i Fermës), gjatë vlerësimit të dokumenteve (psh. vlerësimi i Planit të Biznesit). Projektet e papranueshme nuk i nënshtrohen procesit të dhënies së pikëve (selektimit) Refuzohen në këtë fazë.

21. LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca Nr. 1 A	Formulari i aplikimit
Shtojca Nr. 1 B	Lista e dokumenteve të dorëzuara
Shtojca Nr. 2	Modeli për përgatitjen e Planit të Biznesit
Shtojca Nr. 3	Procedurat e Prokurimit
Shtojca Nr. 4	Lista e shpenzimeve të pranueshme
Shtojca Nr. 5	Standardet Minimale Kombëtare
Shtojca Nr. 6	Kërkesa për Pagesë
Shtojca Nr. 7	Letra Informuese
Shtojca Nr. 8	Forma e Ankesës për agropërpunues
Shtojca Nr. 9	Zyrat Rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë
Shtojca Nr. 10	Indikatorët e ndikimit,
Shtojca Nr. 11	Pjesa financiare e planit të biznesit (në Excel)
Shtojca Nr. 12	Kodi i etikës për kompanitë këshilluese
Shtojca Nr. 13	Promovimi
Shtojca Nr. 14	Deklarata nën betim /Zotimi
Shtojca Nr. 15	Deklaratë nën betim për të drejtën e shfrytëzimit të tokës së trashëguar

SHTOJCA NR.1 A FORMULARI PER APLIKIM (krijohet gjatë procesit të aplikimit).

SHTOJCA NR.1 B – LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA-2022

MASA 3 LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA- 2022

Nr.	Dokumenti	Obligativ	Opcional
1.	Formulari për aplikim (Përpilohet gjatë procesit të aplikimit)	<input type="checkbox"/>	
2.	Kopja e Letërnjoftimit te Republikës se Kosoves valid të perfaqësuesit të ndërmarrjes	<input type="checkbox"/>	
3.	Çertifikata e regjistrimit në regjistrin e fermës (NIF) - Të jetë në emër të subjektit juridik dhe të ketë të regjistruara të gjitha asetet. (Kopje)	<input type="checkbox"/>	
5.	Çertifikata e regjistrimit të biznesit Çertifikata e numrit fiskal	<input type="checkbox"/>	
6.	Plani i biznesit (sipas modelit të AZHB-se)	<input type="checkbox"/>	
7.	Nga Agjencia Ushqimit dhe Veterinës - a. Vendim për Aprovim - në rastin e përpunimit të qumështit dhe mishit b. Vendim për Regjistrim - në rastin e sektorit te pemëve, perimeve verës dhe pika grumbulluese /depo	<input type="checkbox"/>	
8.	Aplikuesit për prodhim të verës: Certifikata e Vreshtarit nga Regjistri Kadastral i Vreshtave - në rast se ka vreshta obligativ.		<input type="checkbox"/>
9.	Aplikuesit për prodhim të verës: Dokumenti nga DVV për prodhimin vjetor -	<input type="checkbox"/>	
10.	Certifikata nga regjistri i prodhuesve të verës në Kosovë (Obligativ vetëm në aplikuesit në sektorin e verës)		<input type="checkbox"/>
11.	Te gjithë aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera ose te rregulluara detyrimet tatimore, tatimin në të ardhura dhe tatimet e tjera të aplikueshme; Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës- që dëshmon se aplikuesi i ka te shlyera apo te rregulluara detyrimet tatimore tatimin në të ardhura dhe tatimet e tjera të aplikueshme;	<input type="checkbox"/>	
12.	Gjendja e pergjithshme e deklarimeve dhe transakcioneve te tjera nga ATK		<input type="checkbox"/>
13.	Lista e stafit të kompanisë ne momentin kur dorëzohet formulari për aplikim - nga ATK	<input type="checkbox"/>	

14.	Kontrata e punës së përfaqësuesit të ndërmarrjes me kohëzgjatje së paku për 3 vjet nga data e aplikimit -		<input type="checkbox"/>
15.	LISTA E KONTRATAVE me fermerë nëse aplikuesi i posedon ato		<input type="checkbox"/>
16.	Në rastin e projekteve të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet t'i dorëzojnë: <ul style="list-style-type: none"> • Certifikatën e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi; • Në rast se toka është e marrur me qira, kontrata duhet të jetë e noterizuar për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit. • Kontrata duhet të përmbaj edhe pëlqimin e pronarit (qeradhënësit për investimin që do të bëhet në tokën ose objektin e tij. Pëlqimi mund të jetë pjesë e kontratës së qeramarrjes ose i ndarë veçmas). • Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi • Kopjet e skicave të objektit; • Aplikuesi që aplikon në investimet për menaxhimin e mbetjeve dhe menaxhimin e ujrave të shkarkuara në rastin e aplikimit të sjellin projekt ideor me paramasa dhe parallogaritje. • Parallogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara. 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
17.	Në rast të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit, aplikuesit duhet ta dorëzojnë edhe projektin teknik të planit të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit.	<input type="checkbox"/>	
18.	Raportin/ procesverbalin (jo më të vjetër se gjashtë muaj) të lëshuar nga AUV për gjendjen ekzistuese të operatorit dhe cilat standarde duhet t' i plotësoj	<input type="checkbox"/>	
19.	Pëlqim nga organi kompetent (Komuna) për leje të ndërtimit, në rastet e projekteve të ndërtimit / zgjerimit, por jo në rastet e projekteve të rinovimit	<input type="checkbox"/>	
20.	Bizneset joraportuese të TVSH-së: dokumenti i shtypur nga uebfaqja e ATK-së: http://apps.atkks.org/BizPasiveApp/VatRegist/SearchVat		<input type="checkbox"/>
21.	Formulari për indikator (përpilohet gjatë procesit të aplikimit nga aplikuesi)Edhe formulari fizik plotësohet dhe I bashkangjitet aplikacionit	<input type="checkbox"/>	
22.	Pëlqimi i bashkepronarit-ve, (Deklaratë e nënshkruar, të cilës i bashkangjitet/en kopja/et e letërnjoftimit/eve) në rast të investimeve në asete me më shumë pronarë	<input type="checkbox"/>	
23.	Deklarate për zotim se të dhënat e paraqitura janë të sakta	<input type="checkbox"/>	

SHTOJCA NR.2 MODEL PËR PËRGATITJEN E PLANIT TË BIZNESIT



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developmen

MODEL PËR PËRGATITJEN E PLANIT TË BIZNESIT
për projektet e përkrahura nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit
Rural

SHËNIM:

Ky dokument është një model si të shkruhet plani i biznesit dhe duhet të respektohet në tërësi. Në rast se ekziston ndonjë kapitull që nuk ndërlidhet me projektin tuaj, ju duhet të njoftoni me një fjali brenda kapitullit përkatës.

Pjesa financiare e planit të biznesit duhet të bëhet në Excel, ashtu që vlerësimi të jetë më i lehtë dhe më i shpejtë.

1 Informata të përgjithshme

1.1 Emri i aplikuesit (me të dhënat e tij specifike të identifikimit)

1.2 Asetet kryesore në pronësi të aplikuesit: tokë (me specifikim të llojit të pronësisë), objekte, pajisje dhe makineri, kafshë etj. – sikur në Regjistrin e Fermës.

Tabela 1. Asetet e aplikuesit

Asetet	Data e blerjes / ndërtimit	Gjendja e fundit e bilancit	Sasia (me copë)
1. Objektet – gjithsej			
1.1 detaje.....			
1.2 detaje.....			
2. Pajisje – gjithsej			
2.1 detaje.....			
2.2 detaje.....			
3. KAFSHË			
3.1 detaje.....			
3.2 detaje.....			
4. Të tjera - detaje			
GJITHSEJ			

Tabela 2. Toka

Nr.	Rajoni/Komuna/Fshati	Sipërfaqja (m ²) / lloji i shfrytëzimit	Ndermarrja
1			
n			

2 Përshkrimi projektit

2.1 Emërtimi i investimit.

2.2 Vendi i projektit (rajoni, komuna dhe fshati).

2.3 Qëllimi, me përshkrimin e objektivave, arsytimit të nevojës dhe mundësisë së investimit.

2.4 Duhet të ceket konsistenca mes objektivave të Masës dhe objektivave të projektit. Sqarimet për objektivat e përgjithshme dhe së paku për një të një prej objektivave të projektit duhet të bëhet prezantimi sipas tabelës në vijim:

Tabela 3. Harmonizimi i objektivave të programit me ato të projektit

Objektivat e përgjithshme dhe specifike	Objektivat e projektit	Përshkrimi si do të arrihen objektivat
Për të rritur aftësinë konkurruese të pikave dhe qendrave grumbulluese për frutat pyjore, nëpërmjet shfrytëzimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore dhe përdorimit më të mirë të faktorëve të prodhimit, duke u fokusuar në vlerën e shtuar të prodhimit. <i>(domosdoshme)</i>		
Së paku një prej objektivave specifike në vijim:		
Objektiva specifike të masës dhe nënmasës		
Objektiva specifike të masës dhe nënmasës		

<p>***Duhet të bëhet një prezantim ku theksohet saktësisht se për sa kohë duhet të përfundojë kthimi i investimit. Kthimi i investimit duhet të kalkulohet vetëm për pjesën e investimit që mbulohet me bashkëfinancim privat (shiko tab. 10).</p> <p>Duhet të merren parasysh vetëm investimet që në mënyre direkte gjenerojnë ekstra vlerë të prodhimit (si psh. traktor, apo ndonjë mjet për mjelje por jo stallë apo depo e plehut etj.);</p> <p>**Në rast të pemishteve të reja, vreshtave të rrushit ose pemëve të buta ekstra vlera e shitjes duhet të llogaritet për atë vit që bimët do të gjenerojnë rendimente maksimale;</p> <p>***Prezantimi duhet të mbështetet në të ardhurat dhe shpenzimet dhe të paraqiten në tabelën 11.</p>	<p>—</p> <p>—</p> <p>—</p> <p>—</p>	
---	-------------------------------------	--

3. Të dhëna lidhur me fuqinë punëtore dhe menaxhimin e projektit

3.1. Menaxheri (emir, mbiemri, pozita Brenda organizatës, studimet relevante dhe përvoja profesionale)

3.2. Numri i përgjithshëm i punonjësve aktual, prej të cilëve me detyra ekzekutive.

3.3 Vlerësimet rreth fuqisë punëtore që do të punësohen pas zbatimit të projektit
prej të cilave vende të reja pune për zbatimin e projektit.

Plani i biznesit duhet të përmbaj nje pershkrim të hollsishe me te investimeve dhe aktiviteteteve konform kerkesave te AUV- it per permirsimin e standarteve

Aplikuesi duhet të demonstrojë në planin e biznesit qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fund të realizimit të projektit. Ndërmarrja duhet të demonstrojë se ajo mund t'i kryejë detyrimet dhe borxhet rregullisht, pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes

Gjithashtu, plani i biznesit duhet të tregojë se në çfarë mënyre zbatimi i projektit do të çojë në përmirësimin e performancës së përgjithshme të ndërmarrjes agro-ushqimore përmes prezantimit të perspektivës së qëndrueshmërisë financiare/ekonomike.

4. Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit

Emri, numri, vlera, karakteristikat teknike dhe funksionale të makinerisë / pajisjeve / teknologjive / mjeteve të transportit / pajisjeve që do të blihen përmes projektit dhe, nëse është e nevojshme, prezantimi teknik i objekteve ku do të vendosen pajisjet dhe mjetet. Prokurimet duhet të bazohen në kapacitetet aktuale parashikuara të prodhimit.

Tabela 5. Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit

Nr.	Emri / lloji i pajisjeve / makinerisë	Njësitë	Vlera pa TVSh	TVSh	Gjithsej vlera me TVSh	Përqindja e përkrahjes publike
1.						
2.						
GJITHSEJ						

Shenim : Të specifikohet karakteristikat teknike të pajisjeve dhe makinërive që përbëjnë një linjë prodhuese.

5. Kalendari i zbatimit (muajt) dhe fazat kryesore

Orari i investimit i shprehur me vlera, muaj dhe aktivitete.

Tabela 6. Shembull / Orari për shpërndarje

Lloji i investimit dhe kostoja totale (euro)	Viti (p.sh. 2022)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Psh. tavolina për pastrim	5 000		
Psh. makineria për klasifikim		15 000	
Psh. makineria për tharje			8 000

Tabela 7. Shembull / Orari për ndërtimin e objekteve të reja

Lloji i investimit dhe kostoja totale (euro)	Viti (psh. 2022)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
psh. përbërësitë e ndërtimit	5 000		
psh. Ndërtimi i katit të 1-rë pa dritare dhe kulm		10 000	
psh. kati i 1-rë, dritaret dhe kulmi			5 000

6. Kapaciteti prodhues

Kapacitetet prodhuese që rezultojnë nga investimi (në njësi fizike). Kapaciteti prodhues përveq kapacitetit në njësi fizike (kg/tonë), aplikuesi të paraqes edhe vlerën e parashikuar monetare për kapacitetin prodhues të planifikuar dhe të harmonizohet me pjesët / kapitujt tjerë ku paraqiten të dhëna financiare.

Duhet të paraqitet përshkrimi i rrjedhës teknologjike të punës që aplikohet në teknologjinë e projektit.

7. Furnizimi i tregut / shitja

Tabela 8. Furnizuesit potencial të ndërmarrjes

Furnizuesit potencial të aplikuesit				
Emri i furnizuesit me lëndët e para / materialet ndihmëse / produktet / shërbimet	Adresa	Produkti furnizues dhe shuma e përafërt	Vlera e llogaritur	% nga shpërndarja totale
1				
2				
N				

Tabela 9. Klientët potencial të aplikuesit

Klientët potencialë të aplikuesit			
Nr.	Klienti (Emri dhe adresa)	Vlera	% e shitjes
1			

2			
3			

8. Konkurrenca dhe strategjia e tregut që duhet të aplikohet

Përshkrimi i konkurrencës lokale dhe ndërkombëtare. Përshkrimi i strategjisë së tregut.

9. Detaje financiare të investimit

Tabela 10. Shpenzime të detajuara të pranueshme dhe të papranueshme

Shpenzimet e pranueshme	Ndihma publike	Bashkëfinancimi privat (euro)	Totali
Investimet e pranueshme			
...			
Shpenzimet administrative (psh. hartimi i planit të biznesit)			
Investimet e papranueshme			
TOTALI			

Rrjedhja e parasë së gatshme (të ardhurat / pagesat)

Parashikimi i të ardhurave dhe pagesave për 3 vjet pas finalizimit të investimit. Aplikuesi duhet të demonstrojë profitabilitetin e fermës së tij për çdo vit si dhe disponueshmerinë mujore të parave të gatshme. Shuma e parave të marrë nga kredia regjistrohet si e hyrë kurse këstet mujore për kthimin e kredisë regjistrohen si shpenzim.

Në rastin e personave juridikë llogaritet pasqyra e të ardhurave për tri vitet e fundit që është dorëzuar në Administratën Tatimore.

Shënim: Supozimet duhet të shpalosen duke pasur parasysh gjendjen financiare të vitit të kaluar për projektin e dorëzuar. Për më tepër duhet të merren parasysh lidhja midis shitjes, parashikimit, përdorimit të kapacitetit të prodhimit dhe para kontratave të shitjes.

SHTOJCA NR.3 PROCEDURAT E PROKURIMIT

PROCEDURAT E PROKURIMIT

(të jenë të bashkangjitura me kontratën e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor për përfituesit)

1. Dispozitat e përgjithshme të zbatueshme për të gjitha llojet e blerjeve

- Të gjithë ofertuesit /tenderuesit duhet të plotësojnë Rregullën e origjinës – për detaje shih dispozitat dhe shtojcat e tjera relevante në Udhëzuesin e Aplikuesit;
- Asnjë nënkontraktues nuk mund të krijojë marrëdhënie kontraktuese në mes të ndonjë nënkontraktuesi tjetër dhe përfituesit;
- Blerjet duhet të respektojnë investimet që përmbushin kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në kuadër të masave dhe udhëzimeve të planit të biznesit psh. për sa i përket kthimit të investimeve, rrjedhës së parasë etj.
- Procedurat e prokurimit vlejnë vetëm për investimet e pranueshme, për investimet e papranueshme nuk janë të obligueshme procedurat e prokurimit;
- Ka 3 lloje të procedurave: blerjet e drejtpërdrejta, blerjet me më së paku 3 oferta dhe përzgjedhje bazuar në prokurimin me shpallje publike (tender i hapur);
- Procedura për blerjet që do të aplikohen është në varësi të vlerës së blerjeve; është e ndaluar ndarja e blerjeve për llojin e njëjtë të mallrave, punimeve apo shërbimeve me qëllim të shmangies së rregullave procedurale të aplikueshme për një prag më të lartë;
- Ofertuesit nuk duhet të jetë në konflikt të interesit;
- Në rastin e shtrembërimit të informacionit të kërkuar nga përfituesi ose dështojnë për të dhënë këtë informacion, ofertuesit do të përjashtohen nga dhënia e kontratave;
- Respektimi i rregullave të prokurimit është një kusht i detyrueshëm për t'u pranuar shpenzimet. Prandaj, dosja e kërkesës duhet të përmbajë dokumentet e pagesave për të provuar plotësimin e procedurave të prokurimit, si në Shtojcën 5 të kontratës.

2. Kriteret e dhënies / shpërblyese:

Kontratat duhet të jepen si më poshtë:

A. Në rast të furnizimit / mallrave - të bazuar në çmimin më të ulët;

B. Në rastin e Ndërtimit (nëkupton rezultatit e ndërtimit ose projektit të inxhinierisë civile që vetvetiu është e mjaftueshme të plotësojë një funksion ekonomik ose teknik dhe mbulon të dyja edhe ekzekutimin dhe dizajnimin) - bazuar në çmimin më të ulët;

C. Në rast të shërbimeve (studime ose për ndihmë teknike) - bazuar në çmimin më të ulët;

3. Përkufizimi i konfliktit të interesit

- Ekzistimi i lidhjeve ndërmjet përfituesit dhe furnizuesit (të afërmit, apo aksionarë të përbashkët në

kompanitë ofertuese) ose në mes të anëtarëve të komitetit vlerësues.

- Pronësia e përbashkët (si individë ose si aksionarë) në mesin e furnizuesve të cilët dorëzojnë oferta.

4.Procedurat e blerjes:

4.1 Blerjet direkte deri në 10 000.00 euro.

Rregullat:

- Përfituesi mund të blejë drejtpërdrejt nga tregu,
- Kostoja e blerjes duhet t'i respektojë pragjet e vendosura në masë,
- Nuk ka nevojë për një kontratë të nënshkruar mes shfrytëzuesit dhe furnizuesit, përveç në rast të shpenzimeve të konsulencës,
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

4.2 Përzgjedhja e bazuar në të paktën 3 oferta duke filluar nga vlera 10 000.01 euro deri në 60 000.00 euro.

Rregullat:

- Blerjet mund të bëhet vetëm më së paku 3 oferta (kuotim i çmimit);
- Shpenzimet brenda ofertës duhet t'i respektojnë edhe pragjet e vendosura brenda masave;
- Në të gjitha rastet, duhet të nënshkruhet kontrata mes përfituesit dhe furnizuesit,
- Ftesat për oferta, ofertat dhe kontrata duhet të respektojnë dispozitat /detajet e të cilave janë paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe brenda planit të biznesit.
- Përfituesi duhet të dërgojë një ftesë për ofertë, duke respektuar një format standard, si në Shtojcën 1;
- Furnizuesit duhet ta regjistrojnë ofertën e tyre në regjistrin e hyrje / daljeve.
- Përfituesi duhet ta nënshkruajë deklaratën për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit, si në Shtojcën 2.
- Ofertuesit duhet të nënshkruajnë deklaratën e tenderuesit të besueshëm, si në Shtojcën 3.
- Përfituesi do të vendosë për dhënien e kontratës ofertuesit me argumente;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

4.3 Prokurimi me shpallje publike (tender i hapur) - duke filluar nga 60 000.01 euro

Rregullat:

- Të gjitha dispozitat nga pika 4.2. duhet të respektohen;
- Përfituesi duhet të publikojë interesin e tij për blerjen përmes së paku 1 (një) gazete të përditshme kombëtare, por në qoftë se vlera është më e lartë se 150 000 € tenderi duhet të paraqitet edhe në mediat ndërkombëtare. Përveç kësaj, përfituesi ka të drejtë të dërgojë direkt ftesat për furnizuesit e mundshëm për të siguruar një konkurrencë më të mirë në mesin e ofertave, por vetëm në të njëjtën ditë kur është shpallur tenderi;
- Përmbajtja e ftesës publike duhet ta përfshijë të gjithë informacionin e paraqitur në Shtojcën 1;
- Afati kohor për marrjen e ofertave duhet të jetë të paktën 10 ditë; Përfituesi do të krijojë një komision vlerësimi; Ky komision duhet të ketë një numër tek të anëtarëve, të paktën tre, me të gjitha kapacitetet teknike dhe administrative të nevojshme për të dhënë një opinion të vlefshëm mbi tenderët;

- Komisioni i vlerësimit duhet të lëshojë një vendim të argumentuar për dhënien e tenderit;
- Anëtarët e komisionit të vlerësimit duhet të nënshkruajnë një deklaratë të konfidencialitetit dhe neutralitetit, si në Shtojcën 4;
- Të gjitha kërkesat për pjesëmarrje dhe tenderët që i plotësojnë kërkesat, duhet të vlerësohen dhe renditen nga komisioni i vlerësimit në bazë të kritereve të përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës të shpallura paraprakisht;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së Regjistrimit të Biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

Shtojca 1

Emri i përfituesit privat.....

Numri i regjistrimit të biznesit ose numri personal i identifikimit Numri fiskal.....

Adresa.....

Tel. / faks / e-mail Nr
Data

Për: Emri i kompanisë.....

E pranuar sot:

Nr Data ____/____/_____

Emri dhe mbiemri: Nr. i regjistrimit të biznesit

Numri fiskal Nënshkrimi.....

Ftesë për dorëzimin e një oferte

(Formular)

Të nderuar zonja/zotërinj,

(Emri i përfituesit) ju fton që të paraqitni ofertën tuaj për (lloji i blerjes).....

..... për zbatimin e një projekti të bashkëfinancuar nga MBPZHR nën masën /nënmasën kodin <masa/nënmasa dhe emri> me titullin e mëposhtëm titulli i projektit, i cili do të zbatohet në komunën <Emri komuna>.

Përzgjedhja për dhënien e kriterit është (duhet përmendur sipas llojit të kontratës, siç paraqitet në pikën 2 të këtij dokumenti - Kriteret për dhënien e çmimit);

Kontrata do të konsistojë në blerjen/përvetësimin epër implementimin e projektit të lartpërmendur;

Lloji i kontratës: blerja e <shërbimeve/mallrave/punë ndërtuese>; Afati i fundit për dorëzimin e ofertës: <data>, <ora>.

Adresa ku do të dorëzohen ofertat

Data dhe ora kur do të fillojë vlerësimi Vlera

maksimale e blerjes Bashkëngjitur i gjeni sasishtë, specifikimet teknike /termat e referencës për ofertën e

kërkuar (të jetë e bashkëngjitur siç është paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe, nëse është e zbatueshme, në kuadër të planit të biznesit).

Ne presim ofertën tuaj deri në afatin e përcaktuar dhe në adresën e përmendur më lart.

<Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit>

Nënshkrimi, ven dhe data

Shtojca 2

Deklaratë për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit

Unë, i nënshkruari, si përfaqësues ligjor i projektit, deklaroj nën sanksionin e ligjeve në fuqi, se:

1. Nuk ekzistojnë lidhjet (të afërmit, apo aksionarë të përbashkët për çdo kompani) ndërmjet përfituesit (apo partnerë të përfituesve) dhe tenderuesve (ose partnerët e tenderuesit), të cilët dorëzojnë oferta;
2. Nuk ka pronësi të përbashkët (si individë ose si një aksionar) në mesin e ofertuesve nga i cili kam marrë oferta.

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit

Nënshkrimi _____

Data ____/____/____

Shtojca 3

Deklarata për seriozitetin e ofertuesit

Unë, i nënshkruari, si përfaqësues ligjor i projektit, deklaroj me përgjegjësi të plotë nën sanksionin e legjislacionit dhe rregullativës në fuqi se nuk jam në njërin prej situatave të listuara më poshtë:

Në falimentim ose duke u likuiduar, në afera të administruara nga gjykatat, kam hyrë në një marrëveshje me kreditorët, aktivitetet të pezulluara të biznesit, u nënshtrohem procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacional;

Kam qenë i dënuar për ndonjë shkelje lidhur me sjelljen profesionale përmes një gjykimi të plotfuqishëm (res judicata), kam qenë fajtor për shkelje të rëndë profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund të justifikojë përfituesi;

Nuk i kam përmbushur detyrimet lidhur me pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose për pagimin e tatimeve, në përputhje me dispozitat ligjore të vendit në të cilin unë jam përcaktuar dhe në vendin e përfituesit;

Kam qenë objekt i një gjykimi të plotfuqishëm (res judicata) për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Kosovës; Aktualisht i nënshtrohem një ndëshkimi administrativ financiar të lëshuar nga AZHB e cila është përgjegjëse për subvencione dhe grante për bujqësi dhe zhvillim rural në Kosovë.

Jam deklaruar si i papranueshëm për Komisionin Evropian.

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit

Vendi dhe data

Nënshkrimi

Shtojca 4
Deklarata e konfidencialitetit

Deklaratë e konfidencialitetit dhe neutralitetit

Unë, i nënshkruari, anëtar i komisionit të vlerësimit për blerjen e....., nën procedurën e aplikuar <përzgjedhja bazohet në të paktën 3 oferta ose përzgjedhje në bazë të prokurimit të reklamuar, organizuar nga <emri i përfituesit>,

Unë deklaroj me përgjegjësi të plotë nën sanksionin e legjislacionit dhe rregullativës në fuqi, si më poshtë:

- a) Unë nuk kam asnjë të afërm apo aksione ose partnerë të biznesit në mes të ofertuesve dhe komisionit vlerësues;
- b) Unë nuk jam anëtar i ndonjë Bordi, trupit vendimmarrës ose mbikëqyrës për ndonjë nga tenderuesit;
- c) Unë nuk kam asnjë interes që mund të ndikojë në neutralitetin tim gjatë vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu, unë do të angazhohem plotësisht në ruajtjen e konfidencialitetit të përmbajtjes së ofertave edhe të veprimtarisë së komisionit të vlerësimit në rast se informacioni mund të ndikojë në të drejtat ligjore, pronë e tenderuesit, ose sekretet e tyre tregtare.

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit

Vendi dhe data

Nënshkrimi

Shtojca 5 e Kontratës

Dokumentet që duhet të dorëzohen bashkë me Kërkesën për pagesë, varësisht nga procedura e prokurimit.

Numri i dokumentit	Vlera e tenderit		
	Deri në 10 000 euro	10 000 – 60 000 euro	Më shumë se 60 000 eur
Lloji i blerjes	a. Mallra <input type="checkbox"/> b. Ndërtime c. Shërbime <input type="checkbox"/>	a. Mallra <input type="checkbox"/> b. Ndërtime c. Shërbime <input type="checkbox"/>	a. Mallra <input type="checkbox"/> b. Ndërtime c. Shërbime <input type="checkbox"/>
1	Deklarata		Kopja e shpalljes e publikuar në shtyp/gazetë
2		Së paku tri ftesa me shkrim të plotësuar, të nënshkruara nga pranuesi i ofertës (tenderuesit), nga Shtojca 1	Ftesa me shkrim të plotësuar, të nënshkruara nga pranuesi i ofertës (tenderuesit), nga Shtojca 1 – nuk është e obligueshme – nëse ky është rasti/ vendosur nga përfituesi i grantit
3		Kopjet e certifikatës për regjistrimin e biznesit të secilit nga tenderuesit (për së paku 3 tenderues)	Kopjet e certifikatës për regjistrimin e biznesit të secilit nga tenderuesit (për së paku 3 tenderues)
4		Kopjet e numrit fiskal të tenderuesve (për së paku 3 tenderues)	Kopjet e numrit fiskal të tenderuesve (për së paku 3 tenderues)
5		Ofertat e pranuar (së paku 3)	Ofertat e pranuar (së paku 3)
6			Vendimi për krijimin e komisionit për vlerësim
7		Deklarata për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit (nga Shtojca 2)	Deklarata për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit (nga Shtojca 2)
8		Deklarata për besueshmërinë e tenderuesit (nga Shtojca 3)	Deklarata për besueshmërinë e tenderuesit (nga shtojca 3)
9			Deklarata për konfidencialitetin dhe neutralitetin (Shtojca 4)
10		Raporti për dhënien e tenderit	Raporti për dhënien e tenderit

11		Kontrata e nënshkruar me ofertuesin e përcaktuar fitues	Kontrata e nënshkruar me ofertuesin e përcaktuar fitues
----	--	---	---

*Vlera dhe tërësia e dokumenteve i referohet një ose më shumë blerjeve – varësisht nga lloji i blerjes (të veçanta janë ato për shërbime, mallra ose ndërtim), secila blerje mund t'i referohet një ose më shumë faturave të paguara.

SHTOJCA NR.4 LISTA E SHPENZIMEVE TË PRANUESHME – 2022

<i>LISTA E SHPENZIMEVE TË PRANUESHME PËR MASËN 3</i>	
<i>Investimet në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore</i>	
Kodi i shpenzimeve	Emri i shpenzimeve të pranueshme
	Hardueri dhe softueri (të nevojshëm për menaxhimin e proceseve prodhuese) janë të pranueshme në të gjitha shpenzimet e paraqitura në Listën e Shpenzimeve të Pranueshme
(3.1)	SEKTORI I QUMËSHTIT
	<i>NDËRTIMI</i>
1	Ndërtimi, renovimi dhe zgjerimi i objekteve për përpunimin e qumështit dhe produkteve të qumështit, hapësirat percjellëse për pranimin e lëndëve të para, përpunimi termik, ftohje dhe ruajtje të produkteve finale, paketim dhe magazinim të materialit paketues dhe shtesave (aditiveve) Laboratori dhe nyjet sanitare, rrjeti rrugor i brendshëm, Hapësirat për instalimin e sistemeve për ventilim, ftohje dhe ngrohje, objekte të energjisë, ndërtimi dhe / apo rindërtimi i sistemeve me furnizim të ujit (përfshirë puset), gaz, energji elektrike (përfshirë gjenerator) dhe kanalizim, përfshirë pajisjet për trajtimin e ujërave të zeza.
2	Investime në pajisjet për shfrytëzimin e energjisë së ripërtritshme për nevojat e ndërmarrjes. -impianetet diellore fotovoltaike, - hidro impianetet, impianetet me erë, - -impianetet e biomasës etj. duke përfshirë lidhjen nga impianti për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në rrjetin shpërndarës, ndërtimi i rrethojave, rrugëve dhe parkingut brenda ekonomisë.
	<i>Paisje</i>
1	Paisje për grumbullimin dhe magazinimin e qumështit në pikat grumbulluese, si dhe aparate të duhura matëse.

2	Automjete të specializuara për transportin e lëndës së parë së bashku me pajisje përkatëse (marrja e mostrave dhe pajisje për kontrollin e cilësisë) Automjete të specializuara për transportimin e produkteve finale
3	Pajisje për marrjen e mostrave, pranimin, përpunimin, mbushjen dhe paketimin e qumështit dhe produkteve të qumështit
4	Pajisje për pastrim, larje dhe dezinfektim të Pajisje higjienike, instalimi i CIP (Clean in Place) sistemeve
5	Pajisje për manipulimin dhe magazinimin e produkteve të qumështit
6	Pajisje për vëzhgimin, matjen dhe trajtimin e proceseve prodhuese dhe magazinuese (me montazh).
7	Pajisje për përmirësimin dhe kontrollin e cilësisë së produkteve (HACCP, ISO 22000), shërbimet për ngritjen e sigurisë ushqimore (HACCP, ISO22000). Shërbimet këshilluese për implementimin e sistemit të sigurisë HACCP.
8	Pajisje për trajtimin, dhe transportin e mbetjeve dhe materialit paketues brenda objektit
9	Pajisje për pastrimin dhe filtrimin e ujit hyrës.
10	Pajisje për sigurinë e kushteve mikroklimatike të veçanta në sipërfaqet prodhuese dhe magazinuese duke përfshirë pajisje për ajër të kondicionuar – rregullimi i : ngrohjes/ftohjes, tharjes/lagështisë së ajrit)
11	Pajisje higjienike për larjen dhe tharjen e duarve në objekt dhe tualete (përfshirë dushet), pajisje për dhomë garderebash dhe pajisje për pastrimin, larjen dhe dezinfektimin e veshjeve dhe mbathjeve
12	Pajisje laboratorike
13	Ndërtimi i rrethojave, rrugëve dhe parkingut brenda ekonomisë
2	SEKTORI I MISHIT DHE THERRTORE
	<i>Ndërtimi</i>
1	Përpunimi i mishit Ndërtimi, renovimi dhe zgjerimi i objekteve për prodhimin e mishit. Hapësira për përpunimin e mishit të grirë, përgatitjen, hapësira për pranimin dhe magazinimin e mishit, hapësira prodhuese, duke përfshirë dhomat me kushte mikroklimatike të veçanta për prodhim, hapësira për paketim, hapësira për magazinim të produkteve finale, hapësira për magazinim të erëzave, aditivëve dhe mjeteve tjera që kërkohen për prodhim, hapësira për magazinimin e materialit paketues; hapësira ndarëse për magazinimin dhe ruajtjen e –reagjentëve për pastrim, larje dhe dezinfektim; hapësira për grumbullim të nën produkteve shtazore që nuk janë për konsumim njerëzor. Hapësira për instalimin e sistemeve për ventilim, ftohje dhe

	ngrohje, ndërtimi dhe / apo renovimi i sistemeve për furnizim me ujë (përfshirë pusët), gaz, energji elektrike (përfshirë gjenerator) dhe kanalizim, përfshirë edhe objektet për trajtimin e mbetjeve dhe ujërave të zeza. Hapësirë laboratorike, nyje sanitare etj.
2	Ndërtimi, renovimi dhe zgjerimi i thertoreve për therje e kafshëve, hapsira për trulllosjen dhe therjen e kafshëve, hapsira për kryerjen e procesit prodhues; hapësirat për nxjerrjen e të brendshmeve dhe përpunimit të mëtutjeshëm, hapsira për analizë (autopsi) dhe heqjen e eshtrave nga mishit; hapsira për zbrazjen dhe pastrimin e stomakut dhe zorrëve; hapsira për magazinim ftohës të mishit; hapsira për magazinimin e mishit që konsiderohet jo adekuat për konsum njerëzor, hapsira për ftohje të mishit; hapsira për autopsi dhe paketim të mishit; hapsira për paketimin e nën – produkteve të ngrënshme; hapsira për transferimin apo largimin e mishit; hapsira për pastrim, larje dhe dezinfektim të duhur të makinerisë për automjetet transportuese të kafshëve; hapsira për shërbime veterinare, hapsira për magazinim ndarës të mishit të paketuar dhe jo të paketuar, frigorifer, hapsira për magazinim të nënprodukteve shtazore që nuk janë të parapara për konsum njerëzor, hapësira për instalimin e sistemeve të ventilimit, ftohjes dhe ngrohjes së ajrit. Objekte për pranimin dhe mbajtjen e përkohshme të kafshëve për therje duke përfshirë hapsirat për kafshë të lënduara ose të dyshura nga semundjet.
3	Ndërtimi i një zone apo hapësire të mbuluar për shkarkimin e kafshëve
4	Ndërtimi i objektit për pastrim, larje dhe dezinfektim të automjeteve për kafshët e gjalla
5	Ndërtimi i impianteve për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (impiantet diellore, hidro impiantet, impiantet me erë, impiantet e biomasës etj., duke përfshirë lidhjen nga impianti për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në rrjetin shpërndarës.
	Ndërtimi i rrethojave, rrugëve dhe parkingut brenda ekonomisë
	<i>Paisje</i>
1	Paisje për shkarkimin e kafshëve rampa – laura
2	Pajisje për transportimin e kafshëve të gjalla në thertore
3	Pajisje për shkarkimin dhe vijën kulluese të gjakut
4	Paisje për pranimin e lëndës së pare
5	Sistemi për transportimin e pjesëve(mishit) të therur
6	Paisje për përpunimin e mishit në thertore pas kullimit (gjakosjes)
7	Aparati për përcaktimin e indeve muskulore të mishit të therur
8	Paisje për grumbullimin e mbeturinave me prejardhje shtazore
9	Paisje për përpunimin dhe paketimin e nënprodukteve të ngrënshme
10	Paisje për zbrazjen dhe pastrimin e stomakut, fshikëzës dhe zorrëve
11	Paisje për prerje (copëtim), përpunim, paketim dhe etiketim
12	Paisje për përpunimin dhe magazinimin e yndyrës
13	Paisje për ftohjen dhe / apo ngrijjen e lëndëve të para dhe produkteve finale, përfshirë aparatet matëse

14	Paisje për prodhimin e mishit të grirë, përgatitjet e mishit, mishi mekanikisht i ndarë dhe produktet e mishit.
15	Paisje për pranimin, trajtimin, ruajtjen dhe transportimin e produkteve finale në qendrat e shitjes me aparate të duhura matëse
16	Paisje për pastrimin, larjen dhe dezinfektimin e automjeteve
17	Paisje për kontrollë të brendshëm veterinare.
18	Paisje laboratorike me përjashtim të pajisjeve prej qelqi.
19	Paisje për vezhgimin, matjen dhe trajtimin e proceseve prodhuese dhe magazinuese (me montazh)
20	Paisje për pastrimin, larjen dhe dezinfektimin.
21	Paisje për detektimin metalik dhe / apo rreziqeve tjera fizike
22	Paisje për sigurimin e kushteve mikroklimatike të veçanta në prodhim dhe / apo hapësira për magazinim (përfshirë paisje për ajër të kondicionuar, ngrohje / ftohje, tharje / lagështi ajri)
23	Paisje higjienike për larjen dhe tharjen e duarve në objekt dhe tualete (përfshirë dushet), paisje për dhomë gardërobash dhe pajisje për pastrimin, larjen dhe dezinfektimin e veshjes dhe mbathjes
24	Paisje për trajtimin fizik, kimik dhe biologjik të ujërave të zeza, parandalimi i ndotjes së ajrit dhe tretësve
25	Paisje për impiante për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë
26	Paisje për permiresimin dhe kontrollin e cilësisë së produkteve (HACCP, ISO 22000), shërbimet për ngritjen e sigurisë ushqimore (HACCP, ISO22000). Shërbimet këshilluese për implementimin e sistemit të sigurisë HACCP.
3	SEKTORI PËR PËRPUNIMIN E PEMËVE , PERIMEVE DHE PIKA GRUMBULLUESE /DEPO
	<i>Ndërtimi</i>
1	Ndërtimi, renovimi dhe zgjerim i objekteve për përpunim dhe grumbullim/depo. Hapësirë për pranimin e lëndëve të para, larje / pastrim, klasifikim, trajtim, ruajtje, tharje, pemë të ngrira, analiza të produkteve finale, me rrjetin e brendshëm rrugor brenda objektit, magazinimi i materialeve paketuese, aditivëve dhe produkteve finale, hapësira për sistem të ventilimit, ftohje dhe ngrohje, objekte të energjisë; ndërtimi dhe/apo rindërtimi i sistemeve për furnizim me ujë (përfshirë puset), gaz, energji elektrike (përfshirë gjenerator) dhe kanalizim, përfshirë objektet për trajtimin e ujërave të zeza.
2	Ndërtimi i impianteve për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (impiantet diellore, hidro impiantet, impiantet me erë, impiantet e biomasës etj., përfshirë lidhjen nga impiantja për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në rrjetin shpërndarës nga impianti për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë të objektit).
3	Ndërtimi i rrethojave, rrugëve dhe parkingut brenda ekonomisë.
	<i>Paisje</i>
1	Paisje për larje / apo tharje, pastrim dhe klasifikim

2	Paisje dhe makineri për përpunimin, paketimin, etiketimin dhe magazinimin e përkohshëm
3	Paisje për pasterizim / sterilizim
4	Paise për ftohje dhe ngrirje
5	Paisje për ventilim artificial, ajër të kondicionuar, sisteme ftohëse dhe ngrohëse të objekteve për përpunim dhe magazinim
6	Paisje dhe makineri për trajtimin e mbetjeve dhe ujërave të zeza
7	Paisje dhe makineri për sistemet ngrohëse
8	Paisje për transportin e pemëve dhe perimeve (kontejnerë, arka plastike apo druri te madhesise se caktuar)
9	Makineri për transportimin e pemëve dhe perimeve brenda objektit
10	Paisje për trajtim fizik, kimik dhe biologjik të ujërave të zeza, parandalimi i ndotjes së ajrit
11	Paisje higjienike për larjen dhe tharjen e duarve në objekt dhe tualete (përfshirë dushet), pajisje për dhomë gardërobash dhe pajisje për pastrimin, larjen dhe dezinfektimin e veshjeve dhe mbathjeve
12	Linja mbushese, pajisje per etiketim mbeshtjelles dhe pajisje tjera te specializuara.
13	Paisje laboratorike
14	Paisje për detektim të qelqit dhe metalit dhe / apo rreziqe tjera fizike
15	Paisje për ruajtjen e lëndës së parë dhe produktet finale
16	Paisje për impiante për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë
17	Investimet per implementimin e standardeve te menaxhimit te cilesise(HACCP, ISO 22000)
18	Paisje per pastrimin dhe filtrimin e ujit hyres.
4	SEKTORI I VERËS
	<i>Ndërtimi</i>
1	Ndërtimi, renovimi dhe zgjerimi i objekteve për prodhimin e verës, hapsira përcjellëse në procesin e prodhimit. Ndërtimi i impianteve për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (impiantet diellore, hidro impiantet, impiantet me erë, impiantet e biomasës etj., përfshirë lidhjen nga impanti për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në rrjetin shpërndarës.
2	Ndërtimi dhe / apo renovimi i objekteve për menaxhimin e mbetjeve
3	Ndërtimi i rrethojave, rrugëve dhe parkingut brenda ekonomisë.
	<i>Pajisje</i>
1	Pajisje dhe makineri për përpunimin e rrushit
2	Paisje dhe makineri për mushtin dhe verën
3	Paisje per mbajtjen e verës, duke përfshirë pompat dhe tanqet e nevojshme
4	Linjë prodhimi për mbushjen e verës me pajisje adekuate përfshirë pajisje dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e shisheve.
5	Tanqe dhe tubacione nga inoxi
6	Paisje për transportim brenda verarisë sipas kërkesave të produktit (paleta për shishe, kontainer...)

7	Pajsje higjienike për larjen dhe tharjen e duarve në objekt dhe tualete (përfshirë dushet), pajisje për dhomë gardërobash dhe pajisje për pastrimin, larjen dhe dezinfektimin e objekteve dhe pajisjeve
8	Pajsje për trajtimin fizik, kimik dhe biologjik të ujërave të zeza.
9	Pajsje për ventilim artificial, ftohje dhe ngrohje të objekteve për përpunim dhe magazinim.
10	Pajsje për analiza fiziko kimike në verë dhe pije të forta alkoholike
11	Investimet per implementimin e standardeve te menaxhimit te cilësisë (HACCP, ISO 22000)
12	Pajsje për impiante për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë
13	Pajsje për shfrytëzimin e bërësisë së rrushit
14	CIP sistem i pastrimit
LISTA E PUNËVE TË PRANUESHME PËR MASËN 3	
	Aktivitetet që kanë të bëjnë me demelimin <ul style="list-style-type: none"> - demolimi i ndërtimeve ekzistuese - transporti i materialeve në deponinë më të afërt aktivitetet ndihmëse
1	Punët e tokës <ul style="list-style-type: none"> - gjermimi i sipërfaqes humusore - gjermimi i tokës - gjermimi i themeleve - ndërtimi i argjinaturës - ngritjen dhe përforcimin e bazës - transporti i materialit të gjermuar - aktivitetet ndihmëse
2	Punët me beton <ul style="list-style-type: none"> - ndërtimi i bazës nga betoni - vendosja e konstruksioneve të nevojshme - vendosja e armaturës - ndërtimi i dyshemesë së betonit dhe argjinaturat e çimentos - puna e betonimit, rregullimi i terenit, qasjes në rrugë / lidhjen rrugore - vendosjen e elementeve të duhura të parafabrikuara - hapja e sistemit të kanaleve - aktivitetet ndihmëse
3	Punimet me blloka/tulla <ul style="list-style-type: none"> - murimi - izolimi horizontal dhe vertikal i objektit - suvatim i tavanit dhe mureve në objektit - ndërtimi i rrethojës, rregullimi i terenit, rrugët / lidhjeve rrugore - vendosjen e elementeve të parafabrikuara - ndërtimi i elementeve te vogla brenda objektit (oxhakut, sistemit te ventilimit etj) - aktivitetet ndihmëse

4	<p>Punimet nga druri</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërtimi i të gjitha elementeve që lidhen me objektin e ri apo adaptimin e objektit të vjetër - vendosja e konstruksioneve të drurit (bazës, trareve dhe ndërtimet e kulmeve) - punë ndërtuese nga druri siç janë dyshemeja, rregullimi i hapësirës, rrethojat e rrugës - vendosja e konstruksioneve të vogla nga druri - aktivitetet ndihmëse
5	<p>Punimet e izolimit dhe fasadës</p> <ul style="list-style-type: none"> - izolimi - fasada - vendosjen e elementeve të parafabrikuara
6	<p>Punimet e ndërtimit të kulmit</p> <ul style="list-style-type: none"> - vendosja e konstruksioneve të kulmit - mbulimi i kulmit / vendosja e tjegullave / llamarinës e materiale tjera.
7	<p>Punimet nga llamarina</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërtimi i ulluqeve - ndërtimi i sistemit për kanalizim atmosferik - prerësit e borës - aktivitetet ndihmëse
8	<p>Punimet nga qeramika</p> <ul style="list-style-type: none"> - përgatitja e bazës për vendosjen e pllakave të qeramikës - vendosja e pllakave të qeramikës - aktivitetet përfundimtare pas vendosjes së pllakave të qeramikës - aktivitetet ndihmëse
9	<p>Punimet nga druri</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërtimi i dritareve, dyerve, rrethojës së drurit, shkallëve etj - ndërtimi i elementeve të brendshme dhe të jashtme të drurit - aktivitetet ndihmëse
10	<p>Punimet për vendosjen e katit</p> <ul style="list-style-type: none"> - krijimin e bazës për ndërtimin e katit - ndërtimi i katit - aktivitetet përfundimtare - aktivitetet ndihmëse
11	<p>Punët e lyerjes / ngjyrosjes</p> <ul style="list-style-type: none"> - lyerja e tavaneve dhe mureve - lyerja e sipërfaqeve të drurit dhe metalit - aktivitetet ndihmëse
12	<p>Punimet me metal</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërtimi i elementeve metalike - vendosja e konstruksioneve metalike - vendosja e rrethojës (së ballkonit, së shkallëve etj) dhe rrethimi i objektit - vendosja e elementeve të nevojshme metalike të parafabrikuara - aktivitetet ndihmëse

13	<p>Punimet nga guri</p> <ul style="list-style-type: none"> - murimi me gurë - mveshja me gurë / shtresa të gurëve - murime i rrethojës, rregullimi i ambientit, nga guri, qasja ne rruge / lidhjeve rrugore - vendosjen e elementeve të parafabrikuara - aktivitetet ndihmëse
14	<p>Instalimet teknike</p> <ul style="list-style-type: none"> - instalimi i furnizimit me energji elektrike - instalimi i furnizimit me gaz - vendosjen e instalimeve të jashtme dhe të brendshme të energjisë elektrike - vendosjen e sistemit te drenazhës - instalimi i sistemit të furnizimit me ujë, vendosja e rezervuarëve të ujit, hidroforit etj - vendosjen e sistemit të brendshëm dhe të jashtëm të kanalizimit që lidhen me sistemin sekondar të kanalizimit apo kanalizimin e gropës septike/ rezervuar, - ndërtimi i gropës septike / rezervuar - instalimin e paisjeve të brendshme sanitare - instalimin e sistemeve për ngrohje, ventilim, ajër të kondicionuar dhe sistemeve të ajrit/ pastrimit të ujit (sistemet për ngrohje dhe ftohje), - instalimin e pajisjeve për trajtim të ujit dhe stacioneve te pastrimit te ujit, - aktivitetet ndihmëse
15	<p>Aktivitetet e tjera</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërtimi i parkingut dhe vendparkimeve - punimi i rrjetit rrugor - rregullimi i ambientit (duke përjashtuar bime dekorative) - aktivitetet tjera ndihmëse
	- <i>Lista e shpenzimeve të pranueshme për instalimin e paisjeve</i>
1	Instalimi i pajisjeve dhe makinerisë së pranueshme
2	Instalimin e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtitëshme (era, dielli, gjeotermale, bio-gazit etj)
3	Instalimi i pajisjeve kompjuterike dhe programeve kompjuterike duke përfshirë sensorët
	SHPENZIMET E PËRGJITHSHME PËR MASËN 3
	<i>Lista e shpenzimeve të përgjithshme për përgatitjen e planit të biznesit</i>
1	Shpenzimet administrative, edhe pse ndodhin para nënshkrimit të kontratës, janë të pranueshme vetëm në qoftë se projekti është përzgjedhur dhe është kontraktuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.
2	Shpenzimet e tjera të nderlidhura me projektin, siç janë: shpenzimet për arkitekt, për inxhinier dhe shpenzimet për studime parapake, si dhe nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante janë të pranueshme deri në 7% të shpenzimeve të pranueshme por jo më shumë se 15,000 €, kurse shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit janë të pranueshme deri në 3% të shpenzimeve të pranueshme për projekt, por jo më shumë se 5,000 €;
	<i>Shpenzimet e përgjithshme për shërbime (punë mjeshtrie)</i>
1	Pagesat për ofrimin e shërbimeve të ndërtuesve (mjeshtrisë) referoju te lista e çmimit të tregut.
	<i>Shpenzimet e publicitetit dhe informimit në nivel të projektit</i>

1	<p>Shpenzimet e pranueshme të marketingut për të gjitha nënmasat e Masës 3 janë: përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosjeve, broshurave, posterëve, etj., për promovim të produkteve, por jo edhe për shpërndarje të tyre. Po ashtu, shpenzime të pranueshme të marketingut janë edhe prodhimi i audio dhe video-spotëve promovuese, por jo edhe shpërndarja e tyre mediale;</p> <p>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar në 5% të totalit të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 10,000 €;</p>
---	---

SHTOJCA NR.5 STANDARDET MINIMALE KOMBËTARE

Aneksi i mëposhtëm paraqet listën e standardeve minimale kombëtare për masat që është pjesë përbërëse e PZHBR-së në Kosovë.

Siguria dhe cilësia e ushqimit

Tema (fusha e standardeve)		Korniza ligjore e Kosovës (legjislatiioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjës për zbatim)
Sektori i qumështit	Regjistrimi dhe miratimi i objekteve	Ligji Nr. 03/L-016 për <i>ushqimin</i>		
		Rregullorja Nr. 10/2011 <i>për kontrollet zyrtare të kryera për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë me ligjin per ushqimin dhe ushqim per kafshë dhe rregullat për shëndet dhe mirëqenie të kafshëve</i> Rregullorja Nr. 11/2011 <i>mbi higjienën e mallrave ushqimore</i>	Operatorët e Bizneseve Ushqimore që merren me ushqime që kanë prejardhje joshtazore dhe operatorët e vegjël që furnizojnë konsumatorët drejtpërdrejt, janë të obliguar që të regjistrohen te Autoriteti Kompetent (Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës). Operatorët e Bizneseve Ushqimore që merren me ushqime që kanë prejardhje shtazore si thertoret, fabrikat për përpunimin e mishit, qumështorët dhe depot ftohëse duhet t'i nënshtrohen procedurave të miratimit	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës

Tema (fusha e standardeve)	Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjës për zbatim)
Siguria e ushqimit, higjiena dhe të ushqyerit e kafshëve	<p>Rregullorja Nr. 11/2011 per higjienën e mallrave ushqimore</p> <p>Rregullorja Nr. 12/2011 per përcaktimin e rregullave specifike mbi higjienën e ushqimit me prejardhje shtazore</p> <p>Rregullorja Nr. 27/2012 per kriteret mikrobiologjike të mallrave ushqimore</p>	<p>Operatorët e Bizneseve për Ushqim (OBU) të Njerëzve dhe Kafshëve, përveç Ligjit mbi Ushqimin, duhet të respektojnë rregullat e përcaktuara në rregulloret e cekura. Ka dispozita të përkohshme që ju japin operatorëve kohë për të avancuar strukturat e tyre dhe funksionalitetin (p.sh. përputhjen me parimet HACCP deri në fund të vitit 2013).</p> <p>Kontrulli zyrtar vjetor dhe plani i marrjes së mostrave është plan i bazuar në rrezik që operatorët duhet të respektojnë kriteret mikrobiologjike të prodhimeve që vendosen në treg dhe kriteret e sigurisë së ushqimit gjatë fazave të prodhimit.</p>	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
Gjurmimi (<i>Traceability</i>)	Ligji Nr. O3/L-016 mbi ushqimin	Bazuar në ligjin e ushqimit, OBU janë të obliguar të zbatojnë parimin e gjurmimit në të gjitha fazat e prodhimit.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
Etiketimi i ushqimit të njerëzve dhe ushqimit të kafshëve	Ligji Nr. 04/L-121 mbi mbrojtjen e konsumatorëve U.A. 12/2005 për etiketimin e mallrave ushqimore	Kërkesat për etiketim janë përcaktuar në Udhëzimin Administrativ 12/2005 për etiketimin e mallrave ushqimore që bazohet në Direktivën 2000/13/EC. Të gjitha prodhimet duhet etiketuar sipas këtij U.A. që përmban informata të rëndësishme për konsumatorin.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës Ministria e Industrisë dhe Tregtisë
Mbrojtja e mjedisit			

Tema (fusha e standardeve)	Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjës për zbatim)
Prodhimtari e sigurt e qumështit dhe mishit në fermë	U.A. MA 20/2006 mbi kriteret e higjienës së qumështit të freskët Ligji për veterinarinë 21/2004	Përveç kriterëve për qumësht të freskët që përcaktojnë parametrat që duhet përmbledhur nga bujqit, Ligji për Veterinarinë përcakton rregullat për prodhuesit parësor sa i përket sigurisë së prodhimeve në aspektin e sëmundjeve shtazore në fermat blegtorale.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
Përpunuesit e qumështit dhe grumbulluesit e qumështit	Rregullorja Nr. 11/2011 mbi higjienën e mallrave ushqimore Rregullorja Nr. 12/2011 mbi përcaktimin e rregullave specifike mbi higjienën e ushqimit me prejardhje shtazore Rregullorja Nr. 27/2012 mbi kriteret mikrobiologjike të mallrave ushqimore U.A. MA 20/2006 mbi kriteret e higjienës së qumështit të freskët	Qumështoret duhet të respektojnë rregulloren në fuqi për higjienën e prodhimeve të tyre, objekteve dhe praktikave të prodhimit të sigurt të qumështit dhe prodhimeve të qumështit. Rregullorja e parasheh që OBU duhet të respektojë parimet HACCP deri në fund të vitit 2013. Ekziston udhëzimi administrativ që përcakton kriteret për qumështin e freskët që duhet përmbushur para se qumështi i freskët të mund të përpunohet më tutje nga përpunuesit.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
Sektori i Përpunimi i mishit			Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës

Tema (fusha e standardeve)	Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjës për zbatim)
<p>Miratimi si përpunues mishi</p>	<p>Ligji Nr. 03/L-016 mbi ushqimin</p> <p>Rregullorja Nr. 10/2011 për kontrollet zyrtare të ndërmarra për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë me ligjin për ushqimin dhe ushqimin për kafshë dhe rregullat për shëndet dhe mirëqenie të kafshëve</p> <p>Rregullorja Nr. 11/2011 mbi higjienën e mallrave ushqimore</p> <p>U.A. MA 01/2006 mbi miratimin e thertoreve dhe objekteve për përpunimin e mishit dhe inspektimin e tyre</p>	<p>Bazuar në aktet e deklaruara, thertoret dhe objektet për përpunimin e mishit duhet miratuar për operim. Ato duhet të përmbushin kërkesat për higjienën në objektet e tyre, aktivitetet dhe kërkesat lidhur me lëndën e parë.</p>	<p>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës</p>

Tema (fusha e standardeve)	Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjës për zbatim)
Cilësia dhe siguria e ushqimit	<p>Rregullorja Nr. 11/2011 <i>mbi higjienën e mallrave ushqimore</i></p> <p>Rregullorja Nr. 12/2011 <i>mbi përcaktimin e rregullave specifike mbi higjienën e ushqimit me prejardhje shtazore</i></p> <p>Rregullorja Nr. 13/2011 <i>për përcaktimin e rregullave specifike mbi organizimin e kontrolleve zyrtare të prodhimeve me prejardhje shtazore për konsum nga njerëzit</i></p>	<p>Kjo rregullore specifikon kërkesat minimale që prodhuesit e mishit duhet të përmbushin për të vendosur prodhimet e tyre në treg.</p> <p>Nuk ka dispozita të përgjithshme dhe specifike për proceset e prodhimit dhe vetë-kontrollet, kontrollet zyrtare që duhet të verifikojnë përputhshmërinë janë përcaktuar në Rregulloren 13/2011.</p>	
Prezantimi dhe përdorimi i HACCP	<p>Rregullorja Nr. 11/2011 <i>mbi higjienën e mallrave ushqimore</i></p>	<p>Kjo rregullore përcakton; OBU-të duhet të punojnë sipas parimeve HACCP deri në fund të vitit 2013.</p>	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës

Tema (fusha e standardeve)	Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjës për zbatim)
Kontrolla sanitare	<p>Rregullorja Nr. 12/2011 <i>mbi përcaktimin e rregullave specifike mbi higjienën e ushqimit me prejardhje shtazore</i></p> <p>U.A. MA 01/2006 <i>mbi miratimin e thertoreve dhe objekteve për përpunimin e mishit dhe inspektimin e tyre</i></p> <p>Rregullorja Nr. 13/2011 <i>mbi përcaktimin e rregullave specifike mbi organizimin e kontrolleve zyrtare të prodhimeve me prejardhje shtazore për konsum nga njerëzit</i></p>	Kriteret minimale për sanitetin e objekteve janë përcaktuar në disa rregullore. Kërkesat për sanitet dhe kushte higjienike janë të obligueshme për OBU-të gjatë miratimit të tyre dhe procesit të regjistrimit në fillim, gjithashtu edhe në gjitha fazat tjera të prodhimit. Verifikimi i përputhshmërisë është përgjegjësi e inspektorëve të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës.	
Menaxhimi i mbeturinave dhe nenprodukteve	<p>Ligji Nr. 04/L-060 <i>mbi Mbetjet</i></p> <p><i>Draft rregullorja për mesproduktet</i></p>	Rregullat e përgjithshme për mbetjet janë përcaktuar brenda këtij ligji. Rregullat specifike për mesprodukte blegtorale do të përcaktohen në bazë të <i>Rregullores (EC) Nr. 1069/2009</i> e cila është në procedurat e hartimit.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
Pajisjet për therje, përpunim ushqimi dhe mirëmbajtje	<p>Rregullorja Nr. 11/2011 <i>mbi higjienën e mallrave ushqimore</i></p>	Rregullorja Nr. 12/2011 përcakton kërkesat specifike për OBU-të për therje të llojeve të ndryshme, procedurat e therjes, pajisjet dhe tërë zinxhirin e sigurisë së ushqimit	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës

Tema (fusha e standardeve)		Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjës për zbatim)
		<p>Rregullorja Nr. 12/2011 <i>mbi përcaktimin e rregullave specifike mbi higjienën e ushqimit me prejardhje shtazore</i></p> <p>Rregullorja Nr. 13/2011 <i>mbi përcaktimin e rregullave specifike mbi organizimin e kontrolleve zyrtare të prodhimeve me prejardhje shtazore për konsum nga njerëzit</i></p>	sa i përket prodhimeve me prejardhje shtazore. Përcakton detyrat e OBU-ve dhe përgjegjësitë për informimin dhe gjurmimin e zinxhirit ushqimor.	
	Prezentimi dhe përdorimi i HACCP	Rregullorja Nr. 11/2011 <i>mbi higjienën e mallrave ushqimore</i>	Kjo rregullore përcakton; OBU-të duhet të punojnë sipas parimeve HACCP deri në fund të vitit 2013.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës

Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve

Tema (fusha e standardeve)		Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjëse për zbatim)
Shën deti	Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve	Ligji Nr. 21/2004 Ligji për veterinën		

Tema (fusha e standardeve)	Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjëse për zbatim)
(gjedhet, delet, dhitë)	Udhëzimi administrativ Nr. 12/2012 Identifikimi dhe Regjistrimi i Kafshëve	Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është që të përcaktojë vendin e duhur të prodhimeve me prejardhje shtazore si dhe lëvizjen e tyre brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, kushtet dhe kriteret për gjedhet, delet, dhitë, derrat dhe kuajt.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
Mbrojtja e kafshëve gjatë transportit dhe therjes	Ligji Nr. 21/2004 Ligji për Veterinën dhe Ligji Nr. 02/L-10 për Mirëqenien e Kafshëve.		
	Udhëzimi administrativ Nr. 17/2005 për bartjen e kafshëve brenda Republikës së Kosovës. Udhëzimi administrativ 24/2006 për therjen e kafshëve nga njerëzit.	Udhëzimi administrativ aktual përcakton qarkullimin e të gjitha kategorive të kafshëve të gjalla brenda territorit të Kosovës. Përmes këtij udhëzimi administrativ përcaktohen kërkesat për therje humane të kafshëve të synuara për therje, dhe gjatë shtrirjes, lidhjes (<i>pening</i>), trulllosjes, vrasjes dhe therjes, objektet për therje, mbikëqyrjen e tyre dhe inspektimin e kafshëve dhe objekteve, si dhe metodat e therjes.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
Kushtet për mbrojtjen e kafshëve të mbajtura për qëllime	Ligji Nr. 02/L-10 Ligji për Mirëqenien e Kafshëve.		

Tema (fusha e standardeve)		Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjëse për zbatim)
	të fermës	Udhëzimet Administrative 19/2006 për vendosjen e kafshëve në karantinë.	Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është që të rregulloj çështjet lidhur me karantinën e kafshëve të gjalla që importohen në Republikën e Kosovës.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës

Tema (fusha e standardeve)	Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjëse për zbatim)
Sëmundjet e kafshëve	<p>Ligji Nr. 21/2004 Për Veterinarinë, Udhëzimet administrative për parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve ngjitëse: Tërbimi Nr: 10/2005; Shapi 14/2005; Gripi i shpezëve 24/2005; FMD 27/2006; <i>Bluetongue</i> 28/2006; CFS 33/2006; TSE 34/2006; TB, bruceloza leukoza të gjedhet 26/2007 ; B. melitensis (dele, dhi dhe derra) 07/2008; Antraksi 06/2008; Sëmundja e bletëve 15/2008; Sallmonella të shpezët 32/2008;</p>	<p>Të gjitha këto udhëzime administrative janë në pajtim për parandalim, luftim dhe çrrënjosje të sëmundjeve ngjitëse në Republikën e Kosovës.</p>	<p>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës</p>

Tema (fusha e standardeve)		Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjëse për zbatim)
	Shëndeti i punëtorëve, higjiena dhe mirëqenia	Ligji Nr. 04/L-161 Për sigurinë dhe shëndetin në punë	Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve gjithashtu përmban parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë.	Inspektorati I punes- MPMS
	Mbrojtja e mjedisit			

Mbrojtja e mjedisit

Tema (fusha e standardeve)		Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjës për zbatim)
Mbrojtja e	Mbrojtja e ujit sipërfaqësor	Ligji Nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës	Ndalohet kryerja e të gjitha punëve të cilat shkaktojnë ndryshimin në gjendjen e ujit. Intervenimet me qëllim të përmirësimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së gjendjes së mirë të ujërave, kryhen në pajtim me planet për menaxhim të pëlqejve lumore.	Inspeksioni i ujërave- MMPH

Tema (fusha e standardeve)	Korniza ligjore e Kosovës (legjislacioni relevant)	Standardet minimale kombëtare (përshkrim i shkurtër i kërkesave dhe standardeve)	Organet teknike (përgjegjës për zbatim)
Mbrojtja e tokës (dheut)	Ligji Nr. 02/L-26 për tokën bujqësore	Pronari apo shfrytëzuesi i tokës bujqësore është i detyruar që tokën bujqësore ta shfrytëzojë në mënyrën e cila i përshkruhet në ligj, duke mos e zvogëluar vlerën e saj dhe duke përdorur masat agroteknike përkatëse.	Inspeksioni për bujqësi-MBPZHR
Mbrojtja e ajrit	Ligji Nr. 2004/30 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Çdo ndërmarje, duhet ta ruaj cilësinë e ajrit, ta mbrojë atë nga ndotjet e shkaktuara gjatë veprimtarisë që ushtrohen në territorin e Republikës së Kosovës.	Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit-MMPH
Ruajtja e habitateve natyrore	LIGJI Nr. 03/L-233 Për mbrojtjen e natyrës	Pronarët dhe përdoruesit e ligjshëm të përbërësve të natyrës janë të detyruar t'ju lejojnë përfaqësuesve të organeve për kryerjen e punëve administrative dhe/ose profesionale në mbrojtjen e natyrës - këtu e tutje: organet kompetente - dhe personave të autorizuar nga ata të vizitojnë dhe të shikojnë ato me qëllim të hulumtimit, mbledhjes të dhënave profesionale si dhe të mbikëqyrin zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara për mbrojtjen e natyrës, si edhe për vlerat e mbrojtura të natyrës.	MMPH

SHTOJCA NR.6 KËRKESA PËR PAGESË



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural /Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development
 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture Development Agency

KËRKESA PËR AVANS	
MASA 3- Përpunimi dhe Tregëtimi I Produkteve Bujqësore 2022	
I. Të dhëna për aplikuesin	(Emri dhe mbiemri ose subjekti juridik)
	Rajoni:
	Komuna:
	Vendbanimi:
	Adresa:
	Telefoni:
	E-maili:
	Faqja e internetit:
II. Titulli i projektit
III. Numri Unik i Regjistrimit (NUR) të projektit

Vetëm për përdorim zyrtar (kjo pjesë plotësohet nga zyrtari rajonal):

Numri unik i regjistrimit (NUR) i kërkesës për avans:

XI. Data / Nënshkrimi	
Dita – muaji – viti /...../..... (Emri, mbiemri dhe nënshkrimi) (Vula për subjektet juridike)

DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA		
Ju lutem shënoni me "x" dhe radhitini ato sipas kësaj renditjeje në fund të kërkesës për pagesë		
<i>1. Dokumentet e Përgjithshme</i>		
1. Kopja e letërnjoftimit valid të Republikës së Kosovës dhe kopja e regjistrimit të Biznesit, dokumenti që tregon se kush e ka të drejtën e nënshkrimit në emër të kompanisë		<input type="checkbox"/>
2. Autorizimi i vërtetuar nga noteri (në rastin kur kërkesa dorëzohet nga i autorizuari)		<input type="checkbox"/>
3. Kopja e letërnjoftimit valid të personit të autorizuar (në rastin kur kërkesa dorëzohet nga i autorizuari)		<input type="checkbox"/>
4. Kopja e llogarisë Bankare		<input type="checkbox"/>
4. Garancionin Bankar (Garancioni bankar duhet të sigurohet për periudhën kohore deri sa të realizohet pagesa e fundit nga AZHB-ja, respektivisht deri të vendimi i fundit nga komisioni i ankesave. Çdo kërkesë për afat shtesë duhet të mbulohet me garancion bankar.		<input type="checkbox"/>
6. Kopjen e Kontrates dhe kopjen e Letrës Informimit (miratimit)		<input type="checkbox"/>
Vlera e Projektit		
1. Vlera totale e projektit në €		
2. Vlera e Përkrahjes Publike €		
3. 50 % e Vleres së Përkrahjes Publike (paradhënia) €		

Verejtje: Kërkesa për paradhënie do të miratohet vetëm pasi të nënshkruhet kontrata dhe të ofrohet garancioni bankar nga përfituesi.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

KËRKESA PËR PAGESË-
2022

MASA 3 Nën sektori. _____

I. Të dhëna për aplikuesin	(Emri dhe mbiemri ose subjekti juridik)
	Rajoni:
	Komuna:
	Vendbanimi:
	Adresa:
	Telefoni:
	E-maili:
Faqja e internetit:	
II. Titulli i projektit
III. Numri Unik i Regjistrimit (NUR) të projektit

Vetëm për përdorim zyrtar (kjo pjesë plotësohet nga zyrtari rajonal):

Numri unik i regjistrimit (NUR) i kërkesës për pagesë:

Vetëm për përdorim zyrtar (kjo pjesë plotësohet nga zyrtari rajonal):

IV. Data e dorëzimit:

(__ / __ / __)

Dita — muaji — viti /...../..... (Emri, mbiemri dhe nënshkrimi) (Vula për subjektet juridike)
--	--

Shënim: Përfituesi plotëson vetëm hapësirat me ngjyrë të bardhë

DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Ju lutem shënoni me “ ” dhe rradhitini ato sipas kësaj rënditjeje në fund të kërkesës për pagesë

<u><i>1. Dokumentet e përgjithshme</i></u>	
Kopja e letërnjoftimit valid të Republikës së Kosovës dhe kopja e regjistrimit të Biznesit, dokumenti që tregon se kush e ka të drejtën e nënshkrimit në emër të kompanisë	<input type="checkbox"/>
Autorizimi i vërtetuar nga noteri (në rastin kur kërkesa dorëzohet nga i autorizuari)	<input type="checkbox"/>
Kopja e letërnjoftimit valid të personit të autorizuar (në rastin kur kërkesa dorëzohet nga i autorizuari)	<input type="checkbox"/>
4. Faturat origjinale që vërtetojnë shpenzimet e kryera	<input type="checkbox"/>
5. Listën e të punësuarëve dhe pagesën e kontributeve, Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 3 vjet, aq sa zgjatë periudha monitoruese;	<input type="checkbox"/>
Jrdhër pagesa (në rastet kur pagesa është kryer në bankë në vlerë mbi 500€) / kuponi fiskal (në rastet kur pagesa është kryer me para të gatshme nën 500 €) e cila i bashkëngjitet faturës dhe tregon se përfituesi e ka kryer pagesën	<input type="checkbox"/>
Pasqyra e llogarisë bankare që përfshinë periudhën e pagesave që tregon se përfituesi i ka kryer pagesat (në rastet kur pagesat janë bërë me transfer në bankë)	<input type="checkbox"/>
Para paraqitjes së kërkesës për pagesë në AZHB, secili projekt duhet të vlerësohet nga AUV nëse janë plotësuar standardet kryesore kombëtare sipas ligjeve në fuqi, së bashku me kërkesën për pagesë dhe dokumente tjera, duhet të sigurojnë Raportin të bashkëngjitur me Listat e kontrollit nga AUV-i që konfirmon se investimi është në përputhje me standardet kombëtare.	<input type="checkbox"/>
Vetëm në rast të projekteve të ndërtimit	<input type="checkbox"/>
8. Lejen e ndërtimit lëshuar nga organi kompetent i Komunës;	<input type="checkbox"/>
9. Vlerësimin e ndikimit në mjedis nëse është paraparë me ligj	<input type="checkbox"/>

Dokumente lidhur me procedurat e prokurimit (dokumentet e ndara dhe të kompletuara për secilën procedurë të prokurimit)

Numri i dokum entit	Vlera e tenderit		
	Deri në 10 000.01 euro <input type="checkbox"/>	10 000.01 – 60 000 euro <input type="checkbox"/>	Më shumë se 60 000 euro <input type="checkbox"/>
Lloji i blerjes	a. Mallra <input type="checkbox"/> b. Ndërtime <input type="checkbox"/> c. Shërbime	a. Mallra <input type="checkbox"/> b. Ndërtime <input type="checkbox"/> c. Shërbime	a. Mallra <input type="checkbox"/> b. Ndërtime <input type="checkbox"/> c. Shërbime
1	Deklarata	-	Kopja e shpalljes e publikuar në shtyp/gazetë
2		Së paku tri ftesa me shkrim të plotësuar, të nënshkruara nga pranuesi i ofertës (tenderuesit), nga Shtojca 1	Ftesa me shkrim të plotësuar, të nënshkruara nga pranuesi i ofertës (tenderuesit), nga Shtojca 1 – nuk është e obligueshme – nëse ky është rasti/ vendosur nga përfituesi i grantit
3		Kopjet e certifikatës për regjistrimin e biznesit të secilit nga tenderuesit (për së paku 3 tenderues)	Kopjet e certifikatës për regjistrimin e biznesit të secilit nga tenderuesit (për së paku 3 tenderues)
4		Kopjet e numrit fiskal të tenderuesve (për së paku 3 tenderues)	Kopjet e numrit fiskal të tenderuesve (për së paku 3 tenderues)
5		Ofertat e pranuar (së paku 3)	Ofertat e pranuar (së paku 3)
6			Vendimi për krijimin e komisionit për vlerësim
7		Deklarata për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit (nga Shtojca 2)	Deklarata për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit (nga Shtojca 2)
8		Deklarata për besueshmërinë e tenderuesit (nga Shtojca 3)	Deklarata për besueshmërinë e tenderuesit (nga shtojca 3)
9		-	Deklarata për konfidencialitetin dhe neutralitetin (Shtojca 4)
10		Raporti për dhënien e tenderit	Raporti për dhënien e tenderit
11		Kontrata e nënshkruar me ofertuesin e përcaktuar fitues	Kontrata e nënshkruar me ofertuesin e përcaktuar fitues

Tabela e kostove sipas kërkesës për pagesë Numri Unik i Regjistrimit (NUR) të kërkesës për pagesë:

№	Lloji i shpenzimeve	Sasia		Çmimi për njësi pa TVSH /Euro/	Çmimi për njësi me TVSH /Euro/	Shuma totale pa TVSH /Euro/	Shuma totale me TVSH /Euro/	Numri i faturës	Data e faturës	Përkrahja e autorizuar /Euro/
		Njësia matëse	Sasia							
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										
11										
12										
13										
14										
15										
Shuma totale:										

Shënim: hapësirat e hijezuara në tabelën e mësipërme duhet të plotësohen vetëm nga zyrtarët e Agjencisë së Pagesave

SHTOJCA NR.7 RAPORTI I VLERËSIMIT I DËRGOHET APLIKUESIT permes SMS.

SHTOJCA NR. 8 FORMA E ANKESËS

Ankesë

Emri Mbiemri _____, Fshati _____
Komuna _____

Ankohem ndaj vendimit nr: _____ i dt. _____, si aplikues i

Projektet e Zhvillimit Rural:

Spektori:

përpunim i qumështit përpunim i

mishit

përpunimi pemëve dhe perimeve

prodhimi i verës

Nr. i aplikacionit _____

Shkaqet e ankimit:

Vërejtje: Bashkëngjit dokumentet që i konteston

SHTOJCA NR.9 KONTAKTET DHE PIKAT INFORMUESE

Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

MBPZHR / AZHB MBPZHR / AZHB Adresa: Rr: Ukshin Hoti 10,000 Prishtinë- Kompleksi „Ramiz Sadiku,, kati I IX nga e Hëna deri të Premten nga ora 10:00 - 12:00 dhe 13:00 – 15:00 tel; 03820038-871 ose 3820038-421

Zyrat Rajonale të AZHB-së

Nr.	Rajoni	Adresat	Telefoni
1	Prishtine	“Zona Industriale”- Fushë Kosovë, (përballë Maxi-Marketit)	038601-169
2	Mitrovice	“Mbretëresha Teutë” p.n.	028522- 501
3	Peje	Instituti Bujqësor, “F idanishtja”	039431-276
4	Gjakove	Rr. “Marin Brleti” nr.2,kati III.	0390 320-992
5	Prizren	Rr. “Avni Rrustemi” 159	029244-793
6	Ferizaj	“Dëshmorët e Kombit” p.n.	0290324-661
7	Gjilan	“Bulevardi i Pavarësisë” (Rr.eFerizaj-it, Soliteri katiI)	028032-6106

SHTOJCA NR 10 FORMULARI PËR INDIKATOR

Masa 3, - Sektori 3.1 Perpunimi i qumështit & 3.2 Përpunimi i mishit Viti 2022

Komuna.....

Mbledhja e treguesve për projektin.....

Aplikuesi.....

Numri identifikues i fermës

--	--	--	--	--	--	--	--

Lloji i treguesit	Treguesi	Të dhënat të ofruara nga aplikuesi		Kontrolli nga AZHB-ja
		PO	JO	
Input	Vlera totale e ndihmës publike (euro)			<input type="checkbox"/>
Output	*Vëllimi i përgjithshëm i investimit (euro)			<input type="checkbox"/>
Rezultati	Ndërmarrjet do t'i përmirësojnë standardet e tyre drejt përputhjes me standardet kombëtare të BE-së për siguri të ushqimit/shëndetit të kafshëve dhe mjedisit	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Produktet e reja do të sigurohen dhe /ose do të fusin/aplikojnë teknikat e reja	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Trajtimi i mbeturinave /menaxhimit duhet të futet / te përmirësohet	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Marketingu duhet të përmirësohet	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Marrëdhëniet kontraktuese me fermerët duhet të zgjerohen /konsolidohen	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Teknikat për ruajtjen e energjisë duhet të përshtaten	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Energjia e ripërtëritë duhet të prodhohet nga Ndërmarrja	PO	JO	<input type="checkbox"/>
Ndikimi	Vlera totale e të hyrave nga shitja e prodhimit pa zbatimit të projektit			<input type="checkbox"/>
	Vlera totale e të hyrave nga shitja e prodhimit ne vitin e pare si rezultati i zbatimit të projektit			<input type="checkbox"/>
	Konsumi i ndërmjetësuar = Kosto totale në vitin e kaluar para zbatimit të projektit me: lëndë të parë + mirëmbajtjen e ndërtesave dhe makinerive + energji, ujë, lëndë djegëse / transportin, por pa shpenzimet e punës, me qira, kthimit të kredive dhe interesin bankar			<input type="checkbox"/>
	Konsumi i ndërmjetësuar = Kosto totale në vitin e ardhshëm si rezultat i zbatimit të projektit me: lëndë të parë + mirëmbajtjen e ndërtesave dhe makinerive + energji, ujë, lëndë djegëse / transportin, por pa shpenzimet e punës, me qira, kthimit të kredive dhe interesin bankar			<input type="checkbox"/>
	Numri i përgjithshëm i**të punësuarve me orar të plotë të punës në vitin e fundit para zbatimit të projektit (FTE)			<input type="checkbox"/>
	Numri i të punësuarve me orar të plotë të punës në vitin e ardhshëm si rezultati i implementimit te projektit (FTE)			<input type="checkbox"/>

* - shpenzimet e pranueshme (mbështetja publike + private bashkë-financimi i shpenzimeve të pranueshme) + shpenzimet jo të pranueshme

** - numri i përgjithshëm i vendeve të reja të punës me orar të plotë (FTE) Numri i përgjithshëm i vendeve të punës (FTE) do të llogaritet si punë shtesë në një 1 vit pas implementimit të projektit, si rezultat i drejtpërdrejtë i investimeve të bëra përmes këtij projekti; 1 FTE = 225 ditë pune për vit.

Masa 3, Nënmasa – 3.3 Përpunimi i pemeve dhe perimeve, 3.4 përpunimi i veres, dhe 3.5 pika grumbulluese /depo - Viti 2022

Komuna.....

Mbledhja e treguesve për projektin.....

Aplikuesi.....

Numri identifikues i fermës

--	--	--	--	--	--	--	--

Lloji i treguesi	Treguesi	Të dhënat të ofruara nga aplikuesi		Kontrolli nga AZHB – ja
Input	Vlera totale e ndihmës publike (euro)			<input type="checkbox"/>
Output	*Vëllimi i përgjithshëm i investimit (euro) nga i cili			<input type="checkbox"/>
	1. Përpunimi i pemeve dhe perimeve			<input type="checkbox"/>
	2. Përpunimi i Verës			<input type="checkbox"/>
	3. Pika grumbulluese/ depo			<input type="checkbox"/>
Rezultati	Ndërmarrjet do t'i përmirësojnë standardet e tyre drejt përputhjes me standardet kombëtare të BE-së për siguri të ushqimit /shëndetit të kafshëve / dhe mjedisit	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Produktet e reja do të sigurohen dhe/ose do të fusin/aplikojnë teknikat e reja	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Trajtimi i mbeturinave /menaxhimit duhet të futet /të përmirësohet	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Marketingu duhet të përmirësohet	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Marrëdhënie kontraktuese me fermerët duhet të zgjerohet /konsolidohen	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Teknikat për ruajtjen e energjisë duhet të përshtaten	PO	JO	<input type="checkbox"/>
	Energjia e ripërtërre duhet të prodhohet nga Ndërmarrja	PO	JO	<input type="checkbox"/>
Ndikimi	Vlera totale e të hyrave nga shitja e pa zbatim të projektit			<input type="checkbox"/>
	Vlera totale e të hyrave nga shitja e prodhimit ne vitin e pare si rezultati i zbatimit të projektit			<input type="checkbox"/>
	Konsumi i ndërmjetësuar = Kosto totale në vitin e kaluar para zbatimit të projektit me: lëndë të parë + mirëmbajtjen e ndërtesave dhe makinerive + energji, ujë, lëndë djegëse / transportin, por pa shpenzimet e punës, me qira, kthimit të kredive dhe interesin banker			<input type="checkbox"/>
	Konsumi i ndërmjetësuar = Kosto totale në vitin e ardhshëm si rezultat i zbatimit të projektit me: lëndë të parë + mirëmbajtjen e ndërtesave dhe makinerive + energji, ujë, lëndë djegëse / transportin, por pa shpenzimet e punës, me qira, kthimit të kredive dhe interesin banker			<input type="checkbox"/>
	Numri i përgjithshëm i**të punësuarve me orar të plotë të punës në vitin e fundit para zbatimit të projektit (FTE)			<input type="checkbox"/>
	Numri i të punësuarve me orar të plotë të punës në vitin e ardhshëm si rezultati i implementimit te projektit (FTE)			<input type="checkbox"/>

* - shpenzimet e pranueshme (mbështetja publike + private bashkëfinancimi i shpenzimeve të pranueshme) + shpenzimet jo të pranueshme

** - numri i përgjithshëm i vendeve të reja të punës me orar të plotë (FTE) Numri i përgjithshëm i vendeve të punës (FTE) do të llogaritet si punë shtesë në një 1 vit pas implementimit të projektit, si rezultat i drejtpërdrejtë të investimeve të bëra përmes këtij projekti; 1 FTE = 225 ditë pune për vit.

SHTOJCA NR.11 PLANI I BIZNESIT- PJESA FINANCIARE

Kthimi Investimeve - KI / për grantet e zhvillimit rural

Vitet	Parashikimi i shpenzimeve dhe të byrave pa implementimin e projektit (euro)			Parashikimi i shpenzimeve dhe të byrave nëse implementohet projektin (euro)			Dallimi si rezultat i implementimit të projektit (euro)				Vlera e bashkë-financimit privat të shpenzimeve të pranueshme (euro)	Kthimi i Investimit KI (nëse të gjitha rubrikat kanë ...)
	Vlera totale e shpenzimeve të prodhimit	Vlera totale e të byrave	Profiti	Vlera totale e shpenzimeve të prodhimit	Vlera totale e të byrave	Profiti	Dallimi në të hyra	Dallimi në shpenzime	Profiti shtesë	Profiti shtesë (pasqyrë kumulative)		
Viti 1			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
2			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
3			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
4			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
5			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
6			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
7			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
8			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
9			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00
10			0.00			0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00

Skjarim:

Vetëm në rubrikat e bardha mund dhe duhet të shkruhet

Së paku numri në fund të kësaj kolone duhet të jetë pozitiv, përndryshe projekti duhet të refuzohet si i papranueshëm sepse profiti shtesë nuk e mbulon investimin as pas 10 vitesh



Rrjedha e parase ne exell per tri vitet e ardhshme

Me rastin e perpilimit të planit të biznesit nder te tjera konkretisht të rrjedha e parase duhet pasur parasysh se si të hyra duhet te deklarohen vetem të hyrat nga shitja e prodhimit si rezultat i zbatimit te projektiti . në kete kolone mos shkruani te hyra nga burimet tjera psh Pagesa direkte , kredi etj.

Rrjedhja e parasë-Cash-flow 2022					
Te hyrat			Shpenzimet		Saldo (euro)
Data	Artikulli	Vlera (euro)	Artikulli	Vlera (euro)	
Viti 1			Lëndët e para kryesore		Nëse në këtë kolonë paraqitet një vlerë negative, projekti duhet të refuzohet si i pa pranueshëm
			Fuqia punëtore		
Muaji 1			Rryma, uji		
			Transporti/karburanti		
			Mirëmbajtja dhe riparimet		
			këstet e kredisë		
			Investime të reja		
	Tjera		Tjera		
	Total	0.00	Total	0.00	
Viti 1			Lëndët e para kryesore		
			Fuqia punëtore		
Muaji 2			Rryma, uji		
			Transporti/karburanti		
			Mirëmbajtja dhe riparimet		
			këstet e kredisë		
			Investime të reja		
	Tjera		Tjera		
	Total	0.00	Total	0.00	
Viti 1			Lëndët e para kryesore		
			Fuqia punëtore		
Muaji 3			Rryma, uji		
			Transporti/karburanti		
			Mirëmbajtja dhe riparimet		
			këstet e kredisë		
			Investime të reja		
	Tjera		Tjera		
	Total	0.00	Total	0.00	

SHTOJCA NR.12 KODI I ETIKËS PËR KOMPANITË KËSHILLUESE

Rekomandime për aplikues: Kodi i Etikës për kompanitë këshilluese

MBPZHR ose AZHB nuk mund të ndërhyjë në marrëdhëniet kontraktuese në mes të dy palëve private.

Megjithëkëtë, e konsiderojmë të rëndësishme të bëjmë disa rekomandime:

- Për përgatitjen e aplikacionit, aplikuesi nuk është i obliguar të angazhojë kompani këshilluese.
- Aplikuesi vendos vetë nëse do të marrë këshillues dhe cilin këshillues do të angazhojë.
- Në rast të projekteve më të komplikuar (psh. me plan të biznesit dhe ndërtim), këshillojmë aplikuesin të marrë këshilltarë të specializuar.
- Zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë e kanë të ndaluar të rekomandojnë këshilltarë të caktuar. Në rast se dëshmohet konflikti i interesit në mes të këshilltarit dhe Agjencisë të Pagesave, aplikacioni refuzohet si tentim mashtrimi dhe zyrtari ndëshkohet me ligjet e vendit dhe me rregullat e brendshme të AZHB- së.
- Aplikuesi nënshkruan kontratë me këshilluesin para aplikimit. Nuk mjafton marrëveshja gojore!
- Shpenzimet e këshillimit pranohen nëse projekti përzgjidhet dhe financohet nga AZHB. Për këtë këshilluesi duhet të lëshojë faturë të rregullt dhe aplikuesi duhet ta paguajë atë.
- Në rast se projekti deklarohet i papranueshëm për fajin e këshilluesit, aplikuesi nuk duhet të paguajë sepse është detyrë e këshilluesit të përgatisë vetëm projekte të pranueshme.
- Nëse aplikacioni është i pranueshëm por nuk ka pikë të mjaftueshme, këshilluesi duhet të paguhet sepse ai nuk ka ndikim në përcaktimin e pikëve.
- Aplikuesi duhet të kujdeset që t'i sigurojë të gjitha dokumentet e nevojshme me kohë dhe t'ia bashkëngjitë ato aplikacionit të tij. Këshilluesi duhet të kontrollojë kompletimin e aplikacionit.
- Aplikuesi mund të kërkojë ndihmë nga këshilluesi edhe në implementimin e projektit nëse këtë e kanë paraparë në kontratë.
- Aplikuesi nuk lejohet të ndërrojë kompaninë këshilluese pas përzgjedhjes së projektit sepse pranimi i shpenzimeve të përgatitjes së projektit është i lidhur me kompaninë që ka përgatitur projektin.

SHTOJCA NR.13 PROMOVIMI

Të gjithë përfituesit duhet t'i respektojnë rregullat e promovimit të përcaktuara nga institucioni financues. Të gjithë përfituesit e granteve nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, para kërkesës për pagesën e fundit, në vendin e investimit, duhet të vendosin një tabelë siç është paraqitur në Shtojcën nr. 13. Kjo tabelë duhet të vendoset në vend të dukshëm, me madhësi: 100 cm x 50 cm, e punuar nga plastikë e fortë, e shkruar me ngjyrë të qëndrueshme ndaj ndikimeve atmosferike.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture
Development Agency*

DEKLARATË NËN BETIM / ZOTIM

Unë _____ me numër personal _____
Adresa: _____, me përgjegjësi të plotë ligjore
penale deklaroj nën betim se me nënshkrimin tim dhe bashkangjitjen e dokumenteve në
aplikimin online siguroj që të gjitha dokumentet, informatat dhe të dhënat që janë prezantuar
në aplikim për Programin e Zhvillimit Rural për vitin 2022 janë të qarta, të besueshme dhe të
sakta dhe se për çdo paqartësi, josaktësi dhe falsifikim do mbajë përgjegjësi ligjore dhe penale.

Nënshkrimi i Deklaruesit

Datë _____.____.2022

*Ky dokument është përgatitur nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në
bashkëpunim me Autoritetin Menaxhues dhe shpërndahet falas*

Masa 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve

Udhëzues për Aplikues

2022

1 OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINANCIARE TË MASËS 7

1.1 Hyrja

Udhëzuesi ka për qëllim t'u ndihmoj aplikuesve në përgatitjen e aplikacioneve të tyre, të qartësoj kushtet e pranueshmërisë që duhet të respektohen, sistemin e pikëve, cilat janë investimet e pranueshme, cilat janë dokumentet e nevojshme për aplikim, si do të bëhet vlerësimi i projekteve, si do të njoftohen aplikuesit për rezultatet e vlerësimit, cilat janë ndëshkimet në rast të parregullsive apo tentimeve për mashtrim etj.

Roli i Udhëzuesit është të sqaroj në detaje dispozitat e paraqitura në masë, dhe Jo të përsëris atë. Prandaj ky nuk e zëvendëson masën por duhet lexuar (bashkë me shtojcat) me qëllim të shmangies së gabimeve gjatë aplikimit.

1.2 Kjo masë përbëhet nga këto nën masa:

7.1 Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i produkteve jo drusore të pyllit

7.2 Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural

7.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare;

7.4 Prodhimi i mjaltit

7.5 Aktivitete jo-bujqësore në zona rurale

a) Përpunimi i leshit

b) Prodhimi i humusit

7.6 Rritja e shpezëve të fshatit dhe

7.7 Kultivimi i peshkut

Secila nën-masë ka ndarje të ndryshme financiare, kriteret specifike për pranueshmëri dhe kriteret e veta të përzgjedhjes.

1.3 OBJEKTIVAT E MASËS 7

1.3.1 Objektiva e përgjithshme dhe objektivat specifike

Objektiva e përgjithshme

Zhvillimi ekonomik dhe përmirësimi i cilësisë së jetës, përmes diversifikimit të bizneseve, zhvillimit të komunitetit dhe përfshirjes sociale.

Objektivat Veçanta

Punësimi dhe rritja e të ardhurave në zona rurale

Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale

Zbutja e dukurisë së shpërnguljes nga zonat rurale drejt atyre urbane dhe

Zhvillim i balancuar në aspektin ekonomik dhe sociale të zonave rurale

1.4 Buxheti/Mjetet financiare

Tabla 1 Ndarja e planifikuar buxhetore, për masën 7 sipas nënmasave:

		Buxheti	%
7.1	Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve jo drusore të pyllit përfshirë bimët mjeksore dhe aromatike	600,000.00	8.33
7.2	Zhvillimin e turizmi rural dhe agro – turizmi	3,500,000.00	48.61
7.3	Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare	700,000.00	9.72
7.4	Prodhimi mjaltit	500,000.00	6.94
7.5	Aktivitetet jo-bujqësore në zona rurale	500,000.00	6.94
a)	Përpunimi i leshit të deleve	400,000.00	5.56
b)	Prodhimi i humusit	200,000.00	2.78
7.6	Rritja e shpezëve të fshatit	300,000.00	4.17
7.7	Kultivimi i peshkut	500,000.00	4.94
	Gjithesëjt	7,200,000.00	100.00

1.5 Përkufizimet kryesore

“MBPZHR” - nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

“Autoriteti Menaxhues” - nënkupton entitetin publik brenda MBPZHR-së, përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e PZHR;

“ARBK”- nënkupton Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

“AZHB” - nënkupton Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në kuadër të MBPZHR, përgjegjës për zbatimin e PZHR;

“PZHR 2022” – nënkupton Programin për Zhvillimin Rural për vitin 2022;

“Masa 7” - nënkupton diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e bizneseve;

“Thirrja për aplikim” - nënkupton njoftimin publik për pranimin e aplikimeve;

“Aplikues” - nënkupton personin fizik apo juridik, i cili aplikon për të përfituar projekt në PZHR 2022;

“Aplikacioni” - nënkupton formularin e plotësuar për aplikim me të gjitha dokumentet e kërkuara nga AZHB;

“Projekt” - nënkupton dokumentin që parasheh investimin e planifikuar për përkrahje nga PZHR 2022, të dorëzuar nga aplikuesi;

“Përzgjedhja” - nënkupton selektimin e projekteve, sipas pikëve të renditura;

“Kriteret e përzgjedhjes” - nënkupton kriteret që Autoriteti Menaxhues duhet t’i përcaktoj, për të siguruar prioritetet e financimit të projekteve më të mira që adresojnë nevojat e identifikuara në analizën SWOT dhe objektivat e përcaktuara në PZHR 2022;

“Përfitues” - nënkupton personin fizik apo juridik, i cili është përzgjedhur përfitues pas vlerësimit të aplikimit, nënshkrimit të kontratës dhe financimit të projektit nga MBPZHR;

“Shkalla e përkrahjes publike” - nënkupton kontributin nga buxheti publik për zbatimin e projektit;

“Kontrata” - nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të përfituesit dhe AZHB-së për zbatimin e projektit të përfituar;

“Mashtrim” - nënkupton çdo vepër e qëllimshme ose mospërfillje sipas përkufizimit të Ligjit Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, 16 tetor 2012);

“Shpenzimet e pranueshme” - nënkupton shpenzimet që përkrahen me mjete financiare;

“Periudha e zbatimit të projektit” - nënkupton periudhën për zbatimin e afatit të projektit të përcaktuar në udhëzim administrativ dhe kontratën e nënshkruar mes përfituesit dhe AZHB

“Kërkesa për pagesë” - nënkupton parashtrimin e kërkesës për pagesë për shpenzimet e pranueshme, të dëshmuara me fatura valide për shpenzimet e realizimit të projektit;

“Ex-post kontrolli” - nënkupton periudhën kohore prej tre (3) vjetësh pas ekzekutimit të pagesës së fundit, gjatë të cilës përfituesi duhet ta ruajë qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave është përzgjedhur si përfitues;

“NIF” - nënkupton Numrin Identifikues të Fermës;

“PJDP”-nënkupton produktet jodrusore të pyllit;

“BMA”-nënkupton bimët mjeksore aromatike.

“FERMA”- nënkupton njesin prodhuese në aspektin teknik dhe ekonomik e cila menagjohet nga fermeri në të cilin zhvillohen aktivitete bujqësore dhe aktivitete të zhvillimit rural

“ZGJERIMI”- nënkupton zgjerimin e objektit ekzistues

NDËRMARRJE MIKRO -është ndërmarrja që ka të punësuar deri në 9 punëtorë.

NDËRMARRJE E VOGËL- është ndërmarrja që ka të punësuar 10 deri në 49 punëtorë.

ZONË RURALE: për nevoja të këtij programi zona rurale janë të gjitha vendbanimet me më pak se 30.000 banorë. -

ZONA MALORE: janë ato zona rurale që janë të paraqitura të Lista e vendbanimeve (zonat kadastrale) në zonat malore (“lloji A”) dhe B

RENOVIM - Kthimi i objektit ekzistues në kushte të pranueshme duke bërë ripërtëritjen, zavendësimin, apo rregullimin e pjesëve të dëmtuara ose të degraduara.

EKONOMI FAMILJARE – për nevoja të programit, termi ekonomi familjare nënkupton: të gjithë anëtarët të cilët shfrytëzojnë asetet e njejta bujqësore (toka, mekanizimi, depo, kafshët, shtalla dhe objektet përcjellëse). Ekonomia familjare duhet të ketë vetëm një NIF. Në rast se haset më shumë se një NIF në një ekonomi familjare, aplikacioni refuzohet.

Stilit ”të zonës rurale”

Materiali ndërtimor dominues i pranueshem për muret e objektit: druri, guri dhe tulla e argjilës/baltës e papjekur ose e pjekur.

Dominues – nënkupron më shumë se gjysma e mureve.

Fasadat e suvatuara me llaq ose baltë, në masën dominuese të sipërfaqes, janë të pranueshme vetëm në rastë se objekti ekzistues (shih foton) ka qenë i suvatur.

Sipërfaqja e brendshme e mureve të dhomave lejohet të jetë e suvatur me llaq ose me baltë, kurse nëse është e pa suvatur duhet të jenë nga druri, guri ose tulla.

Objektet e ndërtuara nga materialet tjera (blloka, beton, hekur apo metale tjera) janë të pranueshme vetëm nëse ato janë të kamofluara në masën dominuese, me materjalet e pranueshme nga pika a.

Kulmi duhet të jetë i mbuluar me tjegulla të argjilës, me rrasa të gurit, me dërrasa ose me kashtë.

Kulmet e mbuluara me materjale të tjera janë të pranueshme vetëm nëse ato janë të kamofluara në masën dominuese, me materiale të pranueshme nga pika c.

Dyert dhe dritaret duhet të jenë nga druri.

Dyert dhe dritaret e punuara nga materiale të tjera janë të pranueshme vetëm nëse ato janë të kamofluara në

masën dominuese, me materiale të panueshme nga pika e.

Nëse objekti ka shkallë të brendshme ose të jashtme, së paku shkelëset duhet të jenë prej druri, ndërsa konstruksioni tjetër mund të jetë prej dururi apo metali.

Dyshemeja nuk do të merret për bazë gjatë vlerësimit, sepse ajo mund të mbulohet me qilim, rogoz, janë apo shtroja tjera tradicionale.

2 PËRFITUESIT

Përfituesit përfundimtarë në këtë masë janë fermerët, sipas definicionit nga Ligji Nr. 04 / L- 090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03L- 098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe ndërmarrjet e tjera bujqësore të regjistruara në Regjistrin e Fermës. Ligji Nr. 04/L-220 Për Investime të Huaja, (Gazeta Zyrtare Nr.1/09 Janar 2014).

Në rastin e ndërmarrjeve, përfitues mund të jenë; mikro ndërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla (këto ndërmarrje mundën me qenë përfitues pa marrë parasysh ku janë të themeluar zona rurale apo urbane por që aktivitetin e tyre zhvillojnë në zona rurale)

Në rastin e personave juridik, biznesi duhet të jet i regjistruar me aktivitetin përkatës për të cilën aplikon. (Biznesi në listën e kodeve të aktiviteteve duhet të kenë të regjistruar edhe aktivitetin për të cilin aplikojnë)

Mikrondërmarrja duhet të ketë të punësuar deri nëntë (9) punëtorë;

Ndërmarrja e vogël duhet të ketë të punësuar prej dhjetë (10) deri dyzetenëntë (49) punëtorë;

GLV – të mund të jenë përfitues (vetëm nëse janë të akredituara nga MBPZHR)

3 KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës;

Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë mbi 18 vjeç, por jo më i vjetër se 65 vjeç deri në ditën e aplikimit. Në rastin e personit juridik ky kriter nuk aplikohet.

Aplikuesit duhet ta dorëzojnë aplikacionin me të gjitha dokumentet e nevojshme në listë e dokumenteve të kërkuara dhe të paraqitura në Udhëzuesin për Aplikues;

Investimi duhet të kryhet në zona rurale (sipas përkufizimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-27 për zona malore);

Personi fizik duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e detyrueshëm elementar (8 ose 9 vjeçar) (Në rast të personit juridik kjo vlen për pronarin ose personin e autorizuar);

Të gjithë aplikuesit duhet të dorëzojnë certifikatën e pronës/fletën poseduese dhe kopijen e planit (për vendin e investimit);

Te gjithë aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera ose te rregulluara detyrimet tatimore, tatimin në të ardhura dhe tatimet e tjera të aplikueshme.

Aplikuesit nuk duhet të kenë obligime financiare ndaj MBPZHR-së

Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë tri vjetëve pas realizimit të projektit, aq sa zgjatë periudha monitoruese. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike;

Aplikuesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse nuk e ka përfunduar investimin paraprak. Nëse përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR në 3 vitet e fundit dhe ndodhet në periudhën monitoruese, para nënshkrimit të kontratës së re me AZHB-në duhet të bëhet një kontroll në mënyrë që të bëhet verifikimi i projektit të mëparshme. Nëse projekti nuk është mirëmbajtur dhe /ose nuk është funksional nuk mund të lidhet kontrata e re.

Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të vogla ose baras me 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një projekt-propozim sipas modelit të AZHB-së. Projekt-propozimi për nën masën e turizmit rural është i veçantë;

Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit të AZHB-së.

Plani i biznesit për nën masën e turizmit rural është i veçantë;

Modelet për projekt-propozim për planin e biznesit do të publikohen në ueb-faqen e agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe MBPZHR dhe do të jenë në dispozicion për të gjithë aplikuesit;

Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 3 vjet, aq sa zgjatë periudha monitoruese.

Përfituesit të cilët në planin e biznesit janë zotuar të kenë të punësuar, duhet të regjistrohen në ARBK së paku si Biznes Individual dhe të gjitha pagesat duhet të bëhen nga llogaria e biznesit.

Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural nuk bënë të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar. Në rast se vërtetohet se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen masat ndëshkimore në përputhje me ligjin;

Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB-në.

Aplikuesi mund të aplikojë vetëm me një projekt brenda vitit.

Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të draft programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021 – 2027 për Masën 7 është treqindmijë (300.000) € për përfitues.

Nëse toka ose ndonjë pronë tjetër ku do të bëhet investimi është në bashkëpronësi, aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve dhe kopjet e letërnjoftimeve.

Kontrata për qiramarrje nuk kërkohet vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, mbesat, e kështu me radhë.) dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës apo certifikatës së lindjes dhe / apo certifikatës së vdekjes.

Po ashtu, aplikuesi duhet të plotësojë Deklaratë nën betim, me të cilën dëshmon se toka me të cilën aplikon dhe për të cilën ai është trashigimtarë potencial, nuk shfrytëzohet nga trashigimtarët tjerë potencial.

Në rast të projekteve të ndërtimit /zgjerimit/renovimit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

Kopjen e skicave;

Parallogarinë e shpenzimeve për materiale dhe për punë;

Fleta poseduese dhe kopja e planit, obligative për të gjithë aplikuesit;

Nëse toka merret me qira - kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet për parcelën ose objektin ku do të bëhet ndërtimi / zgjerim/rinovim, kurse për projektet që nuk parashohin ndërtim /zgjerim/renovim në pronë të huaj, mjafton kontrata e noterizuar e qiramarrjes për 5 vjet (duke e llogaritur nga viti i aplikimit);

Toka nën hipotekë nuk është e pranueshme për investim, qoftë në pronësi apo e marrë me qira.

Në rast të projekteve të ndërtimit / zgjerimit me kërkesën për pagesë në AZHB, përfituesit duhet të dorëzojnë:

Lejen ndërtimore nga komuna, për ndërtim/zgjerim me sipërfaqen të bazës mbi 10m²;

Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse parashihet me Ligj;

Në rast të ndërtimit/ zgjerimit në hapësirat e parqeve nacionale kërkohet edhe pëlqimi nga MMPHI-ja.

Për nënmasën -Prodhimi i mjaltit, ata të cilët aplikojnë vetëm për pajisje dhe mjete tjera, e nuk aplikojnë për ndërtim objekti, duhet të dokumentojnë me fotografi për ekzistimin e objektit në momentin e aplikimit.

Për nënmasën - Zhvillimi i turizmit rural para nënshkrimit të kontratës me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë përfituesit potencialë të cilët planifikojnë të investojnë në objekte që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore, duhet ta marrin pëlqimin nga Ministria e Kulturës / Departamenti i Trashëgimisë Kulturore.

Te nën masa - Zhvillimi i turizmit rural –termi “zgjerim”, e ka kuptimin e zgjerimit të objektit ekzistues, nëse aktiviteti i turizmit rural zhvillohet në bungalo/kamp shtëpizë, atëherë lejohet ndërtimi i ri (bungalove/kamp shtëpizave tjera si zgjerim i kapacitete ekzistuese) në parcelën apo në hapësirën ku veç është biznesi ekzistues i turizmit rural, Brenda të njëjtit vendbanim

Për nën masën - Kultivimi i peshkut, me kërkesën për pagesë duhet të dorëzohet Licenca për aktivitetet e akuakulturës/ kultivimi i peshkut.

Investimet duhet të jenë në përputhje me standardet përkatëse minimale kombëtare të paraqitura në udhëzuesin për aplikues, të cilat duhet të përmbushen më së voni para kërkesës për pagesën e fundit dhe të verifikohen gjatë kontrollit nga personat zyrtarë në vendin e investimit.

Te behet digjitalizimi në vendin ku behet investimi.

Përfituesit janë të detyruar të mbajnë të gjitha të dhënat e kontabilitetit të paktën tri (3) vjet pas zbatimit të projektit, si dhe të bashkëpunojnë me zyrtarët e MBPZHR-së për të siguruar çdo informacion të kërkuar nga AZHB ose MBPZHR si dhe zyrtarë tjerë të autorizuar nga të dy palët, për të kontrolluar dhe audituar zbatimin e projekteve. Kushtet e financimit do të përcaktohen më detajisht në kontratë në mes të përfituesit dhe AZHB-së.

Sqarim: Sa i përket të dhënave për të mbajtur kontabilitetin në fermë, informatat të merren në Departamentin e Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore (DAESB)

4 INVESTIMET E PRANUESHME DHE SHKALLA E PERKRAHJES PUBLIKE

4.1 Investimet e pranueshme

- Ndërtim, zgjerim dhe renovim të pronës së paluajtshme;
- Blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, duke përfshirë pajisjet kompjuterike, softuerin dhe pajisje tjera për digjitalizim;
- Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtitëshme
- Në kuadër të këtij investimi mbështetës, shitja e energjisë elektrike në rrjet lejohet për aq sa respektohet kufiri "vetë-konsum" (d.m.th. energjia elektrike e shitur në rrjet është e barabartë mesatarisht me energjinë elektrike e shpenzuar gjatë vitit). Kjo justifikohet me faktin se, meqenëse energjia elektrike nuk mund të ruhet, ajo nëse nuk harxhohet, mund të lëshohet në rrjet; rrjeti i energjisë elektrike mund të konceptohet si një vend depozitimi për energjinë elektrike ku futet dhe tërhiqet gjatë vitit në sasi të ngjashme dhe me një ritëm të ndryshëm.
- Koncepti i "vetë-konsumit" duhet të kontrollohet në fazën në të cilën paraqitet / vlerësohet një projekt. Investimi konsiderohet i pranueshëm kur kapaciteti (teorik) i energjisë i impiantit të energjisë së rinovueshme ("investimi") nuk tejkalon 120% të konsumit mesatar prej 3 vjetësh të fermës.
- Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt propozimit nuk mund të kalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme në rast të investimeve që parashohin ndërtim/gjerim të objekteve, shpenzimi për arkitekt, inxhinier dhe licenca janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme.

4.2 Shkalla e përkrahjes publike:

- Vlera minimale e pranueshme për projekt për të gjitha nën-masat pesëmbëdhjetëmijë (15,000) euro;
- Përkrahja publike është 60% e shpenzimeve të pranueshme të investimit;
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt sipas nën-masave;
- Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i produkteve jo drusore të pyllit – njëqindmijë (100,000) euro;
- Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural është njëqindmijë (100,000) euro;
- Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare- pesëdhjetëmijë (50,000) euro;
- Prodhimi i mjaltit - tridhjetëmijë (30,000) euro;
- Aktivitete jo-bujqësore në zona rurale – tridhjetëmijë (30,000) euro
- Përpunimi i leshit –vlera e projektit njëqindmijë (100,000) euro;
- Prodhimi i humusit vlera e projektit pesëdhjetëmijë (50,000) euro
- Rritja e shpezëve të fshatit tridhjetëmijë (30,000) euro;
- Kultivimi i peshkut - njëqindmijë (100,000) euro.

Shenim: TVSH është shpenzim i pranueshëm vetëm për persona fizik dhe ndërmarrje joraportuese të TVSH-së. Për ndërmarrjet raportuese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm.

Në këtë adresë të internetit mund të shkarkohen raportet për bizneset me të cilat mund të vërtetohet nëse biznesi është raportues apo jo i TVSH-së:

<http://apps.atk-ks.org/BizPasiveApp/VatRegist/SearchVat>

5. KRITERET E VEÇANTA TË PRANUESHMËRISË DHE INVESTIMET E PRANUESHME PËR NËNMASA

Prodhimi i mjaltit

Aplikuesi, qoftë person fizik apo juridik duhet të kenë minimum 30 koshere me bletë.

Investimet e pranueshme për prodhimin e mjalti

- Blerja e koshereve pa bletë;
- Blerja e makinerisë dhe pajisjeve për prodhimin dhe përpunimin e mjaltit;
- Rimorkio të specializuara për bartjen e koshereve, vetëm për aplikuesit me mbi 100 koshere;
- Investimet në pajisje për nxjerrjen e produkteve të bletës;
- Investimet në pajisje për kultivimin e mëmave;
- Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i dhomës së mjaltit (maksimumi pesëmijë (5.000) euro)
- Blerja e pajisjeve laboratorike për analizim të produkteve të bletëve;
- Blerja e linjave teknologjike për mbushje dhe paketim të mjaltit;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Investimet për përmirësimin e sigurisë së cilësisë së mjaltit;
- Blerja e pajisjeve për IT, dhe dixhitalizim;
- Investime për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe mbetjeve të ujit;
- Investime në marketing
- Te gjitha paisjeve te linjës se vjeljes se mjaltit te i'u gravohet numri i NIF-it te fermerit.

Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve jo drusore të pyllit përfshirë bimët mjeksore dhe aromatike

Të drejtë aplikimi kanë vetëm personat juridik ose bizneset individuale të regjistruar në ARBK me aktivitetin përkatës;

Aplikuesi duhet të jetë i licencuar për grumbullimi e PJDP dhe BMA (nga Departamenti i Pylltarisë);

Investimet e pranueshme për Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve jo drusore të pyllit përfshirë bimët mjeksore dhe aromatike

- Ndërtimi /zgjerimi/renovimi i objektit;
- Blerja e pajisjeve për përpunimin, magazinimin, paketimin e produkteve të sektorit;
- Blerja e pajisjeve për larje, pastrim, ruajtje, klasifikim, etiketim;
- Blerja e pajisjeve për tharje, për ftohje, për ngrirje të thellë;
- Blerja e rafteve për tharje;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Blerja e pajisjeve per IT, dhe digjitalizim;
- Investime për trajtimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujit.

Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare

- Të drejtë aplikimi kanë personat fizik dhe juridik në keto aktivitete për përpunim;
 - Përpunimi i prodhimeve blegtorale;

- Përpunimi i pemëve, perimeve dhe kërpurdhave;
- Përpunimi i verës dhe rakisë;
- Përpunimi i drithërave/brumrave (brumëra të llojeve të ndryshme, ëmbëlsira);
- Përfituesit e kësaj nën masë para kërkesës për pagesë përfundimtare duhet të regjistrohen në regjistrin qendror të objekteve të regjistruara ose të aprovuara në AUV (në varësi të kapacitetit prodhues).

Investimet e pranueshme për Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare

- Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i objekteve për prodhim, ruajtje dhe përpunim të prodhimeve;
- Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i objekteve me pamje të përshtatur stilit të zonës rurale për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale (të përshkruhet në projekt-propozim);
- Investimet në makina dhe pajisje për përpunimin e mishit, qumështit (përfshirë njësitë mobile për përpunimin e qumështit), përpunimin e pemëve dhe perimeve, për pastrim, klasifikim, tharje, grumbullim, pasterizim, ruajtje, frigorifer me ftohje, me ngrirje, furra për pjekje të brumërave, përzierëse të ndryshme të brumërave, pajisje për prodhimin e rakisë, pajisje për mbushje për raki dhe verëra, prodhime të verës, etj.;
- Investimet në blerjen e pajisjeve për matje, paketim dhe etiketim;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Investime për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe mbetjeve të ujit;
- Blerja e pajisjeve për IT, dhe dixhitalizim;
- Investimet në pajisje specifike, me qëllim të përmirësimit të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit;

Sqarim

Si duhet të jetë një hapësirat ku përgatitet, trajtohet apo procesohet ushqimi:

Hapësirat ku përgatiten trajtohen apo procesohet ushqimi duhet të dizajnohen dhe të planifikohen që të mundësojnë praktikatat e mira të higjienës së përpunimit të ushqimit duke përfshirë mbrojtjen kundër kontaminimit në mes apo gjatë veprimeve.

- Sipërfaqet e dyshemesë duhet të mirëmbahen në kushte të mira dhe të jenë nga material që pastrohet lehtë dhe sipas nevojës dezinfektohet. Kjo kërkon përdorimin e materialeve të papërshkrueshme, jo-absorbuese, që pastrohet lehtë dhe jo toksike. Sipas nevojës dyshemeja duhet të mundësoj kullimin – largimin adekuat të ujit nga sipërfaqja
- Sipërfaqet e mureve duhet të mirëmbahen në kushte të mira dhe të jenë nga material që pastrohet lehtë dhe sipas nevojës dezinfektohet. Kjo kërkon përdorimin e materialeve të papërshkrueshme, jo-absorbuese, që pastrohet lehtë dhe jo toksike dhe kërkon sferfaqe të lemuar deri në hapësirën e pershtatshme për veprime.
- Tavanët dhe instalimet e mbikokës duhet të kondstruktohen dhe përfundohen ashtu që të parandalojnë pluhurin dhe reduktojnë kondenzimin, rritjen e mykut të padëshiruar dhe shpërndarjen e copëzave (grimcave)
- Dritaret dhe të hapurat tjera duhet të konstruktohen për të parandaluar akumulimin e pluhurit. Ato që hapen në ambientin e jashtëm duhet me qenë të pajisuara me rrjeta për mbrojtje ndaj insekteve, të cilat mund të menjahohen lehtë për pastrim. Dritaret duhet të jenë nga materiali që pastrohet lehtë dhe sipas nevojës dezinfektohet
- Dyert duhen të jenë lehtë të pastrueshme dhe sipas nevojës të dezinfektohen. Dyert duhet të jenë nga material që lehtë pastrohet dhe sipas nevojës dezinfektohet
- Sipërfaqet (përfshirë edhe sipërfaqet e pajisjeve) në hapësira ku punohet /përpunohet ushqimi, posaqërisht ato në kontakt me ushqimin duhet të mbahen në gjendje të mirë dhe të pastrohen lehtë sipas nevojës të dezinfektohen. Kjo kërkon përdorimin e materialeve të lemuar, të pastrohet lehtë, jo – toksike dhe rezistente ndaj korodimit.

- Hapësirat e përshtateshme duhet të jenë në dispozicion për të mbajtur higjienën adekuate personale të punëtorëve(përfshirë hapësirat për larje dhe terje të duarëve, pikat sanitare higjienike, hapësirat për ndërrime të rrobave):
- Sipërfaqet në kontakt me ushqimin duhet të jenë në gjendje të mirë, që të pastrohe lehtë dhe ku është nevoja të dezinfektohen, kjo kërkon përdorimin e materialeve të lëmuar që lahen dhe janë të rezistueshme ndaj korodimit dhe jo toksike.
- Duhet të jetë në dispozicion furnizimi adekuat me ujë të nxehtë/ ftohët të pijshëm
- Duhet të jenë në dispozicion masa adekuate dhe hapësira për deponimin higjienik dhe menjanimin e substancave hazarde (te rrezikeshme) dhe të pangrueshme (jo –konsumuese) si dhe mbeturinave në gjendje të lëngët apo ngurtë
- Duhet të jenë në dispozicion hapësirat adekuate dhe masat për mirëmbajtjen dhe monitorimin e temperaturës adekuate.
- Duhet të jenë në dispozicion numër adekuat i lavamanëve me rrjedhje dhe lidhur me një sistem efektiv të drenimit.
- Lavamanët për pastrimin e duarëve duhet të pajisjen me ujë të rrjedhshme të ngrohet dhe të ftohet si dhe me material adekuat për pastrim e duarëve
- Duhet të ketë pajisje të përshtateshme dhe të mjaftueshme të ventilimi natyral apo mekanik
- Nyjet sanitare për punëtorët
- Nyjet sanitare duhet të kenë ventilim adekuat natyrore apo mekanike
- Vendi i veçant (veshtrorja për punëtor)
- Hapësirat e punës duhet të kenë ndriqim adekuat natyral apo mekanik
- Objekte/hapësirat duhet të jenë të kenë pajisje për largimin e ujit duhet të jenë adekuat dhe të kullueshme
- Prodhimet e gatëshme duhet të jenë të vendosur në hapësira adekuat ku pengohet kontaminimi i ushqimit

Aktivitetet jo bujqësore në zona rurale

Të drejtën e aplikimit kanë personat fizik dhe juridik në këto aktivitete;

Prodhimi dhe përpunim i produkteve nga lekura;
 Prodhimi dhe përpunim i produkteve nga leshi;
 Prodhimi dhe përpunim i produkteve nga druri;
 Prodhimi dhe përpunim i produkteve nga metali;
 Prodhimi dhe përpunim i produkteve nga letra;
 Prodhimi dhe përpunim i produkteve nga plastika;
 Prodhimi dhe përpunim i produkteve nga poçarija dhe çeramika;
 Prodhimi dhe përpunim i produkteve nga tekstili;
 Prodhimi i humusit;

Investimet e pranueshme: Aktivitetet jo bujqësore në zona rurale

- 1.Ndërtim / renovim /zgjerim i objektit;
2. Blerja e mjeteve dhe pajisjeve për kryerjen e veprimtarive jo bujqësore;
- 3.Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- 4.Blerja dhe vendosja e pajisjeve për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe të ujit.

Zhvillimi dhe promovimii turizmit rural dhe Agro-turizmit

Apikuesi duhet të dëshmojnë se objekti që do të rinovohet /zgjerohet ti përshtatet stilit” të zonës rurale”;

Objekti ekzistues në të cilën do të investohet, me rastin e aplikimit, duhet të dëshmohet Të mbështetet me fotografi dhe të ketë pamje që i përshtatet stilit të zonës rurale.

Përfituesit të cilët planifikojnë të investojnë në objekte që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore, para nënshkrimit të kontratës me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet ta marrin pëlqimin nga Ministria e Kulturës / Departamenti i Trashëgimisë Kulturore;

Aplikuesi në momentin e aplikimit duhet ta dorëzojë projektin ideor të përgatitur nga arkitekti i diplomuar (vërtetohet me diplomë të fakultetit).

Objekti i planifikuar të ndërtohet/zgjerohet, sipas projektit, i përshtatet stilit të zonës;

Nëse aplikuesi është personat fizik /fermë para kërkesës për pagese duhet të regjistrohet si biznes dhe atë si ofrues i shërbimeve “hoteliere/bujtinë”;

Personat fizik mund të aplikojnë për objekte me jo më shumë se 4 dhoma dhe jo më shumë se 10 shtetër kurse personat juridik deri në 8 dhoma dhe jo më shumë se 16 shtretër.

Personat fizik që aplikojnë për shërbimeve të ushqimit/restorant duhet të regjistrohet si biznes, para kërkesës për pagese si ofrues i shërbimeve “hoteliere” (Restoranti duhet të ketë kapacitet prej 25 deri 50 ulëse);

Në rast të investimeve në ndërtimin e shtigjeve për këmbësorë dhe biçiklistë përreth objekteve të turizmit rural dhe kur këto shtigje kalojnë nëpër prona private, me rastin e aplikimit duhet të silltet pëlqimi i noterizuar i pronarëve të pronave nëpër të cilat kalon ky shteg

Investimet e pranueshme për Zhvillimi dhe promovimii turizmit rural dhe Agro-turizmit

- Rindërtim dhe zgjerim i objektit ekzistues për ofrimin e shërbimeve të akomodimit, ambienteve për përgatitjen e ushqimit dhe pijeve;
- Blerja e pajisjeve dhe orendive për rregullim të brendshëm të objektit;
- Rregullimi i infrastrukturës turistike (parqe tematike ose argëtimi, fusha tenisi, pishina, shtigje rekreative, shtigje fitnesi, rrugë panoramike, shtigje për çiklizëm);
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Blerja e pajisjeve për IT, dhe digjitalizim;
- Investime për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe mbetjeve të ujit;
- Investimet në marketing

Akuakultura/kultivimi i peshkut

- Të derjtën e aplikimit kanë personat fizik dhe ata juridik
- Të gjithë aplikuesit, para kërkesës për pagesën e fundit duhet të jenë të regjistruar si biznes dhe të licencuar për kultivim të peshkut nga MBPZHR.
- Aplikuesi që aplikon për ndërtimin/rinovim/ zgjerim/ të inkubatorit për riprodhimin e peshkut mund të aplikojnë vetëm ata të cilët në vitin paraprak kanë shitur më shumë se 30 ton peshk të freskët.

Investimet e pranueshme për Akuakultura/kultivimi I peshkut:

- Ndërtim/zgjerim/ renovim të bazeneve për kultivimin e peshkut;
- Ndërtimi/zgjerim/renovim të inkubatorit për riprodhimin e peshkut;
- Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit;
- Blerja e pajisjeve të nevojshme për kultivimin dhe trajtimin të peshkut të ujërave të ëmbla;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Investime për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe të ujit.

Rritja e shpezeve të Fshatit

Kriteret e veçanta

- Të drejtën e aplikimit kanë personat fizik dhe ata juridik;
- Aplikuesit, në momentin e aplikimit, duhet të dëshmojnë se kanë së paku 5 m² toke për kokë pule ose rose dhe 15 m² tokë për kokë bibe ose pate.
- Në momentin e aplikimit duhet të kenë së paku:
 - 300 pula, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 1500 krerë;
 - 300 rosa, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 1500 krerë;
 - 100 pata, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 500 krerë;
 - 100 biba, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 500 krerë.
- Në rast të mbajtjes së kombinuar një patë ose një bibë është e barabartë me 3 pula ose tri rosa dhe duhet të arrihet numri ekuivalent me vlerat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Investime e pranueshme për rritjen e shpezëve të fshatit

- Ndërtimi stallës për mbajtjen e shpezëve;
- Investime në vendosjen e rrethojës për sipërfaqen në të cilën mbahen shpezët;
- Blerja e pajisjeve të nevojshme për rritjen e shpezëve për prodhimin e vezëve dhe mishit të pulave, bibave, patateve dhe rosave;
- Inkubatorë të vegjël në përputhje me kapacitetin prodhues;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Investime për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe të ujit.

5 KRITERET E PËRZGJEDHJES

Në mënyrë që të sigurohet që investimi të përmbushë objektivat e masës, projektet e pranueshme do të poentohen sipas pikëve më mëposhtme

Tabela 4: Kriteret e përzgjedhjes për nën -masën "Prodhimi i mjaltit

Kategoritë			Pikët	
1.	Madhësia e fermës në momentin e aplikimit	Numri i koshereve	30 - 60	55
			61 - 150	50
			>150	45
2.	Aplikuesi është i regjistruar si biznes me (kodin e bletarisë)		5	
3.	Adresa / vendbanimi i aplikuesit	Investimi është në zonë malore;	5	
4.	Mbrojtja e mjedisit ¹	Investimet në energjinë e ripërtritshme;	10	
5.	Siguria e ushqimit	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit;	10	
6.	Punësimi	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit / planit të biznesit;	5	
7.	Gjinia e fermerit ²	a) Femra/person fizik së paku 2 vite pronare e fermës ku zhvillohet aktiviteti i "Prodhimtaria e mjaltës" të dëshmohet me NIF; b) Femra /person fizik afarist dhe juridik se paku 2 vite pronare e biznesit "Prodhimtaria e mjaltës"	5	
8.	Aplikuesi i ri ³	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri;	5	
GJITHSEJ			100	

¹ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural

² Gjinia e fermerit, aplikuesi do të merr piket e këtij kriteri nëse ferma (bletishta)ose biznesi (me aktivitetin " prodhim i mjaltës") është në pronësi të saj në dy vitet e fundit. Krijimi i Kushteve artificiale për të marrë pikë paraqet mashtrim dhe do të ndëshkohet sipas nenit 38A, nen-paragrafit, 1.2.3 të Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

³ Pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet.

Tabela 5: Kriteret e përzgjedhjes “Grumbullimi dhe përpunimi produkteve jo drusore të pyllit përfshirë bimët mjekësorë dhe aromatike

	Kategoritë		Pikët
1.	Përvoja e aplikuesit	Aplikuesi (ndërmarrja) ka përvojë 2 vite e më shumë (në grumbullimin, përpunimi të PJDP dhe BMA);	45
		Aplikuesi (ndërmarrja) ka përvojë më pak se 2 vite (në grumbullimin, përpunimi të PJDP dhe BMA);	40
2.	Vendi i investimit	Investimi në zona malore;	10
3.	Siguria e ushqimit	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit;	15
4.	Punësimi	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit / planit të biznesit;	10
5.	Mbrojtja e mjedisit ⁴	Investimet në energjinë e ripërtitshme;	10
6.	Aplikuesi i ri ⁵	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri;	5
7.	Prodhimtaria organike	I certifikuar për prodhim organik;	5
	GJITHSEJ		100

⁴ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtitshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtitshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtitshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

⁵ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

Tabela 6: Kriteret e përzgjedhjes për nën-masën “Përpunimin e prodhimeve bujqësore në ekonomin familjare”

		Kategoritë	Pikët
1.	Madhësia e fermës	> 1ha tokë bujqësore (toka në emër aplikuesit);	50
		≤ 1ha tokë bujqësore (toka në emër aplikuesit);	45
		3 e më shumë lopë qumështore ose 15 dele ose 15 dhi (në ekonominë familjare në emër të aplikuesit);	50
		Me pak se 3 lopë qumështore ose 15 dele ose 15 dhi (në ekonominë familjare në emër të aplikuesit);	45
2.	Siguria e ushqimit	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit;	15
3.	Mbrojtja e mjedisit ⁶	Investimet në energjinë e ripërtritshme;	15
4.	Punësimi	Krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të planit të biznesit/projekt propozimit;	5
5.	Vendi i investimit	Investimi në zona malore;	5
6.	Gjinia e fermerit	Aplikuesi Femër	5
7.	Aplikuesi i ri ⁷	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri ;	5
GJITHSEJ			100

⁶ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural

⁷ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

Tabela 7: Kriteret e përzgjedhjes për nën -masën “Aktivitete jo-bujqësore në zona rurale”

Kategoritë		Pikët	
1.	Aplikuesi i ri ⁸	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri;	45
		Aplikuesi është mbi 40 vjeç;	35
2.	Përvoja aplikantit	Aplikuesi ka së paku 2 vjet përvojë në aktivitetin për të cilën aplikon, (të jetë i regjistruar si biznes për veprimtarinë e caktuar);	15
3.	Vendi i investimit	Investimi është në zonë malore;	15
4.	Punësimi	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit / planit të biznesit ;	10
5.	Mbrojtja e mjedisit ⁹	Investimet në energjinë e ripërtitshme;	10
6.	Gjinia e fermerit	Aplikuesi Femer	5
GJITHSEJ			100

⁸ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

⁹ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtitshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtitshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtitshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural

Tabela 8: Kriteret e përzgjedhjes për nën-masën “Zhvillimin e turizmit rural /agro-turizmi”

	Kategoritë		Pikët
1.	Përvoja e aplikuesit	Aplikuesi (ka përvojë 2 vite e më shumë në ofrimin e shërbimeve të turizmit);	55
	a)Përvoja e aplikuesit në turizëm rural (për personat fizik, të dëshmohet me NIF) b)Për biznese të dëshmohet me aktivitetin përkatës të biznesit	Aplikuesi (ka përvojë më pak se 2 vite në ofrimin e shërbimeve të turizmit);	50
2.	Vendi i investimit	Investimi në zona malore;	10
3.	Aplikuesi i ri ¹⁰	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri;	5
4.	Gjinia e fermerit	a) Femra/person fizik së paku 2 vite pronare e fermës ku zhvillohet aktiviteti i turizmit rural(të dëshmohet me NIF); b)Femra /person fizik afarist apo juridik se paku 2 vite pronare e biznesit për turizëm rural;	5
5.	Mbrojtja e mjedisit ¹¹	Investimet në energjinë e ripërtitshme;	10
6.	Punësimi	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekte propozimit / planit të biznesit;	5
7.	Trashëgimia kulturore	Investimet në objekte të trashëgimisë kulturore;	5
8.	Përkrahja nga GLV –të	Investimet që janë në linjë me SZHL të GLV-së përkatëse;	5
	GJITHSEJ		100

¹⁰ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

¹¹ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtitshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtitshme dhe i fiton pikët për-këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtitshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural.

Tabela 9: Kriteret e përzgjedhjes për nën -masën "Kultivimi i peshkut"

	Kategoritë		Pikët
1.	Kapaciteti prodhues Për fillestar kapaciteti pas investimit. (në biznes plan)	≥ 3 t/vit - < 10 t/vit	45
		≥ 10 t/vit - < 30 t/vit	40
		≥ 30 t/vit	35
2.	Përvoja e aplikuesit në akuakulturë	Aplikuesi është i licencuar nga MBPZHR-ja;	20
		Aplikuesi ka marrë pagesa direkte për akuakulturë në vitin paraprak, por nuk është i licencuar;	15
		Aplikuesi është fillestar;	10
3.	Aplikuesi i ri ¹²	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri/re;	5
4.	Vendi i investimit	Investimi është në zone malore;	10
5.	Punësimi	Investimi përfshinë krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit / planit të biznesit;	10
6.	Mbrojtja e mjedisit ¹³	Investimet në energjinë e ripërtitshme.	10
	TOTAL		100

Tabela 10: Kriteret e përzgjedhjes për nën -masën "Rritja e shpezëve të fshatit"

	Kategoritë		Pikët
1.	Përvoja e aplikuesit para aplikimit	≥ 500 pula ose rosa (ose gjithsej me shumë se 500 krerë)	55
		≥ 200 pata ose biba (ose gjithsej me shumë se 200 krerë)	
		< 500 pula ose rosa (ose gjithsej me pak se 500 krerë)	50
		< 200 pata ose biba (ose gjithsej me pak se 200 krerë)	
2.	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	10
3.	Aplikuesi i ri ¹⁴	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri/re	15
4.	Vendi i investimit	Investimi është në zone malore;	20
	GJITHSEJ		100

¹² I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

¹³ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtitshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtitshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrolli, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad -hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtitshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të aplikohet neni 38A i Ligji Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural

¹⁴ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

Shenim : Për të gjitha masat dhe nenmasat në rastet kur aplikuesit kanë numer te njejetë të pikëve Përparësi kane projektet e dorezuara ma heret .

Sqarim për kritere të përzgjedhjes:

Kriteri “i moshës” në rastet kur aplikuesi është personi juridik, për dhënien e pikave për fermerë të rinj, do të merret në konsideratë mosha e pronarit të ndërmarrjes, kurse në rast kur personi juridik ka ma shumë pronarë, atëherë merret për bazë mosha mesatare e të gjithë bashkëpronarëve.

Kriteri: “Vendi i investimit” pikët për këtë kriter të përzgjedhjes i marrin ata aplikues të cilët e bëjnë investimin në Zona Malore,Lista e vendbanimeve (zonat kadastrale) në zonat malore (“lloji A”) dhe lloji B Në rastet kur aplikuesi pretendon se vendbanimi i tij është në lartësi mbidetare mbi 700 m, por nuk është në listën e zonave malore, ai e shkruan në planin e biznesit/projekt=propozim faktin se vendbanimi i tij sipas matjeve vetanake është mbi këtë lartësi. Me rastin e vlerësimit të projektit, ky pretendim pranohet nga zyrtari vlerësues, por ky fakt vërtetohet gjatë kontrollës së parë në terren nga zyrtari i AZHB-së.

6 AFATI I ZBATIMIT

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 90 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, përveç për nënmasën - Akuakultura/kultivimi i peshkut – në të cilën afati i zbatimit të projektit është 10 muaj (300 ditë) me mundësi vazhdimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pas periudhës prej 90 ditëve, respektivisht 300 ditë, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë.

AZHB-ja mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç është kushtet e papershtatshme klimatike, sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër.

7 RREGULLAT E SHPENZIMEVE TË PRANUESHME

Shpenzimet e pranueshme indikative për këtë masë:

Paratë e projektit mund të merren vetëm pasi përfituesi ka realizuar investimin dhe ka paguar faturat në përputhje me aplikacionin e tij dhe kontratën të cilën e ka nënshkruar me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (shih shtojcën nr. 6).

Shpenzimet janë të pranueshme vetëm nëse ato ndodhin pas nënshkrimit të kontratës mes përfituesit dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me përjashtim të shpenzimeve administrative për përgatitjen e projektit të cilat mund të ndodhin para nënshkrimit të kontratës, por ato u pranohen vetëm përfituesve të përzgjedhur.

Të gjitha mallrat e blera duhet të jenë pjesë e listës së shpenzimeve të

Shpenzimet e pranueshme duhet të përkufizohen në:

- Ndërtim/renovim/zgjerim të pronës së palujatshme (po jo edhe blerja e pronës);
- Blerja e makinave, pajisjeve sipas vlerës së tregut;
- Shpenzimet maksimale të pranueshme për promovim nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së

gjithëmbarshme të investimeve të pranueshme. Investimet për promovimin e produkteve të prodhuara dhe të përpunuara janë: materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në panairët lokale/kombëtare, etj;

8 PROMOVIMI I PËRKRAHJES

Të gjithë përfituesit duhet t'i respektojnë rregullat e promovimit të përcaktuara nga institucioni financues. Të gjithë përfituesit e granteve nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, para kërkesës për pagesën e fundit, në vendin e investimit, duhet të vendosin një tabelë siç është paraqitur në shtojcën nr. 16.

9 APLIKIMI

Aplikimi bëhet përmes web-modulit online në web-faqen e AZHB-se www.azhb-ks.net, në të cilën gjendet linku “aplikimi online” që dërgon në modulën e [aplikimit online PZHR](#). Në web-modul regjistrohet projekti si dhe ngarkohen (upload) në PDF dokumentet e nevojshme për aplikim.

Duhet të keni kujdes se në momentin kur përfundoni me nuk mund të ktheheni mbrapa dhe as të bashkangjiteni dokumente pasi përfundon procesi.

Pas përfundimit të procesit të aplikimit online, fillon shqyrtimi administrativ i aplikacioneve;

Shenim -Pas përylljes së procesit të aplikimit online fermeri është i obliguar që origjinalin e aplikimit (dosjen) ta ruaj për një afat kohor prej 3 viteve në mënyrë që ta ketë në dispozicion kur ti kërkohe nga zyrtarët e AZHB-së.

9.1 Thirrja për aplikim dhe afati i fundit

Thirrja për Aplikim bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe njoftimi publikohet në ueb-faqen e internetit të MBPZHR-së: <http://www.mbpzhr-ks.net/> dhe në ueb-faqen e internetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë [http://www.azhb-ks.net/dhe në mediat e shkrura dhe elektronike](http://www.azhb-ks.net/dhe_në_mediat_e_shkrura_dhe_elektronike)

10 PROCEDURA E PËRZGJEDHJES, VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKACIONEVE

10.1 Vlerësimi i projekt-propozimit/ plan biznesi

Plani i Biznesit ose Projekt-Propozimi janë pjesë e verifikueshmërisë së pranueshmërisë.

Shenim: Të dhëna të rreme/false do të çojnë në refuzimin e aplikacionit ose kthimin e çdo pagese të bërë për përfituesit! Çdo përpjekje për mashtrim, do të raportohet dhe do të trajtohet si mashtrim në dëm të fondeve publike!

Aplikacionet me vlerë të investimeve të pranueshme mbi 20,000 Euro duhet të përmbajnë një Plan të Biznesit - shtojca 5. Për nënmasën 7.2 Zhvillimin e turizmi rural dhe agro – turizmi - projekt propozim /plan i biznesit bëhet sipas modelit të paraqitur në shtojcën nr. 4. Aplikacionet me vlerë të investimeve të pranueshme deri 20,000 Euro duhet të përmbajnë një Projekt-Propozim sipas modelit të paraqitur shih në shtojcën nr. 3. Plani i Biznesit/Projekt-propozimi, si dhe modeli i tyre për nënmasën 7.2 janë pjesë të

verifikimit dhe kontrollit.

Të dhënat/informacioni i paraqitur në këto dokumente do të kontrollohen me të gjitha bazat e të dhënave të tjera ekzistuese (Regjistrin e Fermës, Regjistrin për Identifikimin e Kafshëve, sLPIS etj.), duhet të mbështetet nga dokumentet e kërkuara – Lista e dokumentave dhe t'i nënshtrohet kontrollit në vend para se të nënshkruhet kontrata, para pagesës së mjeteve financiare dhe pasi që projekti është përfunduar, gjatë periudhës së monitorimit x-post.

Plani i Biznesit/Projekt-Propozimi, Modelin për nënmasën 7.2 duhet të jete sipas modelit të përgatitur nga MBPZHR-ja.. Të gjithë kapitujt e tij duhet të trajtohen plotësisht, prandaj përjashtimi i një kapitulli do të çojë në refuzimin e aplikimit. Për më tepër, ekstra-kapitujt nuk do të merren parasysh gjatë vlerësimit të projektit. Kontrollat e mëposhtme janë pjesë e vlerësimit të plan bizneseve / projekte propozimeve të të gjitha nënmasave:

Të gjithë kapitujt dhe nënkaptujt duhet të plotësohen në mënyrë të detajuar, nëse ndonjë kapitull nuk është i aplikueshëm për projekt-propozimin, ajo duhet të shpjegoj;

1. Së paku 1 (një) objektiv specifik i kësaj mase duhet të plotësohet
2. Kthimi i investimeve dëshmon që fitimi shtesë (të hyrat shtesë – kosto shtesë) mbulon kostot e investimeve (të llogaritet vetëm bashkëfinancimi privat) për së paku 10 vjet
3. Vlerësimi se ka kapacitete të mjaftueshëm (njerëzore) për drejtimin e fermës/biznesit
4. Blerjet e propozuara të jenë në përputhje me nevojat e aplikuesit (Psh jo pajisje me kapacitet që nuk perputhet me nevoja te aplikuesit.)
5. Ndërtimet/renovimet të propozuara janë në përputhje me kapacitetet e aplikuesit.
6. Kostot e vlerësuara për blerjet/ndërtimet/renovimet të jenë të arsyeshme; Aplikuesi duhet të kontrolloj nëse shpenzimet e parashikuara të shpenzimeve të tij janë në përputhje me çmimet e tregut
7. Orari për blerjet/ndërtimet/renovimet duhet të jetë real dhe t'i jap mundësinë e investimit.
8. Rritja e prodhimit është paraqitur dhe është plotësisht në përputhje me shpenzimet e propozuara.
9. Pajisjet/teknologjia janë përshkruar.
10. Furnizuesit e mundshëm dhe klientët potencial janë identifikuar .
11. Strategjia e tregut .
12. Për të gjitha investimet e pranueshme dhe të papranueshme janë paraqitur saktë vlerat e ndihmës publike dhe financimeve private.
13. Bilanci i rrjedhës së parasë, në fund të çdo muaji, duhet të jetë pozitiv në 3 vite të ardhshme pas përfundimit të investimit.
14. Të hyrat totale në llogaritjen e Kthimit të Investimit janë në përputhje me te hyrat totale ne vitin e parë te prodhimit të paraqitur në indikatorët e ndikimit
15. Aplikuesi nuk ka krijuar kushte artificiale për të përfituar përparësi.
16. Parashtruesi i kërkesës nuk ka krijuar kushte artificiale për marrjen e një avantazhi që është kundër objektivave të masës.

Për Projekt Propozim janë të zbatueshme kontrollat nr: 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15 dhe 16.

10.2 Kontrollat në terren

Do të kryhen së paku 3 kontrolle në terren:

1. Kontrolli i Parë (kontrolli para miratimit),
2. Kontrolli i Dytë (kontrolli pas investimit e para pagesës),

Pas parashtrimit të Kërkesës për pagesë, Drejtorja e Kontrollit e AZHB-së është i obliguar të verifikojë zbatimin e investimeve me anë të kontrollit në teren. Ne kete rast përfituesi eshte i obliguar të jete i pranishëm gjate zhvillimit te kontolles në teren me se largu 5 dite nga njoftimi i AZHB-së.

3. Ex-post Kontrolli (Monitorimi) dhe Superkontrolli,

AZHB kryen Ex-post kontroll për verifikimin e të gjitha projekteve të përzgjedhura për financim tre (3) vjet, nga dita e ekzekutimit të pagesës së fundit. Ne kete rast përfituesi është i obliguar te jete i pranishëm gjate zhvillimit te kontolles ne teren me se largu 5 dite nga njoftimi i AZHB-së.

4. Rikontroli.

Kontroli i Parë (kontrolli para miratimit), realizohet pas procesit të vlerësimit dhe përfshinë:

- kontrollin e asetëve të deklaruar në Planin e Biznesit nga aplikues,
- verifikimin e parcelave katastrale,
- Verifikimin e numrit të kafshëve, shpezëve etj. dhe
- Verifikimin e pikave kyçe për të cilat është poentuar aplikacioni.

Çdo mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Kontrollit dhe do të ndikoj në procesin e Miratimit të aplikacionit.

Kontroli i Dytë (kontrolli pas investimit e para pagesës) realizohet pas kryerjes së investimeve sipas kontratës dhe paraqitjes së pakos së kërkesës për pagesë nga përfituesi dhe përfshinë:

- kontrollin e secilit pozicion investues sipas tabelës për investimet e parapara, Letrës së Informimit dhe kontratës së nënshkruar,
- verifikimin e cilësisë së investimit,
- Verifikimin e numrit të kafshëve, shpezëve etj. dhe
- Verifikimin e realizimit të standardeve minimale nacionale.

Ç' do mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Kontrollit të Dytë dhe do të ndikoj në procesin e Autorizimit të pagesave.

Ex-post Kontrolli (Monitorimi) është proces i monitorimit të projektit të bashkfinancuar nga MBPZHR-AZHB dhe përfituesit, sipas obligimeve të marrura me kontratë, për periudhën 3 vjeçare dhe përfshinë:

- Verifikimin e të gjitha pozicioneve investuese, dhe
- Verifikimin e funksionalitetit të projektit dhe mirmbajtja e investimeve.

Çdo mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Ex-post kontrollit dhe do t'i drejtohet zyrës ligjore për procedim të mëtutjeshëm.

Superkontrolli është kontroll i veçant që organizohet me vendim të zyrtarëve siprorë ka ka për qëllim:

- verifikimin e investimeve të kryera në terren,
- pengimin e manipulimeve dhe mashtrimit, dhe
- vlerësimin e punës së inspektoratit.

Rikontroli është kontroll që organizohet vetëm në raste të caktuara dhe me kërkesë të Drejtorive përkatëse (Drejtoria së Miratimit të Projekteve dhe Drejtoria së Autorizimit të Pagesave).

Kujdes: Kur ka kërkesë për kontroll, përfituesit janë të obliguar të lejojnë qasje të lirë dhe të menjëhershme në investimet e bëra, kjo vlenë po ashtu edhe nëse kërkohet ndonjë dokument shtesë nga Agjensioni për Zhvillimin e Bujqësisë. Nëse ndodh mos rrespektimi i këtij kushti duhet të bëhet kthimi i menjëhershëm i grantit dhe ndëshkimi i aplikuesit!

10.3 RADHITJA NË LISTË E APLIKUESVE

Të gjitha projektet që kanë kaluar kriteret e pranueshmërisë, pas vlerësimit, duhet të radhiten në listë në bazë

të pikëve të fituara dhe eventualisht kohës së aplikimit. Përzgjedhja e përfituesve bëhet duke filluar nga aplikuesi me numrin më të madh të pikëve dhe vazhdon deri sa të shpenzohet buxheti i paraparë. Procedurat e dhënies së grantit dhe njoftimi i aplikuesit.

Pas kontrolles administrative dhe vleresimit AZHB përgatitë Raportin preliminar. Projektet klasifikohen në këtë raport në: 1) projekte të pranueshme dhe të vlerësuara me pikë dhe 2) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë të refuzuara).

Raporti preliminar nënshkruhet nga kryeshefi i AZHB-së dhe publikohet në ueb faqe të Azhb-së dhe ueb faqe të MBPZHR-së.

11 ANKESAT

Prej ditës së publikimit në ueb faqe të AZHB/MBPZHR-së dhe pranimit të Raportit të Vlerësimit apo Vendimit për Refuzim, aplikuesi ka afat 30 ditë (kalendarike) të ushtrojë ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Komisioni i Ankesave merr vendim Brenda 30 ditësh perveq ne raaste të veqanta.

12 PROCEDURAT E IMPLEMENTIMIT

Të gjithë përfituesit do të nënshkruajnë një kontratë standarde „Jetëgjatësia e kontratës mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja Palët (Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe përfituesi) deri në përfundimin e periudhës monitoruese që është 3 vjet pas zbatimit të projektit

(Nëse brenda periudhës së paraparë me kontratë përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR, duhet të bëhet një kontrollë para nënshkrimit të kontratës së re me AZHB-në mënyrë që të bëhet verifikimi i projektit të mëparshëm a është funksional, kjo vjen si rrjedhojë e (Jetëgjatësia e kontratës mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja Palët (Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe përfituesi) deri në përfundimin e periudhës monitoruese që është 3 vjet pas zbatimit të projektit);

Periudha e përfundimit të projektit nënkupton përfundimin e investimit. Kontrata e mbulon edhe periudhën e monitorimit.

Aplikuesit nuk mund ti ipet një projekt i ri nëse ka qenë përfitues i vitit paraprak dhe nuk e ka përdunduar investimin.

Shenim: Në rast se përfituesi tërhiqet nga implementimi i projektit pas nënshkrimit të kontratës, ai e humb të drejtën për aplikim në vitin vijues.

Përfituesit që pas nënshkrimit të kontratës nuk e implementojnë projektin dhe nuk lajmërohen në AZHB për t'u tërhequr, humbin të drejtën e aplikimit për tri vitet e ardhme.

13 PAGESA E PROJEKTIT

Pagesa bëhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm në përputhje me intensitetin e ndihmës publike, duke plotësuar formularin e kërkeses për pagese ofruar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Përfituesi do të bashkëngjisë provat e kryerjes së procedurave të prokurimit në kërkesën për pagesë –

ashtu si kërkohen këto procedura dhe provat e pagesës (së bashku me faturat dhe provat e ekzekutimit të pagesave, p.sh. transferi bankar i cili është i miratuar/vulosur nga banka për pagesa me vlerë mbi 500 euro, ndërsa për ato nën 500 euro, faturat dhe kuponin fiskal).

Aprovimi i teresushem i pagesës do të ndodhë pas kontrollit të caktuar të dokumentit të paraqitur dhe pas kontrollit të dytë në terren të kryer nga zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. E tërë dosja e kërkesës për pagesë duhet të skanohet në CD dhe të dorëzohet bashkë me kërkesën për pagesë në AZHB.

Shenim: Në rast se përfitues janë personat juridik, biznesit llogaria në të cilën do të kryhet pagesa nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë duhet të jetë e personit juridik, biznesit dhe Jo në emër të pronarit. Gjithashtu, nëse përfituesi është femër, llogaria bankare duhet t'i përket asaj, e jo burrit të saj dhe anasjelltas.

14 MONITORIMI

Të gjitha projektet do të monitorohen 3 vjet pas implementimit të projektit dhe kontrollimi do të bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Qëllimi i investimit duhet të ruhet edhe 3 vjet pas investimit. Gjithashtu, përfituesi duhet të vazhdoj t'i respektoj të gjitha kushtet e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes për të cilat aplikuesit janë poentuar. Nëse ndodhë shkelja e këtyre rregullave, atëherë do të kthehet granti dhe përfituesi do të ndëshkohet sipas ligjit.

15 Shtojcat

Shtojca 1 Lista e dokumenteve të kërkuara -Masa 7

Nr	DOKUMENTI	Obligative	Opcionale
1.	Formulari për aplikim (krijohet gjate procesit te aplikimit)	<input type="checkbox"/>	
2.	Kopja e letërnjoftimit të republikes së kosovës valid të aplikuesit ose përfaqësuesit	<input type="checkbox"/>	
3.	Çertifikata ose ekstarkti i lindje	<input type="checkbox"/>	
4.	Formulari për indicator (perpilohet gjate procesit të aplikimit nga aplikuesi)Edhe formulari fizik plotesohet dhe I bashkangjitet aplikacionit.	<input type="checkbox"/>	
5.	Në rastin e personave juridik/biznes: Certifikata e numrit fiskal Certifikata e regjistrimit të biznesit	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
6.	Projekt-propozimi – Në rast të projekteve në vlerë deri 20,000 €; Plani i biznesit – Në rast të projekteve në vlerë mbi 20,000 €; Projekt-propozimi për masën 7.2 (Shih shtojca 4) Duhet të jetë sipas modelit të AZHB-së	<input type="checkbox"/>	
7.	Certifikata e regjistrimit në regjistrin e fermës (NIF) me aneks	<input type="checkbox"/>	
8.	-Dëshminë për përfundimin e shkollimit të detyrueshëm (8 ose 9 vjeçar) (në rast të personit juridik kjo vlen për pronarin / personin e autorizuar) të noterizuar.	<input type="checkbox"/>	

9.	Vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi është në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij, duhet të sjellë: certifikatën e martesës apo certifikatën e lindjes dhe / apo certifikatës së vdekjes dhe DEKLARATË NËN BETIM- Për të drejtën e shfrytëzimit të tokës së trashëguar Psh Nese toka eshte ne emer te gjyshit te aplikuesit per te deshmuar pronesin e tokes duhet te bashkangjiten certefikata e lindjes se aplikuesit , certifikata e lindjes /vdekjes se prindit dhe certefikata e lindjes /vdekjes se gjyshit <i>(ky dokument është obligativ tek prona e trashëguar, siç është përshkruar në paragrafin e më lartë)</i>		<input type="checkbox"/>
10.	Të gjithë aplikuesit duhet të dorëzojnë certifikatën e pronës/fletën poseduese dhe kopijen e planit (për vendin e investimit) si dhe te digjitalizojn vendin e investimit dhe nje kopje te ketij digjitalizimi tja bashkangjesin aplikacionit .	<input type="checkbox"/>	
8		Deklarata për besueshmërinë e tenderuesit (nga Shtojca 3)	Deklarata për besueshmërinë e tenderuesit (nga shtojca 3)
9		-	Deklarata për konfidencialitetin dhe neutralitetin (Shtojca 4)
10		Raporti për dhënien e tenderit	Raporti për dhënien e tenderit
11		Kontrata e nënshkruar me ofertuesin e përcaktuar fitues	Kontrata e nënshkruar me ofertuesin e përcaktuar fitues

Tabela e kostove sipas kërkesës për pagesë

Numri unik i regjistrimit (NUR) të kërkesës për pagesë:

№	Lloji e shpenzimeve	Sasia		Çmimi për njësi pa TVSH /Euro/	Çmimi për njësi me TVSH /Euro/	Shuma totale pa TVSH /Euro/	Shuma totale me TVSH /Euro/	Numri i faturës	Data e faturës	Përkatja e autorizuar /Eur
		Njësia matëse	Sasia							
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										
11										
12										
13										
14										
15										
	Shuma totale:									

Shënim: Hapësirat e hijezuara në tabelën e mësipërme duhet të plotësohen vetëm nga zyrtarët e

AZHB-së në tabelën e mësipërme duhet të plotësohen vetëm nga zyrtarët e AZHB-së

Shtojca 3 Raport i vlerësimit

-Aplikuesit i dërgohet raporti i vlerësimit

Shtojca 4 Forma e Ankesës

Ankesë

Emri Mbiemri _____ Fshati _____
_____ Komuna _____

Ankohem ndaj: _____ nr. _____ i dt. _____, si aplikues

Shkaqet e ankimit:

Bashkëngjit dokumentet që i contestoni

Projektet e Zhvillimit Rural: *Spektori:*

- 7.1 Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve jo drusore të pyllit përfshirë bimët mjeksore dhe aromatike
- 7.2 Zhvillimin e turizmi rural dhe agro – turizmi
- 7.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare
- 7.4 Prodhimi mjaltit
- 7.5 Aktivitetet jo-bujqësore në zona rurale
 - a) Përpunimi i leshit të deleve
 - b) Prodhimi i humusit
- 7.6 Rritja e shpezëve të fshatit
- 7.7 Kultivimi i peshkut

Shtojca 5 Lista me adresa të zyrave rajonale të bujqësisë

Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

MBPZHR /AZHBA Adresa RR: Ukshin Hoti 10000 Prishtinë (Kompleksi, Ramiz Sadiku'' Çdo ditë pune nga ora 10:00-12:00 – 13:00-15:00 Nga e hëna deri				
Nr.	Rajoni	Adresat	Telefoni	e-maili

1	Prishtina	Zona Industriale - Fushë Kosovë, përballë Maxi-Marketit,	038 601 169	
2	Mitrovica	“Mbretëresha Teutë” pa nr.	028 522 501	
3	Peja	Instituti Bujqësor “Fidanishtja” Pejë	039 431-276	
4	Gjakova	“Marin Barleti” nr. 2, kati III.	0390 320-992	
5	Prizreni	“Avni Rrustemi” 159	029 244-793	
6	Ferizaj	“Dëshmoret e Kombit” pa nr.	0290 324 661	
7	Gjilani	Rr: “Bulevardi i Pavarësisë” (Rr. e Ferizajt) (Soliteri kati I)	0280 326 106	

Shtojca 6 Logo-Promovimi

Kjo tabelë duhet të vendoset në vend të dukshëm, me madhësi: 100 cm x 50 cm, e punuar nga plastikë e fortë, e shkruar me ngjyrë të qëndrueshme ndaj ndikimeve atmosferike.



Shtojca 7 Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme

Mund ta gjeni në uebfaqen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit www.mkrs-ks.org
dhe në uebfaqen e Agjencisë për Zhvillim e Bujqësisë www.azhb-ks.net.

Shtojca 8 Deklarata nën Betim/Zotim



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i
Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture Development Agency*

DEKLARATË NËN BETIM/ZOTIM

Unë _____ më numër të personal _____
Adresa: _____, me përgjegjësi të plotë ligjore penale
deklaroj nën betim se më nënshkrimin time dhe bashkangjitjen e dokumenteve në aplikimin online
siguroj që të gjitha dokumentet, informatat dhe të dhëna që janë prezantuar në aplikim për Programin
e Zhvillimit Rural 2022 janë të qarta, të besueshme dhe të sakta dhe së për çdo paqartësi, josaktësi dhe
falsifikim do e mbajë përgjegjësi ligjore dhe penale.

Datë ____ . ____ .2022

Nënshkrimi i Deklaruesit

Shtojca 9 Deklarata nën betim



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i
Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
*Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture Development
Agency*

DEKLARATË NËN BETIM
Për të drejtën e shfrytëzimit të tokës së trashëguar

Unë _____ më numër personal _____

Adresa: _____, me përgjegjësi të plotë morale dhe penale nën betim deklaroj se personi emri i të cilit është në fletën poseduese të tokës, më të cilën aplikoj për Projektet e Zhvillimit Rural 2022 në AZHB-MBPZHR është: ____ (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, bashkëshortit etj.), këtë e dëshmoj përmes çertifikatës së _____, si shfrytëzues i ligjshëm i tokës dhe dëshmoj se toka me të cilën aplikoj dhe për të cilën jam trashigimtarë potencial, nuk shfrytëzohet nga trashigimtarë tjerë potencial.

Nënshkrimi i Deklaruesit

Data ____/____/____

Ky dokument është përgatitur nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në bashkëpunim me Autoritetin Menaxhues dhe shpërndahet falas.

**Masa 5: Përgatitja zbatimi i strategjive të zhvillimit
lokal – qasja LEADER**

Udhëzues për Aplikues

2022

1. Arsyeshmëria

LEADER është pjesë e politikës së zhvillimit rural të BE-së, që ndihmon në ngritjen e kapaciteteve dhe përvojës në zbatimin e politikave të BE -së të zhvillimit rural, gjithashtu kjo ndihmon vendet kandidate në përgatitjen për anëtarësimin në BE.

Qasja LEADER ka për qëllim zhvillimin e komunitetit, duke kontribuar në përmirsimet ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore të zonave lokale, duke angazhuar një numër të gjerë partnerësh privat dhe publik multi-sektorial gjithnjë duke marrë parasysh burimet e komunitetit në nivelin lokal.

Qëllimi kryesor i GLV-ve është që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të zonave rurale, duke i ofruar përkrahje komunitetit rural për përgatitjen dhe zbatimin e strategjive zhvillimore në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokal.

Në periudhën 2007-2009, me iniciativën e MBPZHR-së, janë themeluar 30 Grupe Lokale të Veprimit (GLV) - të cilat kanë mbuluar të gjithë zonën rurale të vendit në Kosovë. GLV-të në Kosovë kanë qenë të organizuar mbi bazën e komunave në këtë mënyrë secilës komunë i korrespondon një GLV. GLV-të kanë qenë të regjistruar si Organizata jo-Qeveritare (OJQ) në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Gjatë viteve (2010 -2013) GLV-të kanë zbatuar/ implementuar projekte të ndryshme për të mirën e komuniteteve të tyre me mbështetje financiare nga MBPZHR-ja, komunat dhe organizatat e tjera donatore. Në mënyrë që të lehtësohet promovimi, komunikimi dhe shpërndarja e informacionit midis GLV-ve dhe akterëve të tjerë rural është themeluar edhe Rrjeti i Zhvillimit Rural (RrZhR). RrZhR duke funksionuar si një platformë diskutimi.

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2014, është realizuar aktiviteti “Ndihmesa teknike për GLV-të e mundshme” në formë të thirrjes për prezantime të Strategjive Zhvillimore Lokale (SZhL). Janë paraqitur 12 GLV-të dhe RrZhR-ja të cilët kanë përgatitur Strategjitë e Zhvillimit Rural.

Komisioni përzgjedhës ka bërë vlerësim të thukët të 12 SZhL-ve të parashtruara. Vlerësimi është bërë në bazë të kriterëve të pranueshmërisë dhe të përzgjedhjes, të identifikuar paraprakisht.

12 GLV-ve dhe RrZhR-se së GLV-ve u janë aprovuar Strategjitë e Zhvillimit Rural, dhe këto 12 kanë qenë GLV të aprovuara.

Gjatë periudhës 2015 -2020 GLV-të e aprovuara janë mbështetur nga MBPZHR-ja me mjete financiare për kryerjen e aktiviteteve të tyre. Mirëpo shpesh me problem për shkak të mos kuptuarit të qasjes LEADER.

2. Përkufizimet kyçe

Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime:

- 1.1. “**MBPZHR**” - nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 1.2. “**Autoriteti Menaxhues**” - nënkupton entitetin publik brenda MBPZHR-së, përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e PZHR;
- 1.3. “**ARBK**”- nënkupton Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
- 1.4. “**AZHB**” - nënkupton Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në kuadër të MBPZHR, përgjegjës për zbatimin e PZHR;
- 1.5. “**PZHR 2022**” – nënkupton Programin për Zhvillimin Rural për vitin 2022;
- 1.6. “**Masa 5**” - nënkupton përgatitjen dhe zbatimin e strategjive zhvillimore lokale - Qasja LEADER;
- 1.7. “**Thirrja për aplikim**” - nënkupton njoftimin publik për pranimin e aplikimeve;
- 1.8. “**Aplikues**” - nënkupton personin fizik apo juridik, i cili aplikon për të përfutur projekt në PZHR 2022;
- 1.9. “**Aplikacioni**” - nënkupton formularin e plotësuar për aplikim me të gjitha dokumentet e kërkuara nga AZHB;
- 1.10. “**Projekt**” - nënkupton dokumentin që parasheh investimin e planifikuar për përkrahje nga PZHR 2022, të dorëzuar nga aplikuesi;
- 1.11. “**Përzgjedhja**” - nënkupton selektimin e projekteve, sipas pikëve të renditura;
- 1.12. “**Kriteret e përzgjedhjes**” - nënkupton kriteret që Autoriteti Menaxhues duhet t’i përcaktoj, për të siguruar prioritetet e financimit të projekteve më të mira që adresojnë nevojat e identifikuar në analizën SWOT dhe objektivat e përcaktuara në PZHR 2022;

- 1.13. **“Përfitues”** - nënkupton personin fizik apo juridik, i cili është përzgjedhur përfitues pas vlerësimit të aplikimit, nënshkrimit të kontratës dhe financimit të projektit nga MBPZHR;
- 1.14. **“Shkalla e përkrahjes publike”** - nënkupton kontributin nga buxheti publik për zbatimin e projektit;
- 1.15. **“Kontrata”** - nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të përfituesit dhe AZHB-së për zbatimin e projektit të përfituar;
- 1.16. **“Mashtrim”** - nënkupton çdo vepër e qëllimshme ose mospërfillje sipas përkufizimit të Ligjit Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, 16 tetor 2012);
- 1.17. **“Shpenzimet e pranueshme”** - nënkupton shpenzimet që përkrahen me mjete financiare;
- 1.22. **“Periudha e zbatimit të projektit”** - nënkupton periudhën për zbatimin e afatit të projektit të përcaktuar në udhëzim administrativ dhe kontratën e nënshkruar mes përfituesit dhe AZHB.
- 1.23. **“Kërkesa për pagesë”** - nënkupton parashtrimin e kërkesës për pagesë për shpenzimet e pranueshme, të dëshmuara me fatura valide për shpenzimet e realizimit të projektit;
- 1.24. **“Ex-post kontrolli”** - nënkupton periudhën kohore prej tre (3) vjetësh pas ekzekutimit të pagesës së fundit, gjatë të cilës përfituesi duhet ta ruajë qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave është përzgjedhur si përfitues;
- 1.25. **“NIF”** - nënkupton Numrin Identifikues të Fermës;

3. Objektiva e përgjithshme

Masa 5 Zbatimi Strategjive të zhvillimit lokal – Qasja LEADER si objektive kryesore ka përkrahjen e ngritjes së kapaciteteve të GLV-ve të përzgjedhura, anëtarëve të GLV-ve dhe banorëve rural, me qëllim të shtimit të shkathësisë të tyre në fushën e demokracisë dhe zhvillimit lokal.

4. Objektivat specifike

- Përmirësimi i kapitalit social dhe qeverisjes vendore duke krijuar një partneritet privato-publik (GLV -të Grupet Lokale të Veprimit), të cilët krijojnë dhe zbatojnë strategjitë e zhvillimit lokal;
- Animi i territorit dhe ngritja e kapaciteteve të popullatës lokale dhe Grupeve Lokale të Veprimit;
- Kontributi në ekonominë rurale, turizmin rural, forcimin e jetës kulturore dhe sociale të komunitetit, përmirësimin e zonave publike në zonat rurale, përmirësimin e standardeve mjedisore në zonat e GLV-ve si temat kryesore për strategjitë e zhvillimit lokal;
- Rrjetëzimi me GLV-të e tjera, shkëmbimi i praktikave më të mira, shpërndarja e programeve IPARD dhe mësimi i qasjeve të reja për zhvillimin rural në nivel kombëtar si me vendet kandidatë ashtu edhe me shtetet anëtare;
- Funkcionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura sipas qasjes LEADER;
- Ndërtimi i kapaciteteve të GLV-ve të përzgjedhura dhe RRZHR-së

5. Struktura e GLV-së

GLV -t zakonisht përbëhen nga: anëtarësia e tyre, organet vendimmarrëse dhe stafi profesional. Shkalla dhe natyra e kësaj ndryshon nga GLV në GLV dhe shpesh rregullohet nga shkalla e buxhetit të GLV-së.

6. Përfituesit

Do të jenë Grupet Lokale të Veprimit të zgjedhura dhe të kontraktuara nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë.

7. Grupet lokale të veprimit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme

- Grupi lokal i veprimit duhet të ketë një formë ligjore (p.sh. shoqatë);
- Duhet të propozoj një strategji të integruar të zhvillimit lokal bazuar në karakteristikat e LEADER-it siç përcaktohet në pikën 9.prej (a) deri (d);
- Duhet të demonstroj aftësinë për të përcaktuar dhe zbatuar një Strategji të Zhvillimit Lokal (SZHL) për zonën;

- Aftësia për të menaxhuar fondet publike: Organi qeverisës duhet të siguroj që GLV-të të zgjedhin një menaxher administrativ, financiar i cili do të jetë në gjendje të menaxhoj fondet publike dhe të siguroj funksionimin e kënaqshëm të partneritetit.

8. Forma ligjore dhe regjistrimi

Një GLV duhet të regjistrohet me një proces të regjistrimit ligjor në fillim të formimit të tij. Një shoqatë jofitimprurëse (OJQ) është një formë tipike ligjore për një GLV, e cila gjithashtu mundëson anëtarësim falas për këdo që jeton në territor.

9. Zbatimi i Qasjes LEADER

Kërkesat bazike që duhet të plotësoj një GLV për Qasjen LEADER duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

- Hartimi dhe zbatimi një strategjie të bazuar në ndërveprimin ndërmjet akterëve dhe projekteve të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë lokale;
 - Strategjia e zhvillimit lokal e bazuar në zonë mirë të definuar/përcaktuar;
 - Partneritetin Publiko-Private të Grupet Lokale të Veprimit;
 - Qasja nga poshtë lart për vendimmarrje për grupet lokale të veprimit në lidhje me zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal;
- Përmbajtja minimale e Strategjisë së Zhvillimit Lokal (SZHL)**
 - Përkufizimin e Zonës/territorit të GLV-së duhet të jetë koherente/kompakte dhe të ofroj masë/sasi të mjaftueshme të burimeve njerëzore, financiare dhe ekonomike për të mbështetur zbatimin e strategjisë së zhvillimit lokal.
 - Analiza e nevojave të zhvillimit dhe potencialit të zonës, duke përfshirë një analizë të pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT) - GLV-të duhet të marrin në konsideratë jo vetëm statistikën, por edhe pikëpamjet e akterëve /palëve lokal.
 - Përshkrimi i strategjisë dhe objektivave të saj GLV-të përcaktojnë vizionin dhe objektivat në përputhje me temat prioritare PZHR 2022-2028.
 - Përshkrimi i procesit të përfshirjes së komunitetit në përgatitjen e strategjisë, strukturën e partneritetit dhe rregullat e brendshme të vendimmarrjes.
 - Plani i veprimit/aktiviteteve të SZHL-së. Të gjitha veprimet/aktivitetet e propozuara duhet të jenë të lidhura me temat e zgjedhura me prioritetet. Plani i veprimit/aktiviteteve më vonë do të përkthehet në plane vjetore të hollësishme.
 - Plani financiar me një buxhet tregues/orientues për periudhën e kohëzgjatjes së SZHL-së i ndarë në: shpenzime operative ose të funksionimit të GLV-së, animacionin / ndërtimin e kapaciteteve dhe për projekte të vogla.
 - Kërkesat për GLV-të zonat që duhet të mbulojnë/përfshihen nga SZHL-të e tyre**
 - Zona e GLV-së duhet të jetë koherente dhe të siguroj masë kritike të mjaftueshme për sa i përket burimeve njerëzore, financiare dhe ekonomike për të mbështetur një strategji të zhvillimit të qëndrueshëm;
 - Popullsia e secilës zonë duhet, si rregull, të jetë jo më pak se 10,000 banorë dhe jo më shumë se 150,000 banorë, duke përfshirë vendbanimet me një popullsi më të vogël se 25,000 banorë;
 - I njëjti lokacion nuk duhet t'i përkas më shumë se një GLV-je, që do të thotë një partneritet, një strategji dhe një territor;
 - Partneritetin Publiko-Private të Grupet Lokale të Veprimit**
 - Në nivelin e vendimmarrjes, partnerët ekonomik dhe social, si dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile, të tilla si fermerë, gra rurale, të rinjë dhe shoqatat e tyre, duhet të përbëjnë më shumë se 50% të partneritetit. Për më tepër, minimumi 20% do të jenë përfaqësues të autoriteteve lokale. Sidoqoftë, autoritetet publike siç përcaktohet në përputhje me rregullat kombëtare, do të përfaqësojnë më pak se 50% të të drejtave të votimit;
 - 10% e pjesëmarrjes së grave dhe / ose të rinjve për të siguruar diversitetin e moshës dhe

barazinë gjinore

- Anëtarët e organeve vendimmarrëse të GLV-së duhet të jenë banorët resident ose vepronë në zonën e mbuluar nga Strategjia e Zhvillimit Lokal;
- GLV-ja duhet të propozoj një Strategji të Zhvillimit Lokal të integruar që përfshinë të paktën elemente minimale dhe tema prioritare siç specifikohet në Programin e Zhvillimit Rural.

d) Qasja nga poshtë lart për vendimmarrje për grupet lokale të veprimit në lidhje me zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal

- Qasja nga poshtë-lart është një element që e bën qasjen LEADER edhe më të dobishme.
- Ai synon të inkurajoj një proces të pjesëmarrjes lokale në çdo aspekt të politikave zhvillimore.
- Kërkohet përfshirja e akterëve vendor në të gjitha nivelet, qoftë përmes konsultimit ose duke i përfshirë në partneritet. Synohet që e gjithë komunitetin, të jenë promotorët të ideve dhe projekteve si : grupet e interesit ekonomik, social, institucionet përfaqësuese publike dhe private.
- Pjesëmarrja inkurajohet në çdo fazë: gjatë fazës së përcaktimit, gjatë zbatimit, gjatë vlerësimit dhe rishikimit të programit qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet atyre organeve që përfaqësojnë interesat kolektive.

10. Aftësi për të administruar fondet publike

GLV-ja duhet të tregoj në strategjinë e saj se si do të organizohet brenda dhe se ka kapacitete të mjaftueshme për të administruar fondet publike si dhe për rolin e strukturës.

Struktura e një GLV-je duhet të përbëhet nga:

- Antarësia
- Strukturat Qeverisëse
- Ansambleja e përgjithshme
- Bordi /ekzekutiv
- Nën - komitetet
- Menaxheri i GLV-s dhe
- Stafi tjetër
-

11. Aktiviteti i pranueshëm

- Përgatitja e Strategjive të Zhvillimit Lokal të GLV-ve

12. Lista e shpenzimeve të pranueshëm

- Punëtoritë dhe ngjarje informative për nxitjen e pjesëmarrjes aktive të popullsisë rurale në procesin e zhvillimit lokal;
- Shërbimet e ekspertëve;
- Përkthimi i dokumenteve dhe interpretimit;
- Qeraja e objekteve/sallës dhe pajisjeve;
- Furnizim me ushqim për pjesëmarrësit;
- Blerja e materialeve;
- Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit;
- Aktivitetet e nxitjes së interesimit, siç janë trajnimet, pjesëmarrja në seminare, punëtori dhe panairë, parapagimi për publikime dhe blerja e tyre, aktivitete të tjera të zgjimit të interesimit, etj.
- Publiciteti, publikimet, broshurat, fletëpalosjet etj
- Përgatitja /përpunimi dhe shpërndarja e materialeve informuese të nevojshme për përgatitjen, publicitetin e strategjive lokale të zhvillimit;
- Shpenzimet për publikimin e Strategjisë së Zhvillimit Lokal.

- Shpenzimet e mirëmbajtjes së xhirollogarisë së GLV-së, (dokumentohen me pasqyrën bankare vjetore të GLV-së.)

13. Përfituesi përfundimtar

- Përfituesit përfundimtar janë të gjitha GLV-të potenciale që e kalojnë kontrollën administrative

14. Shkalla e përkrahjes publike

Intensiteti i mbështetjes, i shprehur si pjesë e mbështetjes publike në shpenzime të pranueshme është 100% për përgatitjen e SZHL të GLV-ve.

GLV-të duhet të bëjnë kërkesën për paradhënie 80% dhe kërkesën për pagesë pas dorëzimit të SZHL-ve 20%.

15. Buxheti për përgatitjen e SZHL - për GLV

Masa 5	Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal - Qasja Leader"	Buxheti	%
	Numri i GLV -ve që aplikojnë *	20	
	Buxheti për një GLV	10,000.00	5
	Totali i buxhetit	200,000.00	100

Numri i GLV -ve që aplikojnë *

Numri i GLV-ve që aplikojnë për përgatitjen e SZHL-ve parashikim 20, nëse aplikojnë më shumë atëherë buxheti ndahet për numrin e GLV-ve që kanë aplikuar.

16. Administrimi i shpenzimeve të pranueshme

GLV potenciale të cilët e kalojnë kontrollën administrative, pas nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, 80% e të gjitha shpenzimeve të pranueshme i marrin si paradhënie.

Ndërsa, pas përfundimit të projektit, GLV-ja përfituese duhet të sjellë dëshmitë e nevojshme për të gjitha shpenzimet e kryera gjatë zbatimit të projektit si: faturat, formularin e ditëve të punës të menaxherit dhe të ekspertëve, CV-në e menaxherit, CV-në e ekspertit si dhe procedurën e përzgjedhjes së eksperteve, si për mjetet e marra në paradhënie, ashtu edhe për 20% të mjeteve të cilat paguhen pas përfundimit të projektit. Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti, GLV-ja përfituese obligohet të kthejë mjetet e marra.

Ndihma publike nga MBPZHR jepet në dy këste: 80% si paradhënie dhe 20 % pas përfundimit të projektit.

Njëkohsisht GLV-t potenciale përfitues të mjeteve financiare për përgatitjen e SZHL-ve duhet të e dorëzojnë në Autoritetin Menaxhues "Strategjit e Zhvillimit Lokal" së paku 3 (tri) kopje fizike dhe elektronike në CD.

17. Shtrirja gjeografike e masës

Qasja LEADER duhet të zbatohet në zonat rurale siç përcaktohet në strategji /program.

18. Afati i zbatimit

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 6 muaj prej momentit të nënshkrimit të kontratës me AZHB -në. Përfituesi/GLV -t kanë edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund të zgjas afatin e zbatimit për më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë.

19. Procedura e aplikimit

Thirrja për aplikim

Thirrja për Aplikim bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe njoftimi do të publikohet në faqen e internetit të MBPZHR: <http://www.mbpzhr-ks.net/> dhe në faqen e internetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë <http://azhb.rks-gov.net>.

20. Dorëzimi i aplikacionit dhe Afati i fundit

Aplikimi bëhet përmes web-modulit online në web-faqen e AZHB-së www.azhb-ks.net, në të cilën gjendet linku "aplikimi online" që dërgon në modulën e aplikimit online;

Në web-modul regjistrohet projekti si dhe ngarkohen (upload) dokumentet e nevojshme për aplikim; Aplikimi online duhet të ketë të ngarkuara të gjitha dokumentet e kërkuara brenda afatit për aplikim PDF;

Në aplikacionin online duhet të përfshihen aktivitetet dhe shpenzimet e pranueshme lidhur me projektin për të cilin aplikohet;

Aplikuesi mund të aplikoj vetëm një herë brenda programit për Zhvillim Rural 2022;

Aplikuesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri, nëse projekti i mëparshëm nuk është përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB-në;

Aplikuesi siguron që të gjitha informatat dhe dokumentet e dhëna janë të qarta dhe të sakta;

Aplikuesi pranon një njoftim online përmes e-mailit për dorëzimin e aplikacionit në të cilin përfshihet data.

Shënim: Pas përmbylljes së procesit të aplikimit online, fermeri/GLV potenciale është i obliguar që origjinalin e aplikimit (dosjen) t'a ruaj për një afat kohorë prej 3 viteve në mënyrë që ta ketë në dispozicion kur t'i kërkohet nga zyrtarët e AZHB-së.

21. Shqyrtimi i aplikacioneve

Pas përfundimit të procesit të aplikimit online fillon shqyrtimi administrativ i aplikacioneve;

- Procesi i vlerësimit të aplikacioneve;
- Shpallja publike e rezultateve preliminare të vlerësimit të projekteve;
- Njoftimi i fermerit /GLV -ve me rezultatin e vlerësimit të projektit;
- Periudha e ankimimit / E drejta e ankesës;
- Kontrolla e parë në terren;
- Miratimi / Refuzimi i projekteve;
- Periudha e ankimimit;
- Nënshkrimi i kontratës në mes të përfituesit dhe AZHB-së;
- Koha e kryerjes së investimeve;
- Dorëzimi i kërkesës për pagesë nga përfituesi bëhet në AZHB;
- Kontrolli administrativ i pakos së kërkesës për pagesë;
- Masat ndëshkimore në rast të parregullësive gjatë zbatimit të projekteve;
- Autorizimi dhe ekzekutimi i pagesës;
- Kontrolla pas zbatimit të projektit;
- Vendimi për kthimin e mjeteve financiare;
- E drejta e ankesës.

Procedimi administrativ përfundon brenda një periudhe prej 45 ditëve, pas përfundimit të procesit të aplikimit deri tek letra informuese/publikimi i rezultateve preliminare mbi përkrahjen, në pajtim me nenin 98 Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në rastet e kompleksitetit të çështjes administrative, afati mund të shtyhet bazuar në nenin 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

22. Procedura e përzgjedhjes

- Përzgjedhja e përfituesve të mundshëm bëhet sipas kriterëve të kontrollës administrative të të gjitha GLV-ve të përzgjedhura dhe RrZhr-së që i plotësojnë kushtet e pranueshmërisë dhe kontrollën administrative (dokumentet e kërkuara dhe projekt propozimin sipas formës së publikuar në udhëzues) të jenë përfitues potencial.
- Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë publikon thirrje dhe bënë përzgjedhjen e Grupeve Lokale të Veprimit bazuar në kontrollën administrative të pranueshmërisë.
- Kontrata nënshkruhet ndërmjet Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë dhe GLV-ve Potenciale;
- Ndërsa vlerësimin e SZHL-ve e bënë Komiteti Vlerësues i themeluar nga Autoriteti Menaxhues.

23. Refuzimin i projekteve

Aplikuesi refuzohet nëse:

- Ka dokumentacionin e pa kompletuar;
- Dështon t'i plotësojë kriteret e pranueshmërisë;
- Shpenzimet nuk mund të verifikohen si të pranueshme;
- Projekti nuk është i qëndrueshëm ekonomikisht;
- Në rast të mashtrimit në çdo fazë të procedurës;
- Aplikuesi njoftohet për projektin që është refuzuar me anë të vendimit për refuzim të nxjerrë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Vendimi për refuzim përmbanë arsyet e refuzimit në mënyrë të detajuar;
- Aplikacionet e papranueshme - deklarohen të papranueshme vetëm ata të cilët nuk i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret të kontrollës administrative të cilin e bëjnë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë.

24. Procedurat administrative

- GLV-të potenciale aplikojnë në PZHR 2022 në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë me projekt propozim apo plan- biznesi për mbulimin e kostove për përgatitjen e SHZL-ve.
- GLV-të potenciale të përzgjedhura nënshkruajnë kontratë me AZHB-në (kontrata përcakton të drejtat dhe obligimet e një GLV-je) në përputhje me rregullat e vendosura.
- AZHB-ja kontrollon GLV-të në lidhje me obligimet që dalin nga kontrata (kontrollin administrativ dhe kontrollin në vend).
- AZHB-ja ekzekuton pagesat për GLV-të në bazë të kërkesave të kontrolluara dhe të miratuara për pagesë.

Lista e shtojcave

Shtojca 1. Lista e dokumenteve të dorëzuara

Shtojca 2. Formulari për Aplikim

Shtojca 3 .Projekt propozimi për GLV-të e përzgjedhura dhe RrZhr të GLV-ve

Shtojca 4. Kërkesa për pagesë

Shtojca 5.Raporti i Vlerësimit

Shtojca 6. Lista e Shpenzimeve të Pranueshme

Shtojca 7 .Deklaratë nën betim/zotim se të dhënat janë të sakta

Shtojca 8. Kontaktet dhe vendet informuese për aplikim

Shtojca 9. Promovimi

Shtojca 1 Lista e dokumenteve të dorëzuara

Për GLV-të potenciale

Dokumentet e bashkangjitura /ju lutem shënoni më // (dhe rradhitni ato sipas listës së dhënë në fund të këtij aplikacioni	Obligative
Formulari për aplikim (Formulari i aplikimit krijohet vet nga sistemi pasi që aplikimi është online)	<input type="checkbox"/>
Aplikanti/GLV e potenciale duhet të paraqesë një projekt propozim) Shih Aneksi nr.3	<input type="checkbox"/>
Dëshminë se trupi menaxhues i GLV-së së përzgjedhur prezenton interesat e grupeve të ndryshme publike dhe private (lista e anëtarëve të trupit menaxhues)	<input type="checkbox"/>
Mbi 50% të anëtarëve duhet të jenë anëtarët që paraqesin partnerët ekonomik, sociale, shoqërinë civile, asociacione, shoqata të ndryshme që mbulojnë atë territor. (lista e anëtarëve dhe nga vijnë institucioni, organizata, kompania private etj)	<input type="checkbox"/>
Jo më pak se 20% të jenë anëtarë që vijnë nga institucionet publike (lista e anëtarëve)	<input type="checkbox"/>
Respektimi i diversitetit të moshës dhe barazia gjinore më së paku 10 % të anëtarëve të jenë femra dhe të rinjë. (lista e anëtarëve si dhe të paraqitet moshja e tyre, gjinia (data e lindjes)	<input type="checkbox"/>
Çertifikatën e regjistrimit të GLV-së së përzgjedhur në Regjistrin e OJQ-ve, në Ministrinë e Administratës Publike	<input type="checkbox"/>
Kopje e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar nga GLV-ja e përzgjedhur	<input type="checkbox"/>
Çertifikatën e numrit Fiskal të GLV-së së përzgjedhur dëshmia e kryerjes së obligimeve të antarësisë ndaj RrZhr-së	<input type="checkbox"/>

Deklarata nën Betim/Zotim se të dhënat e paraqitura janë të sakta	<input type="checkbox"/>
---	--------------------------

Shtojca 2 Formulari për Aplikim

(Formulari i aplikimit krijohet vet nga sistemi pasi që aplikimi është online)

Shtojca 3 Projekt propozimi për GLV-t e potenciale

A. Model për projekt propozim për GLV e potenciale

SHËNIM: Ky dokument duhet të respektohet në tërësi. Ky dokument nuk është për t'u plotësuar por është një model si të shkruhet projekt - propozimi.

1. Informata të përgjithshme

Grupi Lokal i Veprimit i Përzgjedhur, adresa, regjistrimi dhe të dhënat për kontakt të zyrës operative.

Përshkrim i shkurtër: Roli i Grupit Lokal të Veprimit

Bordi menaxhues dhe trupa udhëheqëse me nominim nga personi përgjegjës. Trupi menaxhues i GLV-së potenciale duhet të jetë i përbërë në atë mënyrë që të paraqes interesat e grupeve të ndryshme publike dhe private të popullatës në zona rurale.

Numri i anëtarëve më shumë se 50% duhet të jenë partnerërt që përfaqësojnë shoqërinë civile, partnerët ekonomik, shoqatat e ndryshme që veprojnë në atë territor.

Minimumi duhet të jenë 20% e anëtarëve nga institucionet publike (më pak se 50%).

Të respektohet diversiteti dhe barazia gjinore më së paku 10% të jenë femra dhe 10% duhet të jenë të rinjë të paraqitet në listë me data të lindjes.

Kapacitet e ekspertëve të angazhuar për çështje të caktuar njohur për çasjen LEADER, bujqësi, ekonomi, financa, analiza të tregut, analiza të socio ekonomike të teritorit, përgatitje të projekteve, kontabilist etj. Sipas nevojës së GLV-s së përzgjedhur dhe të aprovuar nga Bordi i GLV-s së përzgjedhur (proceduar e selektimit të jenë transparente) të paraqitet së paku 3 CV të ekspertëve)

Aktivitetet e deritashme të realizuara dhe planet.

Aktivitetet e planifikuara që do t'i realizon gjatë periudhës së zbatimit të projektit Përshkrimi i projektit – ju lutem përdore tabelën e mëposhtme:

Tabela 1 – numrimi i aktiviteteve të propozuara për

Aktivitete	Sasia/numri	Shpenzimet/ totale të përlllogaritura
Organizmit të takimeve me palë me interes	xxxxxx	...euro
Organizimi seminareve nivele lokale	xxxxxx	...euro
Vizitat në terren	xxxxxx	...euro
Eksperti 1	ditë/pune	...euro
Eksperti 2	ditë/pune	...euro

Transporti (bileta/karburante) bazuar në Regjistrin e udhëtimit me veturë);	Detajet duhet të regjistrohen në libra të veçantaeuro
Publikimet e ndryshme (broshura, fleteplosje)	euro
Aktivitetet e tjera	euro

Përshkrimi i aktiviteteve të propozuara, shembull:

Në rast të angazhimit të ekspertëve:

- Numri optimal për ditë pune për të gjithë ekspertët 30 ditë. (nuk mund të tejkalohet)
- Shuma maksimale e pagesës ditore për ekspert 100 euro/ditë. (pagesa për ditë nuk guxon me qenë më shumë se 100 euro/ditë)
- Në rastin e kontraktimit të ekspertit, CV-ja e ekspertit dhe konfirmimi për përvojën duhet të dorëzohen në momentin e kërkesës për pagesë tek Agjencia për Zhvillimin Rural (procedurat e selektimit të jenë transparente) te paraqitetse paku 3 CV te ekspertve)

Në rastin e propozimit për aktivitetin:

Organizmit të takimeve me palë me interes: Numri përafërsisht i pjesëmarrësve; duhet të bëhet përshkrimi përshkrimi i hapësirës (sallës) për takim (p.sh. sipërfaqja minimale m²); logjistika që duhet të sigurohet (mikrofonat dhe zërimi, video-projektori dhe laptopa, flip-chart, etj), agjenda e ditës, për materialet e shtypura ne letër etj. Këto duhet të paraqiten si vlerësim në këtë projekt propozim, ndërsa;

Të gjithë pjesëmarrësit të takimit duhet të dokumentohen me listën e pjesëmarrësve, si dhe agjenda e takimit, të cilat do të duhet të dorëzohen në kohën e kërkesës për pagesë të shumës së mbetur.

Në rastin e propozimit për aktivitetin:

Organizimi i seminareve në nivele lokale: Numri përafërsisht i pjesëmarrësve; duhet të bëhet përshkrimi përshkrimi i hapësirës (sallës) për takim (p.sh sipërfaqja minimale m²); logjistika që duhet të sigurohet (mikrofonat dhe zërimi, video-projektori dhe laptopa, flip-chart, etj), agjenda e ditës, për materialet e shtypura ne letër etj. Këto duhet të paraqiten vlerësim në këtë projekt propozim, ndërsa Të gjithë pjesëmarrësit të takimit duhet të dokumentohen me listën e pjesëmarrësve, dhe agjendën, të cilat do të duhet të dorëzohen në kohën e kërkesës për pagesë të shumës së mbetur (20%).

Në rastin e propozimit për aktivitetin: Vizita në terren të bëhet një vlerësim se sa vizita në terren do të mund të realizohen.

Të gjitha vizitat në terren të duhen dokumentohen me një raport të shkurt të vizitës në terren (qëllimin e vizitës, më kë jeni takuar dhe rezultatet e takimit). Të gjitha këto duhet të dorëzohen në kohën e kërkesës për pagesë për shumë të shumës së mbetur (20%). Lista e pjesëmarrësve

Transporti (bileta/karburante) bazuar në regjistrin e udhëtimit me veturë; (për km sa paguhet 25 cent)

Shpenzimet e paparashikuara

Për të gjitha këto duhet të bëhet një vlerësim për shpenzimet e mundshme.

Ndërsa në fund të aktivitetit/projektit duhet të dokumentohen këto shpenzime me fatura dhe ditët e punës së menaxherit. Të gjitha këto duhet të dorëzohen në kohën e kërkesës për pagesë për shumën e shumës së mbetur (20%).

- Të përgatitet një orar indikativ për realizimin e përgatitjes së SZHL

P.sh nëse afati i zbatimit është 6 muaj një orar indikativ të aktiviteteve duhet të përshinë aktivitetet siç janë punëtoritë (numri i punëtorive, numri takimeve me pale të ndryshme dhe një orar indikativ për përgatitjen e draftit të pare të SZHL/ diskutimin e tij si dhe finalizimin.

Zgjedhjen e ekspertit/ve për përgatitjen e SZHL, të gjitha procedurat e nevojshme për zgjedhjen. (p.sh konkursi)

Aktiviteti	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5	Muaji 6
Përzgjedhja e ekspertit për përgatitjen e SZHL						
Organizmi punëtorive						
Organizimi i takimeve me grupe të veçanta punuese/focus grupe						
Përgatitja e draftit të pare të SZHL						
Kampanja informuese për SZHL						
etj						

Lista e rezultateve të pritura dhe indikatorët e pritur.

Të gjitha aktivitetet të dokumentohen me fotografi dhe lista të pjesëmarrësve



Shtojca 4 Kërkesa për pagesë
 Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural /Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development
 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture Development

XI. Deklaratat

Me nënshkrimin e kësaj kërkesë për pagesë

Unë deklaroj se:

- 1) Të gjitha të dhënat, dhe dokumentet të cilat unë i kam paraqitur me këtë kërkesë për pagesë janë të vërteta.
- 2) Investimet e përfshira në kërkesën për pagesë janë kryer me të vërtetë.
- 3) Shpenzimet për të cilat kërkoj të paguhem janë të pasqyruara në Tabelën e Kostove të kësaj kërkesë
- 4) GLV-ja nuk ka marrë përkrahje tjetër financiare publike për të njëjtat investime.
- 5) GLV-ja nuk ka borxhe të prapambetura në institucionet publike.
- 6) GLV-ja është dakord që Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ta publikojë këtë informacion për projektin tim – emrin e përfituesit, vendndodhjen e investimeve, shumën e përkrahjes dhe shumën totale të kostove
- 7) Të gjitha faturat janë të paguar dhe çmimet nuk janë të fryera
- 8) Jam i vetëdihëm se paraqitja e të dhënave të pavërteta ndëshkohet me ligjet e vendit

XII. Data / Nënshkrimi

Dita — muaji— viti

...../...../.....

...../.....

...

(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

(Vula për subjektet juridike)

Shënim: Përfituesi plotëson vetëm hapësirat me ngjyrë të bardhë

№	Lloji i shpenzimeve	Sasia		Çmimi për njësi pa TVSH /Euro/	Çmimi për njësi me TVSH /Euro/	Shuma totale pa TVSH /Euro/	Shuma totale me TVSH /Euro/	Numri i faturës	Data e faturës	Përkrahja e autorizuar /Euro/
		Njësia matëse	Sasia							
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										
11										
12										
13										
14										
15										
Shuma totale:										

Shënim: hapësirat e hijezuara në tabelën e mësipërme duhet të plotësohen vetëm nga zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë

Shtojca 5 Raporti i Miratimit

Në rast të kontestimit të rezultateve, ju keni afat prej 30 ditë nga dita e pranimit të letrës miratuese të projektit të ushtroni Ankesë. Komisioni bënë vlerësimin e ankesave dhe brenda 30 ditë duhet të kthejë përgjigje vetëm në raste specifike afati mund të zgjase me shumë.

Shtojca 6 Lista e Shpenzimeve të Pranueshme

Masa 5 "PËRGATITJA ZBATIMI I STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT LOKAL - QASJA LEADER"

- Shërbimet e ekspertëve me CV të verifikuar (ekspertët e zhvillimit ekonomik, rural dhe regjional, mjedisit, marketingut);
- Shpenzimet e studimit për zonën (p.sh studime socio-ekonomike, regjionale, të marketingut etj).
- Shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë;
- Shpenzimet e udhëtimit brenda Kosovës, duke përfshirë akomodimin dhe mëditjet;
- Shpenzimet e aktiviteteve të nxitjes, animimit të interesimit të popullatës nga zonat rurale (p.sh trajnimet, pjesëmarrja në seminare, punëtori dhe panaire, parapagimi për publikime dhe blerja e tyre, aktivitete të tjera të zgjimit të interesimit etj);
- Shpenzimet e punëtorive dhe ngjarjet informative për nxitjen animimin e pjesëmarrjes aktive të popullatës rurale në procesin e zhvillimit lokal;
- Shpenzimet për marrje me qira të objekteve dhe paisjeve për organizime të ndryshme, si dhe shërbimet hoteliere (ofrimi i ushqimit dhe pijet);
- Shpenzimet për përgatitje dhe publikimin e materialeve/publikimeve promovuese (fletëpalosje të ndryshme, promovime etj).
- Shpenzimet e transportit;
- Shpenzimet e paparishikuara;
 - Punëtorit dhe ngjarje informative për nxitjen e pjesëmarrjes aktive të popullsisë rurale në procesin e zhvillimit lokal;
 - Shërbimet e ekspertëve;
 - Përkthimi i dokumenteve dhe interpretimit;
 - Qeraja e objekteve/sallës dhe pajisjeve;
 - Furnizim me ushqim për pjesëmarrësit;
 - Blerja e materialeve;
 - Shpenzimet e udhëtimit;
 - Aktivitetet e nxitjes së interesimit, siç janë trajnimet, pjesëmarrja në seminare, punëtori dhe panaire, parapagimi për publikime dhe blerja e tyre, aktivitete të tjera të zgjimit të interesimit, etj.
 - Publiciteti, publikimet, broshurat, fletëpalosjet etj
 - Përgatitja /përpunimi dhe shpërndarja e materialeve informuese të nevojshme për përgatitjen, publicitetin e strategjive lokale të zhvillimit;
 - Shpenzimet për publikimin e Strategjisë së Zhvillimit Lokal.
 - Shpenzimet e mirëmbajtjes së xhirollogarisë së GLV-së, (dokumentohen me pasqyrën bankare vjetore të GLV-së.)

Shtojca 7 Deklaratë nën Betim / Zotim



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i
Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture Development Agency*

DEKLARATË NËN BETIM / ZOTIM

Unë _____ me numër personal _____

Adresa: _____, me përgjegjësi të plotë ligjore penale deklaroj nën betim se me nënshkrimin tim dhe bashkangjitjen e dokumenteve në aplikimin online siguroj që të gjitha dokumentet, informatat dhe të dhënat që janë prezantuar në aplikim për Programin e ZHR 2022 janë të qarta, të besueshme dhe të sakta dhe se për çdo paqartësi, josaktësi dhe falsifikim do mbajë përgjegjësi ligjore dhe penale.

Datë ____ . ____ .2022

Nënshkrimi i Deklaruesit

Shtojca 8 Kontaktet dhe vendet informuese për aplikim

Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

AZHB /MBPZHR

Adresa: Rr. "Ukshin Hoti" 10,000 Prishtinë (Kompleksi Ramiz Sadiku) kati I IX Nga e hëna deri të premten nga ora 10:00-12:00 dhe 13:00 - 15:00 tel. 03820038-871 ose 03820038-421

Shtojca 9. Promovimi

Të gjithë përfituesit duhet t'i respektojnë rregullat e promovimit të përcaktuara nga institucioni financues. Të gjithë përfituesit e granteve nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, para kërkesës për pagesën e fundit, në vendin e investimit, duhet të vendosin një tabelë siç është paraqitur në Shtojcën nr. 15. Kjo tabelë duhet të vendoset në vend të dukshëm, me madhësi: 100 cm x 50 cm, e punuar nga plastikë e fortë, e shkruar me ngjyrë të qëndrueshme ndaj ndikimeve atmosferike.



Ky dokument është përgatitur nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në bashkëpunim me Autoritetin Menaxhues dhe shpërndahehet falas.